



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT
PROGRAMI I DOKTORATURËS "SHKENCA EKONOMIKE"

Dizertacion

Në kërkim të gradës `Doktor Shkencash`

**MODELIM PËR RENDITJEN DHE NORMIMIN E
SIGURISË FINANCIARE TË BANKAVE NË VENDET NË
ZHVILLIM – APLIKIM NË MJEDISIN BANKAR TË
SHQIPËRISË.**

Udhëheqës Shkencor:

Prof. Dr. Shkëlqim CANI

Doktoranti:

MSc. Ada ALIAJ

Durrës, 2014

© Copyright

i

Ada Aliaj

2014

**Udhëheqësi i Ada Aliaj vërteton se ky është version i miratuar i disertacionit të
mëposhtëm:**

**MODELIM PËR RENDITJEN DHE NORMIMIN E SIGURISË
FINANCIARE TË BANKAVE NË VENDET NË ZHVILLIM –
APLIKIM NË MJEDISIN BANKAR TË SHQIPËRISË.**

Prof.Dr.Shkëlqim CANI

**MODELIM PËR RENDITJEN DHE NORMIMIN E SIGURISË
FINANCIARE TË BANKAVE NË VENDET NË ZHVILLIM –
APLIKIM NË MJEDISIN BANKAR TË SHQIPËRISË.**

Përgatitur nga Ada ALIAJ MSc

Disertacion i paraqitur në
Fakultetin e Biznesit
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
Në përputhje të plotë
me kërkesat
për Gradën “Doktor”

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Shtator, 2014

Dedikim!

Familjes dhe miqve të mi

Falenderime dhe Mirënjohje!

Mirënjohje dhe falenderim pa fund prindërve, bashkëshortit, familjes time të shtrenjtë, për sakrificat, dashurinë e pakushtëzuar e gjithçka.

Respekt dhe falenderim udhëheqësit Prof.Dr. Shkëlqim Cani për kohën, mendimet, dhe mbështetjen e pakursyer.

Falenderim të veçantë për kolegët, bashkëpunëtorët dhe miqtë që më dhanë shtysë, këshilla dhe mbështetje në kryerjen e këtij punimi.

Po ashtu një mirënjohje e veçantë shkon për Prof.As.Dr. Ilir Hoti, Dekan në Fakultetin e Biznesit UAMD, për bashkëpunimin dhe kritikën konstruktive.

Një falenderim i posaçëm shkon për Prof. Dr. Myslym Osmani, i cili me profesionalizëm dhe dashamirësi më ndihmoi për realizimin e këtij punimi.

Falenderoj gjithashtu kolegë e bashkëpunëtorë, mike shumë të mira të cilat kanë kontribuar në rrahje mendimesh në çështje të veçanta të punimit si: Jonada Mamo, Ikbale Tota, Ina Shehu, Rovenat Troplini, anëtare të departamentit të Financë-Kontabilitetit UAMD, Olta Nexhipi anëtare e departamentit të Menaxhimit UAMD, Brunilda Licaj anëtare e departamentit të Turizmit UAMD.

Deklaratë mbi origjinalitetin

Ada ALIAJ

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të shkruara nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat, tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë edhe internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tilla.

Jam e vetëdijshme se në rast të mospërputhjeve, Këshilli i Profesorëve të UAMD-së është i ngarkuar të më revokojë gradën “Doktor”, që më është dhënë mbi bazën e kësaj teze, në përputhje me “Rregulloren e programeve të studimit të ciklit të tretë (Doktoratë) të UAMD-së, neni 33, miratuar prej Senatit Akademik të UAMD-së me Vendimin nr. , datë _____

Durrës, më _____

Firma

PËRMBLEDHJE

Çdo ditë përjetojmë se bankat janë të ekspozuara me shkallë të lartë dëndurie si ndaj rreziqeve specifike [të kontrollueshme nga drejtimi/amvisimi i tyre] edhe ndaj rreziqeve themelore që u imponohen nga krizat dhe nga një kombinim sjelljesh të strukturave qeveritare, autoriteteve mbikqyrëse dhe kompetencës ligjore. Sa thënë më sipër qëllimi kryesor i punimit është ndërtimi i një modeli normimi për bankat që operojnë në tregun Shqiptar si një treg me karakteristika të ekonomive emergjente. Nën presionin e krizës financiare globale, normimit të bankave në tregjet emergjente iu kushtua një rëndësi e veçantë. Kompanitë më të mëdha normuese janë përpjekur të ndërtojnë metodologji të qendrueshme normimi, por normimet që ato i kanë bërë institucioneve financiare që operojnë në tregjet emergjente nuk dëshmojnë për metodologji të qendrueshme. Kriza nxorri në pah rreziqe të nënvlerësuara më parë dhe nënvizoi rolin dhe funksionin e autoriteteve mbikqyrëse për sistemet e paralajmërimit të hershëm. Autorë të ndryshëm janë të mendimit që normimi i bankave mbetet një çështje e hapur dhe e mbyllur njëkohësisht, e cila po drejton të gjitha autoritetet monetare drejt ndryshimit të rregulloreve të bankave dhe kuadrit mbështetës. Në përgjigje të kësaj akademikët dhe ekspertët në studimet e tyre për metodologjinë e normimit të bankave janë në kërkim të domosdoshmërisë, rëndësisë dhe dobisë që ka për vendimmarrje të palëve ekzistuese që implikojnë marrëdhëniet me bankat dhe konkretisht të aksionarëve, të depozituesve, të financuesve, të huamarrësve, të vetë drejtimit të bankës, të tregjeve dhe publikut. Normimi bëhet edhe më i dobishëm për vendet në zhvillim sepse bankat operojnë nën opacitet të rritur dhe mund të priren për stimuj me përmbajtje toksike rreziku për rezultate të pafavorshme dhe me shanse më të larta dështimi. Për të realizuar normimin janë përdorur 3 modele të ndryshme. Jemi bazuar në përpunime statistikore dhe në modelim ekonometrik. Mungesa e përvojave të mëparshme nga kompani apo akademikë na bëri të aplikojmë modele alternative për të parë nëse do të na sillnin të njëjtat rezultate. Jemi fokusuar në treguesin më rezultativ dhe që nga ana kontabël është më pak i manipulueshëm dhe më shumë diskriminues për cilësinë e aktiveve të bankave sikurse është treguesi i kredive jo të mbara (*non performing loans* -NPL). Modelet na vërtetojnë se mbarëvajtjen financiare të bankave krahasimisht me njëra-tjetrën mund ta masim me normën e NPL-së duke qenë se kjo është përfaqësuesja e të 4 grupeve raporteve bazë (përfitueshmëri, likuiditet, mjaftueshmëri kapitale, efikasitet) që përdoren për të normuar bankat. Më tej për të vlerësuar qendrueshmërinë financiare të bankave krahasimisht me njëra-tjetrën, kemi vendosur të përdorim *metodën me mesatare shumëpërmasore*. Kemi renditur bankat duke përdorur dy metoda, modelim ekonometrik dhe përpunim statistikor të të dhënave. Komponentët kryesor të modelit (modelimi ekonometrik dhe mesatarja shumëpërmasore) janë të domosdoshëm por nuk e ezaurojnë normimin në versionin përfundimtar të tij. Racionalja në normim vazhdon me faktin se sa mbështetje financiare nga qeveria mund të marrë banka dhe për të përcaktuar pozicionin e tyre përfundimtar jemi bazuar në fuqinë financiare të secilës prej tyre duke marrë në konsideratë edhe disa tregues të tjerë si qendrueshmëria e fitimeve, indeksin `Herfindahl-Hirschman`, analizën e kompozimit të aktiveve dhe indeksin `Z`. Pas analizës së të gjithë faktorëve të mësipërm bëjmë vlerësimin përfundimtar të shëndetit financiar të bankave të marra në shqyrtim. Në kushtet e mungesës së këtij produkti në tregun Shqiptar, ky punim kontribuon në literaturë duke ofruar 2 modele alternative normimi në funksion të tregut Shqiptar. Për më tepër informon të gjithë palët e interesuara për shëndetin financiar të bankave.

Fjalët kyçe: Normimi, NPL, Tregues financiarë, Indeksi Herfindahl-Hirschman, Indeksi Z.

SUMMARY

Nowadays the banks are by elevated frequency exposed to specific risks [diversifiable and controllable by their management] and to fundamental risks [non diversifiable and imposed by force majeure of crises of governmental, supervisory and regulators behavioral volatility]. To this extent the key rationale of this paper is to design a rating model for banks operating in the context and distinguishing features of emerging economies where the Albanian market prospect situates. In the repress of the global financial crisis in emerging economies, the bank rating becomes of the prime assignment. The exploratory efforts for sustainable rating methodology of the major rating agencies have come under increased scrutiny. The ratings they assigned to financial institutions in emerging markets is not achieving the far-reaching outcomes. The crisis highlighted risks that had been underestimated, brought into greater relief the value of supervisory function for early warning systems. Several authors agrees that bank rating remains an open end debate, which is leading the monetary authorities to commit to an overhaul of banks' regulatory and support frameworks. In response, academicians and experts are recently allocating significant research to bank rating methodology, seeking comment from involved parties like investors, depositors, financiers, the bank's management, and the public. To sum up bank ratings are widely used for both regulatory and investment purposes.

The bank rating becomes even more beneficial to developing countries since the banks conduct their business under the risk information asymmetry with high propensity for the increase of cloudiness content in financial information which tend to conceal the toxic assets for adverse outcomes and higher chances of failure. There are designed and proposed three diverse models for bank rating. The models algorithm is to reach bank ranking as a launching point on the way to conclude with bank rating paradigm. The work interrelates the design, use and testing the statistical and econometric modeling closing by submitting an application. Notwithstanding the shortages of preceding attempts for definite bank rating model for developing countries, from companies or academicians, we have scrutinized their pioneering precious work by escalating to portray alternative models and investigate the convergence of expected results with the concurring ones from the rating agencies.

In this thesis we propose and consider the *Non Performing Loans Portfolio* as the dependent variable and as the utmost dominant indicator which is the most genuine or with the lowest chance to be altered or crooked. NPL is the most discriminative and with the strongest content to fairly represent the quality of bank assets.

The models provide evidence that comparative performance of banks can be measured, assessed and represented most objectively and accurately by the rate of NPL. This is because NPL comprises all descriptive factors and performing determinants of the four classes of financial ratios the supervisors use persistently: the profitability ratio, the liquidity ratio, the capital adequacy ratio, and the efficiency ratio. Additionally for higher assurance we alternatively reassess the financial firmness of banks distinctively to each other, by using the multidimensional weighted-average method. Both the econometric model and the multidimensional weighted-average method, which we have structured and applied, are not exhaustive because of inherent discrepancies and potential presence of type I and type II errors. So far to insert the effect of potential financial support from Government and/or from an Institutional Investor the model expands to auxiliary inquiries on profitability sustainability, 'Herfindahl-Hirschman' analysis, and 'Z' index rectification. Thereafter a definite outcome on ranking and rating escalation emerges as conclusive classification of banks to be glanced by potential and factual interested parties.

Key Terms: *Rating, NPL, Financial indicators, Herfindahl-Hirschman Index, Z Index.*

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Kapitulli 1 Hyrje	1
Kapitulli 2 Vështrimi kërkimor dhe literatura	9
2.1 Historiku i Normimit	9
2.2 Kritika ndaj Kompanive të Normimit.....	12
2.3 Faktorët, Variablat Përcaktues të Modeleve të Normimit	14
2.3.1 Normimet e Kredisë Bankare si Bazë për Normimin e Bankave	16
2.4 Roli i Mbështetjes/Ndihmës Qeveritare në Normimin e Bankave	21
2.5 Modelet Normuese të Kompanive më të mëdha të Normimit	23
2.5.1 Diferencat në Normim	31
2.6 Aspekte të ardhme të Normimit Bankar	32
Kapitulli 3 Metodologjia e Ndjekur dhe Instrumentat e Përdorur.....	35
3.1 Metodologjia Studimore	37
3.2 Bllok Skema e Kërkimit	39
3.2.1 Metodologjia e Moody`s	39
3.2.1.1 Cilësia e Zotërimeve/Aktiveve (Moody`s).....	43
3.2.1.2 Kapitalizimi	44
3.2.1.3 Likuiditeti dhe Financimi	46
3.2.1.4 Fitimshmëria.....	47
3.2.2 Metodologjia e Standard & Poor`s në Normimin e Bankave.....	48
3.2.2.1 Metodologjia: Vendosja e ICR dhe SACP	51
3.2.2.2 Pikëvendosja e Ankorimit SACP: Kombinimi i Rrezikut Ekonomik me Rrezikun e Industrisë	52
3.2.2.3 Pozicioni i Biznesit.....	54
3.2.2.4 Pozicioni i Rrezikut	60
3.2.2.5 Financimi dhe Likuiditeti	63
3.2.3 Metodologjia e Fitch në Normimin e Bankave	64
3.2.3.1 Struktura e Metodologjisë së Fitch.....	64
3.2.3.2 Algoritmi i Metodologjisë së Fitch.....	66
3.2.4 Krahasimi Divergjues/Konvergjues i Metodologjive Moody`s, S&P, Fitch	70
3.3 Mjedisi Makroekonomik	73
3.4 Përzgjedhja e Variablave	79

3.5 Kampionatura e Zgjedhur dhe Përpunimi i të Dhënave	82
3.6 Ndërtimi i Modelit dhe Testimi i tij.....	84
Kapitulli 4 Analiza e Rezultateve dhe Gjetjet	92
4.1 Analiza e Rezultateve të Modelit të parë të Regresionit pa Variabla Dummy.....	92
4.2 Analiza e Rezultateve të Modelit të dytë të Regresionit me Variabla Dummy.....	94
4.3 Metoda me Mesatare Shumëpërmasore	99
4.4 Racionalja në Normimin e Bankave	101
4.4.1 Përqendrimi i Tregut Bankar	102
4.4.2 Pozita në Biznes	106
Kapitulli 5 Diskutimi i Rezultateve, Konkluzionet dhe Rekomandimet	119
Bibliografia	126
Shtojcat	132

LISTA E TABELAVE

Tabela 3.1	Metodologji për ankorimin e rrezikut ekonomik dhe të industrisë bankare	53
Tabela 3.2	Përcaktimi i faktorit specifik normues të SACP për bankën	54
Tabela 3.3	Pozicioni i biznesit.....	55
Tabela 3.4	Kapitali i korrigjuar me rrezik	57
Tabela 3.5	Vlerësimi i kapitalit të korrigjuar me rrezik	57
Tabela 3.6	Llogaritja e qendrueshmërisë së kapitalit për një bankë të supozuar	58
Tabela 3.7	Ndikimi në SACP i kombinimit të përbashkët të kapitalit dhe fitimeve dhe pozicioni i rrezikut.....	61
Tabela 3.8	Impakti në SACP i kombinimit të likuiditetit dhe financimit.....	63
Tabela 3.9	Diferencat dhe drejtimet spikatëse të tre agjensive më të mëdha normuese	72
Tabela 3.10	Lidhja funksionale ndërmjet variablave	87
Tabela 3.11	Korrelacionet midis variablave	88
Tabela 3.12	Testet për vlefshmërinë e modelit.....	89
Tabela 3.13	Lidhja funksionale e variablave me normimin	90
Tabela 3.14	Matrica përcaktuese e normimit	91
Tabela 4.1	Analiza e regresionit pa variabla dummy	94
Tabela 4.2	Analiza e regresionit me variabla dummy	97
Tabela 4.3	Renditja e bankave sipas vlerës mesatare të normës së NPL faktike	98
Tabela 4.4	Renditja e bankave sipas vlerës mesatare të normës së parashikuar të NPL	98
Tabela 4.5	Renditja e bankave sipas metodës mesatare shumëpërmasore	99
Tabela 4.6	Krahasimi i renditjes sipas dy metodave	101
Tabela 4.7	Indeksi HHI për depozitat.....	102
Tabela 4.8	Indeksi HHI për aktivet.....	103
Tabela 4.9	Indeksi HHI për kreditë	103
Tabela 4.10	Indeksi HHI për depozitat/totalit të tregut	105
Tabela 4.11	Indeksi HHI për kreditë/totalit të tregut.....	105
Tabela 4.12	Indeksi HHI për aktivet/totalit të tregut.....	105
Tabela 4.13	Llogaritja e koeficientit të variacionit dhe Indeksit Z.....	116
Tabela 4.14	Strukturimi i faktorëve normues sipas niveleve	117
Tabela 4.15	Ndikimi në pozicionin e bankës i kombinimi të përbashkët të qendrueshmërisë së fitimeve dhe riskut të biznesit	118

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 3.1	Normimi vlerësues i emetuesit të kredisë	49
Grafiku 3.2	Kuadri i normimit sipas S&P	50
Grafiku 4.1	Përpjesa e tregut në numër degësh në vitin 2009	106
Grafiku 4.2	Përpjesa e tregut në numër degësh në vitin 2010	107
Grafiku 4.3	Përpjesa e tregut në numër degësh në vitin 2011	107
Grafiku 4.4	Përpjesa e tregut në numër degësh në vitin 2012	108
Grafiku 4.5	Kompozimi i aktiveve për bankën Raiffeisen	109
Grafiku 4.6	Kompozimi i aktiveve për bankën BKT	109
Grafiku 4.7	Kompozimi i aktiveve për bankën Alpha.....	110
Grafiku 4.8	Kompozimi i aktiveve për bankën Pro Credit	110
Grafiku 4.9	Kompozimi i aktiveve për bankën Credins	111
Grafiku 4.10	Kompozimi i aktiveve për bankën Intesa San Paolo	111
Grafiku 4.11	Përpjesa e tregut për numrin e punonjësve në vitin 2009	113
Grafiku 4.12	Përpjesa e tregut për numrin e punonjësve në vitin 2010	113
Grafiku 4.13	Përpjesa e tregut për numrin e punonjësve në vitin 2011	115
Grafiku 4.14	Përpjesa e tregut për numrin e punonjësve në vitin 2012	115

KAPITULLI 1

HYRJE

Në vendet në zhvillim, industrisë bankare po i kërkohet një rol dhe pjesëmarrje me peshë në mjedisin financiar dhe të biznesit, duke e prirur gjithnjë e më shumë në rreziqe të ndryshme, që metamorfojnë nga rrezik biznesi në rrezik financiar dhe anasjelltas. Kjo ciklike rreziku po imponon rishikim të të gjitha stadeve të amvisimit të tij, që nga identifikimi, matja, vlerësimi dhe alternativat kontrolluese nëpërmjet shmangies, ndarjes, transferimit dhe rrezikut që mbajnë vetë bankat. Rreziqet e portofolit të biznesit të bankave dhe të firmave po bëhen gjithnjë e më të larmishme. Përballja me portofol rreziqesh me shkallë të lartë diversifikimi po kushtëzon gjithashtu edhe rishikim ritmik të doktrinave të rrezikut duke përfshirë si aspektet normuese, operacionale po ashtu edhe ato mbikqyrëse.

Trendi i industrisë bankare në dy dekadat e fundit karakterizohet nga rritja e ndjeshme e ‘oreksit për rrezik’. Kimia e rrezikut bankar në ecurinë historike të fundme, po shfaqet si proces transformimi i rrezikut operacional në rrezik biznesi, dhe nga rrezik biznesi në rrezik financiar. Brendapërbrenda rrezikut financiar, ka një kompleksitet variabël që vështirëson priorizimin e rrezikut sepse në periudha kohore të caktuara godet më shumë rreziku i tregut, e më pas rreziku i likuiditetit, rreziku i kredisë, etj. Kjo ka implikuar thuajse të gjitha sistemet bankare të vendeve të zhvilluara, ndërkohë që ka dëmtuar portofolet bankare të vendeve në zhvillim.

Në këtë mjedis po krijohen asimetri jo vetëm në informacion por edhe në sjelljen organizative dhe institucionale të bankave, ku simptomat variabël të diagnozave të larmishme të rrezikut financiar dhe të biznesit, po kërkohen të trajtohen gjithnjë e më shumë në suazat e rrezikut operacional apo brenda rrezikut specifik.

Bankat e mëdha por me shtrirje më të pakët globale, kanë varësi shumë më të lartë nga rreziku politik dhe rreziku makroekonomik i vendit amë e i vendeve analoge për nga shkalla e zhvillimit. Nga ana tjetër, sa më të mëdha por sa më pak globale, aq më shumë janë të ndjeshme nga rreziqe sistemike të përkohëshme (*Birdsall 2006*)¹. Në SHBA kanë falimentuar thuajse të gjitha bankat ku mbi 85% e veprimtarisë së tyre shtrihet brenda SHBA p.sh. Lehman Brothers, Bank of America, etj. Bankat e mëdha me shtrirje më të gjerë globale kanë ekspozim më të ulët ndaj rreziqeve financiare si dhe shkallë më të lartë të imunitetit specifik ndaj krizave.

Nga bankat e mëdha me shtrirje të gjerë globale, mësimi më i çmuar është se modelet e kontrollit të rrezikut janë shumë dinamike, për faktin se nëse në një vend vijon recesioni, në një tjetër ka nisur ngritja, etj., kjo bën që bankat e mëdha globale të drejtojnë sipas filozofisë së të qenurit në krizë të vazhdueshme dhe kanë praktika diversifikuese mjaft kundërciklike, gjë që ja ka ulur koston e rrezikut.

Bankat krahas rrezikut specifik apo të brendshëm të tyre përballen edhe me rrezik themelor apo sistematik, i cili vjen nga jashtë mjedisit qoftë të vetë bankës, por edhe nga jashtë mjedisit të krejt industrisë bankare.

Çdo ditë përjetojmë se bankat janë të ekspozuara me shkallë të lartë dëndurie si ndaj rreziqeve specifike [të kontrollueshme nga drejtimi/amvisimi i tyre] edhe ndaj rreziqeve

¹ Birdsall, Nancy -Stormy Days on an Open Field. Asymmetries in the Global Economy. WIDER Research Paper No. 2006/31

themelore që u imponohen nga krizat dhe nga një kombinim sjelljesh të strukturave qeveritare, autoriteteve mbikëqyrëse dhe kompetencës ligjore.

Në kompleksitetin e rreziqeve që përjeton industria bankare në dekadën e fundit po përjetohet ‘mplakje e shpejtë’ e doktrinave, ndryshime në legjislacion, rishikim modelesh vlerësuese për gjendjen e bankave, deri edhe në riformatim të Kornizës së Kontrollit të rrezikut financiar në institucionet bankare të njohur si Basel III. Basel III u propozua pa u maturuar dhe u zbatuar plotësisht Basel II, ndërkohë që sot po flitet edhe për një Basel IV.

Në korrik të viti 2013, Komiteti i Baselit papritmas pranoi se *Basel III* mund të jetë shumë i ndërlikuar jo vetëm për bankat dhe për shumicën e investitorëve, por gjithashtu edhe për shumicën e mbikëqyrësve të industrisë bankare. Në këtë dilemë, Komiteti i Baselit botoi duke hedhur në diskutim fletën me titull "*Korniza rregullatore: ndjeshmëria e balancimit të rrezikut, thjeshtësia dhe krahaseshmëria*," ku tregohet gatishmëria për të riparë matjen e rrezikut bazuar në riprojektimin e metodologjisë së vlerësimit të aktiveve/zotërimeve të peshuara me rrezik (*Basel Committee Discussion Paper July 2013*). Ftesa e Komitetit të Baselit ka qenë me afatin deri në Tetor 2013, ndërkohë që pesha më e madhe e opinionëve drejtohen për të kombinuar projektin e rishikimit të vlerësimit të aktiveve në rrezik me mundësinë apo ecurinë dinamike të probabilitetit të shndërrimit të rrezikut të kredisë së bankave në rrezik likuiditeti të kombinuar me dy grup faktorësh: a) *të brendshëm* që mbizotërohen nga rreziku operacional, b) *të jashtëm* që mbizotërohen nga impakti i sistemit legjislativ, institucional dhe mbikëqyrës, si dhe nga përmbajtja e politikës fiskale dhe monetare. Kjo është linja e deritanishme që po çel rrugën për përpilimin e Basel IV (*Basel Committee Discussion Paper July 2013*).

Z. Stefan Ingves Kryetar i Komitetit të Baselit dhe Guvernatori Sveriges Riksbank thekson se: "*Komiteti është fort i vetëdijshëm rreth debatit në lidhje me kompleksitetin e kuadrit rregullator aktual dhe për këtë arsye, Komiteti ka ngritur që vitin e kaluar një Task Force për të parë këtë çështje në thellësi. Komiteti beson se do të përfitojnë nga të dhëna të mëtejshme për këtë çështje kritike përpara se të vendosë për meritat dhe ndryshimet specifike të kuadrit aktual...*"

Pikërisht kjo ngjarje dhe të tjera si kjo kanë ndikuar në rishikimet dhe ritmet e këtij punimi. Gjatë punës për një shtrim sa më të plotë teorik të modelit për normimin e bankave ka një bibliografi jo të bollshme. Nga ana tjetër, duke pasë referenca jo të shumta në numër, përmbajtja e tyre karakterizohet nga shkalla e lartë e dialektikës së identifikimit, matjes dhe modelimit të problemeve që lidhen me tre segmente kryesore.

Së pari, sa janë të standartizuara informacionet dhe baza e të dhënave që ofrojnë bankat dhe organet mbikëqyrëse për të krijuar një bashkësi paraprake kushtesh për gjetjen e një modeli sa më të qendrueshëm normimi. Në këtë pikënyje problemore grupohen shumë punime që rekomandojnë se çfarë duhet të përgatitet në *ex ante* për një model sa më të mirë. Të gjitha forcat akademike dhe institucionale që kontribuojnë janë në një emërues të përbashkët që lidhet me standartizimin e përpunimit kontabël të të dhënave sipas IFRS, si dhe me standartizimin e raportimit të pasqyrave financiare dhe të të gjitha pikave shpalosëse (*disclosures*) nga ana e bankave.

Së dyti, sa modele disponibël ka për të përpunuar bazën e të dhënave të standartizuara (*sikurse kërkohet më sipër*) dhe cili model do të konsiderohet më i qendrueshëm, duke marrë në konsideratë se industria bankare, doktrina e rrezikut dhe normimi i tyre janë shqetësime që rrokin disa dekada. Punime akademike rreth përpunimit të bazës së të dhënave si objekt më vete nuk ka, por këto zhvillohen brenda strukturës së punimeve kritike ndaj modeleve ekzistuese dhe ndaj ecurisë dhe dukurive jo sinkron ndërmjet ekonomive të zhvilluara dhe të vendeve në zhvillim. Brenda dikotomisë, ekonomi të zhvilluara dhe ekonomi në zhvillim,

diferenca më spikatëse, është se modelet e normimit të bankave në ekonomitë e zhvilluara bazohen më shumë në rrezikun specifik të vetë bankave dhe më pak në rrezikun sistematik, sepse mikroekonomia e bankave konsiderohet me një shkallë më të lartë pavarësie ndaj mjedisit makroekonomik dhe politik (Cani, Baleta)². Ndërsa në vendet në zhvillim, modelet e normimit të bankave në këto ekonomi bazohen më shumë në rrezikun sistematik [makroekonomik dhe politik] se sa në rrezikun specifik të vetë bankave. Kjo sepse mikroekonomia e bankave konsiderohet me një shkallë më të lartë varësie ndaj mjedisit makroekonomik dhe politik të vendeve në zhvillim.

Së treti, ekspozimi në rrezikun për fals negativ apo fals pozitiv nga një model normimi. Këtu dedikohen edhe punimet akademike, ku mbi 85% e shkrimeve jepen pas kritikës ndaj modeleve që aplikojnë shoqëritë e normimit (*Moody's*, *Fitch* dhe *Standards & Poor*). Vëmendësimi për nga cilësia e modeleve shtron sfidën e rishikimit si të bazës së të dhënave, të zgjedhjes së variablave dhe të ridizenjimit të modeleve. Në vendet në zhvillim, rreziku për fals negativ apo pozitiv është shndërruesi apo akseleruesi i kalimit nga një rrezik specifik në një rrezik sistematik për krejt sistemin bankar. Kjo sepse modelet shpesh herë cilësojnë financiarisht si më të shëndetshme apo edhe si më të dobët një bankë që nuk është e tillë në krahasim me një tjetër.

Së katërti, shqetësimi për qendrueshmërinë e modeleve mbetet kronik. Fakti është se as bashkësia e botimeve akademike dhe as gjigandët e biznesit të normimit (*Moody's*, *Fitch* dhe *Standards & Poor*) nuk ofrojnë një model të qendrueshëm normimi. Vështirësitë konsistojnë si në përcaktimin dhe konfigurimin dinamik të një variabli të varur p.sh. të normimit po ashtu edhe në zgjedhjen e variablave të pavarur që spikasin më mirë në funksion të lidhjes qëllimore që kërkohen. Asnjë kornizë modelore dhe institucion apo korporatë e specializuar nuk gjen prehje sidomos kur bëhet fjalë për vende në zhvillim që kanë portofol shumë të diversifikuar dhe të ndërruar mangësish p.sh. mungesa e legjislacionit, e institucioneve, e tregjeve, etj. (Leone 2008)³. Sot kërkimet priren për modele më të thjeshta dhe më të pranueshme. Për këtë arsye Komiteti i Basel i kërkon krejt komunitetit bankar, rregullator dhe akademik që të konsiderojë qasje përmirësuese të Bazel III për thjeshtësi, për ndjeshmëri dhe krahasueshmëri rreziku ndërmjet bankave, për shpjegime sa më të qarta të llogaritjeve, formulave, etj., si dhe për aplikim sa më korrekt dhe sistematik.

Përgjatë punimit tonë mbeten një numër problemesh të ngritura që kërkojnë rishikim, sidomos kur bëhet fjalë për model normimi. Bankat vlerësohen duke përdorur deri në shtatë raporte të ndryshme përgjatë një periudhe kohore. Në vend që t'i kontribuojnë stabilitetit financiar, rezultati neto mund të kthehet në një rritje të pasigurisë rregullatore dhe kontrollit të rrezikut. Tek Basel III, të metat e Basel II nuk janë trajtuar në mënyrë të përshtatshme dhe konkretisht akoma nuk kanë përfunduar procedurat për të specifikuar pasojat e parashikueshme për bankat që shkelin rregullat ekzistuese “Për ndërhyrje të mëhershme të strukturuar” ose “Për Veprimet e menjëhershme rregulluese/korrigjuese”.

Si rrjedhojë, arsyet dhe nxitësit se përse bankat duhet të mbajnë rezerva kapitale fillestare shtesë mbeten të paqarta. Nga ana tjetër, ndikimet nxitëse dhe shtrembërimet konkurruese të paraqitura nga disa banka të ashtuquajtura “*shumë të mëdha për të dështuar*” ende nuk janë adresuar në mënyrën e duhur. Në këtë mënyrë, disiplina e tregut për marrjen përsipër të rrezikut të këtyre bankave mbetet e dobët.

Përfundimisht, zbatimi i detyruar i disiplinës së tregut nëpërmjet përdorimit të kapitalit rezervë ka rol të ngushtë në Kornizën e Basel III. Komiteti i Baselit tani ka 27 anëtarë, ku secili ka bërë rekomandime të bazuara në sistemin bankar të vendit të tij. Në mënyrë të

² Cani, Sh, Baleta, T, -Central Bank of Albania. Is it really independent? Bank of Albania Working Papers -1999

³ Leone, M, “Revised Fair-Value Rule Is Weaker: Moody's” –CFO.com, November 2008.

pashmangshme, të gjitha idetë e këshillat e tregtuara për të arritur një kompromis rrezikojnë bërjen e Basel III edhe më të komplikuar.

Kësisoj në sfidën për një model normimi, kompleksiteti i mësipërm na ka motivuar për të kërkuar një model që merr në konsideratë jo vetëm dallimet e një ekonomie në zhvillim ndaj ekonomisë së vendeve të zhvilluara, por edhe brenda vendeve në zhvillim, jemi vëmendësuar në specifikat që ka Shqipëria. Për analogji, kriza e fundit argumentoi se me gjithë disiplinën që autoritetet përkatëse aplikuan për anëtarësimin në BE, rreziku i asimetrisë së informacionit mbeti pa u perceptuar, derikur u spikatën veçoritë p.sh. të Greqisë, Portugalisë, Irlandës, Italisë ndaj vendeve të BE. Kjo d.t.th., se nuk kërkohet përzgjidhje parimore, pa e përpunuar me elementët rrethanor.

Kompleksiteti i modelit të normimit dhe i produktit që modeli ofron ndikon jo vetëm tek bankat, investitorët, publiku por edhe tek rregullatorët e mbikëqyrësit. Duhet kuptuar se llogaritjet e kapitalit mbeten të vështira dhe kërkojnë modele të sofistikuara matematikore dhe burime njerëzore të kualifikuar. Këto janë të rralla për Bankën e Shqipërisë, po ashtu edhe për lojtarët e tregut financiar e bankar. Kjo është sfiduese për faktin se mbetet kronike kërkesa për ekspertizë dhe modelim të avancuar. Pavarësisht nga mangësitë dhe vështirësitë, ajo që kërcënon më shumë është mungesa e transparencës për të shpalosur problemet përballë publikut që është financuesi i 6/7 për bankat. Përveç shoqërive të normimit edhe Komiteti i Baselit ka përsëritur nevojën për transparencë, megjithë pohimet e deklaratimet se bankat ushtrojnë kontabilitetin sipas IFRS (në Shqipëri që nga viti 2009). Kjo na rikthen në domosdoshmërinë e një modeli normimi që përkon e i shërben paralajmërimit të hershëm (Gramlich, Miller, Oet, Ong -2010)⁴.

Duket si paradoks që natyra e rreziqeve bankare ndryshon vazhdimisht, por kjo ndodh sepse sa më shumë ekonomia liberalizohet, aq më shumë pasurohet kërkesa për produkte financiare e bankare, për mpleksjen e tyre me risitë teknologjike p.sh. bankimin elektronik, mobile banking, etj., që “pasuron” gjithashtu edhe ekspozimin e bankës në rrezik të sistemeve elektronike të informacionit, në rrezik specifik dhe themelor, etj. Kjo d.t.th., se është vështirë të thuhet nëse po punohet për sistemimin e pasojave nga *kriza* që po ikën, nga *kriza* që jemi apo nga *kriza* që po vjen (Catão, Luis dhe Kapur)⁵.

Nga kerkimi rezulton se edhe FMN-ja zotëron dhe përdor sistem të paralajmërimit të hershëm për krizat monetare/valutore të monedhës, por nuk ka sistem të tillë për krizat bankare. Gjatë viteve 1970- ka pasur 26 kriza valutore dhe vetëm 3 kriza bankare (Kaminsky dhe Reinhart -1999). Ndërkohë që krizat bankare janë katërfishuar në periudhën e viteve 1980 dhe 1990 kur ka ndodhur edhe rritja e liberalizimit financiar dhe e globalizimit (Moshirian, Fariborz, Qiongbing 2009)⁶.

Edhe pse janë zhvilluar shumë modele për parashikimin e krizave bankare, performanca e tyre krahasuese është e vështirë për tu vlerësuar (Davis, Karim). Edhe në këto modele, pavarësisht se variablat janë nxjerrë nga komplete të ndryshme historike të dhënash dhe janë përdorur variabla të ndryshëm të varur dhe metodologji të përgjithshme, përsëri kritika argumenton dhe provon se treguesit kryesor janë kundërshtues të bashkësisë që përfaqësojnë dhe jashtë kampionit. Hulumtimet shpesh përpiqen për të gjetur dhe për të ofruar zgjidhje duke përmirësuar specifikimet dhe zgjedhjet.

⁴ Gramlich, D, Miller, G, Oet, M, Ong, S, “Early warning systems for systemic banking risk: critical review and modeling implications” - Banks and Bank Systems, Volume 5, Issue 2, 2010

⁵ Catão, Luis A.V. and Sandeep Kapur : Volatility and the Debt Intolerance Paradox. IMF Staff Papers 53(2) 2006.

⁶ Moshirian, Fariborz, Wu, Qiongbing –“Banking Industry Volatility and Banking Crises”, Journal of International Financial Markets, Institutions and Money, Vol. 19, 2009

Prandaj ne jemi të vetëdijshëm se nuk i ezaurojmë shqetësimet për model perfekt normimi, por synojmë pasurimin modelor dhe strukturor duke përpunuar mangësitë dhe kritikën kumulative të të gjitha aspekteve që lidhen me normimin. Pa cënuar modestinë, kjo është një tentativë për ndërtimin e një modeli normimi që merr në konsideratë teorinë e sinjalizimit të hershëm, hazardin moral dhe përcaktorët specifik që shërbejnë për të përmbushur honin ndërmjet alarmit të rremë për krizë ose jo krizë dhe ndodhjes së vërtetë të krizës (Krugman 2009)⁷.

Për shkak të:

- (a) Mungesës së të dhënave uniforme raportuese –p.sh. në Shqipëri nuk ka uniformitet në treguesit për tu raportuar nga bankat. P.sh. kreditë me probleme, aktivet e peshuara në rrezik, etj., nuk raportohen nga shumica e bankave. Banka e Shqipërisë edhe Shoqata e Bankave ofron dhe shpalos informacion vetëm për industrinë bankare në tërësi pa përfshirë secilën bankë.
- (b) Mungesës së të dhënave uniforme të mjaftueshme historike, sepse bankat me peshën më ndikuese kanë ndryshuar qoftë strukturën aksionare, po ashtu edhe emrin tregtar p.sh. Banka Popullore në Societe Generale, Emporiki në Credit Agricole, që të dyja në moshë nën 5 vjet.
- (c) Mungesa e përpjekjeve për normim bankash si dhe prirja për vlerësim të bankave duke u bazuar në teknika empirike të vlerësimit, duke shfaqur një përpjekje për të përdorur scoring (pikëzimin) sipas kategorive të CAMELS.

Normimi në vendet në zhvillim si tregues i rrezikut të dështimit të një banke në pozitën huamarrëse [pranues depozitash dhe emetues bondesh] është veçanërisht i rëndësishëm sepse shërben si mjet informacioni për vendimmarrje të duhura nga investitorët dhe mbikëqyrësit. Normimi bëhet edhe më i dobishëm për vendet në zhvillim sepse bankat operojnë nën opacitet të rritur dhe mund të prirën për stimuj me përmbajtje “toksike” rreziku për rezultate të pafavorshme dhe me shanse më të larta dështimi (Rojas-Suarez 2000 , Rojas-Suarez 2001). Modelit i normimit konsiderohet i suksesshëm kur ka përmbajtje superiore informuese në krahasim me prodhuesit disponibël ekzistues të informacionit për pjesëmarrësit në tregjet financiare (Hand et al. 1992 Reiter, Zeibert 1991 dhe Ederington et al. 1987).

Misioni i normimit të bankës përqendrohet në parashikimin dhe parandalimin e rreziqeve sistemike si rreziku më kërcënues për investitorët. Mjetet aktuale për matjen e rrezikut financiar mbështeten në përkufizimet relativisht të ngushta të një ngjarje sistemike. Një kuadër i plotë gjendet tek puna teorike e Goodhart, Sunirand, dhe Tsomocos (2006) të cilët argumentojnë se rreziku i vjen nga (i) kthesat dinamike në nivelin e industrisë financiare, (ii) goditjet ndaj mjedisit të tregjeve makroekonomike dhe financiare, si dhe në mënyrë implicite nga (iii) shpërbërjet potenciale të zhbalancimeve financiare të përhapura.

Por, në ekonominë në zhvillim, ka motivues të rëndësishëm të rrezikut sistematik që lidhen me kontabilitetin krijues (fiktiv), me neglizhencën kontribuese dhe krahasuese të bankave dhe të vetë bankës qendrore si mbikëqyrëse e tyre. Këto burime të rrezikut veprojnë njëkohësisht në të dhënat e vëzhguara dhe për këtë arsye duhet të jenë pjesë e kornizës diagnostikuese. Përndryshe, mund të lindin atributet e pasakta ndaj rrezikut. Për shembull, duke lejuar për ndërlikime nëpërmjet pikënyjeve komunikuese të bizneseve, por jo për ekspozim përpjestimor ndaj faktorëve të përbashkët të rrezikut, mund të perceptohet si varësi për lidhjet që në fakt nuk ekzistojnë.

⁷ Krugman, P, "The Return of Depression Economics and the Crisis of 2008" W.W. Norton Company Limited, 2009.

Disa studime kanë theksuar rëndësinë e përqendrimit të modeleve të normimit në kushtet specifike vendore brenda një kategorie përkatësie –p.sh. brenda kategorisë së vendeve në zhvillim modeli i normimit për Shqipërinë duhet të shohë kushtet specifike të saj. Aspekti tjetër është se për të arritur në një mjet sa më të mirë normimi duhet të përfshihet informacioni nga nivele të rrezikut si makroekonomi dhe si industri për linja biznesi të ndryshme. Kjo nxjerr në pah ndikimin e ponderuar të kushteve makroekonomike /financiare.

Burimi kryesor i rrezikut në librat e bankave është grupimi i llogarive të dështuara p.sh. në kreditë e ndërtimit. Ndryshimet negative në kushtet makroekonomike dhe financiare ndikojnë në aftësinë paguese të të gjitha firmave huamarrëse (financiare dhe jo-financiare), në ekonomi që përcillet deri tek portofolet e bankave. Faktorët e vëzhguar të rrezikut makrofinanciar janë sistematike dhe një burim i varësisë kryq.

Kriza e kursim-kredive të viteve 1990-, flluska dotcom e vitit 2001, si dhe kriza financiare e periudhës 2007-09 kanë të përbashkët falimentimet e disa grupe korporatash. P.sh., falimentimi i grupit financiar Lehman, Merrill Lynch, etj. Nga shumë autorë pohohet se firmat janë të ekspozuara ndaj faktorëve të përbashkët të rrezikut, të tillë si *normat e interesit, shlyerja nga aksionet* si dhe luhatjet në rritjen e GDP (Chava & Jarrow 2004). Lëvizjet e këtyre faktorëve kanë shkaktuar ndryshime të korreluara me normat e falimentimit të firmave (Das, Duffie, Kapadia & Saita 2007). Gjithashtu duhet të ritheksojmë se, niveli i informacionit luan një rol të rëndësishëm: disa nga faktorët përkatës të rrezikut mund të jenë viktimë e dobësisë për të qenë të pakapshëm "pasiguria për vlerat e këtyre faktorëve ka ndikim në normat e falimentimeve të kushtëzuara të firmave që varen nga të njëjtat dobësi". Këto fillimisht na kanë motivuar dhe, më pas na kanë argumentuar se në modelin e normimit duhet injoruar madhësia e bankës si prerogativë për probabilitet të ulët të dobësisë financiare dhe pamjaftueshmërisë së mbijetesës së saj (Estrella, Park, Peristiani 2000)⁸.

Ajo që ndodhi në sistemin bankar pas gushtit 2008 ka treguar se, në kushte të paqëndrueshme ekonomike, madhësia e një banke qoftë vendore apo globale nuk është garanci absolute për besueshmërinë në qendrueshmërinë apo stabilitetin financiar dhe biznesor të saj. Firmat, korporatat deri edhe individët që kanë për të marrë një vendim për bashkëpunim me një bankë të veçantë, duhet të jenë të vetëdijshëm për besueshmërinë në lidhje me mbarëvajtjen e bankës dhe për këtë qëllim shërben modeli i normimit.

Projektimi për një kornizë të vlerësimit të bankave si industri dhe veç e veç si dhe krijimi i një baze të përshkallëzuar nivelore krahasimi, merr në konsideratë dy bashkësi treguesish, treguesit cilësorë dhe ato sasiorë. Karakteristikat e bankave bazuar në tregues të madhësisë së aktiveve, kapitalit, shtrirjes në treg, etj., së bashku me treguesit e raporteve financiare janë drejtimet më të referuara, më të këshilluara dhe më të përdorura për normimin e bankave, si nga autoritetet akademike po ashtu edhe nga agjensitë e specializuara më me peshë (*Moody's, S&P, Fitch*). Në teknikat e normimit të instrumentave që emetojnë këto banka apo korporata si p.sh., bonde të korporatave, prirja ka qenë për aplikimin e *modeleve probit* në metodat e normimit, ku gjithmonë ka një variabël kategorik me 6 ose 7 rezultate të mundshme renditëse (Kaplan dhe Urwitz (1979).

Nga shumica e studimeve empirike mbi normimin e bondeve të korporatave në përgjithësi, vetëm pak prej tyre e shikojnë normimin të fokusuar në elementë specifikë nga brenda një industrie deri tek një firmë e veçantë. Ekziston një lidhje ndërmjet diversitetit në normim në një sektor të caktuar dhe vështirësisë për të karakterizuar rrezikun e firmave (Morgan 2002). Kjo shpjegon gjetjen se industria bankare në SHBA, së bashku me industrinë e sigurimeve janë nga industritë me dallimet më të mëdha në të dy firmat kryesore të normimit (*Moody's* dhe *S&P*).

⁸ Estrella, A, Park, S, Peristiani, S "Capital Ratios as Predictors of Bank Failure" - FRBNY Economic Policy Review / July 2000.

Në sektorin bankar të Shqipërisë, gjasat janë për rreziqe më të mëdha dhe më të vështira për tu vërejtur, për këtë arsye edhe vlerësimet për model normimi argumentohen të jenë më të ndryshme në përkufizimin e mbarëvajtjes dhe të kredibilitetit të një banke. Për pasojë edhe diferencat ndërmjet klasifikimeve të ndryshme në normim janë të konsiderueshme. Këtu bëhet interesante për tu analizuar se çfarë i motivon dhe i nxit këto dallime.

Qëllimi i vlerësimit është që t'i ofrojë investitorëve informacion të vlefshëm për vendin apo makromjedisin ku ushtron veprimtarinë banka, për subjektet e biznesit që konkretizojnë marrëdhëniet kontraktuale me bankat (qoftë si depozitues po ashtu edhe si huamarrës), instrumentat e borxhit që emetohen për financim, shkalla e cilësisë financiare të projekteve dhe të të mirave që garantojnë si kolateral, si dhe përvoja juridike e zgjidhjes së konflikteve.

Kriza financiare ndërkombëtare e vitit 2008 ka provokuar shumë reflektim dhe analizë brenda bashkësisë ndërkombëtare për mënyrat dhe rrugët që duhen zgjedhur dhe aplikuar për të forcuar sistemin financiar. Autoritetet mbikqyrëse vendore të bankave dhe të sektorit privat së bashku me organizata të tjera ndërkombëtare kanë bërë përpjekje të vazhdueshme për të zhvilluar dhe përdorur treguesit e maturisë në makro (*macro-prudential*) për shëndetin dhe qendrueshmërinë e sistemeve financiare.

Në punim, modeli që propozojmë bazohet në kornizën teorike të normimit nga distanca dhe përhapjen e borxhit të varur. Normim nga distanca d.t.th., pa u bazuar në ekspertizën e informacionit të hollësishëm të brendshëm të bankës. Kjo përfshin edhe mbajtjen e një log gabimesh për parashikimet dhe qendrueshmërinë e nivelit normues p.sh. AAA, AA, BB, etj. Çështja komplementare ka të bëjë me ekzaminimin e vetive teorike të treguesve, përkatësisht, nëse janë apo jo të lidhur me objektivat konservative të mbikëqyrësve [të Bankës Qendrore].

Teza se në ekonomitë e zhvilluara si BE-ja dhe SHBA, institucionet financiare dështojnë/falimentojnë rrallë, ka rezistuar në kohë për periudhën 1980-2007, por jo për periudhën 2007-2013. Në Evropë rezultojnë 12 falimentime financiare për periudhën 25 vjeçare 1984-2010, ndërkohë që ka 7 falimentime për periudhën 2007-2013 (Northern Rock, Roskilde Bank, ANB Financial, Bear Stearns, etj.). Problemi shtrohet se informacioni për mbarëvajtje të ulët financiare shpesh herë është i vonuar dhe ndërkohë kostoja e falimentimit bëhet edhe më e lartë. Mungesa e të dhënave paraqet probleme të dukshme për modelimin e normimit, për shqetësimin e përbashkët si industri financiare si dhe për varësinë financiare ndaj falimentimit.

Si pasojë, modelet e bazuara në përvojën aktuale të falimentimeve mund të japin vetëm një pamje të pjesshme të stresit aktual. Matësit e tjerë të rrezikut të kredisë dhe të likuiditetit mund të plotësojnë informacionin historik të falimentimeve (Bauer, Zanjani 2012)⁹. Një informacion i tillë për vendet si Shqipëria mund të realizohet vetëm pasi të vendoset një standard. Asnjë bankë nuk përkon me standardet e raportimit në rrezik, madje asnjë bankë nuk ngjason njëra me tjetrën kur raportojnë, si dhe për produktin kontabël që raportojnë. Kjo është përcaktuese e suksesit/dështimit të aplikimit të modelit të normimit.

Treguesit e diferencimit në rrezikun e mbarëvajtjes së pritshme financiare varen nga vetë diferencimi në transparencën, drejtësinë, saktësinë dhe objektivitetin e përpunimit dhe raportimit kontabël që përfshihen si bërthama e modelit të normimit. Ne e përfshijmë këtë në analizën tonë, duke marrë në konsideratë informacione të tjera shtesë në formën e kundërkëmbimeve të kredisë së dështuar (*Credit Default Swaps*). Megjithatë, kohëzgjatja e

⁹ Bauer, D, Zanjani, G, "The Marginal Cost of Risk, Risk Measures, and Capital Allocation" –Georgia State University Oct. 2012

shkurtër e serive kohore, numri i kufizuar i bankave pohohet nga të gjithë autorët, si një problem kronik (Davis, Karim -2011).

Për këtë ne konstatojmë si parakusht cilësinë kontabël të bankave e cila ndikon edhe në treguesin e paqendrueshmërisë bankare (*banking fragility*). Dihet mirë që bankat përballen me goditje apo shok si në anën e aktiveve/kredive po ashtu edhe në anën e detyrimeve/depozitave. Këto fillimisht hasen në një bankë por më pas përhapen si sistemike dhe infektojnë krejt sektorin bankar dhe ekonominë e lidhur me të brenda një vendi dhe në vendet e tjera ku ka rrjetizim të bankave të vendit zanafillë. Globalizimi i bankave do të thotë se goditjet që ndikojnë në një bankë të veçantë ose në një vend, tani përcillen në krejt sistemin financiar dhe ekonominë reale të vendeve të tjera (Peek dhe Rosengren 1997). Për shembull kriza e bankave japoneze e vitit 2000, provoi se goditjet ndikuan duke goditur ofertën e ekonomisë reale në SHBA.

Projektimi i modelit të normimit ndjek metodologjinë e ngjashme që përdor Standard & Poor's, por me parametra dhe tregues të zgjedhur me përparësi dhe me parametra specifik për Shqipërinë. Metodologjia e Vlerësimit të Rrezikut të Vendit në Industrinë Bankare (*Bank Industry Risk Assessment -BICR*) bazohet në dy struktura të rreziqeve themelore që kërcënon bankat, në atë të rrezikut ekonomik dhe të rrezikut të industrisë.

Rreziku ekonomik i sektorit bankar përcaktohet nga struktura dhe qendrueshmëria e ekonomisë vendore duke marrë në konsideratë rolin/politikën e Qeverisë, rrezikun e kredisë të të gjithë bashkësisë së publikut huamarrës (individë dhe firma) dhe faktorë të tjerë. Faktorët që merren në konsideratë janë (a) riaftësimi ekonomik (*economic resilience*), (b) disbalancat ekonomike (*economic imbalances*), (c) rreziku i kredisë (*credit risk*) dhe (d) rreziku i likuiditetit në ekonomi.

Rreziku i industrisë përcaktohet nga efektiviteti i rregullativës bankare dhe politikave të autoriteteve mbikëqyrëse/rregullatore për të pakësuar ekspozimin ndaj rrezikut të krizave financiare, të rrezikut ndaj çenimit të mjedisit të konkurrueshmërisë, të kontrollit të “oreksit për rrezik”, performancës dhe çrregullimet e tregut të industrisë bankare. Faktorët që merren në konsideratë janë (a) korniza institucionale (*institutional framework*), (b) dinamika konkurruese (*competitive dynamics*), dhe (c) financimi i krejt sistemit (*system wide funding*).

Këto bashkësi rreziqesh themelore apo sistemike formojnë pikënisjen/ankorimin nga ku modeli i normimit nis vlerësimin e rrezikut idiosinkratik duke përcaktuar profilin vlerësues të secilës bankë. Në këtë mënyrë modeli i normimit është fleksibël dhe dialektik duke marrë në konsideratë të gjitha dukuritë e reja nën parimin e përpjekjes për transparencë të çdokohshme me autoritetet mbikëqyrëse [Banka e Shqipërisë], me aksionarët dhe me të gjithë aktorët e tregut, qofshin klientët depozitues apo huamarrës.

VËSHTRIMI KËRKIMOR DHE LITERATURA

Në lidhje me normimin e bankave literatura është shumë e kufizuar, thajse vetëm për vendet e zhvilluara, me strukturë modelore të paqëndrueshme duke motivuar rishkrime dhe punime me prirje rishikuese të modeleve, të treguesve dhe të interpretimeve. Gjithsesi, në këtë fushë, autorë të ndryshëm kanë të përbashkët domosdoshmërinë, rëndësinë dhe dobinë që ka për vendimmarrje të palëve ekzistuese që implikojnë marrëdhëniet me bankat dhe konkretisht të aksionarëve, të depozituesve, të financuesve, të huamarrësve, të vetë drejtimit të bankës, të tregjeve dhe publikut.

Vetë shoqëritë e normimit me botimet e tyre ofrojnë më shumë informacion marketimi, ndërkohë që përkrah këtyre botimeve hasen edhe kritika që kërkojnë ndryshim por pa rekomanduar qartësisht së çfarë dhe si duhet realizuar. Vlerësimet normuese të bëra nga kompanitë e normimit Moody's, Standard and Poor's dhe Fitch luajnë një rol të rëndësishëm në çmimvënien e riskut të kreditit.

Rëndësia rritet edhe më shumë në vendet në zhvillim (*developing countries*) siç edhe është e klasifikuar Shqipëria, përse kohë agjentët ekonomikë nuk kanë eksperiencë për vlerësimin e riskut. Në vendin tonë asnjë bankë nuk ka kontraktuar ndonjëherë nga agjensitë e normimit për të vlerësuar "shëndetin ekonomik dhe financiar" të saj. Një nga arsyt është edhe tarifa e lartë që duhet ti paguajnë agjensive të normimit. Duke bërë analogji me tregje të tjera emergjente apo në zhvillim me përmasa më të mëdha se tregu jonë, shikojmë se në fund të 2007 vetëm 84 nga 1135 banka në Rusi kishin kontraktuar agjensinë e normimit Moody's¹⁰.

2.1- HISTORIKU I NORMIMIT

Përgjithësisht të gjitha shkrimet/punimet kanë dënduri më të lartë në *post crisis* se sa në *ex-ante*. Për këtë arsye në kërkimin tonë jemi nisur që nga punimet e hershme të pararendësve të shoqërive të sotme normuese që nisin në prag të krizës financiare të 1837 (Cantor, Packer)¹¹ ku drejtimi vlerësues ishte aftësia e tregtarëve për të paguar borxhet e tyre. Në vitin 1841 themelohet agjensia e parë normuese nga Louis Tappan në New York (Langhoir, Herwig)¹² dhe më 1859 shfaqet agjensia normuese e Robert Dun, por botimi i udhëzuesit të parë haset më 1857 (Cantor, Packer)¹³. Sikundër cekëm me lart, krizat janë motivueset kryesore të rishikimit dhe të përmirësimit të teknikave dhe modeleve normuese. Pikërisht kriza financiare e vitit 1907 rriti kërkesën për informacionin e pavarur në lidhje me gjendjen financiare të korporatave dhe shoqërive të mëdha që huamernin si nëpërmjet sistemit bankar po ashtu edhe nëpërmjet emetimeve të bondeve në treg. Në vitin 1909 shfaqet

¹⁰ A. A. Peresetsky and A. M. Karminsky, 2011, Models for Moody's bank ratings, MPRA 34864

¹¹ Cantor, Richard; Packer, Frank (Summer/Fall 1994). "The credit rating industry". *Federal Reserve Bank of New York Quarterly Review* (Federal Reserve Bank of New York).

¹² Langohr, Herwig M.; Patricia T., Langohr (2009). *The rating agencies and their credit ratings*. Wiley, John & Sons,

¹³ Cantor, Richard; Packer, Frank (Summer/Fall 1994). "The credit rating industry". *Federal Reserve Bank of New York Quarterly Review* (Federal Reserve Bank of New York).

puna e analistit financiar John Moody dhe botimi i parë për normimin e emetuesve të bondeve (Sinclair)¹⁴

Botimi i vitit 1913 i Moody's për normimin karakterizohet nga dy ndryshime domethënëse: (a) përfshirja e gjerë e firmave dhe korporatave industriale dhe (b) nis së pari simbolizimi i normimit me gërma p.sh. AAA, AA, BB, etj. Në thelb pjesa e modelit normues kishte të njëjtën bazë si të agjensive pararendëse¹⁵. Në vijim, në vitin 1916 hasen botimet normuese të Poor's Publishing Company, më 1922 të Standard Statistics Company dhe më 1924 të Fitch Publishing Company^{16,17}.

Në SHBA, industria e normimit konsolidohet me shpejtësi pas miratimit të Aktit *Glass-Steagal* të 1933 dhe ndarjes së biznesit të investimit në instrumentat financiarë nga biznesi bankar (Sinclair)¹⁸. Si përgjigje e kësaj tregu u rrit dhe u zgjerua përtej atij të institucioneve tradicionale bankare investuese, duke krijuar akses për investitorët e rinj të cilët krijuan kërkesë për produkte cilësore të informacionit në lidhje me kompanitë ku do të investonin duke blerë bondet apo duke huadhënë.

Kahu mbizotërues i cilësisë ishte transparenca. Kjo nxiti miratimin e ligjeve të reja, të detyrueshme për dhënien e informacioneve shpjeguese për emetuesit, si dhe krijimin e Komisionit të Letrave me Vlerë dhe të Bursës (SEC). Në këtë periudhë (1936) u prezantuan "Manualët e njohura të normimit" (Sylla)¹⁹ dhe kriteret mbikqyrëse, sipas të cilave Bankat lejohen të emetojnë bonde me shkallë të pranueshme rreziku të njohura si bonde në gradë "investimi", të cilat ligjërisht përkufizoheshin vetëm nga Fitch, Moody, Poor dhe nga Standard & Poor's (White)²⁰.

Nga viti 1930 deri 1980, normimi u shtri edhe për emetuesit qeveritarë lokale si p.sh., për Bashkitë dhe për korporatat që njiheshin si *Blue Chip* (Toffler)²¹. Në vijim biznesi i normimit u ndërkombëtarizua, duke vlerësuar edhe emetuesit qeveritar të vendeve të ndryshme duke përcaktuar rrezikun e vendit apo rrezikun sovran²².

Gjatë Depresionit të Madh teknikat e normimit pësuan një tronditje rishikuese për shkak të dështimeve të Qeverive emetuese ku spikat rasti i Gjermanisë. Pas Luftës së II Botërore, doktrina financiare udhëzohej nga Marrëveshja e Bretton Woods, ku roli mbikëqyrës për shëndetin financiar të Qeverive ju dha FMN-së. Në fund të viteve 1960 dhe 1970 normimi i dedikohet në mënyrën dhe standardet më të larta vetë bankave si emetuese të depozitave. Deri në këtë kohë shoqëritë normuese paguheshin vetëm nga palët emetuese, por fill pas këtyre ndryshimeve në shërbimin normues kontribuonin me pagesë edhe investitorët. Arsyet për këtë

¹⁴ Sinclair, Timothy J. (2005). *The New Masters of Capital: American Bond Rating Agencies and the Politics of Creditworthiness*. Ithaca, New York: Cornell University Press

¹⁵ "Moody's History: A Century of Market Leadership". *moody's.com*. Retrieved 17 September 2013.

¹⁶ Ibid

¹⁷ White, Lawrence J. (Spring 2010). "The Credit Ratings Agencies". *Journal of Economic Perspectives* (American Economic Association) 24 (2): 211–226. doi:10.1257. Retrieved 22 September 2013.

¹⁸ Sinclair, Timothy J. (2005). *The New Masters of Capital: American Bond Rating Agencies and the Politics of Creditworthiness*. Ithaca, New York: Cornell University Press. p. 26.

¹⁹ Richard Sylla (1–2 March 2000). "A Historical Primer on the Business of Credit Ratings". *The Role of Credit Reporting Systems in the International Economy*. Washington, D.C.: The World Bank. Retrieved 21 September 2013.

²⁰ White, Lawrence J. (Spring 2010). "The Credit Rating Agencies". *Journal of Economic Perspectives* (American Economic Association) 24 (2): 211–226. doi:10.1257. Retrieved 22 September 2013.

²¹ Alvin Toffler, *Powershift: Knowledge, wealth, Violence at the Edge of the 21st Century*, NY, Bantam, 1990, pages 43–57

²² Ibid

ndryshim u përballën me problemin e “kalorësve të lirë” (White 2002)²³ dhe kompleksitetin e tregjeve financiare (Whiute L.)²⁴.

Në tregjet financiare, njerëzit nuk kanë informacion për titujt që blejnë apo se çfarë shëndeti financiar ka firma që i ka emetuar. Eliminimi i asimetrisë në informim për transaksionet e investimeve në tregjet financiare ka krijuar biznesin e normimit të firmave p.sh. nga *Standard & Poor's*, *Moody's*, etj., që botojnë për pozitën financiare të firmave huamarrëse duke i klasifikuar në *AAA*, *BBB*, etj., sipas shkallës së rrezikut që kanë. Gjithsesi zgjidhja e plotë e ‘problemit të zgjedhjes së kundërt’ dhe e asimetrisë pengohet nga ‘problemi i shëtitësve të lirë’ që vërehet në rrethana kur njerëzit nuk paguajnë për të përftuar një informacion për të cilin kanë paguar të tjerët më parë.

Agjensitë e normimit shtuan nivele normimi në ndryshim të përshkallëzimit sistemor. Konkretisht në vitin 1973, Fitch shtoi simbole plus dhe minus për sistemin ekzistues të normimit. Një vit më pas, Standard & Poor's bëri të njëjtën gjë, ndërkohë që edhe Moody's filloi duke përdorur krahas gërmave edhe numrat për të njëjtin qëllim (1982).

Fundi i sistemit Bretton Woods në 1971 në dekadat 1970- dhe 1980- çoi në liberalizimin e rregullave financiare dhe në zgjerimin global të tregjeve të kapitalit. Në vitin 1975, rregullat e SEC përcaktuan referenca eksplicite për normimin (Cox)²⁵, ndërkohë që si institucion, SEC ndryshoi kërkesat minimale të mjaftueshmërisë së kapitalit për broker-dealer, duke lejuar rezerva më të vogla për emetues me shkallë sigurie më të lartë dhe u bë e njohur “Organizatat e njohura vendore për normim statistikor” (“*Nationally Recognized Statistical Ratings Organizations*” -NRSROs)²⁶. Më pas kjo i referohesh korporatave normuese të quajtura si “Tre të Mëdhenjtë” (Cantor, Packer)²⁷. Kjo është periudha historike kur agjensitë e normimit u rritën me përmasa globale, sepse bashkë me to u rrit në masë të ndjeshme edhe biznesi i emetimeve, sa që në vitin 2009, tregu i obligacioneve në mbarë botën (borxhi total gjendje) arriti një shumë rreth 82’200’000’000’000 USD²⁸.

Vitet 1980- shënojnë fazën moderne të të gjithë botimeve për normim të bankave sepse u rrit shumë shpejtësia e grumbullimit dhe e përpunimit të të dhënave për hir të globalizimit të industrisë së Teknologjisë dhe Informacionit IT.

Tendencat më spikatëse ekonomike të viteve 1980 dhe të viteve '90 që sollën zgjerim të rëndësishëm për tregun e kapitalit global janë:

1-Largimi nga financimi i ndërmjetësuar apo nga huatë bankare drejt financimit të drejtpërdrejt nëpërmjet emetimit të bondeve; dhe

²³ White, Ben (31 January 2002). "Do Rating Agencies Make the Grade?; Enron Case Revives Some Old Issues". *The Washington Post*.

²⁴ White, Lawrence J. (24 January 2009). "Agency Problems—And Their Solution". *The American*. American Enterprise Institute.

²⁵ Christopher Cox (26 September 2007). "The Role and Impact of Credit Rating Agencies on the Subprime Credit Markets". *sec.gov*. Securities and Exchange Commission.

²⁶ "Oversight of Credit Rating Agencies Registered as Nationally Recognized Statistical Rating Organization". *sec.gov*. Securities and Exchange Commission. 2 February 2007. Retrieved 19 September 2013.

²⁷ Cantor, Richard; Packer, Frank (Summer/Fall 1994). "The credit rating industry". *Federal Reserve Bank of New York Quarterly Review* (Federal Reserve Bank of New York). p. 8.

²⁸ Outstanding World Bond Market Debt from the Bank for International Settlements via Asset Allocation Advisor. Original BIS data as of March 31, 2009; Asset Allocation Advisor compilation as of November 15, 2009. Accessed January 7, 2010.

2-Prania në ulje e shtetit për hir të globalizimit duke u udhëhequr drejt liberalizimit ekonomik të tregjeve globale të kapitalit dhe të marrëdhënieve ndërmjet qeverive dhe industrisë bankare.

Rritja e huamarrjes së drejtpërdrejtë implikon pjesëmarrje më sistematike dhe më të përgjegjshme të veprimtarisë së normimit. Fundi i viteve 1990- dhe vitet 2000- shënuan rritje shumë të ndjeshme të huamarrjeve të drejtpërdrejta nëpërmjet emetimeve të bondeve të korporatave. Inxhinieria financiare i projektoi si produkte, madje edhe vetë shoqëritë e normimit kontribuan në këto projekte duke krijuar një konflikt interesash që u shfaq në mesin e viteve 2000 dhe që lidhesh me faktin se 3 shoqëritë më të mëdha të normimit nuk klasifikonin për më me rrezik instrumentat financiar që kishin projektuar vetë. Nga ana tjetër kjo rrit edhe ndërvarësinë funksionale të agjensive normuese me institucionet mbikëqyrëse dhe rregullatore²⁹. Normimi shihet si përcaktues nëse investitorët do të mund të blejnë investime të caktuara, ndërkohë që në SHBA SEC kufizon fondet e tregut të parave për të blerë instrumenta financiarë që kanë marrë normime nga çdo agjensi normimi.

Transaksionet e emetimeve përfshijnë Qeveritë dhe korporatat jo vetëm të vendeve të zhvilluara por edhe të vendeve në zhvillim, nga ana tjetër shkëputja nga tregjet e prapambetura për në tregjet në zhvillim karakterizohet nga rritja e borxhmarrjes si nga bankat po ashtu edhe nga emetimi. Në dallim me vendet e zhvilluara, vendet në zhvillim kanë një përzierje të borxhmarrjes më shumë nga bankat se sa nga emetimet. Aspekti tjetër që mbetet kërcënim kronik është shkalla e sigurisë apo niveli i rrezikut që ka një investitor nëse investon në bonde qeveritare qendrore/lokale, në bonde korporatash të vendeve në zhvillim. Kriza e 2008 shpalosi se një shqetësim i tillë është madje në vetë vendet e zhvilluara. Sot mpleksja e transaksioneve, interesave dhe e dobive ndërmjet një vendi të zhvilluar me një vend në zhvillim po krijon përcjellje edhe të problemeve të rrezikut. Vetëm gjatë 2013 J. P. Morgan, ka paguar me vendim gjykate gjoba mbi 7 miliard USD për skandalin e njohur me nofken 'Balena e Londrës' për këtë arsye edhe në rrjedhën kohore pas këtij punimi tendenca e mbikëqyrësve rikthehet në sjelljen konservative të shmangies së transaksioneve spekulative si në derivativa po ashtu edhe në emetimet e 'bondeve rreckë' (*junk bonds*) të lulëzuar në fund të viteve 1970. Prandaj normimi në vendet në zhvillim përballet me ekspozim ndaj tregjeve të reja prandaj merr në konsideratë pësimet e bankave në vendet e zhvilluara apo në tregjet ekzistuese.

2.2- KRITIKAT NDAJ KOMPANIVE TË NORMIMIT

Krahas meritave, shumë referenca literature hasen edhe për kritikën për agjensitë e normimit po ashtu edhe për paplotësinë, mungesat, njëanshmërinë dhe subjektivitetin e metodave të normimit dhe të strukturës së përcaktorëve, faktorëve dhe të variablave që zgjedhin dhe përdorin agjensitë në fjalë. Këtu nis karakteristika tipike e historisë bashkëkohore të pohimeve dhe mohimeve të zhvillimit të normimit dhe rolit të agjensive përkatëse.

Kriza e viteve 2007-8 shënoi një kthesë, ku shumë autorë kritikuan dhe përgjegjësuat agjensitë normuese se kanë vlerësuar për nivele të larta sigurie emetuesit e ndryshëm (korporata dhe qeveri) si dhe instrumentat e tyre, kur më pas në fakt rezultuan të cilësisë shumë të ulët apo 'rreckë' (*junk*). Komisioni i Hetimit të Krizës Financiare (FCIC) i ngritur nga Kongresi dhe Presidenti Amerikan për të hetuar shkaqet e krizës, dhe botues i anketës Raportit të Krizës Financiare (FCIR), arriti në përfundimin se "dështimet" e vlerësimit të

²⁹ *Financial Crisis Inquiry Report*. GPO. 2011. p. 119.

agjensive normuese "Big Three" (*Moody's*, *S&P* dhe *Fitch*) ishin thelbësore në rrotën e shkatërrimit financiar deri në nivelin e falsifikimit informativ³⁰. Shumë instrumenta financiare me rrezik të lartë në të cilat u investuan apo edhe një pjesë e të cilave u përdor si garanci/peng, nuk do të ishin tregtuar pa nënshkrimin miratues të agjensive normuese³¹. Kjo "verbëri" nga shumica e autorëve përfshihet në konkluzionin se "kjo krizë nuk mund të ndodhte pa agjensitë e normimit"³².

Komisioneri i Komisionit të të Sigurtave dhe Bursës në SHBA pohon se vlerësimet e agjensive të mëdha të normimit ishin "katastrofike mashtruese" që krijuan hazardin moral të sjelljes së tyre në gëzim të fitimshmërisë së lartë gjatë dekadës së fundit (Casey)³³. Revista "The Economist" pohon se është përtej argumentit, fakti se agjensitë e normimit bënë një punë të tmerrshme në normimin e letrave me vlerë përpara krizës financiare.

Për këtë arsye të gjitha institucionet mbikëqyrëse dhe palët përfaqësuese të investitorëve, kanë bërë thirrje për "më shumë shpalosje në raportimin e vetë Agjensive normuese, duke përfshirë supozimet, kriteret metodologjike, komisionet/çmimet e shërbimit që kanë arkëtuar dhe nga cilat palë, etj."³⁴ Problemi³⁵ shtrohet nëse:

(a) A meritojnë të ekzistojnë Shoqëritë e normimit?

(b) A duhet riparë territori funksional i tyre dhe varësia mbikëqyrëse?

Bashkësia e shqetësimeve përfshijnë kritikën ndaj metodave/mënyrave të pagesës së agjensive të normimit për shërbimet e tyre të cilat kanë ndryshuar gjatë viteve duke dhënë impakt negativ. Fillimisht shoqëritë e normimit shisnin vlerësimet e tyre tek investitorët apo blerësit e instrumentave financiar, për të qenë sa më të pavarur dhe objektiv në marrëdhënie me emetuesit. Më pas ato paguheshin nga emetuesit dhe jo nga investitorët dhe paralel me këtë pagesë shoqëritë normuese krijuan portofol produktesh duke tejkaluar normimin dhe duke u përfshirë në projektim instrumentash, strukturim të tyre etj. Kjo kërkon që ato tashmë duhet të mbikëqyren nga autoritetet e instrumentave financiare dhe të bursës –p.sh. nga SEC.

Agjensitë e normimit, për të maksimizuar të ardhurat e tyre, u bënë bashkë-lindëse (co-originators) të instrumentave financiare duke konkurrar me bankat e investimit dhe njëkohësisht duke devijuar nga funksioni për të cilin ishin themeluar. Ato ngurruan të ulnin nivelin e sigurisë nga AAA në BBB ose C apo D të letrave me vlerë që ato vetë kishin ndihmuar për t'i krijuar (Greenberg)³⁶.

Agjensitë e normimit duhet të zgjidhin problemin e informacionit asimetrik duke rritur ndjeshëm transparencën, kjo sepse në të vërtetë, ato kanë luajtur rolin e përkundërt duke bërë më të errët dhe opak mjedisin e tregut. Si në të gjitha krizat e mëparshme, edhe në krizën e

³⁰ *Financial Crisis Inquiry Commission Final Report-Conclusions-January 2011*

³¹ *Lessons from the Credit Crisis for the Future of Regulation: Before the Committee on Oversight and Government Reform, United States House of Representatives, 110th Cong. (2008) (testimony Concerning the Role of Federal Regulators by Chairman Christopher Cox, U.S. Securities and Exchange Commission), available at <http://www.sec.gov/news/testimony/2008/ts102308cc.htm>.*

³² Ibid

³³ Casey, Kathleen. "In Search of Transparency, Accountability, and Competition": The Regulation of Credit Rating Agencies", remarks at "The SEC Speaks in 2009". February 6, 2009. US SEC. Retrieved 21 August 2013.

³⁴ Rupert Neate, Ratings agencies suffer 'conflict of interest', says former Moody's boss| The Guardian| 22/08/2011

³⁵ International Economy Magazine Washington D.C. 2008

³⁶ ibid

2008 agjensitë normuese ishin shumë optimiste dhe nuk dhanë asnjë alarm në ex-ante. Ky diagnostikohet si problem sistematik në historinë e mangësive të agjensive normuese.

Prandaj kërkohet/propozohet që të krijohet një institucion kombëtar ose mbase mbikombëtar (supranational) për të ofruar produktin e normimit njëloj sikurse enti i Administrimit të Ushqimeve dhe Medikamenteve vepron për produktet ushqimore dhe farmaceutike. Koncepti i 'mbikombëtare' argumentohet me faktin se nëse një kompani është AAA në një vend mund të mos jetë e tillë në një vend tjetër, prandaj ky ent vështrohet si i përbërë nga tre filiale, në SHBA, BE dhe Azi (Flassbeck)³⁷.

2.3- FAKTORËT, VARIABLAT PËRCAKTUES TË MODELEVE TË NORMIMIT

Rikonceptimi i mbikëqyrjes institucionale mbikombëtare riktheu thuajse të gjithë studiuesit në rishikimin e faktorëve, përcaktorëve dhe ndryshoreve të pavarura dhe të varura/funksionale të modeleve të agjensive normuese në kërkim për zgjidhje sa më të përgjegjshme për shqetësimet e akumuluar dhe të ekspozuara si asnjëherë më parë pas 1930, në krizën 2007-08. Drejtimet kërkimore, debatet, diskutimet dhe kritikën u shtrinë në diferencat modelore që agjensitë normuese aplikonin për banka të njëjta në vendet e zhvilluara, për mangësitë metodike dhe papërkueshmëritë normuese për bankat e vendeve në zhvillim, për specifikat që barti kriza në asimetritë e informacionit ndërmjet dy grup-vendeve, për identifikimin e rrezikut për paplotësi të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit financiar (IAS 39, IAS 9)³⁸ për nevojën e përsosmërisë së kontabilitetit të drejtimit dhe të rrezikut duke provuar pamjaftueshmërinë e Basel II dhe përpjekjet për Basel III, për rolin e Bankave Qendrore dhe rishikimet e legjislacionit rregullues të sistemeve bankare, etj.

Aspektet e mësipërme u reflektuan në rishikimin e punimeve të mëhershme të fushës, me sensin e verifikimit nëse problemet e krizës së 2007-08 ishin trajtuar, parashikuar apo cekur në punimet më ndikuese të mëparshme. Ndër punimet më të cituara të fundit të viteve 1970- (1979) është ai i shpjegimit kritik të metodologjisë së normimit (Kaplan, dhe Urwitz)³⁹ i cili ekzaminohet edhe në rolin e luajtur nga shoqëritë përkatëse. Në vitet 1990- u riinventarizuan problemet në marrëdhënie me subjektet dhe metodat normuese duke parë se cilat prej tyre ishin neglizhuar. Në punimet e viteve 2000- mbizotëron analiza për impaktin e tyre, ndonëse në këtë periudhë hasen më pak punime në fushën e përcaktorëve të normimit. Propozimet për të përfshirë treguesit makro krahas atyre mikro në nivel vendi, industrie, dege, banke, etj., vëmendësohen në nivelet e GDP/frymë, në ritmin e rritjes së GDP reale, në GDP Deflator dhe Inflacionin, në ecurinë dhe përpjestimet disiplinore të deficitit buxhetor, të borxhit publik dhe të treguesve tatimor në Bilancin Fiskal, Bilancin e Pagesave dhe strukturën e borxhit të brendshëm ndaj atij me jashtë, në indikatorët e dështimit për shlyerje borxhi që ka niveli qendror dhe/ose lokal qeveritar i vendeve të zhvilluara, në zhvillim, etj., (Cantor, Packer)⁴⁰.

Shkrime të tjera konsistojnë në rolin më me rrezik të normimit për faktin se gjatë fundit të viteve 1990- deri në mesin e viteve 2000- agjensitë e normimit nëpërmjet raportimeve dhe publicitetit të tyre ndikonin në transaksionet e kredisë ndërkombëtare. Vlerësimet e tyre u

³⁷ ibid

³⁸ 'Basel III' and IFRS 9 -A tightening of the regulations –Royal Bank of Scotland 2011.

³⁹ "Statistical Models of Bond Ratings: A Methodological Inquiry." JOURNAL OF BUSINESS 52, no. 2, 1979

⁴⁰ "Determinants and Impact of Sovereign Credit Ratings" Richard Cantor, Franck Packer –FRBNY Economic Policy Review, Oct. 1996

vëmendësuan si ndaj huamarrësve ose emetuesve korporata po ashtu edhe ndaj emetuesve qeveri duke ofruar përpjekje për vlerësime sa më objektive për shëndetin financiar të tyre.

Përballja me shqetësimin se sa e si shoqëritë normuese pasqyrojnë pozicionin dhe dinamikën konkurruese të bankave dhe sistemeve bankare, të nivelit të rrezikut të qeverive sipas vendeve/tregjeve të zhvilluara dhe në zhvillim, historikun e të dhënave dhe të përvojës së tyre për diagnoza të sakta dhe të gabuara me këto vende e tregje, u sfidua nga rrjetizimi i dukshëm dhe virtual apo 'i padukshëm' i zinxhirit global të marrëdhënieve kreditore dhe debitoare. Në përgjigje të kërkesave për rimodelim dhe rimetodika të normimit vlerësues të korporatave, qeverive, sistemeve bankare dhe bankave individuale që operojnë në kushtet e tregtisë, biznesit dhe veprimtarisë bankare elektronike, agjensitë e normimit qenë shumë të vonuara. Ato më shumë u futën në rrjedhën e marketingut ndaj përparësisë së njërës ndaj tjetrës në ashpërsim të rivalitetit ndërmjet tyre, për diagnoza të gabuara e normime jo reale (McNamara dhe Vaaler)⁴¹.

Nga ana tjetër gjatë fundit të viteve 1990- dhe fillimit të viteve 2000, në hartën gjeopolitike mbarëbotërore u shtuan vendet me ekonomi të lirë tregu dhe me kurse valutore këmbimi të luhatshme, gjë që krijoi një bashkësi ekspozimesh ndaj rrezikut të këmbimit valutor dhe ndikimi i këtij ekspozimi si përcaktor në nivelin e normimit. Kësisoj shumë studime u dedikuan për ekzaminimin e diferencave sistematike ndërmjet përcaktorëve që merreshin në konsideratë, peshat dhe ndikimet e tyre në rrezikun e vendit apo rrezikun sovran, që vlerësoheshin dhe përfshiheshin në modele nga agjensitë e normimit (Trevino dhe Thomas)⁴².

Në këtë periudhë globalizimi të tregjeve u rrit edhe kërkesa për normim nga qeveritë e vendeve në zhvillim dhe me ekonomi relativisht të dobët, për të cilat nuk kishte historik normimi, duke konkluduar se treguesit aktualë ekonomik dhe financiar nuk mjaftojnë të përcaktojnë normimin (Bissoondoyal – Bheenick)⁴³.

Megjithatë, asnjë nga studimet e mësipërme dhe të tjera analoge nuk ofruan modele apo analizë të normimit të bankave, ndërkohë që roli i bankave në këto kohë u bë vendimtar edhe për faktin e mungesës së aktorëve dhe të produkteve të tjera që hasen në tregjet financiare të zhvilluara. A.M. Best duke theksuar rëndësinë e procedurës së normimit të bankave bazohet në faktorët e mëposhtëm që përfshijnë:

(i) Rolin që bankat luajnë në politikat makroekonomike dhe monetare të një vendi si përcjellëse të financimeve dhe të kredive në të gjithë damarizimin financiar të bizneseve dhe të një kombi.

(ii) Mbështetja dhe mandatet rregullatore që ndikojnë në operacionet bankare,

(iii) Natyra e biznesit dhe e operacioneve të bankave që bazohet shumë në burime të huajtura;

(iv) Nevojat që kanë bankat për të amvisuar dhe kontrolluar rrezikun sikurse theksohet në Basel II/III, duke ekspozuar shpesh herë bankat në rrezikun e ngurrimit për të investuar me synim që të kenë likuiditete sa më të mjaftueshme.

(v) Natyra ciklike e industrisë bankare.

⁴¹McNamara, G, Vaaner, P, "The Influence of Competitive Positioning and Rivalry on Emerging Market Risk Assessment", 2000 *Journal of International Business Studies*

⁴² Trevino, L. and Thomas, S., (2000), "Systematic Differences in the Determinants of Foreign Currency Sovereign Ratings by Rating Agency", *Discussion paper, University of Southampton, No. 00-153*

⁴³ 'An analysis of the determinants of sovereign ratings', *Global Finance Journal*, vol. 15, pp. 251-280.

2.3.1 Normimet e kredisë bankare si bazë për normimin e bankave

Këta faktorë tregojnë shkallën në të cilën sistemi financiar varet nga funksionimi i shëndoshë i sistemit bankar, si dhe përforcojnë përdorimin e normimit të kredive bankare për të rritur mbështetjen që qeveritë, institucionet dhe investitorët e pakicës duhet të kenë për bankat. Gjithsesi motivi i thellimit të studimit tonë është pikërisht për të sjellë një kontribut në ‘vakumin’ për modele të normimit të bankave në vendet në zhvillim.

Informacioni asimetric midis industrisë bankare dhe rregullatorëve të saj pengon kalibrimin e kërkesave të bankës për kapital minimal, për të vlerësuar rrezikun. Prandaj, rregullatorët janë mbështetur gjithnjë e më shumë në normimin e kredive bankare si burim informacioni. Besimi i kryerjes së normimit të bankës nga palë jashtë saj (agjensi private normimi), për fat të keq, mund të kthehet në një ‘kalë troje’ nëse agjensitë ‘tregtojnë’ informacion konfidencial ose ofrojnë nivele normimi jo reale.

Rregullat financiare varen shumë nga normimet e kredisë. Sipas Përqasjes Standarde të përshtatshme në Marrëveshjen e Bazelit, "kalibrimi i kërkesave të bankës për kapital ndaj rrezikut të aktiveve të bankës, bazohet në normimet e kredive (BCBS 2006). Duke qene se bankat janë pësueset dhe veprueset më me peshë në kriza, kalimi nga një stad i qetë biznesi dhe hyrja në një fazë ku pasiguria përjetohet si shqetësim në vijim, modelimet e normimit të tyre janë cekur me shkallë frekuence më të lartë nga shumë autorë. Kjo sidomos gjatë viteve 2000-2013.

Punimet konvergjojnë në dyshimet për aftësinë e modeleve ekonomike për të kapur detajet e duhura në normimin e falimentimit të bankave dhe të korporatave, megjithatë një numër studimesh të mëparshme kanë bërë një punë të mirë në shpjegimin dhe parashikimin e falimentimeve dhe të normimit të korporatave dhe të bondeve të emetuara prej tyre mbi bazën e një historiku të shkurtër të të dhënave (Holthausen dhe Leftwich)⁴⁴.

Studimet për normimet e kredive bankare mund të klasifikohen në dy drejtime.

Drejtimi i parë i hulumtimit përmbledh punimet që përpiqen të shqyrtojnë besueshmërinë e normimit, duke përditësuar modelet me përfshirjen e faktorëve të varur nga fakte dhe ngjarje të reja ndikuese p.sh. korniza mbikëqyrëse e Basel II për mjaftueshmërinë kapitale të bankave ka bërë që të rishihet modeli standard për normimin e korporatave, përjashten e aftësisë parashikuese për mjaftueshmërinë kapitale, si dhe llogaritjen e kapitalit. Në vetvete edhe vetë Basel II është rishikuar, gjë që sfidon modelet normuese të përcaktuara para ndryshimeve më të fundit p.sh., të Basel III. Megjithatë studjuesit shohin se përmirësimet provohen të jenë të pamjaftueshme.

Konkretisht bankat preferojnë aplikimin e peshave më të ulta të kapitalit në rrezik, duke bërë që të jenë të prirura për të anuar portofolet e tyre drejt kredive me shkallë sigurie më të ulët (Altman dhe Saunders)⁴⁵. Vëzhgimi i agjensive normuese për çështje të ndryshme të normimit të bankave nga vende të ndryshme por me performancë financiare të ngjashme është gjithashtu komponent i përfshirë në nivelin e parë.

Drejtim tjetër që formon nivelin e parë, është edhe analiza e ndikimit të ciklit të biznesit në normimin e bankave duke identifikuar prirjen e agjensive normuese për të qenë shumë prociklike dhe në përgjigje propozohet risihikimi i modelit duke kombinuar përcaktorë

⁴⁴John, H, Holthausen, R, "The effect of Bond Rating Agency Announcements on Bond and Stock Prices", Journal of Finance 47, 1986.

⁴⁵Altman, E, Saunders, A, "Credit Ratings and the BIS Reform Agenda" 2001, Center for International Political Economy and the Bank of England Conference on "Banks and Systemic Risk," May 23rd – May 25th, London, England

makroekonomikë me ato mikro. Aspekti alternativ është edhe verifikimi se sa ndikon vetë normimi në ciklin e biznesit (d'Amato, Furfine)⁴⁶.

Drejtimi i dytë i hulumtimit thellohet në cilësinë e përbërësve të modelit ku zgjedhja e përcaktorëve zë peshën më të lartë në punimet bashkëkohore. Moody's Investors Services në vitin 1998 paraqiti paketën e normimit të fuqisë financiare të një banke (bank financial strength ratings -BFSRs), duke përfshirë 50 vende. Në përgjigje të kësaj pakete u zhvillua një model logjistik regresioni për të shpjeguar dhe parashikuar nivelin e fuqisë financiare të një banke.

Modeli merr në konsideratë të dhëna kontabël dhe financiare specifike për një bankë që konsiderohen variabla themelor për të përcaktuar përmasat e rrezikut, raportet e provizionimit të huarave dhe të fitimshmërisë. Nga këta përcaktorë provizionimi i kredive u konsiderua më me peshë, ndërkohë që rreziku i vendit injorohet si i parëndësishëm (Poon, Firth, Fung)⁴⁷. Në janar të vitit 2013 u botua punimi për kontabilitetin e përcaktorëve të normimit të bankave (Hassan, Barrell)⁴⁸.

Kontributi i industrisë bankare të krizës së fundit financiare 2007/8 ka ngritur shqetësime në përmasa publike në lidhje me përfshirjen e tepërt të bankave në aktivitete me rrezik. Përveç kësaj ka pasur shqetësime të gjera edhe në lidhje me aftësinë e agjensive të klasifikimit të kredive për të vlerësuar paraprakisht këto rreziqe. Në këtë kontekst, studimi ynë bazohet në një përzgjedhje të përcaktuesve të normimit të bankave duke përdorur një kampionaturë bankash për të qenë sa më përfaqësuese, në kushtet kur verifikohet homogjenitet për respektimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit

Shumë autorë përkojnë me mendimin se një numër i vogël i variablave kontabël, përkatësisht: madhësia e bankës, niveli i likuiditetit, si dhe treguesit e efikasitetit dhe të fitimshmërisë, janë në gjendje që të përcaktojnë saktë normimin e kredive si aktiviteti kryesor i bankave duke përfshirë një shtrirje për rreth 74 % deri në 78% të bankave të marra si mostër⁴⁹.

Në studimin tonë ne kemi zgjedhur një alternativë më sintetike, duke u fokusuar në treguesin më rezultativ dhe që nga ana kontabël është më pak i manipulueshëm dhe më shumë diskriminues për cilësinë e aktiveve të bankave sikurse është treguesi i kredive jo të mbara (*non performing loans -NPL*). Ky tregues përfshin rezultatën e ndikimit të faktorëve që lidhen me dëmtimin e kredive (*loan impairment*), me kreditë toksike (*toxic loans*) si dhe me pjesën e kredive të peshuara në rrezik por që klasifikohen si standard (Hoti⁵⁰).

Mirëpo, drejtimi për të kaluar nga analiza statike në atë dinamike e NPL-s dhe vëmendësimi tek prirja e korrelacionit dhe e përcaktueshmërisë që NPL-ja ka me të gjithë treguesit e tjerë shprehës të gjendjes financiare të një banke, kërkon ndërthurjen e treguesve absolut dhe relativ të rrezikut, duke bërë që modelet statistikore të përpunohen edhe si ekonometrikë.

Problemi shtrohet në përcaktimin e variablave të bilancit, të pasqyrës së të ardhurave dhe të kombinuar. Në thelb treguesi i NPL-s është tregues bilanci sepse komponentët përlllogaritës janë të bilancit, ndërkohë që treguesi ROE, ROA dhe ROI janë tregues të

⁴⁶ Amato, Jeffery D. and Furfine, Craig, Are Credit Ratings Procyclical? (February 2003). Bank for International Settlements Working Paper No. 129.

⁴⁷ P.H. Poon, W, Firth, M, Hung Gay Fung – “A multivariate analysis of the determinants of Moody's bank financial strength ratings” Elsevier, Vol 9, Aug. 1999.

⁴⁸ Omaira A. G. Hassan and Ray Barrell, “Accounting for the determinants of banks' credit ratings” Working Paper N. 13/2 Brunel University.

⁴⁹ Ibid

⁵⁰ Hoti, I, -Banking Portfolio Impairment Test Outcomes According to International Financial Reporting Standards [Real Case: BIS Banca Implementation], Journal of Business and Economics UAMD 2011

kombinuar sepse fitimi (*return -R*) është i pasqyrës së të ardhurave ndërsa niveli i kapitalit (*equity -E*) dhe i aktiveve (*assets A*) është i bilancit. Shumë autorë vlerësojnë grupin e dytë të treguesve si më përfaqësues, ndërsa në këtë studim vlerësohet se NPL si tregues bilanci mund të kombinohet me tregues të pasqyrës së të ardhurave p.sh., me raportin NPL/E, NPL/A, NPL/Ar gjë që i përgjigjet më mirë edhe formatit të Basel II/III.

Teoria e çmimvënies së aktiveve kapitale (*CAPM*) na mëson se ekspozimi i një banke apo korporate ndaj rrezikut të tregut është përcaktuesi kryesor i kostos së kapitalit të vet korporatës/bankës por jo i rrezikut të aktiveve (King 2009)⁵¹. Kjo sepse të gjitha aktivet që janë me kimi borxhi –p.sh. në llogari të arkëtueshme apo kreditë, rreziku si shkak nis në kahun e debitorëve huamarrës, ku lexohet si rrezik likuiditeti, i cili tek portofoli i bankës apo i çdo korporate kreditore përkthehet si rrezik krediti. Në thelb çdo njësi e paarkëtuar aktivesh të arkëtueshme shndërrohet në njësi të humbura të kapitalit që d.t.th., se një pjesë e strukturës së kapitalit financon humbjet e shkuara dhe në vijim.

Prandaj vlerësojmë se NPL-ja është shkak dhe rënia e kapitalit është pasojë. Për të parë se sa përkeqësohet gjendja e financiare, banka duhet të masë vazhdimisht nëse rënia e aktiveve të huamarrësve të saj nën vlerën e detyrimit të tyre ndaj bankës dhe kreditorëve të tjerë përcillet si rrezik i rënies të aktiveve të vetë bankës duke u shndërruar në rrezikun e pamjaftueshmërisë kapitale të bankës.

Këtu duhet dalluar dalja me humbje e bankës p.sh. kur të ardhurat nga interesat dhe komisionet janë më të vogla nga shpenzimet, nga probabiliteti i falimentimit të bankës, apo mungesa e aftësisë për të shlyer detyrimet. Lidhja ndërmjet këtyre dy dukurive kërkon mos ngatërrimin e modeleve për parashikim falimentimi (*bankruptcies prediction*) me modelet për aftësinë financiare shlyerëse të bankës (*insolvency prediction*).

Drejtimi i ri që sjellim është fakti se bankat në të dy aspektet e mësipërme janë në varësi të fortë nga shëndeti financiar i huamarrësve apo nga dobia financiare e projekteve që financojnë, duke injoruar diferencat në faktorë të tjerë. Kjo d.t.th., se cilësia e portofolit të aktiveve të bankës varet nga cilësia e aktiveve të vetë huamarrësve të saj.

Prandaj në humbjet potenciale të bankës, ndikimi reduktohet në dy faktorë që përkojnë me dy dukuri:

- (a) me shansin e dështimit të debitorëve apo me rrezikun e likuiditetit të debitorëve; dhe
- (b) me shkallën e mbulimit të kredisë me cilësinë dhe vlerën e mjaftueshme të kolateralit të marrë si garanci nga bankat, apo me rrezikun e tregut (*market risk*).

Në nivelin më të thjeshtë, nëse probabiliteti i dështimit të një kompanie është 5%, dhe ku vetëm 80% e borxhit mund të arkëtohet nga banka kreditore, atëherë d.t.th., se humbja është 20%. Në këto kushte humbja potenciale shtesë është +1% apo 20% x 5%. Ky koncept kontabël injorohet në të gjitha raportimet dhe politikat e peshimit në rrezik të kapitalit, duke mos shtuar të paktën për 1% provizione për mbulim humbjeje. Megjithatë kjo nuk është e lehtë në praktikë, sepse humbjet e kreditorit përfshijnë jo vetëm pjesën e shumës së themelorit por edhe të interesave të përshtuara.

Bankat si kreditore kanë nevojë të zbulojnë humbjet potenciale nga falimentimi i klientëve të tyre huamarrës. Prandaj duhet parë se çfarë incidence ka secili në grupin e portofolit të huarave sipas industrive dhe të krejt portofolit dhe të aktiveve të bankës. Pikërisht në këtë pikë duhet thënë se niveli i normimit të një banke varet në funksion të nivelit të normimit të vetë palëve huamarrëse të saj.

⁵¹R. King, M, "The cost of equity for global banks: a CAPM perspective from 1990 to 2009" - BIS Quarterly Review, September 2009

Nga ana tjetër disa studiues përdorin treguesit kontabël si shtesë ndaj atyre makro për të parashikuar krizat financiare, sepse vlerësojnë se treguesit e bilancit veprojnë si përcaktorë në normimin e bankave duke marrë në konsideratë edhe ndikimet e kurseve të këmbimit, duke tërhequr vëmendjen për mos anashkalim të këtij treguesi (Trevino dhe Thomas)⁵².

Në vitin 2006 u bë një thirrje pararendëse për të komentuar metodologjinë e normimit të bankave (*Moody's*) si kontribuese dhe jo pësuese në krizën e vitit 2007-8 sepse bankat u vlerësuan me prirjen për tu përfshirë në veprimtari me rrezik më të lartë nga kapaciteti i tyre. Drejtimet motivuese mbeten ato të punimeve të mëparëshme, duke u vëmendësuar në përcaktorë të ndryshëm sikurse janë normat e pavarura të interesit (Cantor dhe Packer , 1996, Afonso 2003; Bissoondoyal - Bheenick, 2005, Bennell et al , 2006).

Studimi ynë i shërben normimit nga jashtë apo nga distanca (sipas raportimit financiar dhe ekonomik publik). Normimi nga jashtë nuk bazohet në shqyrtimin e informacionit të brendshëm, pra në kontabilitetin financiar dhe jo aq duke u bazuar në kontabilitetin manaxherial të bankave. Këtu merr shtysë analiza me gërmimin e të dhënave (*data mining*) sipas analizës shtjelluese të të dhënave që njihet si *makina e mbështetjes vektoriale* (SVM) dhe sipas teknikave me shumë ndryshore (multivariate technics). Qëllimi kryesor që shpreh Bellotti et al. (2011a , 2011b) është për të krahasuar aftësinë e modeleve të normimit të bankave me analizën shtjelluese të të dhënave sipas së ashtuquajturës *makina e mbështetjes vektoriale*.

Studimet e mëparshme për normimin e bankave klasifikohen në **dy rryma kërkimore.** **Drejtimi i parë** (e.g., Altman dhe Saunders, 2001; Amato dhe Furfine, 2004; Iannotta, 2006; Shen et al., 2012) përpiqet të ekzaminojë vërtetësinë e normimit. Si shembull përmendet taktika e normimit të bankave me mbarëvajtje të ngjashme por që ushtrojnë veprimtari në vende të ndryshme.

Drejtimi i dytë kërkimor priret të nxjerrë në pah përcaktorë të tipeve të ndryshme të normimit (Cantor and Packer, 1996; Afonso, 2003; Bissoondoyal-Bheenick, 2005; Bennell et al., 2006), të metodave për normimin e bondeve (Kaplan dhe Urwitz, 1979; Blume et al., 1998; Iskandar-Datta dhe Emery, 1994; Molinero et al., 1996).

Në vitin 2006 Moody's përgatiti propozimin për rishikimin e metodologjisë së normimit të bankave duke u bazuar në përcaktimin e normimit sipas Fuqisë Financiare të Bankës (*Bank Financial Strength Ratings -BFSRs*) e cila nuk ndryshon faktorët kryesorë të marrë në konsideratë por unifikon metodologjinë drejt një të vetme për tregjet e zhvilluara. Metoda gjithashtu vendos norma normimi për secilin faktor sipas kategorive përkatëse duke synuar pajimin me një linjë udhëzuese transparente të investitorëve ekzistues dhe potencial ndaj instrumentave bankare të borxhit si dhe të vetë bankave si emetuese të këtyre instrumentave (*Moody's*⁵³).

Një gjë analoge u pa edhe në dy agjensitë e tjera të normimit (*Fitch* dhe *S&P*). Ngjarjet pas 2006 motivuan studime të tjera duke u përgjithësuar në tre drejtime gjetjesh:

Së pari Të tre agjensitë e normimit (*Fitch Ratings*, *Moody's Investors Service* dhe *Standard & Poor's*) konvergjojnë në identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut në bankat më të

⁵² Trevino L., Thomas S. "Systematic Differences in the Determinants of Foreign Currency Sovereign Ratings by Rating Agency" Working Paper University of Southampton, 2000.

⁵³ Moody's 1-"Request for Comment: Incorporation of Joint-Default Analysis for Systemic Support into Moody's Bank Rating Methodology," October 2005; "Update to Proposal to Incorporate Joint-Default Analysis into Moody's Bank Rating Methodology," April 2006; 2- "Bank Joint Default Analysis: Rating Methodology Update," August 2006.

mëdha të BE dhe të SHBA duke pohuar përkeqësim të mbarëvajtjes financiare të tyre (Deventer, Donald R., Imai, Mesler)⁵⁴.

Së dyti, Agjensitë pajtohen njëherazi më shumë se deri më 2007, se vlerësimi i besueshmërisë së bankave duhet të marrë në konsideratë edhe financimet mbështetëse të qeverive.

Së treti, Rishikimet e vazhdueshme të metodologjive të agjensive dhe të rezultatit të tyre formojnë opinionin se në sektorin bankar do të ketë rënie të mëtejshme në nivelin e normimit (Packer, Tasharev)⁵⁵.

Treguesit makro të bazuar në trendet e rritjes së kredive dhe të çmimeve të zotërimeve, vlerësohet se mund të kenë qenë efektive në pikën ku kërkohet dhe realizohet identifikimi dhe ndërtimi i hartave të ekspozimit në rrezik të bankave. Përsa i përket karakteristikave të nivelit të vlerësimit të bankës, si agjensitë ashtu edhe tregjet mund të kishin ofruar një vëmendësim më të thellë për nivelin e kapitalit të cilësisë së lartë.

Në vitin 2006, Bankat me raportet e larta kapitale, të “*kapitalit të nivelit të parë*” kanë pasur shumë pak ose aspak nevojë për masa emergjente gjatë krizës, ndërkohë që masat emergjente me kosto të lartë janë vërejtur tek bankat me raportet e ulëta kapitale. Për këtë arsye kuptohet se agjensitë e normimit të bankave ripërfshinë në modelet e tyre këtë karakteristikë, madje me pesha gjithnjë e më në rritje për faktin se dukuria e vitit 2006 spikati më fuqishëm gjatë periudhës vijuese.

Duke grupuar ecurinë e mbarëvajtjes së bankave dhe të normimit të tyre në: përpara krizës dhe pas krizës, dalin në pah probleme që motivuan rishikim dinamik të modelit. Duke analizuar skenarët ex-post, rezulton se sistemi metodologjik përpara krizës nuk spikati si duhet luhatjet rrezikuese të përhapura në mbarë sistemin financiar, duke mos identifikuar si duhet as institucionet bankare më të ekspozuara.

Kritika është se modelet e normimit duhet të kishin orientuar drejt masave emergjente më të forta që lidhen sidomos me ngritjen e kapitalit dhe shitjen e aktiveve. Gjithsesi për një kampionaturë prej 60 bankash ndërkombëtare të mëdha, normimi i fuqisë financiare që u përkatësua nga dy agjensitë normuese (*Moody's* dhe *Fitch*) kanë pasur lidhje të dobët për disa dhe pozitive për të tjerat me masat e emergjencës që u rekomanduan. Në varësi të tipit të agjensisë normuese, disa normime synonin të përcillnin informacion rreth probabiliteteve të dështimit, ndërkohë që të tjerat i referoheshin humbjeve të pritshme nga kreditë. Kjo kufizoi krahasimet ndërmjet sektorëve dhe agjensive. Më përgjithësisht Fender et al. (2008) argumentuan se krahasueshmëria e normimit u dëmtua nga fakti që një shkallë e vetme normimi nuk rendit njëkohësisht institucionet në përmasat e shumëfishta të rrezikut të kredisë.

Indikatorët e tregut të kredisë provuan lidhje të dobta me realitetin. Konkretisht përhapja e kredive të dështuara përpara krizës nuk ishte informuese për performancën e bankave. Kjo u vërtetua edhe përgjatë krizës. Pavarësisht se pritshmëria ka qenë që këto indikatorë të kishin lidhje pozitive me ekspozimin në rrezik të bankave, analiza sipas varësisë empirike vërtetoi të kundërtën, që të ishte e dobët dhe negative. Në nivel sistemor saktësia e normimit përpara krizës mund të ishte shumë më e saktë. Normimi në mesin e vitit 2007 nuk tregoi lidhje me fitimshmërinë e bankave si për vitin 2007, 2008 dhe 2009 (Packer, Tasharev)⁵⁶.

⁵⁴Deventer, V, Donald R., Kenji Imai, Mesler, M, –“Advanced Financial Risk Management: Tools and Techniques for Integrated Credit Risk and Interest Rate Risk Management”. John Wiley, 2004.

⁵⁵Packer,F, Tasharev, N, “Rating methodologies for banks” BIS Quarterly Review 2011.

⁵⁶Packer,F, Tasharev, N, “Rating methodologies for banks” BIS Quarterly Review 2011.

2.4- ROLI I MBËSHTETJES/NDIHMËS QEVERTARE NË NORMIMIN E BANKAVE

Vështirësitë e agjensive të normimit, janë provuar nga vetë pohimet jo të qëndrueshme për ecurinë e normimit të bankave. Analistët e tregut të kredive dhe të tregjeve financiare kanë nxjerrë se në parashikimin e performancës së bankave gjatë krizës së fundit (2008-09) industria bankare imponon një doktrinë rreziku të shumanëshme duke përfshirë nivelin e ndihmës së jashtme që marrin (p.sh. nga Qeveritë), duke rishikuar impaktin e saj në riformimin e faktorëve të rrezikut ndaj të cilëve bankat janë riekspozuar.

Në këtë mënyrë, vlerësimet e besueshmërisë së bankës duhet të përfshijnë në analizë llogaritjet matëse për lidhjen me shkallën e rrezikut sistematik që kanë bankat me probleme në kërkim të një mbështetjeje të mundëshme financiare nga jashtë. Kësisoj edhe me adresimin e këtyre skenarëve në luhatshmërinë e përcaktorëve të brendshëm të performancës së bankave.

Përderisa bankat luajnë rol kyç si ndërmjetës financiarë, ato duke qenë se përbëjnë edhe problem publik, shpeshherë nuk përfitojnë vetëm nga mbështetja e institucionit amë sikurse ndodh me çdo firmë tjetër, por edhe nga autoritete publike sikurse janë qeveritë apo institucionet ndërkombëtare ndërshtetërore p.sh. FMN. Kriza e fundit ka dëshmuar se mbështetja apo ndihma ndaj bankave mund të vijë në forma të ndryshme p.sh. si injektim kapital, si blerje aktivesh ose si provizionim apo kreditim për likuiditet.

Kur ka një angazhim për të mbështetur aftësinë kreditore të një banke, qoftë në mënyrë të dukshme apo të nënkuptueshme, agjencia e normimit duhet të vlerësojë jo vetëm aftësinë e institucionit mbulues apo të sovranit p.sh. aftësinë e qeverisë për të nderuar këtë angazhim, por edhe gatishmërinë e tyre p.sh. të qeverisë për të bërë këtë. Indeksi i borxhit sovran në thelb përmban indeksimin e aftësisë së vetë qeverisë së vendit që ka gjeneruar dhe/ose akumuluar këtë borxh (Alfaro, Laura, Kanczuk -2006)⁵⁷. Kjo d.t.th., se në shumë vende të ngjashme me Greqinë p.sh. Portugalia, Irlanda, Spanja, Italia, etj., u përmend mundësia e financimit të bankave në vështirësi nga qeveritë e këtyre vendeve, por ajo që rezultoi është se në këto vende e sidomos në Greqi, ishin vetë qeveritë në krizë dhe në paaftësi financiare për të përballuar 'shpëtimin' e bankave nëpërmjet financimeve. Ndërsa për vende të tjera sikurse janë Gjermania, Holanda, SHBA, etj., u vërejt një dukuri e përkundërt.

Në këto vende Qeveritë kishin mundësitë dhe mjaftueshmërinë financiare të veta që të financonin bankat në vështirësi të vendeve të tyre, por këto qeveri nuk patën vullnetin dhe dëshirën për një ndërhyrje të tillë.

Nga ana tjetër, edhe nëse mbështetja mund të pritët të jetë e fortë, në shumicën e rasteve, ajo që ka rëndësi është disponueshmëria për ta bërë atëherë kur banka ka nevojë për të. Kjo sugjeron që korrelacioni ndërmjet stresit të bankës dhe burimit të mbështetjes duhet gjithashtu të ekzaminohet. Duke pasur parasysh për bankat me probleme, rëndësinë e mbështetjes financiare nga jashtë, agjensitë e normimit, në përgjithësi përkatësojnë të paktën dy vlerësime normuese të ndryshme për bankat, të cilat referohen si "normim më vehte apo specifik për një bankë" dhe "si normim për të gjitha bankat".

Një normim vlerësues më vehte apo i veçantë për çdo bankë, pasqyron forcën e brendshme financiare të institucionit dhe në këtë mënyrë, përcakton gjasat e kësaj banke për të falimentuar, duke mos anashkaluar faktin se bëhet për rrethanat kur banka është supozuar se nuk ka pritshmëri që të ketë mbështetje financiare nga jashtë.

Përveç konsideratës për vlerësim normues më vehte, të të gjithë faktorëve vlerësues për gjasat dhe madhësinë e mbështetjes financiare nga jashtë që banka ka nevojë dhe mund të

⁵⁷ Alfaro, Laura and Fabio Kanczuk (2006). Sovereign Debt: Indexation and Maturity. Inter-American Development Bank Working Paper 560, Washington, D.C.

marrë, në modelet e normimit është shtuar edhe për faktin se këto ndihma kanë pasur varësi të lartë me vetë gjendjen financiare të qeverive financuese të bankave.

Përfundimisht duhet pohuar se në vendet ku bankat kanë shkallë të lartë sigurie, problemi qëndron se sa do të çënohet mbarëvajtja e bankave nga rreziku i vendit, ndërsa në mjedise ku qeveritë janë në shkallë të lartë sigurie financiare, problemi shtrohet se sa do të çënohen financat publike dhe taksë paguesit kur qeveria financon humbjen e bankave. Nga ana sociale kjo rrezikon të vendosë depozituesit në vështirësi financiare dhe konflikte kontraktuale.

Normimi i rrezikut të vendit nga shumë autorë deri më 2006 është parë si një faktor jo përcaktues me rëndësi për normimin e fuqisë financiare të një banke. Ndërsa agjensitë që kanë ofruar modelet normuese nuk e kanë injoruar këtë faktor duke e analizuar në nivel ekonomie, industrie dhe banke p.sh. modeli i normimit të Standard&Poor's i sheh faktorët makro dhe mikro të lidhur edhe në spektër kohor afatshkurtër dhe afatgjatë. Në këtë aspekt akademikët argumentojnë se banka duhet parë në kontekstin e rrezikut të vendit ku operon, që d.t.th., se nëse një bankë tregtare e huaj operon në një vend që ka nivel të caktuar të rrezikut të vendit p.sh. A, kjo d.t.th., se edhe banka si korporatë që operon në këtë vend nuk mund të tejkalojë shumë normimin e vendit p.sh. mund të normohet AA. Në plotësim të kësaj, banka ka prirje më të lartë të ekspozimit ndaj impaktit të rrezikut të vendit, prandaj kërkohet një denduri më e lartë e analizës monitoruese. Kjo vlen për të gjitha strukturat financiare dhe aq më shumë për tregjet financiare.

Në disa nga ekonomitë e vendeve në zhvillim nuk ka tregje financiare të mirëfillta, madje edhe tregu ndërbankar është shumë dormant dhe nuk ka transaksione. Shumë vende sikurse edhe Shqipëria ka sistem bankar pa treg ndërbankar, sepse:

- (a) nuk ka akses në mjediset financiare ndërkombëtare (as rajonale e as globale);
- (b) bankat e nivelit të dytë operojnë nëpërmjet Bankës së Shqipërisë për financim likuiditetesh (nuk ka asnjë transaksion që bankat e nivelit të dytë t'i huajapin njera tjetrës.
- (c) Shqipëria nuk ka instrumenta financiare dhe as transaksione të standardizuara financiare që d.t.th., se nuk ka treg shumë aktiv afat shkurtër, prandaj mungojnë edhe kreditimet e brendaditëshme, kreditimet për një natë, kreditimet javore, etj⁵⁸.

Gjithsesi në modelet e normimit të vendeve në zhvillim një mungesë e tillë anashkalohet dhe tregu ndërbankar nuk sendërtohet në indikatorë apo faktorë. Kontributi në literaturë që ofrohet me këtë punim konsiston në faktin se rreziku i vendit është më ndikues dhe përcaktues në rrezikun e tregut financiar të vendit, çka d.t.th., se nëse me bankat mund të hasen rrethana që një bankë të tejkalojë një vend me A në siguri më të lartë AA, për tregjet nuk bëhet fjalë për një gjë të tillë, prandaj barazvlerësi i sigurisë në tregje barazon atë të vendit, e thënë ndryshe nëse një vend normohet AA, tregjet financiare të tij nuk mund të jenë mbi AA por nën p.sh. A⁻.

Fakti që në Shqipëri nuk ka treg ndërbankar nuk d.t.th., se bankat janë të paimplikuara dhe të izoluara nga transmetimi i rrezikut me njera tjetrën. Kjo sepse bankat mbajnë firma që janë kliente të ndërsjellta të njëra tjetrave, janë firma që shesin me arkëtim të mëvonshëm dhe blejnë me pagesë të mëvonshme duke pasur llogaritë nëpër banka të ndryshme. Në këtë skemë shumë të ndërthurur operohet ekspozimi në rrezik i një kredie me probleme. P.sh., nëse firma shitëse me pritje X është huamarrëse tek banka ABC, atëherë shlyerja e kredisë që firma X do bëjë ndaj bankës ABC varet nga rreziku që firma X ka për të arkëtuar klientët e saj (duke përfshirë edhe qeverinë në këtë grup klientele).

⁵⁸ Hoti, I, Përjasje të Reja në Doktrinën e Identifikimit, të Vlerësimit dhe të Kontrollit të Rrezikut Sistemik dhe Specifik në Industrinë Bankare të Shqipërisë, Phd Dissertacion. UBT, Shqipëri, 2012.

Kjo d.t.th., se rreziku i kredive tregtare shndërrohet në rrezik bankar. Pra rreziku i kredisë së firmave shitëse me pritje bën që këto të rrisin ekspozimin e rrezikut të huamarrjeve nga bankat, duke shndërruar rrezikun e mos arkëtimit të shitjeve me kredi në rrezik mospagese apo në rrezik likuiditeti duke mos paguar bankën⁵⁹.

Kjo provokon një analizë më të zgjeruar por për modelin që është objekt i ynë do të përbëjë një element kushtëzues që duhet marrë në konsideratë sepse bashkë me zinxhirin e debi kredive apo të vlerave, krijohet edhe zinxhiri i transmetimit të rrezikut, duke u mbarsur me energji potenciale për të shndërruar rrezikun idiosinkratik në rrezik sistemik.

Tregu ndërbankar përfshin llogari që bankat e pranishme të mbajnë njëra me tjetrën për të kryer transaksione të klientëve të tyre. Prandaj quhen edhe *llogari për marrëdhënie me bankat*. Sipas doktrinës normative në përmbushjen e detyrimeve ndërbankare (*interbank settlement obligation*) hasen 3 mënyra:

1- Bankat i dërgojnë, drejtpërsëdrejti para njëra tjetrës për të përmbyllur detyrimet ndërmjet klientëve.

2- Bankat transferojnë pronësi [tituj] ndaj llogarive me njëra tjetrën, kundrejt shumës për të paguar.

3- Bankat rregullojnë pagesat, nëpërmjet një banke të tretë ku kanë llogaritë dhe që quhet bankë korrespondente (*correspondent bank*).

Në të tre këto alternativa për bankat ka kosto oportune dhe rrezik me rezultante rrezikun e kredisë, rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun e pamjaftueshmërisë kapitale. Nga ana e agjensive të normimit financiar të bankave nuk ka një pohim eksplisit për pranimin e skenareve rrjedhëse nga transaksionet ndërbankare. Edhe punime të dedikuara për këto probleme në vendet në zhvillim nuk ka.

Prandaj ne mendojmë se duhet që të rishihet një drejtim për përsosjen e modelit nëpërmjet ndikimit dhe peshës së këtij ndikimi që do të provohet në kohë. Gjithsesi shihet me vend që pas formimit dhe rrahjes së oportuniteteve që duhen për perfeksionimin e modeleve, të jepet opinioni i ekspertëve dhe akademikëve për secilin model normimi.

2.5- MODELET NORMUESE TË KOMPANIVE MË TË MËDHA TË NORMIMIT

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur shpalosim këndvështrimet më ndikuese për modelet normuese të Fitch, Moody's dhe Standard & Poor's.

Fitch

Metodologjia Fitch parashikon më vehte normimin apo sikurse quhen nga vetë agjensia parashikon "*Ratings individuale*". Për lehtësi krahasimi, përpilohet një tabelë e hartës së rrezikut që shërben për t'i përkthyer në shkallë më të ndarë rreziku duke informuar për rrezikun e dështimit të emetuesit ("*Issuer Default Ratings*").

Për të rritur transparencën e normimit vlerësues gjithëpërfshirës, Fitch publikon nivele të veçanta normuese me një shkallë pesë nivelore apo pesë pikësh, e projektuar për të kapur edhe gjasat dhe përmasat e përkrahjes së jashtme apo të financimeve mbështetëse që pritët të ketë një bankë nga Qeveria apo nga një pronar tjetër institucional. Në rastet kur këto normime vlerësuese pasqyrojnë rezistencë nga Qeveria për të mbështetur financiarisht një bankë, atëherë sipas kësaj pritshmërie Fitch raporton një nivel dysHEME për mbështetje financiare të

⁵⁹ Ibid

mundshme nga qeveria, që i referohet një shkallë të raportuar rreziku për bankën veças që është e njëjtë me shkallën e normimit gjithëpërfshirës.

Kjo duhet kuptuar se Fitch shpall një normim vlerësues për vetë mbështetjen financiare të bankës që varësohet nga niveli i mbështetjes, shpejtësia e ofrimit dhe afati i përdorimit të saj. Kështu një bankë që ka gjasa më të larta për tu mbështetur nga qeveria normohet në nivel më të lartë se një bankë tjetër që sipas politikës së qeverisë konsiderohet se nuk duhet mbështetur apo bëhet një mbështetje shumë e vogël/fiktive. Në këtë mënyrë Fitch ka synuar të bëjë lidhjen ndërmjet normimit të veçantë dhe atij gjithëpërfshirës.

Në mesin e vitit 2011, agjensia Fitch e konvertoi përbërjen nivelore të normimit nga 5 pikë nivelore në 19 pikë, e cila i korrespondon saktësisht normimit gjithëpërfshirës. Shkalla e re e normimit më vehte ofron segmentim më të hollësishëm në vlerësimet e Fitch për fuqinë financiare si dhe duke marrë dhe shprehur më qartë mbështetjen financiare probabël që një bankë pret të ketë nga qeveria.

Për Fitch këto vlerësime janë përdorur si futje në modelet e normimit të rrezikut të vendit se sa të rrezikut individual të bankës. Në vitin 2005, Fitch përfshiu dy përmasa të rrezikut, ku e para mishëron një qasje nga poshtë lart (*bottom up approach*) sepse barazon nivelin mesatar të normimit vlerësues si sistem bankar duke u bazuar në secilën bankë të analizuar më vehte.

Indikatori i parë i rrezikut sistemik përfshin një qasje poshtë-lart, ku niveli i normimit vlerësues të rrezikut të krejt sistemit bankar është mesatare e normimit të bankave individuale. Indikatori i dytë i rrezikut sistemik përfshin treguesit makro të projektuar për të identifikuar çdo rritje anormale të kredisë bankare për sektorin privat si dhe çdo rritje të pazakonshme të gjëndjes së aktiveve dhe luhatjes së çmimit të tyre. Një analizë të hollësishme të pohimeve të mësipërme jepet në mënyrë të qartë në punimin e Borio dhe Lowe (2002)⁶⁰ ku kundërtia më e ashprë që pohohet është ajo e burimit të të dhënave për të dy drejtimit e mësipërme.

Përfundimisht duhet thënë se Fitch për vlerësimin e forcës së brendëshme financiare të bankave apo të rrezikut të secilës bankë më vehte bazohet në analizën kontabël të likuiditetit dhe të financimeve, qoftë sipas zërave të bilancit po ashtu edhe për zëra dhe derivativa jashtë bilancit (qoftë për detyrime kontigjente apo të mundëshme nga angazhim garancirash, letër-kredie, etj.; po ashtu edhe për të drejta kontingjente nga palë që garantojnë llogaritë e arkëtueshme.

Për vlerësimin e rrezikut gjithë-përfshirës (*all in rating*) Fitch vëmendësohet në probabilitetin që ka një bankë për mbështetje financuese nga qeveria, duke përcaktuar një nivel dysheme. Fitch e sheh të lidhur këtë me rrezikun e vendit, prandaj përkrah modelin ku niveli i rrezikut të bankave ka ndërvarësi me nivelin e rrezikut të vendit.

Në këtë mënyrë Fitch ofron një vlerësim për mbarë sistemin. Rreziku që paraqet dështimi i Qeverisë, firmave dhe individëve të një vendi për të shlyer detyrimet ndaj palëve investitore apo kreditore rezidente dhe jo rezidente në vendin në fjalë. Rreziku i vendit është dilema më me peshë në vendimmarrjen për të investuar ose jo në një vend të dhënë.

Në parim duhet thënë sesa më shumë hapet ekonomia e një vendi për investitorët e huaj, turizëm, eksport/import kapitalesh, etj., aq më vëmendje i përkushtohet rrezikut të atij vendi. Duke rikërkuar për një mbulim më të gjerë të rrezikut të vendit (*country risk*), pohimi bazë se ky rrezik është rreziku që Qeveria, firmat dhe individët e një vendi, të dështojnë për të shlyer detyrimet ndaj palëve kreditore/investitore është pika më me peshë në shkallën e likuiditetit që sistemi bankar paraqet ndaj depozituesve dhe për mjaftueshmërinë kapitale që banka paraqet në marrëdhënie me autoritetin rregullator (Bankën Qendrore).

⁶⁰ Borio, C and P Lowe (2002): "Assessing the Risk of Banking Crises", *BIS Quarterly Review*, December.

Modeli Fitch ka motivuar shumë shkrime ku vendimmarrja për të investuar në një vend kërkon referim tek institucionet spikatëse në normimin e rrezikut për vende të ndryshme. Institucioni më autoritar shumëpalësh investues, që investon në njohjen, vlerësimin dhe përgjigjen financuese me projekte të ndryshme ndaj rrezikut të çdo vendi është Agjensia Shumëpalëshe e Garantimit të Investimeve (*Multilateral Investment Guarantee Agency - MIGA*) që vepron brenda strukturës së Bankës Botërore.

Shqipëria është shumë e vonëshme në përcaktimin e normimit dhe gjithçka është në mënyrë dhe masë fillestare (jo më shumë se 10 vjet). Kjo rrit koston kohore të punimit për informacion dhe seri kohore më të pasur. Shqipëria është normuar duke u vlerësuar nga Moody's dhe S&P, duke mos u normuar nga agjensitë e tjera të normimit të rrezikut të vendit (*country risk rating agencies*) dhe as nga subjekte të fushës ku përfshihen *Investitorët Institucionalë (Institutional Investor)*, *Njësia e Informacionit të Ekonomistit (Economist Intelligence Unit)*, *Shërbimi i Rrezikut Politik (Political Risk Services)*, si dhe *Udhëzuesi i Rrezikut të Vëndit (International Country Risk Guide)*.

Metodat e përcaktimit të rrezikut të vendit janë të lidhura me ndikim të ndërsjellë me modelet e normimit të bankave në këto vende. Megjithëse nuk ekziston akoma një standard ndërkombëtar për llogaritjen e rrezikut të vendit, e përbashkëta është se të gjitha agjensitë marrin në konsideratë pak a shumë të njëjtët komponentë përbërës të rrezikut të vendit.

Në modelet e normimit të bankave shumë autorë i referohen analizës përbërëse të këtij rreziku. Rreziku i një vendi përbëhet nga *rreziku ekonomik (economic risk)*, *rreziku politik (political risk)* dhe *rreziku financiar (financial risk)*, të cilat mishërohen respektivisht në mundësinë/aftësinë dhe dëshirën/vullnetin që ka një vend [Qeveria, firmat, institucionet dhe individët e tij] për të shlyer detyrimet.

Për këtë arsye aty ku mungon stabiliteti ekonomik dhe ai politik rreziku i vendit është kërcënues dhe kjo përcakton gjeografinë e rrezikut të vendit që i përket vendeve të Amerikës Latine, vendeve të Europës Lindore dhe të Azisë. Prandaj vendim-marrjet për të investuar dhe vlerësuar bankat në këto vende janë shumë të vështira.

Moody's

Metodologjia Moody's bazohet në versionin e ri modelor që u paraqit në fillim të vitit 2007 si model normues përpara nisjes së krizës financiare 2008-09. Kjo metodologji njihet si *Analiza e Përbashkët për Dështim (joint default analysis –JDA)* dhe nga studimet e vlerësimit e Moody's provohet se denduria e dështimeve të bankave ka qenë qendrueshmërisht më e ulët se sa dështimet e korporatave jo-banka që kanë pasur normë të barabartë vlerësimi/normimi.

Metodologjia për vlerësimin e rrezikut të bankës i merr normimet që Moody's bën për çdo bankë më vehte (*stand alone ratings*) si nivele pikënisëse për një normim gjithëpërfshirës. Moody's i quan këto si *'Normime të Forcës Financiare të Bankës' (bank financial strength ratings -BFSR)* apo normime të emetuesit. Kjo agjensi ofron një shtrirje modelore për normim gjithëpërfshirës duke marrë në konsideratë edhe mbështetjet financiare që bankat mund të kenë nga qeveritë ose nga palë interesi/pronare.

Moody's vlerëson 4 tipe mbështetjesh, konkretisht:

- (a) mbështetja nga institucioni operues amë (*operating parent*);
- (b) mbështetja nga grupi bashkëpunues (*cooperating group*),
- (c) mbështetja nga niveli qeveritar lokal/rajonal dhe
- (d) mbështetja nga qeveria qendrore.

Vlerësimi i tyre mpleks rrezikun e vendit me rrezikun e sistemit bankar. Të gjitha këto pasqyrojnë aftësinë apo kapacitetin garantues, vullnetin dhe qendrueshmërinë për mbështetjet ndaj bankës nga secili prej katër palëve mbështetëse me financim ndaj bankës.

Moody's nuk boton posaçërisht ndonjë përmbledhje për rrezikun e sistemit bankar, por në botimet e saj nënkuptohet pjesa e sistemit bankar. Në lidhje me mbështetjen financiare ndaj një banke Moody's arsyeton që një ent qeveritar apo subjekt institucional mbështetës e ka të vështirë ta realizojë atë, nëse banka ka të njëjtat ekspozime në rrezik sikurse pjesa e mbetur e sistemit bankar apo financiar. Nga ana tjetër bankës mund të mos i ofrohet mbështetja financiare kur realisht i duhet dhe e kërkon, p.sh kur përjeton stres financiar të lehtë, prag kritik, etj, por kur mundet ose ka vullnetin për ta ndihmuar qeveria apo enti rregullator/mbikëqyrës.

Reagimi i Moody's ndaj krizës financiare (2008-2013) ka qenë rikalibrimi i peshës së faktorëve që përfshihen në modelin e normimit. Konkretisht përpara krizës, faktorët e mbështetjes financiare nga qeveria kishin peshë të ulët, ndërkohë që me krizën u krijua një rrethanë e re, ku mbështetja qeveritare shmangete falimentime të mëdha. Përgjatë krizës dëshira dhe prirja e qeverive ishte për mbështetje financiare gjithëpërfshirëse. Fakti rezultoi shumë i lartë nga sa pritej nga Moody's.

Kësisoj normimi i bankave specifike që u ndihmuan financiarisht nga qeveritë, dha ndikim në totalin e normimit gjithëpërfshirës së krejt sistemit. Ndikimi ishte rezultat pikërisht i një honi ndërmjet dy niveleve të normimit (të pritshëm dhe fakt) në lidhje me ndihmën qeveritare ose të palëve të tjera. Aspekti plotësues është se thellësia e krizës, në shumë autorë dhe në vetë agjensinë Moody's ngriti pyetje rreth aftësisë së disa qeverive apo enteve sovrane për të ofruar ndihmë financiare ndaj bankave, duke implikuar edhe komunitetin politik ndërkombëtar –p.sh, të Bankës Botërore, FMN, etj, për të ndihmuar apo jo qeveritë për financim ripërtëritës të bankave.

Duke parë nga njëra anë, qendrimet e rrepta institucionale, sipas të cilëve vetëm një qeveri me një program të qartë e të zbatueshëm antikrizë mund të financohet për të mbështetur sistemin bankar, dhe nga ana tjetër duke parë se qeveri të tilla kishte shumë pak, atëherë Moody's uli peshat ndaj faktorëve përfshirës të mbështetjes qeveritare të bankave në modelet e normimit. Kjo u vërejt nga sjellja e tillë e Moody's për të gjitha vendet dhe qeveritë që kishin rrezik politik jo AAA.

Rreziku politik (*political risk*) si nga Moody's dhe shumë autorë identifikohet dhe vlerësohet si rrezik që nuk buron nga biznesi i firmës por nga forca e ngjarje politike të brendshme, të jashtme dhe të kombinuara që çenojnë fitimshmërinë e bizneseve të huaja dhe me kapital të përbashkët (*joint venture*) në vend. Shqipëria të gjithë sistemin bankar e ka në përkatësi kapitali të huaj dhe e ka të ekspozuar nga rreziku politik nëpërmjet ekspozimit të firmave huamarrëse. Konkretisht në kontekstin e Shqipërisë, rreziku politik ka probabilitet të papërfillshëm për tu konsideruar nga ngjarje të ashpra si p.sh., luftrat civile, lëvizjet sociale, konfliktet ndërfetare, ndëretnike, etj.

Në thelb faktorët themelorë lidhen me lëvizjet masive të popullsisë migrim/emigrim me shkallën e lartë të sjelljes 'acide' të forcave politike. P.sh., bankat në vitin 2004-2008 kanë krijuar humbje nga portofoli i kredive duke rritur kreditë me probleme për mbi 4 herë. Kjo periudhë është kur vendimet për të kredituar kanë qenë nën ndikimin e forcave politike, duke rritur numrin e kredive overdraft të pashlyer për shkak të largimeve nga puna, të firmave që futen në biznes për propaganda joshëse tatimore p.sh, sepse deri në 80 mln lek nuk do të paguhet TVSH, kur në fakt pas 2 vitesh ndryshon ligji duke e shtrirë aplikimin e TVSH tek të gjitha bizneset.

Sjellja e paqëndrueshme ndaj politikave fiskale, nga taksë progresive për periudhën 1992-2005, në politikën e taksës së sheshtë për periudhën 2006-2013 dhe duke u rikthyer edhe njëherë në taksën progresive për 2014, krijon prirje që mundësia e qeverisë shqiptare për të financuar bankat të jetë thuajse zero. Aspekt plotësues i kësaj është edhe fakti se vetë bankat

futen në rrethin vicioz për të ashpërsuar koston e krizës nëpërmjet financimit të borxhit qeveritar (Golosov, Sarg 2012)⁶¹.

Konkretisht bankat në Shqipëri duke përjetuar rrezik të lartë në krahun e kredive (për shkak të rritjes së kredive me probleme apo të rritjes së NPL nga 3-4,5%₂₀₀₅ në 28-32%₂₀₁₃) kanë diversifikuar aktivet duke u prirur drejt investimeve në zërat me më pak rrezik dhe kryesisht në të mira thesari. Gjatë periudhës 2007-2014 paralel me rritjen e borxhit të emetuar të qeverisë, bankat kanë trefishuar peshën e investimeve afatshkurtër në të mira thesari nga 1,5% në 5.4%. Krijimi i një portofoli me të mira thesari e ka ulur nivelin mesatar të shlyerjes së bankave duke krijuar problem me pronarët e bankave që synojnë maksimizimin e fitimit nëpërmjet një norme të kërkuar shlyerje shumë më të lartë.

Problemi në fjalë krijon specifikë të ekspozimit në rrezik të bankave në vendet me ekonomi në zhvillim dhe posaçërisht në Shqipëri duke vlerësuar se faktorët makroekonomikë dhe ato industrial tek bankat ndikojnë më shumë tërthorazi nëpërmjet subjekteve huamarrëse të tyre p.sh, rritja e inflacionit, luhatshmëria në politikën tatimore, ciklet politike që kundërtojnë ciklikën e bizneseve me varësi të lartë politike, ndryshimi i strukturës ligjore dhe nënligjore në biznesin e firmave huamarrëse, etj. Të gjitha këto krijojnë një prirje për një model që shmanget nga struktura e treguesve makro që aplikon *Moody's*.

Çdo subjekt biznesi që kërkon të investojë në një vend të huaj, studjon se ç'rrezik paraqet ky vend në shlyerjen e investimit që kryhet si dhe fitimin që realizon. Për disa ekonomistë rreziku i vendit është koncept që shtrihet edhe brenda të njëjtit vend, kur investimi mendohet të kryhet në zona me diferenca të mëdha në zhvillimin ekonomik, politik dhe shoqëror.

Për të përkuar sa më shumë me kriteret e normimit që aplikohen dhe rekomandohen nga shoqëritë e normimit dhe nga punimet e ndryshme për këtë qëllim, një vend me peshë kërkimore dhe studimore, investitorët për të investuar në një vend i referohen indekseve të rrezikut të vendit që raportojnë agjensitë ndërkombëtare të normimit të rrezikut. Në mënyrë kumulative debati është zhvilluar si për ndryshoret, peshat e tyre dhe propozime për përfshirje të ndryshoreve të reja.

Konkretisht *Moody's* përdor 22 ndryshore që përfaqësojnë 3 komponentët e rrezikut të vendit:

1-Rrezikun politik që bazohet në 12 ndryshore

1/(a) Qendrueshmëria e qeverisë (*government stability*) me normim nga 0 deri 12,

1/(b) Kushtet socioekonomike (*socio-economic conditions*) me normim nga 0 deri 12,

1/(c) Profili i investimit (*investment profile*) me normim nga 0 deri 12,

1/(d) Konfliktet të brendshme (*internal conflict*) me normim nga 0 deri 12,

1/(e) Konfliktet të jashtme (*external conflict*) me normim nga 0 deri 12,

1/(f) Korrupsioni (*corruption*) me normim nga 0 deri 6,

1/(g) Prania e ushtarakëve në politikë (*military in politics*) me normim nga 0 deri 6,

1/(h) Tensionet Fetare (*religious tensions*) me normim nga 0 deri 6,

1/(i) Prania e ligjit dhe e rendit (*law and order*) me normim nga 0 deri 6,

1/(j) Tensionet etnike (*ethnic tensions*) me normim nga 0 deri 6,

1/(k) Llogaridhënia demokratike (*democratic accountability*) me normim nga 0 deri 6,
dhe

⁶¹Golosov, M, Sarg, T, "Taxation, redistribution, and debt with aggregate shocks" Princeton University press July 2012.

1/(l) Cilësia e Burokracisë (*bureaucracy quality*) me normim nga 0 deri 4],

2- Rrezikun ekonomik që bazohet në 5 ndryshore

2/(a) Prodhimin e përgjithshëm të vendit për njësi popullsie (*GDP per head of population*) me normim nga 0 deri 5,

2/(b) Rritjen vjetore reale të *GDP* (*real annual GDP growth*) me normim nga 0 deri 5,

2/(c) Normën vjetore të inflacionit (*annual inflation rate*) me normim nga 0 deri 10,

2/(d) Tepricën buxhetore si përqindje ndaj *GDP* (*budget balance as a percentage of GDP*) me normim nga 0 deri 10 dhe

2/(e) Tepricën e llogarisë rrjedhëse si përqindje ndaj *GDP* (*current account balance as a percentage of GDP*) me normim nga 0 deri 15] dhe

3-Rrezikun financiar që bazohet në 5 ndryshore:

3/(a) Borxhi me jashtë si përqindje ndaj *GDP* (*foreign debt as a percentage of GDP*) me normim nga 0 deri 10,

3/(b) Shlyerja e borxhit me jashtë si përqindje ndaj eksportit në mallra dhe shërbime (*foreign debt service as a percentage of export in goods and services*) me normim nga 0 deri 10,

3/(c) Llogaria rrjedhëse si përqindje ndaj eksportit në mallra dhe shërbime (*current account as a percentage of export in goods and services*) me normim nga 0 deri 15,

3/(d) Likuiditete neto si mbulesë në muaj e importeve (*net liquidity as months of import cover*) me normim nga 0 deri 5 dhe

3/(e) Qendrueshmëria e kursit të këmbimit (*exchange rate stability*) me normim nga 0 deri 10.

Standard & Poor's

Agjensia e normimit *Standard and Poor's* (S&P) është ndoshta agjensia që ka propozuar dhe ndërmarrë më shumë rishikime se sa agjensitë e tjera. Në këtë vështrim shumë forca kërkimore e studimore janë vëmendësuar në ecurinë e veprimtarisë së S&P sepse kjo agjensi ka përmirësimet më ritmike në metodologji që nga kriza financiare. Ndonëse edhe për modelet e S&P nuk ka një rivijëzim fundor, ndërkohë që kjo agjensi po risheh nxitjen e transparencës me bankat që i normon më vehte kreditë (*stand-alone credit risk*), duke i raportuar si 'profile më vehte të kredisë' (*stand-alone credit profiles*).

Kjo i shërben edhe lidhjes së agjensisë më shumë me klientët të cilët shohin besueshmëri më objektive dhe cilësisht më të dobishme duke u bazuar në vlerësimet e rrezikut të vendit për industrinë bankare (*Banking Industry Country Risk Assessments* -BICRA). S&P do të vlerësojë dhe normojë rrezikun e industrisë dhe rrezikun ekonomik ose financiar të vendit dhe duke i kombinuar të dy vlerësimet e rrezikut do të formojë nivelin e BICRA. Më pas S&P do të bazohet tek bankat më vehte dhe duke u fokusuar tek një bankë e veçantë, S&P do të përftojë:

(a) komponentin për rrezikun e industrisë dhe

(b) mesataren e peshuar të komponentëve të rrezikut ekonomik dhe /ose financiar të pikëve BICRA sipas të çdo vendi ku operon banka.

Aktualisht S&P ofron informacion javor për normimin e kredisë së emetuesve [huamarrësve qeveritarë] më spikatës në 77 vende dhe në afatshkurtër e afatgjatë. Normimet ofrohen për 7 drejtime bazë:

- 1-Borxhi afatgjatë (*long-term debt*),
- 2-Letrat tregtare (*commercial paper*),
- 3-Aksionet e preferueshme (*preferred stock*),
- 4-Çertifikatat e depozitave (*certificates of deposit*),
- 5-Fondet e tregut të parasë (*money market funds*),
- 6-Bonde të fondeve të ndërsjella (*mutual funds bond*) dhe
- 7-Aftësia paguese e shoqërive të sigurimit ndaj të siguruarve që kërkojnë kompensim dëmi (*claims-paying ability of insurance companies*).

Kombinimi i komponentit për rrezikun e industrisë me mesataren e peshuar të komponentëve të rrezikut ekonomik dhe /ose financiar krijon një pikë/fiksuese apo ankorë për bankën. Përfundimisht forca apo dobësia e një banke e parë në mënyrë specifike apo më vehte shpie në krijimin e profilit të ankorimit të bankës.

Agjensia Standard & Poor's ka rishikuar edhe analizat për normimin specifik të pasigurisë dhe të rrezikut specifik ose më vehte të bankave. Kjo me synimin për të lidhur më mirë profilet e rrezikut individual të bankave me ato të rrezikut tërësor si sistem. Ky prospekt i agjensisë do të kryhet duke vendosur më pak theks në diversifikimin e përfitimeve dhe më shumë vëmendje në rrezikun për derivativat ku është kontraktuar/eksponuar banka apo për zërat jashtë bilancit si dhe për instrumentat e financave të strukturuar.

Analiza e fitimeve do të përqendrohet në treguesit e mbarëvajtjes së korigjuar për rrezikun (*risk adjusted performance -RAP*) dhe në aftësinë për të përdorur portofolet e mbajtura nga bankat për rritjen e nivelit të kapitalit të bankës. Përveç kësaj në ekspozimin e bankës për mbështetje financuese nga jashtë dhe në përcaktimin e rolit që ka qeveria ose një institucion për këtë mbështetje, kërkohet ripërcaktimi se në cilat *rrethana të jashtëzakonshme* banka duhet ta përfitojë dhe qeveritë apo grupet mbështetëse janë të gatshme ta ofrojnë në përmasën e duhur këtë financim. Kjo varet nga rëndësia sistemike që ka banka.

Në këtë punim i kushtohet një angazhim si në literaturën e kërkuar po ashtu edhe në modelimin e normimit vlerësues të bankave për të dalluar rrezikun sistematik nga çrregullimet sistemike. Modeli ynë i shërben një sistemi bankar me struktura biznesesh dhe firmash që nuk kanë qendrueshmëri sepse janë në kërkim të një portofoli sa më me efikasitet të pranuar aktivesh e veprimtarish.

Kjo jepet si nga mosha mesatare e ulët e firmave në biznes 10-15 vjet, ulja e moshës së firmës me mbarëvajtje të lartë ndaj moshës totale të firmës në biznes 30-40% (më 2010-2013 nga 55-65% 2006-2009), cënimi i parimit të 'shqetësimit në vijim' (*on going concern*) sepse shumë firma ose mbyllën ose përcaktojnë sjellje sikur operojnë për të likuiduar vetveten ose i njëjti pronar hap edhe mbyll disa firma. Mesatarisht në Shqipëri hapen dhe mbyllën nga 2500-3000 firma mikro, ndërkohë që rritet numri i firmave dormante, të cilat janë hapur dhe janë regjistruar për pezullim biznesi tek autoritetet tatimore lokale. Tek struktura e firmave SME në zonën 15-18% të firmave SME i njëjti pronar figuron me mbi 2 firma si dhe në mbi 3 struktura me ortakëri.

Të gjitha këto shoqërohen edhe me statistikat në rritje të konflikteve gjyqësore për marrëdhënie biznesi. Në një vëzhgim dhe përpunim statistikor të vitit 2013 plus 6-mujorin e

parë 2014, numri i konflikteve është rritur mbi 3 herë për gjithë periudhën 2010-2013 të marrë së bashkë. Rreth 85% e konflikteve në vlerë të bizneseve janë me bankat, ndonëse numri i konflikteve të bizneseve me njëri tjetrin është rreth 5 herë më i lartë, numri i konflikteve në vlerë që bizneset me palët kreditore duke përfshirë (bankat, furnitorët, kreditorë të tjerë) zënë 94% të vlerës së paraqitur për konflikt⁶². Nga ana tjetër ka një numër në rritje edhe të konflikteve të biznesit me autoritetet tatimore.

Nëse analizojmë ashpërsinë e konflikteve, vlerësojmë se të dy palët simetrike më me peshë në konflikt janë bizneset me kreditorët, por që e gjithë kostoja dhe impakti i konflikteve shkon drejt bankës, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë –p.sh, banka në konflikt me bizneset me performancë të dobët që nuk shlyejnë kreditë, por edhe konflikti i bizneseve me kreditorët e tjerë shpie përsëri në bankë, sepse këto biznese kreditore kanë hyrë në konflikt për mosarkëtime të kahershme, duke zëvendësuar mungesën me likuiditet nëpërmjet huamarrjes bankare. Kjo është një rrjedhë që krijon një qerthull duke gravituar çdo borxh të keq drejt sistemit bankar.

Të gjitha këto, motivojnë një studim më të plotë, por për modelin tonë na detyrojnë të insistojmë në dallimin ndërmjet çrregullimeve sistemike dhe rreziqeve sistemike. Me çrregullime sistemike ne kuptojmë mungesën e stabilitetit të sistemit financiar nga falimentimi i një institucioni ose edhe i palëve më me peshë në biznesin e institucionit (huamarrës, depozitues, tatimore, etj.) që gjenerojnë rrezik sistematik. Ndërsa rreziku sistematik konsiderohet si rrezik që haset në një sistem apo rrjet pagesash në atë rast kur një pjesëmarrës dështon për të përmbushur një detyrim i cili transmetohet në mënyrë zinxhir tek palët që kanë marrëdhënie blerës-shitës dhe debi-kredie në treg. Rreziku sistematik është rrezik themelor dhe i padiversifikueshëm, problem mbetet edhe një alternativ e rrezikut puro sistematik –p.sh, katastrofat natyrore, sociale, njerëzore, etj.

Në strukturën e financimeve që sistemi bankar i ka dhënë ekonomisë rezulton se për 60-65% bankat kanë financuar ecuri normale biznesi dhe brenda këtij grupi vetëm 30-35% të kredive janë destinuar të financojnë rritje ekonomike biznesi. Jashtë këtij grupi janë financimet që bankat i kanë bërë humbjeve në biznes, duke formuar portofolin e kredive të këqija. Nëse për cilësinë financuese të bankave ndaj bizneseve me humbje dhe për faktin se bankat vetë kanë rritur peshën e këtyre financimeve (fals negativ) në dëmtimin e portofolit të aktiveve të bankës, modeli i kërkon brenda bankës (si faktor endogjen) dhe jo jashtë saj. Ajo që mbetet si gabim modelor është se shpesh herë çrregullimet sistemike merren gabimisht si rrezik sistematik.

Brenda argumentit të mësipërm duhet dalluar edhe individualiteti i secilës bankë për t'i bërë ballë një rreziku sistematik agregat (spekulativ dhe puro). Bankat me rezerva dhe mjaftueshmëri kapitale të lartë janë më rezistente dhe immune ndaj goditjeve sistemike dhe e kundërta. Kjo përcakton edhe varësinë e vështirësisë së bankës me mundësinë për tu financuar nga jashtë p.sh., nga qeveria apo investitorë institucionalë, gjë që në thelb na drejton përsëri për tek përcaktorë brenda bankës. Nëse banka do të kërkojë 'ndihmë' realizimi i saj do të ndodhë nga tre kushte rrethanore shumë determinuese, së pari duhet që palët potenciale financuese të mos jenë përfshirë në goditjen sistemike (kusht jashtë bankës); së dyti duhet që palët potenciale financuese të lexojnë probabilitet të lartë ripërtëritjeje të bankës (kusht brenda bankës); së treti shkalla e ndërlidhjes dhe marrëdhënieve që krijohen ndërmjet bankave të veçanta dhe palëve potenciale financuese p.sh. me qeverinë.

Koncentrimi i financimit të qeverisë nga bankat përkon shumë edhe me koncentrimin e vetë bankave që është bërë shumë i lartë deri në limitet që kërkon rregullim. Shumë autorë

⁶²Hoti, I, IFIBI 'Report on Incurred but Not Reported Portfolio of Risks from Business Conflicts Analysis and Proliferation to UNIQA Group' –May 2014.

vlerësojnë se Bankat qendrore duhet të aplikojnë indeksin Herfindahl-Hirschman ku përqendrimi bankar analizohet si kërcënim për faktin se në rastet e një bashkëshkrirje bankash p.sh., të një banke të qendrueshme (RBAL) me një bankë me problem p.sh. me NBG, do të krijonte pozitë monopol duke korrutuar tregun dhe si i tillë ky transaksion është i papranueshëm nga autoriteti rregullator i tregut. Problemi shtrohet nëse p.sh., Societe Generale negocion të blejë Credit Agricole duke përvetësuar me bashkëshkrirje portofolin e kredive. Analiza e matricës SWOT sjell dobi për pjesën e tregut ndërbankar apo kufizon më tepër lirinë/konkurrencën.

Shumica e punimeve konvergjojnë në faktin se shkalla e lartë e koncentrimin të bankave për kreditë dhe depozitat rrit ndjeshëm rrezikun e normuar për krejt sistemin apo rrezikun gjithëpërfshirës. Në këto rrethana probabiliteti i falimentimit të një banke është më i ulët se probabiliteti i falimentimit të sistemit. Por nëse një bankë ka shkallë të lartë koncentrimi në marrëdhënie me qeverinë rrit ndjeshëm rrezikun e normuar për qeverinë duke e ekspozuar në një suazë morale. Në këto drejtime S&P ka bërë vlerësime me impakt të pranueshëm, duke analizuar amalgamën e problemeve të mësipërme në bankat e BE, të Azisë.

Rishikimet e propozuara të S&P për metodologjinë ndryshojnë dukshëm edhe normimin e bankave veças po sipas kriterit individual. Duke u bazuar në një studim kërkimor të një kampionature prej 138 bankash, në 58 banka (42%) niveli i normimit të tyre nuk ka ndryshuar, ndërsa në 45 banka (33%) ka ndryshuar ndjeshëm duke i dhënë normim për më me rrezik apo më poshtë, ndërkohë që vetëm 30 banka (25%) i rivlerësuan me nivel të rritur normimi. Duke parë shpërndarjen gjeografike bankat që kanë pësuar rënie në nivelin normues, apo bankat që janë më me rrezik të ekspozuara janë ato të BE, ndërsa bankat aziatike duke përfshirë Australinë dhe Zelandën e Re janë banka me nivel të rritur të sigurisë.

2.5.1- Diferencat në Normim

Diferencat në normim nga agjensitë më të mëdha normuese na kanë shërbyer për të parë diferencat nga modelime të ngjashme me agjensitë dhe më pas nga model i përpunuar që formon edhe përmbajtjen e punimit në fjalë. Studimi më autoritar për krahasueshmërinë e modeleve të Moody's, Standard & Poor's dhe Fitch i përket Packer, Tasharev (2011)⁶³. Analiza bazohet në 70 banka të mëdha si përpara krizës (mesi vitit 2007) dhe pas krizës (prill 2011) duke u prirur në dy perspektiva *së pari* duke kërkuar për tregues e sinjale të ndryshimeve metodologjike kur për banka të njëjta, agjensitë e ndryshme kanë ofruar norma të ndryshme vlerësimi; *së dyti*, duke u vëmendësuar se si kanë ndryshuar nivelet normuese të një banke nga ana e agjensive normuese (a) që nga momenti kur ka nisur kriza e në vijim, (b) për moment/periudha të njëjta por në hapësira gjeografike të ndryshme (vende të ndryshme), (c) ndryshimet e agjensive normuese në lidhje me mbështetjen financiare nga jashtë të bankave në përkatësi të qeverive të ndryshme apo të rrezikut të vendeve të ndryshme.

Studimi përfshin si vlerësimet për rrezikun gjithëpërfshirës (*all-in ratings*) dhe vlerësimin për rrezikun e veçantë/individual të bankës (*stand-alone rating*). Forca financiare dhe nevoja për mbështetje financiare nga jashtë i përket rrezikut gjithëpërfshirës (*all-in ratings*) dhe referohet si normim për ecuri afat gjatë të normimit të emetimit (*long term issuer default rating*) nga Fitch ose 'normim i emetuesit nga Moody's dhe Standard & Poor's. Normimet janë përkthyer në numër-normë nivelor. Konkretisht AAA=20, AA+=19, AA=18, ... C=0. Ndërkohë që diferenca ndërmjet dy normimeve të njëpasnjëshme njihet si dallor (*notch*) p.sh. ndërmjet AAA dhe AA dallori është 2.

⁶³ Frank Packer, Nikola Tasharev "Rating methodologies for banks" BIS Bank 2011.

Studimi shpalos se nivelet e normimit ndërmjet agjensive ka ndryshime që tejkalojnë mbi 2 njësi dallori. Mospërputhjet e agjensive vërehen si ndërmjet bankave individuale po ashtu edhe ndërmjet sistemeve. Nivelin më të lartë të normimit si për nivel individual po ashtu edhe për sistem e ka Moody's. Kjo agjensi i ka perceptuar bankat me shkallë sigurie më të lartë se sa dy agjensitë e tjera (Fitch dhe S&P). Kjo diferencë ka vazhduar shumë e gjerë deri në vitin 2010 kur nis e ngushtohet duke mos tejkaluar një njësi dallori (që nga prilli 2011). Nga ana tjetër vërehet se niveli më i ulët i ndryshimit është ndërmjet Fitch dhe Moody's (1,1-1,3 njësi dallori). Të marra së bashku gjetjet sugjerojnë se konvergjenca në normimin gjithëpërfshirës është për shkak të pikëpamjeve kriterizuese të ngjashme në lidhje mundësinë e mbështetjes nga jashtë të bankave, ndonëse kanë dallime të ndjeshme në vështrimin që agjensitë japin për banka individuale.

Cilësimi për më poshtë në nivel sigurie i sistemit financiar global për shkak të krizës, ka maskuar disa diferenca goditëse për bankat që krahasohen për rajone të ndryshme gjeografike. Të gjitha agjensitë konvergjojnë në uljen e normimit për bankat e SHBA dhe të BE, duke pohuar njëkohësisht se pozicioni i epiqendrës së krizës është pikërisht në këto dy rajone gjeografike.

Por, për dallim me njëratjetrën, agjensitë kanë ulur shumë pak vlerësimin e vlerës së besueshmërisë dhe të forces financiare të bankave Aziatike dhe të Paqësorit. Me shpalosjen e problemeve dhe të asimetrisë informative të Krizës, normimet gjithëpërfshirëse pësuan rënie më pak se mesatarja e rënies së normimeve individuale të bankave. Kësisoj, pavarësisht nga çështja në lidhje me dëshirën dhe kapacitetin e qeverive të ndryshme për të ndihmuar banka në veçanti të territoreve politike të tyre, përsëri rezultati në 2007 ishte një hon më i madh ndërmjet normimit individual dhe atij gjithëpërfshirës. Sipas vendeve të veçanta niveli më i lartë i ndryshimit të normimit në kah pozitiv për shkak të mbështetjeve financiare që qeveritë dhanë për bankat, haset në SHBA dhe në Britaninë e Madhe (*Drehman Tarashev -2011*)⁶⁴.

2.6- ASPEKTE TË ARDHME TË NORMIMIT BANKAR

Normimi rënës i sektorit bankar që përkon me krizën nuk rezulton se do të përfshijë tregues optimistë për ta ndryshuar atë, sepse nuk ka sinjale pozitive të një kthese që duhet të krijojë optimizëm të sigurtë. Mësimet kryesore nga pësimet e krizës, ndriçuan çështjet që lidhen me rrezikun sistematik, me luhatshmërinë e mbarëvajtjes financiare të bankave, financat e pamundura të disa qeverive për të realizuar mbështetjen financiare. Kjo ka gjeneruar shmangie të financimit të bankave nga disa qeveri. Ulja e normimit vlerësues të bankës në afatshkurtër d.t.th., se banka ekspozohet me më shumë rrezik madje edhe me një rrezik të qendrueshëm në kohë.

Normimi rënës i secilës bankë bart normimin rënës të sektorit bankar ku bën pjesë, gjë që jep impakt negativ duke ulur mundësitë e bankës për rritje kapitali, duke i ekspozuar më shumë në rrezik dhe duke shtuar shqetësimin dhe praninë e autoritetit mbikëqyrës (Banka Qendrore) dhe të agjensisë së sigurimit të depozitave. Këto rrethana krijojnë mjedis me pritshmëri të lartë që aksionarët e bankës të njoftuar për pamjaftueshmërinë kapitale të bankës, orvaten për alternativa zgjidhëse nga më të ndryshme. Ky formon një skenar që motivon ose demotivon një qeveri ose palët përfshirëse si investitor institucional për të mbështetur financiarisht një bankë. Politika monetare pritët të jetë më e ashpër dhe mjedisi rregullator do të ketë kërkesa edhe më shtrënguese. Për vendet e zhvilluara kjo mbetet si

⁶⁴ Drehmann, M and N Tarashev (2011): "Systemic Importance: Some Simple Indicators", *BIS Quarterly Review*, March.

alternativa më reale për përmirësimin e sistemit bankar, që d.t.th., se edhe për vendet në zhvillim sikurse Shqipëria, duhet kërkuar terapi e ngjashme, por me specifikën se mbështetja nga qeveria është thujtë krejtësisht e pamundur dhe mbetet vetëm mbështetja nga FMN.

Kjo d.t.th., se qeveritë me probleme financiare do të rrisin pajtueshmërinë e tyre me FMN, duke u implikuar edhe në kostot financiare e politike reformuese që kjo pajtueshmëri kushtëzon. Kriza që përjetuam nxorri mësim të rëndësishme duke ndryshuar qëndrimet dhe sjelljet e politikës dhe të institucioneve financiare më të larta të vendit në marrëdhënie me FMN. Nga ana tjetër edhe doktrinat dhe rekomandimet modelore që konsideroheshin si fundore, rigjallëruan mjedisin diskutues, kundërtues, kërkues dhe dyshues për versione sa më të qëndrueshme.

Normimi vlerësues bazohet në renditjen e bankave në radhë të parë sipas cilësisë së aktiveve apo të kreditit dhe së dyti në një nivel numëror të paracaktuar të normimit dhe kryerjes me një frekuencë sa më dinamike paralel me ecurinë e ritmeve të mjedisit ekonomik ku bankat zhvillojnë veprimtarinë. Në shumë studime dhe në mënyrë më ezauruese tek Hau, Langfield dhe Ibanez⁶⁵ shtrohet nevoja për treguesin e ‘*mangësisë së cilësisë së zakonshme të normimit*’ (*Ordinal Rating Quality Shortfall -ORQS*), për të siguruar një nivel të mirë të vlerësimit të gabimit relativ.

Kjo historikisht nis kur agjensitë e normimit vlerësonin si më të sigurtat korporatat dhe bankat e mëdha nga ku haset nofka “shumë të mëdha për të falimentuar”. Falimentimi i Enron, i Barings, etj., e shndërroi në retorikë ironike pohimin e mësipërm. Prandaj gjejmë me vend të përjasim kombinatorikën e katër gjetjeve kyçe që duhen vëmendësuar:

Së pari, cilësia e vlerësimit rendor është kundërciklike, ndërsa përmbajtja e informacionit rendor të normimit është më e lartë gjatë krizave bankare. Ky konstatim konfirmon parashikimin e disa prej literaturave teorike ku pretendohet se përfitimet neto të agjensive të normimit për të ofruar normim të cilësisë së mirë janë në nivelet më të ulëta kur biznesi përjeton ngritjen kulmore të cikleve të tij dhe e kundërta.

Së dyti, normimi bankar në nivelin e sipërm cilësor të investimeve, nuk bart marrëdhënie substanciale me probabilitetet e dështimit të pritshëm të referuar dhe të llogaritur për dy vjet më vonë. Kjo gjetje bie ndesh me peshat e rrezikut që aplikohen në qasjen e standardizuar të matjes dhe të vlerësimit të rrezikut të kredisë sipas shtyllës së parë të Basel II. Ekspozimet ndaj institucioneve financiare janë caktuar për 20% peshë rreziku nëse normimi është ndërmjet AAA dhe AA-. Pesha e rrezikut për 50 % vendoset për nivele normuese ndërmjet A + dhe A-, dhe pesha e rrezikut për 100 % vendoset për nivelet e rrezikut nga BBB + në BBB -. Këto ndryshime në peshat e rrezikut që bazohen në Basel II nuk vërtetohen nga praktika dhe nga përvoja që të jenë me hap të prerë dhe që të përfaqësojnë saktësisht dhe objektivisht nivelin e rrezikut.

Së treti, analiza strukturore, zbulon marrëdhëniet sistematike mes anësisë normuese të gabimit të normimit dhe madhësisë së bankës. Bankat e mëdha kanë marrë sistematikisht më shumë nivele/hise të favorshme normimi përkundër rrezikut të pritshëm të dështimit të tyre të rezultuar e të matur dy vjet më vonë. Një rritje në përmasat e një banke me dy *shmangie standarde* (+2σ) shpalos se renditja në normimin ndaj dështimit të pritshëm rezulton të jetë mbivlerësuar për 15 pozicione për çdo 100 bankat në mostër.

Ne argumentojmë se ky vlerësim ekonomik është me plotkuptim i njëanëshëm dhe reflekton subjektivizëm të agjensisë së vlerësimit të kredisë.

⁶⁵ Harald Hau, Sam Langfield and David Marques-Ibanez “Bank Ratings -What determines their Quality?” - Working Paper Series –of European Central Bank NO 1484 / OCTOBER 2012

Së katërti ne do të shmangim sa më shumë që të jetë e mundur, dukurinë e normimit për më shumë të bankave të mëdha kur ka sadopak sinjale të mbivendosjes së interesave të subjektit normues si agjensi me ato të bankave të tilla. Kjo sepse me shoqëritë e normimit dhe bankat ka ndodhur biznesi i mbivendosjes së interesave të përbashkëta.

Në këtë bashkësi përpjekjesh, pa cënuar modestinë edhe ky punim është kontribut plus. Ajo që ka rëndësi finale është dobia që duhet pritur nga një model normimi për të nxitur vendime financiare të rëndësishme, për inisiativa politike që synojnë qendrueshmëri në vlerësimin e bankave dhe në raportimin financiar sa më të vërtetë dhe objektiv të këtij vlerësimi.

Kjo do të bëjë më pak ndikuese por më shumë vërtetues informacionin e agjensive për nivelet e normimit të bankave. Burimet njerëzore, stafi dhe normuesit e bankave do të operojnë brenda një regjimi më kufizues risursesh financiare, njerëzore, ligjore dhe rrezikmarrjeje, duke rritur maturinë për bankat që hasin mungesë ekspertësh, duke shtuar përpjekjet për rrezik më të ulët operacional, për ulje të asimetrisë së informacionit dhe për qendrim kritik dhe shkëputës nga kozmetika kontabël. Shkurt do të krijohet prerogative mjaft merituese kundër korrupsionit të bazës së të dhënave që shlyhet me rezultat shumë më cilësor e më ndikues që del nga përpunimi i tyre.

KAPITULLI 3

METODOLOGJIA E NDJEKUR DHE INSTRUMENTAT E PËRDORUR

I. PYETJA KËRKIMORE THEMELORE

Pyetja kërkimore themelore që shtrijmë në këtë punim është:

A kanë mbarëvajtje financiare të qëndrueshme bankat në Shqipëri krahasimisht me njëra-tjetrën?

II. NËNPYETJE KËRKIMORE

1. Cilët janë treguesit e mbarëvajtjes financiare që do të shprehin më mirë Normimin e bankave?
2. Cilët janë treguesit makro të industrisë bankare që do të shprehin më mirë Normimin e bankave?
3. A identifikohen (sjellje) nga Institucionet Mbikëqyrëse në diferencat që bankat kanë në mbarëvajtjen financiare?
4. Pse është e rëndësishme të studiohet mbarëvajtja financiare e bankave në vendin tonë?
5. A e përmbush një model normimi vlerësimin e mbarëvajtjes financiare të bankave? Çfarë masash duhen marrë nga Autoritetet Rregullative të vendit?
6. A mund ti shërbejë tregjeve në zhvillim një model normimi i aplikuar në tregjet e zhvilluara apo duhet të ndërtojmë një model të posaçëm për tregun Shqipëtar?

III. QËLLIMI KRYESOR I PUNIMIT

Qëllimi kryesor i punimit është normimi i bankave që operojnë në tregun Shqiptar. Ndërtimi i një modeli normimi në kushtet e një informacioni opak të një ekonomie në zhvillim.

Kundrejt qëllimit kryesor apo final ne parashtojmë disa objektiva të ndërmjetme pa të cilat çënohet si modeli ashtu edhe produkti i tij, normimi. Përbërësit e këtyre objektivave të ndërmjetme i kemi grupuar në dy nënbashkësi.

Nënbashkësia e parë përmbledh objektivat e ndërmjetme që lidhen me krijimin e bazës së të dhënave dhe përpunimin e tyre si informacion. Nënbashkësia e dytë përfshin raportimin e informacionit sipas standarteve ndërkombëtare/kombëtare.

I - Objektivat e ndërmjetme që lidhen me krijimin e bazës së të dhënave dhe përpunimin e tyre si informacion:

1. Krijimin e një baze të dhënash që kërkohet nga elementët strukturorë të modelit në varësi të indekseve dhe indikatorëve makro të industrisë bankare, të treguesve të linjave të biznesit të bankave, të variablave të pavarur që përzgjidhen si lidhësa funksionale të modelit në fjalë.
2. Sistemimin dhe përpunimin e bazës së të dhënave si më sipër sipas një standarti modelues me produkt final treguesit e Normimit të bankave.
3. Duke qenë se modeli jonë aplikohet për Normim nga distanca propozohet që të rishikohet në mënyrë dinamike përbërja e treguesve duke braktisur ato tregues që bëhen më pak relevant dhe duke përfshirë ato më me peshë. Kjo për faktin se modeli i normimit i përgjigjet një vendi në zhvillim si Shqipëria që përjeton ndryshime strukturore në krijim tregjesh të organizuara financiare/bursa, reformim të institucionit mbikqyrës për drejtime alternative të identifikimit, matjes dhe kontrollit të bashkësisë së rreziqeve të industrisë bankare në përputhje me kërkesat detyruese të Bassel II/ III.
4. Dinamika e zhvillimit të industrisë bankare pritet të ketë si reduktim të numrit të bankave, po ashtu edhe efikasitet më të lartë të pranisë së çdo banke për njësi territoriale duke pakësuar drejt një niveli optimum të numrit të degëve, agjensive e deri te numri i punonjësve brenda tyre. Kjo dinamikë përkon edhe me trendin drejt *e-banking*, gjë që implikon vëllim transaksionesh elektronike dhe ekspozim ndaj rreziqeve të reja *`hi-tech`* (hakerimin, aksesit i paautorizuar, vjedhjet/mashtimet elektronike). Punimi sygjeron fuqimisht që objektivat e ndërmjetme të trajtohen në vijimësi si një *`going concern`* sepse normimi i bankave në fund të fundit është vlerësim i mbarëvajtjes së biznesit dhe financave bankare si në shtrirjen dhe rrjetizimin gjeo-ekonomik të tyre po ashtu për zhvendosjen drejt produkteve elektronike bankare ku kontakti me klientin më shumë priret të jetë virtual sesa i drejtpërdrejtë.

II- Objektivat e ndërmjetme të raportimit të informacionit sipas standarteve ndërkombëtare/kombëtare.

Cilësia koha plotësia dhe objektiviteti i raportimit të informacionit ekonomik dhe financiar të bankave formon grupin e dytë të objektivave të ndërmjetme që i shërbejnë qëllimit kryesor të modelit të normimit. Komponentët kryesorë të kësaj nënbashkësie përfshijnë:

1. Raportimi uniform sipas standarteve ndërkombëtare të kontabilitetit mbetet sfidë edhe sot kur kanë kaluar 5 vite nga momenti që bankave i është kërkuar të raportojnë sipas IFRS-ve (2009 e në vazhdim). Përgjithësisht respektohet vetëm IFRS 1 ndërsa raportimi i portofolit të kredive dhe kredive individuale në risk ka mospërputhje si në vijimësinë kohore po ashtu edhe brenda një viti raportues. Konkretisht identifikohet mungesë uniformiteti, prani preferencash rrethimore të normuesve të disa bankave për

fshehje informacioni duke cënuar parimin e shpalosjes (discloser). Shkelja e standartit të raportimit të qëndrueshëm nga ana e bankave e korrupton bazën e të dhënave deri edhe vetë modelin, duke e ekspozuar këtë ndaj gabimeve të tipit të I dhe të II, që shpesh i referohemi si fals pozitiv dhe fals negativ.

2. Doktrina e Normimit pretendon me forcë në raportimin e saktë dhe në kohë sepse këtë informacion sasiore e konverton në informacion cilësor në dobi të vendimmarrjes së lexuesve më me interes të nivelit të rinut për çdo bankë (investitorëve aktualë/potencialë, depozituesve, mbikqyrësve vendorë, dhe atyre globalë). Këtu konstatohet një hazard moral kronik sepse pjesa më e madhe e bankave janë filiale të bankave më me emër në BE, ndërkohë raportimi i `bijave` këtu nuk ka kurrëfarë përputhje dhe ngjashmërie me raportimet e bankave `mëmë` (Austri, Itali, Gjermani, Francë etj.). Me mangësi si më lart nuk mundësohet marrja në konsideratë e dallimeve të elementëve brenda një rreziku normimi që janë a) dobësia (vulnerability) b) luhatshmëria (volatility), dhe c) kërcënim (threat). Këto tre përbërës në i shohim si motivues respektiv të përjetimit të gjithkohshëm të rrezikut të normimit. Ndërkohë raportimi me mungesë/mangësi i bankave synon të heqë përjetimin në rrezik që duhet të kenë duke shtrembëruar me prirje zvogëluuese Vulnerabilitetin, volatilitetin dhe kërcënimin.

3.1-METODOLOGJIA STUDIMORE

Metodologjia e aplikuar në këtë studim formësohet me një bazë të dhënash reale të sistemit bankar në Shqipëri, dhe në drejtime të tjera krahasimore. Përpunimi i këtyre të dhënave do të bëhet në bazë të metodave sasiore dhe statistikore që konvergjojnë me metodikat e reja që propozohen. Për të arritur në një vlerësim normues sa më Racional dhe përfundues, kriteri i zgjedhjes dhe i përpunimit të metodologjisë është kërkuar që t'i përgjigjet sa më mirë kushteve specifike të mjedisit bankar në Shqipëri, duke ushtruar peshën më të lartë tek rreziqet më të qenësishme të ekspozimit të bankave. Nga ana tjetër aspekti metodologjik përfshin një riekzaminim në makro të strukturës ekonomike dhe të industrisë bankare, të parametrave të lirisë së tregut apo shkallës së koncentritimit dhe impaktin në konkurrencën potenciale të tregut bankar dhe ndërbankar në kahun e depozitave, të kredive dhe të shërbimeve duke ju referuar edhe shkallës së përqendrimit brenda industrisë bankare.

Hapësira e dytë kërkimore për metodologjinë i referohet rolit kufizues dhe kushtëzues rregullator, duke përfshirë impaktin e doktrinës së rrezikut për mjaftueshmëri kapitale të bankave sipas Bazel II/III, sipas rregulloreve dhe politikave të Bankës së Shqipërisë si autoriteti monetar vendor dhe sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit (IAS 39 dhe IAS 9). Metodologjia duhet që të përkojë me funksionet qëllimore institucionale të mësipërme që sendërtohen nëpërmjet instrumentave dhe teknikave mbikëqyrëse, cilësinë e gjetjeve dhe të raportimit të gjetjeve nga mbikëqyrja dhe të ndërhyrjeve korrigjuese apo rregulluese që priten dhe kërkohen sipas një ecurie kohore për tu përmbushur.

Përcaktues me peshë për funksionin metodologjik është edhe horizonti kohor i dinamikës së veprimtarisë bankare, për faktin se gjatë periudhës 2000-2009 janë përjetuar ndryshime si një përkatësinë aksionare po ashtu edhe në emrin e bankave. Nga ana tjetër e gjithë metoda dhe modeli që gjenerohet prej saj duhet të jetë me të dhëna sa më konsistente dhe homogjene për nga standardi i përpunimit të tyre në informacion bankar. Kjo ka si pikë kthese vitin 2009 kur bankat kanë qenë të detyruar të raportojnë sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe standardeve ndërkombëtare të pasqyrave financiare.

Duke përcjellë metodologji të ndryshme, disa institucione, agjensi dhe ekspertë vlerësojnë metodologjinë e normimit të bankave sipas strukturës së CAMELS që është teknikë normuese e bankave duke u bazuar në komponentë të brendshëm të bankave. Termi

bazohet në shkrutimin e koncepteve të Kapitalit (C), Aktiveve (A), Cilësisë amvisuese (M), Fitimeve (E) dhe Likuiditetit (L). Kjo metodologji bazohet në informacionin e brendshëm dhe përcaktohet duke vlerësuar normim individual për secilin komponent. Ndërkohë që rezultati më i mirë që mund të arrihet është 1,00 dhe rezultati më i keq është 5.00. Metoda bazohet në përkatësim peshash për secilin komponent të modelit p.sh. për kapitalin 0.3, për likuiditetin për 0.1. Kjo metodë i nënndan treguesit e mësipërm në kategori përbërëse.

I- (C) *Përshtatshmëria apo mjaftueshmëria Kapitale* për bankat përcaktohet duke përdorur tri kategori:

- (a) Raporti i kredive të ristrukturuara ndaj kapitalit të domosdoshëm (*core capital*) plus humbjen e kredisë.
- (b) Raporti i kredive me probleme ndaj kapitalit të domosdoshëm dhe zotërimeve të ndjeshme.
- (c) Raporti i kapitalit të domosdoshëm ndaj zotërimeve të ndjeshme, të përshtatura për humbje pagesë të tepërt (mangësi)

II- (A) *Cilësia e Zotërimeve (Asset quality)* përcaktohet duke përdorur katër kategori treguesish:

- (a) Raporti i kredive me rrezik të lartë si përqindje ndaj totalit të kredive.
- (b) Raporti i provizionimit të kredive ndaj kredive jo të mbara plus kreditë e ristrukturuara.
- (c) Raporti i zotërimeve të dëmtuara ndaj totalit të zotërimeve.
- (d) Raporti i kredive jo të mbara plus kreditë të ristrukturuara ndaj totalit të kredive.

III- (M) *Cilësia e Drejtimit (management quality)* analizohet brenda kritereve që bankat aplikojnë brenda vetvetes.

IV- (E) *Fitimet për bankat* analizohen duke u vëmendësuar në dy kategori treguesisht:

- (a) Kthimi në kapital të domosdoshëm
- (b) Raporti i efikasitetit

V- (L) Konkretisht **likuiditeti** analizohet në 3 indikatorë apo kategori:

- (a) Raporti i shpejtë (*quick ratio*) si raport më përfaqësues i shkallës së likuiditetit;
- (b) Raporti i instrumentave financiarë të pa vëna si garanci apo kolateral ndaj zotërimeve të bankës ($FI_{unpledged}/Ass$);
- (c) Raporti i depozitave bazë ndaj zotërimeve apo aktiveve të bankës (Dp/Ass).

VI- (S) *Ndjeshmëria (sensitivity)* ndaj rrezikut të tregut

Kur bëhet fjalë për normim nga distanca në shumë metodologji shmanget komponenti i cilësisë së drejtimit të bankës (M) duke e quajtur si metodën normuese CAELS, për faktin se është e pamundur duke qenë nga jashtë të vlerësohet cilësia e drejtimit. Për këtë arsye metodologjitë kanë ngjashmëri, ndonëse për vendet në zhvillim ka mungesë e mangësi që lidhen me faktin se cili tregues është pikënyja e normimit.

Nga ana tjetër normimi sipas CAMELS mbahet shumë sekret, ndonëse kjo kritikohet nga shumë autorë, por edhe Komisioni i të Sigurtave Financiare dhe Bursës (SEC) [SHBA] që është enti më autoritar në ndjekjen dhe vëzhgimin e sigurisë financiare të bankave që kuotohen në bursë nuk ka qasje në këtë metodologji por e huazojnë nga jashtë. Kjo d.t.th., se sekretimi i metodave mbetet sfida për institucione kaq të rëndësishme sikurse SEC dhe jo më për normues të pavarur për të cilët shërben ky punim.

Këndvështrimi krahasues është hulumtimi në metodologjitë e 3 shoqërive më prirëse në treg sikurse janë Moody's, Standard & Poor's dhe Fitch. Kjo gjithnjë për të ezauruar sa më shumë që të jetë e mundur përfaqësimin dhe përfshirjen e variablave duke marrë në konsideratë një bazë të dhënash reale të sistemit bankar në Shqipëri. Përpunimi i këtyre të dhënave do të bëhet në bazë të metodave sasiore dhe statistikore që ekzaminohen me kushtin që të konvergjojnë me metodikat e reja që kritikohen e më pas rishikohen dhe propozohen nga vetë këto tre shoqëri apo agjensi.

3.2- BLOK SKEMA E KËRKIMIT

Si rrjedhojë bllok skema e kërkimit, gjetjes dhe e përshtatjes së metodologjisë përbëhet nga prioritetet kërkimore që jepen në vijim:

Së pari nga metodologjitë e përdorura për ratingun e bankave, nga tre nga shoqëritë më të mëdha të ratingut Moody's, Standard and Poor's dhe Fitch ne ndalemi në qasjet e reja të aplikuara nga këto kompani për tregjet emergjente (Michael 2011)⁶⁶. Nga ana tjetër ne identifikojmë dhe analizojmë diferencat në rating midis këtyre dy kompanive duke u përpjekur të gjejmë edhe racionalen e këtyre diferencave.

Së dyti, në përmbushje të versionit metodologjik më përgjigjes për Shqipërinë sikurse theksohet në pikën e mëparshme, duke analizuar tregun e Shqipërisë, si një treg në zhvillim me shumë karakteristika të tregjeve emergjente.

Së treti, mbulohet puna e përzgjedhjes së variablave. Kësisoj determinimi i lidhjes funksionale por që ka karakter të rastit ndërmjet variablit të varur dhe variablave të pavarur formon versionin më referues për metodologjinë që aplikohet për Shqipërinë.

Së katërti, përzgjidhet kampionatura e bankave, përpunohet baza e të dhënave.

Së fundi, ndërtojmë modelin dhe e testojmë atë.

3.2.1- Metodologjia e Moody's

Moody's, normimin e parë vlerësues për bankat e ka shpallur në qershor të vitit 1973 dhe sot kjo agjensi mbulon mbi 790 banka nëpër botë duke përdorur dhe shprehur nivelin e tyre të sigurisë sipas një shkalle nivelore nga AAA deri në C. Komponentët kryesorë të përjasjes teorike të Moody's për normimin e bankave përfshijnë në mënyrë dhe proces të vazhdueshëm të pesë faktorëve kyç përpunuese:

- 1-Mjedisi operativ,
- 2-Cilësia e mbikëqyrjes,
- 3-Cilësia e amvisimit,
- 4-Vlera e franshizës dhe
- 5-Themeloret financiarë.

Ndryshimet në vlerë apo shifra të këtyre futjeve kyçe përfaqëson ndryshim faktorësh me ndikim në normimin vlerësues të bankave. Problemi metodologjik që kërkon sqarim lidhet me faktin se:

- (a) Në rastin e normimit vlerësues të forcës financiare këto shihen dhe konsiderohen si faktorë të brendshëm në kushtet e normimit specifik të secilës bankë si ent më vehte.
- (b) Në rastin e normimit vlerësues të emetimit apo futjes në borxh të bankave p.sh. me depozitat, këto faktorë nuk mjaftojnë, prandaj metodologjia merr në konsideratë nivelet e epërme të kurseve valutore të këmbimit, si dhe të faktorëve të mbështetjes nga jashtë dhe së bashku përfaqësojnë një vlerësim të rrezikut të kredisë.

⁶⁶ Lewis, Michael "Boomerang" – Travels in the New Third World. Norton (2011).

1-Mjedisi Operues

Për vendet në zhvillim Moody's vëmendësohet për stadin e zhvillimit të sistemit bankar, duke përfshirë si komponentë të rëndësishëm shkallën e liberalizimit ekonomik, nivelet e ndërmjetësimit e të ç'ndërmjetësimit si dhe sfondin konkurrues. Në mjedisin operues merren në konsideratë faktorët ekonomik më ndikues në sektorin bankar të ndarë sipas grupimit në nivel makro dhe mikro. P.sh., në nivel makro përfshihet sjellja e normave të interesit, nivelet e të ardhurave, të punësimit, etj., dhe në nivel mikro më me peshë konsiderohen përcaktorët e prirjeve ciklike brenda grupeve të industrive specifike.

Kur bëhet fjalë për normimin vlerësues të një banke, Moody's vëmendësohet në rolin që banka në fjalë luan në ekonominë e vendit. Krahas kësaj, Moody's formon një vlerësim subjektiv për shkallën e mundësisë që banka në fjalë ka për mbështetje zyrtare nga qeveria e vendit në rrethana kur banka mund të përballet me vështirësi financiare. Në këtë pikë vlerësohet roli i huadhënësit të zgjidhjes së fundme.

Në rolin e huadhënësit të zgjidhjes së fundme merret autoriteti monetar i një vendi [përgjithësisht Banka Qendrore] që vendimin për huadhënie e ka si funksion dhe të drejtë përjashtimore të saj. Kjo d.t.th., se nëse një bankë tregtare në një vend në zhvillim është në vështirësi për fonde dhe kërkon të huamarrë në treg, por nuk gjen huadhënës, atëherë alternativë e fundit i mbetet të huamarrë nga Banka Qendrore [BQ]. BQ e vlerëson kërkesën dhe e ka privilegj vendimin për t'ia dhënë ose jo huanë. BQ e aplikon këtë të drejtë edhe si instrument të politikës monetare të saj nëpërmjet huave nga sportel skontoja (*discount window*).

Në standardin bankar kreditimet si zgjidhje e fundme janë huara shumë afatshkurtër dhe përgjithësisht BQ e aplikojnë funksionin si huadhënës të zgjidhjes së fundme, për të kapërcyer rrethana që në një sistem bankar rrezikojnë krizë financiare masive. Një rol të tillë mund ta marrë edhe një investitor institucional ose bashkësi shoqërisht financiare. Nga ana tjetër me krizën e viteve 2007-08 këto në shumë vende janë pjesë e programeve qeveritare të financimit të bankave specifike, pasi të provohet se kostoja e mbylljes/likuidimit të bankës është më e lartë se sa kostoja e mbajtjes në jetë ekonomike të saj. Për vendet që nuk ka një kreditues të zgjidhjes së fundit, Moody's analizon mundësinë e financimit nga institucione shumëpalëshe si p.sh., FMN-ja. Një rrethanë e tillë haset në krizën e Argjentinës.

2- Cilësia e Mbikëqyrjes

Si bazë krahasuese për vendet në zhvillim, Moody's përdor të dhënat e publikuara nga organet e ndryshme rregullatore apo të institucioneve barazvlerëse me to duke përfshirë dhe kujdestarët e bankave individuale. Vlerësime subjektive përqendrohen për saktësinë dhe transparencën e të dhënave. Këto vlerësime bazohen në vlerësimin dhe krijimin e opinionëve të pavarura për cilësinë e sistemit përkatës mbikëqyrës dhe rregullues.

Transparenca nuk është një çështje që pretendohet përjashtimisht vetëm për ekonominë në zhvillim, por mbetet një kërkesë edhe për vendet e zhvilluara. Gjatë periudhës 2000 e deri më sot falimentimet e bankave në vendet e zhvilluara kanë ndodhur me denduri dhe ashpërsi të lartë dhe e përbashkëta është se rrënjët gjenden përsëri në sjelljen e dobët dhe rrezikun e lartë operacional të strukturave profesionale dhe institucionale mbikëqyrëse, kontrolluese dhe politike bërëse të mjedisit rregullator. Për këtë arsye transparenca në vendet në zhvillim shihet në mënyrë më të specifikuar brenda kontekstit të pesë stadeve të ndryshme zhvilluese:

1-Stadi me sistem bankar pa transparencë dhe me pak ose aspak mbikëqyrje (ish vendet komuniste të Europës Lindore, të Amerikës Latine dhe Panamaja).

2-Stadi me nxitës politik dhe ekonomik për ndryshim (duke analizuar faktorë të brendshëm dhe të jashtëm).

3-Stadi kalimtar apo i tranzicionit (vend me përgatitje të ligjit të ri për bankat, me krijim dhe funksionim të strukturës rregullatore, përshtatja me standardet e reja kontabël dhe aftësimi e formimi profesional i personelit).

4-Stadi me zbatimin dhe ekzekutimin e kërkesave dhe funksioneve të ligjeve dhe strukturave të reja (cilësia e ligjeve, pavarësia e institucioneve mbikëqyrëse dhe rregulluese nga politika, niveli i kompetencës dhe i përvojës së stafit të ri, krijimi i historisë së të dhënave dhe ndryshimi real i mentalitetit).

5-Stadi me përqijqjet dhe provat e drejtësisë së përmbushjes së aspekteve të mësipërme (transparenca, pavarësia, aplikimi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, skenaret për stres-test, etj.).

Në rrethanat ku Moody's percepton mangësi ose pasiguri në pohimet apo mohimet ndaj drejtimeve të mësipërme mbikëqyrëse dhe rregullatore, veprimtaria vlerësuese e normuese e bankave analizohet edhe në drejtimin *se sa është aftësia vetërrregulluese e bankave në vëzhgim vlerësues* në lidhje me amvisimin e zotërimeve dhe detyrimeve, me mbulesën dhe rezervat provizionuese, me shkallën e kapitalizimit dhe të tretshmërisë financiare të bankave, etj.

Gjithsesi duhet pohuar se në metodologjinë normuese të Moody's, mungesa e një organi mbikëqyrës dhe rregullator (ose prania e mangët e një mbikëqyrësi dhe/ose rregullatori) ka ndikim me peshë në normimin e një banke në përkatësi të kësaj cilësie mbikëqyrëse.

Metodologjitë e Moody's kanë pësuar nga ndikime dhe ndryshime duke imponuar korigjime për faktin se mjediset operuese të bankave janë infektuar me nivel të lartë të zotërimeve të pambara apo me probleme, me volatilitet të lartë dhe me dështime bankare faktike ku një pjesë e tyre janë të zyrtarizuara dhe një pjesë akoma të paraportuara. Vende të ndryshme kanë sjellje institucionale mbikëqyrëse dhe rregullatore të ndryshme si në ritëm të ndërhyrjes ashtu edhe në cilësinë e kësaj ndërhyrjeje. Prandaj këto kanë impaktin e vet në diferencat normuese të secilës bankë që operon në vendet në zhvillim por me karakteristika specifike njëra nga tjetra. Këto pësime kanë nxitur rishikime të kornizave institucionale, të shkallës së ekspozimit dhe të prekjes nga krizat financuese dhe të patretshmërisë financiare të identifikuar nëpërmjet leximit dhe ekzaminimit të informacionit kontabël.

Tretshmëria financiare kontabël është indikator kyç i potencialeve për falimentim të bankave, të cilat përgjatë rrugës drejt vështirësisë financiare e përtej duke përfunduar në falimentim kanë pasur kosto sepse kanë sosur resurse ekzistuese që ishin provizionuar ose edhe që ishin depozituar si fond për sigurim depozitash për të përballuar goditjet nga dështimet financiare. Për këtë arsye, roli i pavarur i organeve dhe i profesionistëve mbikëqyrës ndikon në identifikimin por edhe në raportimin e problemeve për institucionet bankare në monitorim, si dhe në llogaritjen e resurseve mbështetëse për ripërtëritje dhe dalje nga kriza, jo vetëm për bankat që e meritojnë një mbështetje të tillë por edhe për qeveritë që kanë mundësi të sigurojnë fonde financuese për restaurim bankar të bankave me kërcënim falimentimi.

3- Cilësia e Amvisimit

Vlerësimi i cilësisë amvisuese dhe normuese të bankave, nga ana e Moody's rrok dy grupe të rëndësishme faktorësh:

1- Regjistrimi i sjelljes normuese dhe amvisuese në historikun nga e kaluara deri në momentin kur shfaqet problem i falimentimit të një banke, si dhe çfarë shmangiesh janë vënë re ndaj pohimeve dhe objektivave strategjike që ka projektuar, raportuar dhe ka pretenduar banka se po zbaton apo që ka neglizhuar. Një regjistrim i tillë flet për nivelin e 'Të dish si' (*know how*) të normuesve të bankave për veprimtaritë kredituese, rrezik pranuese, rrezik

marrëse, mbrojtëse, për sistemet e përpunimit kontabël dhe të produktit kontabël (të pasqyrave financiare) deri edhe tek amvisimi i zotërimeve dhe detyrimeve.

Në lidhje me strategjinë Moody's në metodologjinë e vet shtron dy çështje bazë:

(a) Sa reale është strategjia e projektuar, e miratuar dhe e mbrojtur nga normuesit e bankave, duke marrë në konsideratë arritjet faktike të deriatëhershme, mjedisin operues aktual dhe se sa i përgjigjet ky mjedis operues arritshmërisë së synimeve të ardhshme?

(b) A përpiket ekipi normues i bankës për të mbajtur nivelin profesional ekspertizë për të përmbushur problemet dhe objektivat që shfaqen në kushtet e rritjes së liberalizimit të tregut dhe fuqisë së konkurrimit të lirë?

Aspekti tjetër që merret në konsideratë është niveli i integritetit profesional të normuesve në të gjithë sektorët e bankave, por veçanërisht në strukturat operuese ku ekspozimi ndaj vjedhjeve, abuzimeve, shpërdorimeve, korrupsionit dhe keqbërjes është më i lartë. Prania e elementëve të tillë janë dëmtues jo vetëm për bankën por edhe për krejt sistemin ku operon banka në fjalë.

4-Vlera e Franshizës

Për Moody's, *vlera e franshizës* së bankës është kombinim i përmasës së bankës, i shtrirjes së saj nëpërmjet numrit të degëve, shkallës së diversifikimit të aktiveve p.sh. të kredive të larmishme si për status juridik të firmave (mikro, SME, ortakëri, korporatë) po ashtu edhe për linja biznesi (prodhim, tregti, turizëm, shërbime, etj.). Të gjitha këto shihen me imazhin në treg të bankës duke u ndalur tek emri i mirë, njohja e brandit të bankës në treg, si dhe tek pozicioni i qendrueshëm konkurrues që banka ka në treg.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet rolit disiplinor që vlera e franshizës si më sipër ka në forcën parashikuese të rrezikut të kredisë, duke përfshirë sjelljen rrezik-marrëse, oreksin rrezikues, shkallën e transferimit dhe të ndarjes së rrezikut që bankat shfaqin duke vepruar në tregje me konkurrueshmëri të lartë. Në fund të fundit problem shtrohet se sa e rëndësishme, e mjaftueshme dhe e përshtatshme është vlera e franshizës së bankës për të mbrojtur hisen e saj në treg. Në shumë vende në zhvillim, shumë banka edhe pse të forta financiarisht dhe me emër franshize, shpesh herë për të ruajtur përparësitë e tyre, janë prirur të fusin në portofolin e tyre klientë të dobët duke ja rritur thellësinë e vështirësisë financiare të bankës dhe duke e ekspozuar bankën në pamjaftueshmëri kapitale. Në të kundërt, bankat më të kujdesshme në këtë drejtim, e kanë mbrojtur vlerën e franshizës duke shmangur një kurth të tillë dhe duke u ruajtur nga niveli i lartë i kapitalit në rrezik.

Problemi shtrohet se sa ka shtrirje parimi i 'shqetësimit në vijim (i vazhdimësisë)' tek një bankë dhe sa larg është banka nga një likuidim i mundshëm, kur përballë identifikohen rritje agresive të aktiveve dhe investime të shtuara me rrezik minimal ose pa rrezik që i njohim si investime kundër-rrezikuese. Ky grup i dytë bankash kanë përkatësim të nivelit më të lartë normues për shkallën e sigurisë ose nivel më të ulët normimi për shkallën e rrezikut.

5-Themelorët Financiarë

Guri i themelit të analizës që Moody's bën për bankat qëndron në themelorët financiarë, ku përpjekja ekzaminuese konsiston në prirjet e cilësisë së zotërimeve, të fitimshmërisë, të likuiditetit dhe të kapitalizimit të bankës. Themelorët financiarë janë komponent sasior në metodologji, ndërsa të gjithë komponentët e tjerë që u përmendën më sipër kanë karakter cilësor.

Të gjitha aspektet ekzaminuese të mësipërme për një bankë krahasohen me bankat e ngjashme me mesataren e industrisë bankare me grupet e bankave me +/- një shmangie

standarde nga banka mesatare e konfiguruar si dhe me tregues të ngjashëm sipas shtrirjes rajonale apo gjeo-ekonomike të bankës në raport me bankat e tjera.

Analiza e themelorëve financiarë ka peshën më të lartë se sa katër komponentët e përmendur më sipër (*mjedisi operues, cilësia e mbikëqyerjes, cilësia e amvisimit dhe vlera e franshizës*). Por duhet mbajtur parasysh se profili tërësor financiar i një banke merret i lidhur ngushtë me komponentët e tjerë cilësorë. P.sh., cilësia e zotërimeve shihet e lidhur ngushtë me nivelin e rezervave që ka provizionuar banka, duke u bazuar në parimin se sa më pak cilësore që të jetë portofoli i zotërimeve aq më i lartë është niveli provizionues dhe e kundërta.

Mirëpo Moody's në metodologjinë e vet nuk përcakton nivele prag të treguesve që një bankë duhet të ketë ose të mbajë (p.sh., si nivel detyrë kapitalizimi) për të ndikuar në normimin vlerësues të saj. Kjo sepse objektivi i Moody's është të arrijë konsistencë në analizën vlerësuese dhe këtë konsistencë e realizon për të gjitha bankat që operojnë në lloje të ndryshme tregjesh në mbarë botën.

3.2.1.1. Cilësia e Zotërimeve/Aktiveve [Moody's]

Në strukturën metodologjike dhe në formimin e opinionit normues të një banke nga ana e Moody's cilësia e zotërimeve është pikëndalja më e rëndësishme dhe më sfiduese. Cilësia e zotërimeve (*asset quality*) varet nga shkalla dhe shuma e të ardhurave që ato gjenerojnë, si dhe nga rreziku që implikohet në këtë proces. Me rrezik më të ulët janë zotërimet likuide apo në të holla, ndërsa arkëtimet e pritshme apo huadhëniet tregtare dhe bankare paraqesin rrezik të lartë, sidomos kur ofrohen pa ndonjë garanci.

Cilësia e zotërimit në thelb është vlerësim i cilësisë fitimsjellëse dhe të likuiditetit të një zotërimi apo bashkësie zotërimesh dhe përcaktohet nga këndvështrimi i vlerësimit që huadhënësi i bën një huadhënieje sesa e sigurtë është për t'u shlyer nga huamarrësi, si shumë themelore dhe interes. Kjo cilësi lipset të zbatohet sipas standardeve përgjithësisht të pranueshme të huadhënies (*generally acceptable credit standards*).

Në këtë vështrim zotërimet ndahen në zotëime me rrezik të lartë (*high risk assets*) dhe zotëime me rrezik të ulët (*low risk assets*). Peshë që ato zënë ndaj zotërimeve gjithsej dhe ndaj shitjeve gjithsej, është një ndër raportet financiar më të rëndësishëm në analizën e zotërimeve. Procesi i shndërrimeve të zotërimeve nga likuide në më pak likuide [dhe anasjelltas] quhet bashkëshndërrim i zotërimeve (*asset conversion*). Analiza e tij përcakton përmbajtjen e rrezikut. Nëse një shumë të hollash huajepet, zotërimi nga të holla (*cash*) shndërrohet në huadhënie (*loan*) dhe kur arkëtohen paratë, zotërimi nga huadhënie shndërrohet përsëri në të holla (*cash*).

Në procesin e normimit të një banke, metodologjia nisët nga rreziku që një zotërim i shfaqur në aktivin e bilancit, të shndërrohet në humbje të ardhshme financiare për shkak të prishjes së cilësisë që përmban. Kjo konsiston në inekuacionin shpjegues bazë që pohon se një aktiv është i cilësisë së dobët kur vlera në bilanc apo në kontabilitet tejkalon vlerën e pritshme të arkëtimeve në të holla nga aktivi (kredia) në fjalë. Kjo pritshmëri mund të përballet me rrezikun që banka të mos arkëtojë kredinë që teknikisht i referohet rrezikut që një zotërim të klasifikohet si zotërim jo i mbarë (*non performing asset*).

Cilësia e kredive që një bankë ka ofruar sipas huamarrësve individual dhe sipas klasave që formojnë agregatin e tyre deri në shkallë portofoli nisët nga kriteri i cilësisë së huamarrësve individual, si grup, si agregat deri edhe si portofol (p.sh. agregati i kredive konsumatore, agregati i kredive për mikrobiznese dhe SME, agregati i kredive për biznese të mëdha, etj.). Nga ana tjetër, cilësia e aktiveve analizohet duke u nisur edhe nga kriteri i emërimit të agregatit sipas llojit të kredisë (p.sh. agregati i kredive tregtare, agregati i kredive prodhuese, agregati i kredive për ndërtim, etj.).

Në thelb treguesit e cilësisë së aktiveve rrokin nivele individuale, si grup deri edhe si portofol. Këto shprehen me raporte financiare të vlerës së zotërimeve me probleme apo të këqija (*bad assets*) ndaj vlerës së agregatit ku bëjnë pjesë p.sh. kredi konsumatore të humbura ndaj kredive gjithsej për konsumatorë, kredi për ndërtim që janë nën-standard apo të dyshimta ndaj kredive gjithsej për ndërtim. Nga analiza e anatomisë së rrezikut, aktivet me cilësi të dobët informojnë për vendimmarrje kreditimi në kushtet e asimetrisë së informacionit që i ka rënduar bankës që në fund të fundit të çon në rrezikun operacional apo të shkeljeve proceduriale, rregullatore, ligjore dhe profesionale përgjatë miratimit.

Treguesit më të rëndësishëm të cilësisë së zotërimeve që modelon Moody's për të matur ndikimin e tyre në dobësinë e gjendjes financiare të bankës janë:

- (a) Raporti i Kredive jo të mbara (NPL) ndaj portofolit të kredive plus qiratë financuese [NPL/Gross loans & leases]
- (b) Raporti i rezervave ndaj Kredive jo të mbara (NPL) [Reserves/NPL]
- (c) Raporti i Kredive jo të mbara (NPL) ndaj kapitalit plus rezerva [NPL/(Eq+Reserves)]
- (d) Vëllimi i rritjes së kredive.

Në të gjithë treguesit e mësipërm Moody's verifikon llogaritjen konsistente, regjistrimin dhe pasqyrimin e saktë kontabël të "kredive jo të mbara" duke ndërhur me korigjime përkatëse në raportimin financiar të bankës nëse rezulton e nevojshme për shkak të cënimit të transparencës dhe objektivitetit. Në llogaritjen e kredive me probleme Moody's vepron me këto kritere:

- (a) Kreditë konsumatore konsiderohen NPL kur tejkalojnë 60 ditë shlyerje si themelorë dhe interesa.
- (b) Kreditë për tregti dhe qera financiare (leasing) konsiderohen NPL kur tejkalojnë 90 ditë shlyerje si themelorë dhe interesa.
- (c) Kreditë e ristrukturuara të analizuara sipas kushteve dhe afatit për shlyerje.

Drejtime plotësuese lidhen me rrezikun e përqendrimit të kredive me probleme në pak firma, pak industri, në një zonë gjeoekonomike si dhe me palë të lidhura (p.sh., me aksionarë, investitorë, etj.). Problemi shtrohet se si identifikohen, raportohen dhe diagnostikohen për masa korigjuese këto raste duke implikuar edhe sjelljen e palëve mbikëqyrëse dhe rregullatore. Kjo krijon një ndërvarësi ndërmjet bankës dhe grupeve financiare që në ekonomitë e vendeve të vogla është më problematike duke cënuar aftësinë dhe lirinë e bankës për ristrukturime me parime tregtare.

3.2.1.2-Kapitalizimi

Metodologjia e Moody's në përcaktimin e ndikimit të normimit vlerësues të bankës së kapitalit përcakton shkallën deri ku kapitali në rrezik i bankës mjafton për të përthithur humbjet potenciale në portofolin e kredive, në portofolin e instrumentave financiarë dhe në portofolin e veprimtarisë jashtë bilancit. Në këtë aspekt metodologjia konvergjon me doktrinën e amvisimit të rrezikut të bankave sipas *Basel II* që shërben për të përcaktuar shkallën e rrezikut që përjeton banka. Ajo ka disa element të përjasjes së përparuar të matjeve (*advanced measurement approaches*) sepse bazohet në vetëvlerësimin që bankat i bëjnë aktiveve të tyre për të matur se sa janë të ekspozuara ndaj rrezikut operacional (*operational risk*) të cilin mund ta mbulojnë duke blerë edhe produkte sigurimi (*insurance*) me kontratë mbulimi të paktën për 1 vit.

Fondi i blerjes së produkteve të sigurimit krijohet duke veçuar nga kapitali shuma të dedikuara për këtë qëllim deri në 20% që njihet edhe si normë e veçimit të kapitalit për rrezikun operacional (*operational risk capital charge*). Rëndësi ka që institucioni sigures të jetë gjithashtu një shoqëri sigurimi e normuar nga Moody's si pa rrezik apo AAA që d.t.th., se siguresi ka garanci do ta mbulojë/kompensojë bankën nëse ndodh një dëm nga rrethana të siguruara. Për banka me shtrirje globale –p.sh. me degë, filiale, etj., jashtë vendit të origjinës për amvisimin e rrezikut operacional aplikohet 'përqsja hibride' (*hybrid approach*) ku banka amë llogarit pjesën e kapitalit të destinuar për këtë qëllim dhe për këtë njofton autoritetin monetar të vendit ku gjendet filiali/dega.

Ka rëndësi të theksohet se për llogaritjen e kapitalit të veçuar burimet kapitale dhe fondet e papërdorura duhet të jenë të filialit/degës dhe jo të grupit. Si modele të identifikimit dhe të vlerësimit të rrezikut operacional mund të përdoren modele që aplikohen nga Banka amë.

Si tregues kryesorë të kapitalizimit përfshihen:

- (a) Raporti i kapitalit ndaj aktiveve gjithsej [$Eq/\Sigma ass$]
- (b) Raporti i kapitalit ndaj aktiveve me rrezik gjithsej [$Eq/\Sigma RiskAss$]
- (c) Raporti i kapitalit të zakonshëm ndaj aktiveve gjithsej [$Eq_{common}/\Sigma ass$]
- (d) Raportet e mjaftueshmëris kapitale sipas Basel II/III

Struktura alternative e kapitalit matet si kapital rregullator apo si kapital në nivelin që kërkohet nga autoriteti monetar vendor dhe/ose Basel II/III. Matësi alternativ i kapitalit rregullator të një banke bazohet në lidhjen:

$$BC_{RAP}=Eq+Pps+Ll\&Ls_R+SubDeb_{conv}+Min_{interests}$$

Ku:

BC_{RAP} =kapitali i bankës sipas parimeve të autoritetit rregullator;

Eq =kapital aksionar [aksione të zakonshme plus fitime të pashpërndara plus rezerva kapitale] (*stockholders' equity*);

Pps = aksione të preferueshme të përhershme (*perpetual preferred stock*);

$Ll\&Ls_R$ =rezerva për humbje nga huadhënie dhe qira financiare (*loan loss reserves & leasing loss reserve*);

$SubDeb_{conv}$ =huamarrje të konvertueshme në kapital (*subordinated debt mandatorily convertible into common stock*);

$Min_{interests}$ =interesa pakicë në varësi dhe certifikata për vlerë neto.

Krahas llogaritjes së kapitalit rregullator, Moody's ekzaminon edhe kapitalin ekonomik duke përfshirë në funksionin llogaritës *kapitalin, rezervat për humbje nga huadhëniet, gjendja e aksioneve të preferueshme* si dhe rezervat apo aktivet e fshehura. Niveli i kapitalit ekonomik korigjohet me humbjet e përealizuara dhe mbivlerësimet apo vlerësimet e fryra të aktiveve. Kjo shihet me profilin në rrezik të bankës kundrejt bilancit që rezulton. Më tej ekzaminimi konsiston në shqyrtimin e politikës së normuesve për kapitalin e bankës, sidomos kur përjetohen faza apo cikle të rritjes së ndjeshme dhe rrethana të blerjeve. Pikëpamja bazë e Moody's është që bankat me normim vlerësues për fuqi financiare, kanë nivele të qëndrueshme dhe të pranueshme të mjaftueshmërisë kapitale në nivel më të lartë nga çdo të duhej të kishin kundrejt profilit për rrezikun tërësor. Në të njëjtën kohë energjia potenciale e një banke për rritje me aktive më me rrezik në tregjet nën standardin e sigurisë bankare për tu kredituar, së bashku me kombinimet e para të bizneseve, do të krijojë trysni ndaj fuqisë kapitale të disa bankave brenda sistemit.

3.2.1.3-Likuiditeti dhe Financimi

Fokusi kryesor i Moody's është vlerësimi i aftësisë së bankës për të financuar veten kur gjendet nën stres financiar. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për mjediset operative që janë të karakterizuara nga luhatshmëri e lartë dhe për shumë banka me *themelore financiare* të dobëta. Moody's fokusohet në burimet alternative të likuiditetit, duke përfshirë edhe shkallën e aksesit të tyre për në tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare të kapitalit. Shkalla në të cilën banka financohet me depozitat bazë nga depozitues me pakicë të cilat kanë prirje për të qenë burime të qëndrueshme financimi, kundrejt depozitave të mëdha apo nga depozitues me shumicë (depozitues institucionale) që kanë prirje për të qenë burime të paqëndrueshme financimi. Aspekti tjetër i financimit që verifikohet është mundësia e financimit të bankave me linja mbështetëse ("back-up").

Tek likuiditeti, Moody's shikon aftësinë e bankës për të shndërruar në likuiditet bilancin e saj, nëpërmjet shitjes së zotërimeve apo aktiveve të saj fitimsjellëse, qoftë duke krijuar një grupim instrumentalizues financimi (*securitization*) të një pjese të portofolit të saj të kredisë ose duke shitur një pjesë apo një portofol investimesh. Këta tregues shihen si të rëndësishëm sepse shërbejnë për të matur pozicionin e përgjithshëm të likuiditetit të bankës. Treguesit më spikatisë që Moody's merr në konsideratë janë:

- (a) Totali i depozitave të analizuara në prirje, përbërje dhe emërtim valutor.
- (b) Shkalla e monetizimit apo raporti depozita ndaj GDP (deposits/GDP).
- (c) Raporti i zotërimeve likuide ndaj depozitave (Liquid Assets/deposits)
- (d) Raporti i zotërimeve si kreditime ndaj shumës së depozita me fonde të tjera të huamarra [Loans/(deposits & borrowings)]

Vlerësimi krahasues që shprehet nga raporti i depozitave ndaj GDP përmban matësat e financimit të depozitave bazë, shkallën e ndërmjetësimit, si dhe masën derisa një ekonomi bazohet në transaksione me para në dorë. Ky tregues shpalos shumë informacion për fazën e zhvillimit të një sistemi të veçantë bankar.

Profili i likuiditetit dhe struktura e financimit të një sistemi bankar janë reflektim i mjedisit operues të sistemit bankar e brenda tij të një banke. Në ekonominë me shkallë më të lartë të luhatshmërisë dhe me akses të kufizuar për në tregjet e kapitalit, mund të pritët një nivel më i lartë i aktiveve likuide ndaj depozitave. Në skenare e rrethana të tilla, metodologjia e Moody's shqyrton zotërimet likuide të sistemit bankar. Kjo me qëllim që të vlerësohet shkalla deri në cilin nivel sistemi bankar në fjalë mund të mbulojë depozitat e veta bazë, pa neglizhuar vëmendjen ndaj paqëndrueshmërisë apo luhatjeve që lidhen me një financim të tillë.

Në shumë ekonomi në zhvillim, aktivet dhe detyrimet priren të rivlerësohen nga tregu shumë më shpesh se ç'ndodh në mjedise të qëndrueshme operuese. Përveç kësaj, struktura e kohëgjatësisë së maturimit të depozitave është zakonisht më e shkurtër se struktura e kohëgjatësisë së maturimit të portofolit të kredive të një banke, e cila mund të reduktohet të përbëhet nga kreditë për kapital punues (për mjete xhiro) që zakonisht qarkullojnë brenda vitit.

Duke operuar mbi një bazë specifike të njësisë ekonomike në normim, Moody's ekzaminon shkallën sipas së cilës një bankë mund të mbështetet për refinancime dhe ristrukturime në rast të një krize likuiditeti, në aksesin që banka ka apo fiton për të hyrë e pjesëmarrë në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Vëmendje e veçantë i kushtohet bankave me profil rreziku si në vijim:

–Themelorë financiarë të dobët, ndërkohë që rritja e kreditimit financohet me huamarrje nga jashtë dhe shumë më pak ose aspak nga konvertimi në para i kredive për arkëtim.

–Moody's mbron pikëpamjen se emetuesit bankar me vlerë të shumtë të borxheve janë më të prekshme nga luhata e besimit të investitorëve gjatë periudhave të rënies ekonomike. Kjo edhe kur përballen me goditje të jashtme që mund të pengojnë aksesin e bankës ndaj financimeve të tilla.

3.2.1.4-Fitimshmëria

Për Moody's, fitimshmëria e një banke konsiderohet përcaktori përfundimtar që lidhet me suksesin apo dështimin e një institucioni bankar. Ndërmjet të tjerave, fitimshmëria mat suksesin e drejtimit në hapësirat dhe rrethanat më kritike për cilësinë e aktiveve, për efikasitetin operues dhe për gjenerimin e të ardhurave thelbësore. Moody's trajton komponentë të ndryshëm të fitimshmërisë, duke përfshirë si burimet po ashtu edhe cilësinë e fitimeve. Horizonti vëzhgues është i lidhur se deri në ç'masë një bankë mbështetet në fitimet jo të zakonshme apo në përvojat e pazakonshme të përjetimit të humbjeve në rrjedhjen e të ardhurave. Gjithashtu metodologjia e vlerëson këtë element edhe me aftësinë e normuesve për të kontrolluar shpenzimet e bankës, sidomos në mjediset operative që karakterizohen me nivel të lartë të shpenzimeve të përgjithshme (tipike për vendet në zhvillim).

Krahas matësve klasikë të fitimshmërisë si p.sh., Shlyerjet ndaj zotërimeve mesatare (*Return On Average Assets -ROAA*) dhe Marzhi neto i interesit (*net interest margin -NIM*), Moody's shqyrton edhe treguesit në vijim:

- (a) Raporti i kredive jo të mbara ndaj fitimshmërisë përpara provizionimit (*NPL/pre-provision profitability*)
- (b) Raporti i fitimshmërisë përpara provizionimit ndaj zotërimeve totale mesatare (*Pre-provision profitability/total average assets*)

Nivelet e ulta të fitimshmërisë lidhen me cilësinë e dobët të zotërimeve/aktiveve të cilat, për shumë banka, përfaqësojnë shpenzime të larta kontabël për aktivet me probleme. Kostot e larta të mbajtjes së zotërimeve me probleme imponojnë kosto të larta pune, kosto të larta të shërbimit juridik, etj., që ndikojnë në uljen e marzhit të fitimit, diferenca më të ulta të interesave në depozita ndaj interesave për kredi, që shoqërohen në një mjedis operativ gjithnjë e më konkurrues.

Në rastet më të dendura në vendet në zhvillim bankat konkurrojnë në krahun e depozitave bazë duke ndikuar në koston e lartë të likuiditetit të bankave me mungesë e nga ana tjetër pika e dobët e këtyre bankave është se kur i shndërrojnë në kredi i rezultojnë edhe kredi me probleme duke dëmtuar aktivet dhe krijuar kosto shtesë. Kështu vlera e franshizës së bankave çenohet duke rritur forcën dhe përpjekjet për të parashikuar rrezikun e kreditit si element i rëndësishëm në normimin vlerësues.

Fitimshmëria e para provizionuar ka rëndësi të madhe për Moody's, sidomos në mjedise operuese të karakterizuara nga nivele të larta të aktiveve me probleme. Nga ana tjetër kjo interpretohet si cënim i aftësisë së një institucioni bankar për të gjeneruar nivele të mjaftueshme të të ardhurave nga ku burojnë mundësitë që të ndërtojnë rezerva për humbjet dhe nivele provizionimi pa grryer bazën e kapitalit të bankës. Kjo shihet në vijueshmërinë jo vetëm të një viti por edhe të viteve të tjera.

3.2.2- Metodologjia e Standard & Poors në Normimin e Bankave

Standard & Poor`s (S&P) ka metodologji të veçantë për bankat dhe tjetër për shoqëritë financiare, bursat, ndërmjetësuesit financiar dhe të ngjashme me këto. Metodologjia S&P konsiston në dy hapa kryesore:

1-Në përcaktimin e profilit kreditues më vehte të bankës (*Stand Alone Credit Profile – SACP*) dhe

2-Në vlerësimin e mbështetjes së jashtëzakonshme që ofrohet nga qeveria apo një grup financues.

Pasiqë përcaktohen gjasat për mbështetjen e jashtëzakonshme, atëherë krijohen kriteret treguese që njihen si *normim i besueshmërisë së emetuesit (issuer's credit rating -ICR)*. Indikatorit ICR llogaritet duke kombinuar ICR me SACP dhe me përfundimet e nxjerra për gjasat e përfitimit të mbështetjes financiare në rrethana kur përjetohet vështirësi financiare.

Në shumicën e rasteve, niveli ICR është i njëjtë me nivelin e indikatorit ICR, ndonëse ka raste të përcaktuara kur kriteret lejojnë caktimin e një niveli ICR më të lartë ose më e ulët se do të rezultonte nga kriteret për caktimin e SACP, duke marrë të nënkuptuar se ka mbështetje të jashtëzakonshme.


Të tre këto komponentë që përfshihen në *grafikun 3.1*, ndikojnë në normimin vlerësues të emetuesit të kredisë (ICR) si dhe në normimin e instrumentave në trajtën e gjendjes së aksioneve të preferueshme dhe hibride (me përmbajtje të përzier kapitali + borxh). Normimet e emetimit ndaj instrumentave hibride i referohen SACP, ndërsa normimet e emetimit ndaj instrumentave të pagarantuar ose të pasigurt të nivelit të lartë i referohen ICR.

Vlerësimi i SACP qëndron në gjashtë faktorë (*shih grafikun 3.2*). Të dy faktorët e parë janë *rreziku ekonomik* dhe *rreziku i industrisë bankare* të cilët përfshihen në metodologjinë e Vlerësimit të Rrezikut të Vendit të Industrisë Bankare (*Banking Industry Country Risk Assessment -BICRA*). Këto përfaqësojnë pikat e forta dhe të dobëta të mjedisit të gjerë operues që vendos apo fikson si spirancë SACP.

Katër faktorët e tjerë përfaqësojnë anët e forta dhe të dobëta specifike për bankën. Duke u bazuar në analizën e këtyre faktorëve, SACP është i përcaktuar në nivele të dallueshme për lartë ose për poshtë në lidhje me pikë vendosjen spirancë.

Korniza mbështetëse e konsideron së bashku, si marrëdhëniet e një banke me grupin e saj amë apo me qeverinë, po ashtu edhe se si kjo marrëdhënie e ndryshon nivelin e përgjithshëm të besueshmërisë për krejt bankën. Sipas metodologjisë së S&P, *indikatorit ICR* është i njëjtë me SACP nëse, në një krizë, banka ka gjasa të marrë kapital shtesë, likuiditet shtesë, ose ulje të rrezikut për hir të ndihmës mbështetëse nga qeveria ose grupi amë. Në praktikë, një bankë zakonisht merr ndihmë qoftë nga grupi i saj amë qoftë nga qeveria. Prandaj, një bankë që është një degë e një banke amë merr vlerësim për tregues ICR më të lartë kur kjo rezulton nga zbatimi i kuadrit të mbështetjes si grup amë ose si mbështetje financuese nga qeveria.

Grafiku 3.1 Normimi vlerësues i emetuesit të kredisë



Grafiku 3.2 Kuadri i normimit sipas S&P

Kuadri i normimit të Bankave


**Metodologjia
BICRA**

Metodologjia e vlerësimit të bankës

**FAKTORËT
MAKRO**

**FAKTORË TË VEÇANTË
TË BANKËS**

MBËSHTETJA E JASHTME



3.2.2.1–Metodologjia: Vendosja e ICR dhe SACP

ICR është vendosur në të njëjtin nivel me indikatorin ICR, ose në disa raste kur aplikohen kriteret përkatëse mund të përcaktohet në një nivel më të lartë ose më të ulët. Pikëpamja për normimin e një banke korrigjohet me kujdes duke marrë parasysh gjendjen besueshmërisë së bankës në veçanti në krahasim me mjedisin e bankave me të cilat konkurron dhe operon dhe që kanë një nivel të ngjashëm SACP, por që gjithashtu mund të jetë një ose dy dallues mbi/nën. Për shembull, nëse një bankë ka një SACP në nivelin 'a-', ajo krahasohet me bankat e tjera me SACP të nivelit 'a', 'a-', dhe 'bbb +'.

Në rishikimin përfundimtar me grupin krahasues të bankave, duhet thënë se raporti i qendrueshmërisë së kapitalit dhe raporti i fitimeve për rezervë janë matësit kryesore për krahasimin në fjalë. Kombinimi i këtyre matësve të fitimeve do të thotë se banka me fitime apo të ardhura më të larta se mesatarja njihet vetëm kur një bankë mban të njëjtën pozitë kapitale ose rrit kapital.

Indikatori ICR është për një dallues më lart kur banka në shqyrtim ka këto veti:

1-Është në një tranzicion pozitiv sepse përjeton pakësim të rrezikut ose përmirëson besueshmërinë që deri në këtë moment nuk është pasqyruar në nivelin e ICR.

2-Është subjekt i prirjeve ekonomike, sociale, politike dhe konkurruese që ndikojnë në rritjen e besueshmërisë së bankës.

3-Është përmbushës i qendrueshëm i detyrave të planifikuara duke spikatur brenda grupit krahasues me bankat e tjera, nëpërmjet niveleve më të favorshme pozitive të raporteve financiare dhe kur një gjë e tillë nuk është përfshirë dhe as raportuar në bazë të metodologjisë së deriatëhershme.

Në skenarë të kundërt, banka mund të përkatësohet nga raporti rregullator si `në rrezik` ose me likuiditet të dobët.

SACP bazohet në vështrimin mikro të bankës. Nëse *rreziku ekonomik* dhe *rreziku i industrisë* përfaqësojnë analizën e besueshmërisë së bankës nga këndvështrimi makro, treguesit që lidhen me pozicionin e biznesit, me kapitalin e fitimet, me rrezikun, me financimin dhe me likuiditetin e bankës, përfaqësojnë analizën e besueshmërisë së bankës nga këndvështrimi mikro. Në analizën makro merret në konsideratë metodologjia e Vlerësimit të Rrezikut të Vendit të Industrisë Bankare (*Banking Industry Country Risk Assessment -BICRA*) nëpërmjet së cilës S&P përcakton pikën spirancë të bankës (SACP) si pikënisje për të vendosur ICR.

Mirëpo përcaktimi makro i normimit vlerësues të bankës nuk mjafton. Kjo korrigjohet në pozicionin që banka ka në shkallën normuese për më lart ose për më poshtë, pasi merren në konsideratë fortësitë dhe dobësitë specifike të bankës. Kjo bëhet duke u bazuar në faktorët e mëposhtëm:

- 1-Pozicioni i Biznesit
- 2-Kapitali dhe Fitimet
- 3-Pozicioni në Rrezik
- 4-Financimi dhe Likuiditeti

Në metodologjinë e S&P **rreziku ekonomik** (*economic risk*) është faktori i parë për përcaktimin e SACP. Një ndryshim në rrezikun ekonomik nxit një ndryshim në pikëvendosjen spirancë të SACP për bankën që operon në mjedisin e vendit ku vlerësohet rreziku ekonomik.

Struktura BICRA e pikëve të rrezikut ekonomik të vendit (niveli 1 me rrezik minimal dhe niveli 10 me rrezik maksimal) ndikon në rrezikun ekonomik të vetë bankës.

Rreziku ekonomik merr në konsideratë stabilitetin dhe strukturën e ekonomisë së vendit ku operon banka, fleksibilitetin e politikës ekonomike, pabarazitë faktike apo potenciale/të mundshme, si dhe rrezikun e kredisë të pjesëmarrësve ekonomik (kryesisht familjarët dhe ndërmarrjet). Metodologjia BICRA kërkon të identifikojë mundësinë për ecuri të pafavorshme ekonomike dhe kapacitetin e sistemit bankar për tu përballur dhe pakësuar impaktin negativ të tyre.

Përveç sa më sipër, kriteri S&P për vlerësimin e kapitalit të bankës përshkallëzohet duke përdorur pikët e rrezikut ekonomik të vendit provizionet kapitale sipas kornizës së provizioneve kuotë të kapitalit të korrigjuar në rrezik (*risk-adjusted capital framework - RACF*). Për të njëjtat ekspozime në vendet me rrezik ekonomik të vlerësuar për më lartë, aplikohen pesha më të larta me rrezik.

Rreziku i industrisë është faktori i dytë për përcaktimin e SACP. Një ndryshim në rrezikun e industrisë bankare nxit një ndryshim pikëvendosjen spirancë të SACP për bankën që operon në mjedisin e vendit ku vlerësohet rreziku i industrisë bankare. Struktura BICRA e pikëve të rrezikut të industrisë bankare të vendit (niveli 1 me rrezik minimal dhe niveli 10 me rrezik maksimal) ndikon në rrezikun e vetë bankës. Rreziku i industrisë vlerëson tre tipare strukturore të industrisë bankare të një vendi dhe konkretisht:

1-Kornizën institucionale apo cilësinë e efektivitetit të rregullativës bankare si dhe të gjitha ndërhyrjet e regjistruara të autoriteteve monetare në amvisimin e çrregullimeve në sektorin financiar të vendit.

2-Dinamika konkurruese ose sfondi konkurrues dhe i mbarëvajtjes së industrisë bankare duke përfshirë produktet financiare dhe rolin e institucioneve financiare jo bankë (*non bank financial institutions -NBFI*). Këtu duhet theksuar se përdorimi sa më i gjerë i produkteve financiare komplekse (p.sh., i derivativave financiare) kontribuon në normim për nivel më të lartë rreziku të industrisë bankare dhe e kundërta.

3-Financimin nëpërmjet tregut monetar apo nga qeveria, duke përfshirë edhe rolin e Bankës Qendrore. Roli mbështetës nga qeveria, banka qendrore dhe kombinimi i të dyjave shihet në ecurinë kohëgjatë dhe jo si politikë apo qendrim momental i tyre.

Nëse banka operon në disa vende, duhet sqaruar se në metodologjinë e S&P, përndryshe nga rreziku ekonomik, rreziku i industrisë bankare nuk llogaritet si mesatare e peshuar. Kjo sepse rëndësi parësore i jepet kornizës rregullatore të vendit amë të bankës dhe jo të vendit ku operon banka.

3.2.2.2–Pikëvendosja e Ankorimit SACP: Kombinimi i Rrezikut Ekonomik me Rrezikun e Industrisë

Rreziku ekonomik dhe rreziku i industrisë bankare janë faktorë fiksues të vendosjes së ankorimit të besueshmërisë së bankës që operon në këto mjedise njëkohësisht, duke përcaktuar në mënyrë specifike një ankorim për secilin rrezik. Ankorimi SACP është konsistent në vlerësimin global për normimin relativ të besueshmërisë së bankës nga pikëvështrimi i tregut bankar dhe cilësohet nga niveli 'a' me më pak rrezik deri tek 'b-' me më shumë rrezik.

Më poshtë jepet *tabela 3.1* që S&P paraqet si metodologji për ankorimin e rrezikut ekonomik dhe të industrisë bankare sipas kriterit të SACP, që është ankorim më vehte i secilës bankë duke u bazuar në makromjedisin operues të ekonomisë dhe të industrisë.

Shkalla nivelore është nga 1 (me rrezikun minimal) deri tek 10 (me rrezikun maksimal). Horizontalisht lexohet nëpërmjet simboleve me gërma ecuria nivelore e rrezikut ekonomik, ndërsa vertikalisht ajo e rrezikut të industrisë.

Tabela 3.1 Metodologji për ankorimin rrezikut ekonomik dhe të industrisë bankare

	Risku ekonomik*									
Risku i industrisë*	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	A	A	a-	bbb+	bbb+	Bbb				
2	A	a-	a-	bbb+	bbb	Bbb	bbb-			
3	a-	a-	bbb+	bbb+	bbb	bbb-	bbb-	bb+		
4	bbb+	bbb+	bbb+	bbb	bbb	bbb-	bb+	bb	Bb	
5	bbb+	bbb	bbb	bbb	bbb-	bbb-	bb+	bb	bb-	b+
6	Bbb	bbb	bbb-	bbb-	bbb-	bb+	bb	bb	bb-	b+
7		bbb-	bbb-	bb+	bb+	Bb	bb	bb-	b+	b+
8			bb+	bb	bb	Bb	bb-	bb-	b+	b
9				bb	bb-	bb-	b+	b+	b+	b
10					b+	b+	b+	B	B	b-
*Me shkallë nivelore nga 1-10, nga më niveli më i ulët i rrezikut në atë më të lartit dhe pikët e rrezikut ekonomik dhe të industrisë janë rrumbullakosur në numër të plotë para se të përfshihen në tabelë. SACP-- Profili kreditues më vehte i bankës (<i>Stand-alone credit profile</i>)										

Krizat e njëpasnjëshme apo seri të bankave provuan mundësinë për humbjen e besimit të depozituesve dhe kreditorëve/investitorëve të bankave, të ndërhyrjeve qeveritare me financim humbjesh si dhe me frenimin e rritjes ekonomike. Ndjeshmëria ndaj besimit dhe ekspozimi huamarrës i bankave mund të shndërrohen nga stres i moderuar në rënie të ndjeshme të mbarëvajtjes dhe forcës financiare të bankave.

Pasiqë përcaktohet ankorimi SACP, metodologjia e S&P vijon me përcaktimin e **faktorit specifik normues të SACP për bankën** që imponon një analizë të karakteristikave specifike të bankës në fjalë. Vlerësimi për secilin faktor mund të rrisë ose të ulë ankorimin me një ose dy dallues deri edhe pa ndikim. Për këtë arsye normimi përcakton numrin e dalluesve që duhen aplikuar për të regjistruar ankorimin për normimin specifik të bankës me SACP. Kjo jepet në tabelën 3.2 ku *faktorët normues* strukturohen sipas niveleve (shumë e fortë, e fortë, etj.) duke përfshirë (a) pozitën e biznesit, (b) kapitalit dhe fitimit dhe (c) pozicioni i rrezikut

Tabela 3.2 Përcaktimi i faktorit specifik normues të SACP për bankën

Analiza specifike e bankës për të përcaktuar SACP			
Faktorët e normimit/renditjes	Rregullimi SACP		
Pozita në biznes			
Shumë i fortë	+2 dallues		
I fortë	+1 dallues		
I përshtatshëm	0 dallues		
Mjaftueshëm	-1 dallues		
I dobët	-2 deri -3 dallues		
Shumë i dobët	-5 dallues		
Kapitali dhe fitimet	bbb- ose më lartë	bb+ deri te bb-	Më poshtë se bb-
Shumë i fortë	+2 dallues	+2 dallues	+2 dallues
I fortë	+1 dallues	+1 dallues	+2 dallues
I përshtatshëm	0 dallues	0 dallues	+1 dallues
Mjaftueshëm	-1 dallues	0 dallues	0 dallues
I dobët	-2 deri -3 dallues	-1 dallues	0 dallues
Shumë i dobët	-5 dallues	-2 dallues	-1 deri -2 dallues
Pozicioni i rrezikut			
Shumë i fortë	+2 dallues		
I fortë	+1 dallues		
I përshtatshëm	0 dallues		
Mjaftueshëm	-1 dallues		
I dobët	-2 deri -3 dallues		
Shumë i dobët	-5 dallues		

Më tej metodologjia implikohet në analizën krahasuese (me diferenca relative dhe absolute) me grupin e bankave [brenda vendit operues] për të parë shkallën e këtyre diferencave ndaj treguesve specifik të bankës me ato të grupit si dhe për të vendosur ICR.

Ka edhe një cilësim tjetër si relativ dhe absolut në metodologjinë e S&P, ku përcaktohet se analiza për pozicionin e biznesit, pozicionin në rrezik, dhe për shkallën e financimit konsiderohet relative, ndërsa analiza për kapitalin, fitimet dhe likuiditetin konsiderohet absolute.

3.2.2.3–Pozicioni i Biznesit

Pozicioni i Biznesit është kombinim i karakteristikave specifike të bankës në shqyrtim dhe të industrisë bankare ku ushtron veprimtarinë banka. *Pozicioni i Biznesit* është faktori i tretë i SACP, i cili mat forcën e operacioneve të biznesit të bankës dhe shpërbëhet në 3 nënfaktorë:

1-Stabiliteti i Biznesit (qendrueshmëria apo paqendrueshmëria e vlerës së franshizës së bankës) që shprehet me: a) Qendrueshmëria e të ardhurave, b) Hisja që ka banka në treg (për kredi dhe/ose depozita), c) Baza e klientelës.

2-Përqendrimi i portofolit apo shkalla e diversitetit (të kredive dhe veprimtarive investuese të bankës) që shprehet me: Kontributi i linjave të biznesit të bankës në totalin e të ardhurave dhe fitimit të saj; dhe,

3-Strategjia e drejtimit dhe e korporatës (cilësia e amvisimit, strategjia dhe qeverisja e korporatës) që shprehet me: a) Pozicionimin strategjik, b) Efektivitetin operacional, c) Amvisimin financiar, dhe c) Politikat financiare.

Forca relative vlerësohet me një numër indikatorësh që jepen në tabelë sipas metrikës përkatëse.

Tabela 3.3 Pozicioni i Biznesit

Pozicioni i biznesit nënfaktorët dhe indikatorët

Nënfaktorët	Sqarimi	Indikatorët
Stabiliteti i biznesit	i Qendrueshmëria apo paqendrueshmëria e vlerës së franshizës së bankës	Qendrueshmëria e të ardhurave, hisja që ka banka në treg (për kredi dhe/ose depozita), dhe baza e klientelës.
Përqendrimi apo shkalla e diversitetit	Përqendrimi i portofolit apo shkalla e diversitetit të biznesit të bankës.	Kontributi i linjave të biznesit të bankës në totalin e të ardhurave dhe fitimit të saj.
Strategjia e drejtimit dhe e korporatës	Cilësia e amvisimit, strategjia dhe qeverisja e korporatës	Pozicionimi strategjik, Efektiviteti operacional, Amvisimi financiar, dhe Politikat financiare.

Për të përcaktuar SACP të bankës bëjmë analizën specifike të bankës dhe rregullimin e pozitës në biznes e bëjmë duke u bazuar në tabelën 3.2

Stabiliteti i Biznesit si nënfaktor i parë lidhet me forcën e bankës për të vijuar me vëllim të qendrueshëm biznesi si dhe për të përballuar rrethana të luhatjes së tregut. Nëse perceptohet se banka nuk i bën ballë luhatjeve të tregut atëherë banka ka probabilitet të lartë që të kërcënohet në rrezikun e dështimit të papritur (*sudden default risk*). Klientët dhe kundërpalët e bankës largohen duke sosur edhe aksesin e bankës në tregjet monetare për likuiditete. Një pozicion biznesi me rrezikun e dështimit të papritur bie ndesh me vlerësimin normues 'a' sipas SACP. Për këtë arsye kriteri bazohet në stabilitetin e të ardhurave, të hises së tregut dhe të bazës së klientelës. Kjo ndihmon të krahasohet qendrueshmëria e biznesit të bankës me ato të bankave të vendit ku operohet si dhe me banka të tjera por në vende me karakteristika të ngjashme.

Shtrirja e analizës për kontributet e secilës linjë biznesi të bankës në të ardhurat dhe fitimshmërinë e saj përfshin si të ardhurat nga interesat po ashtu edhe të ardhurat jo nga interesat. Linjat e biznesit me ritëm konstant kontributesh konsiderohen të qendrueshme e me normim të ulët rreziku; si dhe e kundërta për linja biznesi me luhatje të ndjeshme, të paqendrueshme dhe me ndërprerje. Si linja biznesi përfshihen të ardhurat tregtare nga interesat, të ardhurat neto nga mospërpunimet mbi mesataren të zotërimeve dhe detyrimeve të bankës, të ardhurat të tjera të ndjeshme ndaj tregut dhe komisione për financime jashtë bilancit.

Qendrueshmëria e biznesit konsiderohet se kontribuon në pozicionin e biznesit kur banka gëzon të paktën 2 karakteristika:

- a) Ka qendrueshmëri në bazën e klientelës që d.t.th., se nivel të lartë të mbajtjes së klientelës në afatgjatë dhe se këta klientë kontribuojnë në gjenerimin e të ardhurave të bankës. Kësisoj ka probabilitet të lartë që klientët të qendrojnë me bankën edhe kur përjetohe stres financiar.
- b) Të ardhurat e bankës janë më pak të ndjeshme ndaj perceptimit në treg për besueshmërinë e bankës.

Bankat janë më pak të ndjeshme ndaj rrezikut kur përfshijnë në kontrata klauzola mbrojtëse për shpejtim të arkëtimit të kredive në rrethana dhe ngjarje të specifikuara drejt dhe të pranuar nga klientët e kundërpalët.

Përqendrimi dhe diversiteti i portofolit të veprimtarisë së bankës është nënfaktori i dytë për vlerësimin e pozicionit të biznesit dhe diagnostikohet për larminë e shtrirjes së biznesit të bankës në financimin e bizneseve të përkatësive të ndryshme industriale p.sh. tregti, prodhim (industrial, bujqësor, përpunim, etj.), shërbim, etj., e në zona të larmishme gjeo-ekonomike. Bankat dhe brenda saj degët e bankës me shkallë të lartë të përzierjes së veprimtarisë kanë rrezik më të ulët ndaj pozicionit të biznesit dhe e kundërta, nëse banka e degë të saj kanë shkallë të lartë të përqendrimit të portofolit në pak veprimtari. Sa më e lartë shkalla e larmisë së aktiveve aq më i ulët rreziku dhe aq më i qendrueshëm pozicioni i biznesit të saj. Nga ana tjetër prezenca rajonale e bankës duhet të shihet në kontekstin e oportuniteteve dhe kushteve ekonomike të favorshme që ka rajoni në fjalë për të justifikuar apo argumentuar praninë e bankës në këtë rajon.

Drejtimi/Amvisimi dhe Strategjia janë nënfaktori i tretë i pozicionit të biznesit të bankës dhe përfshin aftësinë e normuesve për të zbatuar planet operacionale në një mënyrë konsistente, sipas strategjisë, misionit dhe vizionit të bankës, sipas oreksit për rrezik të normuesve dhe sipas pronësisë dhe qeverisjes së saj. Ky është vlerësim cilësor që krahasohet me të kaluarën, me nivelet e ndryshme organizative (departamente, dege, etj.) si dhe me grupin krahasimor të bankave në vende me rrezik ekonomik dhe rrezik biznesi të ngjashëm. Një drejtim i suksesshëm d.t.th., realizon në kohë dhe në nivele të larta të detyrave, për rrjedhojë edhe rrezik më të ulët. E kundërta ndodh kur banka nuk ka qendrueshmëri normuese dhe kjo shfaqet në treguesit sasior në rënie të performancës p.sh. të Shlyerjes Kapitale (ROE), rritjes së Fitimeve për Aksion (EPS_{growth}), të skemave shpërblyese, të skemave nxitëse për akses drejtimi dhe për raportimet në lidhje me oreksin për rrezik. Treguesit e mësipërm krahasohen me periudhat e mëparshme, me grupin krahasimor të bankave dhe me segmente kohore më të ngushtë brenda një periudhe krize për të parë se sa ekspozohet banka ndaj rrezikut të strategjisë.

Kapitali dhe Fitimi janë nënfaktori i katërt i pozicionit të biznesit të bankës në normimin sipas SACP. Rëndësia e këtij nënfaktori është se niveli i tyre informon për aftësinë e bankës për të përthithur humbje të mundshme, duke krijuar një masë mbrojtëse për kreditorët dhe depozituesit e saj, si dhe duke rritur perceptimin se banka është një shqetësim në vijim, pra po operon sipas parimit të vazhdimësisë.

Analiza e këtij nënfaktori përfshin 4 hapa:

- (a) **Vlerësimin e kërkesave rregullatore për kapitalin** (hap parakusht që banka të mbahet në biznes nga organet mbikëqyrëse/rregullatore). Çdo shmangie e pafavorshme do të ishte faktor negativ për normimin SACP. Banka me kapital

shumë në prag të limitit minimal rregullator konsiderohet me rrezik të lartë dhe e kundërta.

- (b) **Nivelet e ardhme të kapitalit të korigjuar me rrezikun** (*risk adjusted capital - RAC*) informon për qendrueshmërinë në të ardhmen pasiqë përmbushet kushti pararendës. Treguesi më informues është mbajtja e fitimeve për rimbjellje në kapital për të ruajtur të paprekur raportet e mjaftueshmërisë së kapitali. Ky raport i mbajtjes së fitimeve shpreh edhe raportin e qendrueshmërisë së mbajtjes së mjaftueshmërisë së kapitalit. Nga ana metodologjike kjo shihet më qartë në tabelën 3.4:

Tabela 3.4 Kapitali i korigjuar me rrezik

Raporti financiar RAC = TAC + RWAs
RAC-- Kapitali i rregulluar me rrezik
TAC-- Kapitali total i rregulluar, sipas përkufizimit të kapitalit të Standard & Poor's
RWAs-- Aktive të ponderuara në rrezik, sipas llogaritjeve të Standard & Poor's

Për shembull, nëse aktivet e peshuara në rrezik rriten për 10%, atëherë për të ruajtur nivelin e raporteve të mjaftueshmërisë së kapitalit duhet që edhe nevojat për kapital të rriten afërsisht po me 10%. Mirëpo çdo dështim për të rritur fitimin mbi 10% do të ekspozonte bankën në rrezikun e pamjaftueshmërisë së kapitalit si dhe në kërkesë për tu financuar me kapital shtesë nga jashtë për këtë mungesë.

Nga ana tjetër kur banka merr rrezik më shumë dhe raportin të ardhura më të larta, llogaritja për qendrueshmërinë kapitale korigjohet për këtë duke rritur nivelin e aktiveve të peshuara në rrezik që S&P përfshin në metodologjinë e vet.

S&P përdor 6 shkallë të cilësuesit të raportit të kapitalit të korigjuar me rrezikun, që jepen më poshtë.

Tabela 3.5 Vlerësimi i kapitalit të korigjuar me rrezik

Vlerësimi i kapitalit	
Vlerësimi	Niveli i projektuar i raportit të kapitalit të korigjuar me rrezikun (%)
Shumë i fortë	Më i madh se 15%
I fortë	Më i madh se 10% dhe maksimumi deri 15%
I përshtatshëm	Më i madh se 7% dhe maksimumi deri 10%
Mjaftueshëm	Më i madh se 5% dhe maksimumi deri 7%
Dobët	3% deri në 5%
Shumë dobët	Më pak se 3%
Impakti i shkallëve të vlerësimit modifikohet për bankat me SACP `bb` dhe `b`	

Matësi më i mirë është niveli i projektuar i raportit të kapitalit të korigjuar me rrezikun (*risk-adjusted capital -RAC*). Në versionin metodik jepet edhe tabela e llogaritjes së qendrueshmërisë së kapitalit për një bankë të supozuar:

Tabela 3.6 Llogaritja e qendrueshmërisë së kapitalit për një bankë të supozuar

Llogaritja e qendrueshmërisë së kapitalit për një bankë të supozuar			
Miliona €	Projektimi për vitin e ardhshëm	Vlerësimi për këtë vit	Viti i fundit (aktual)
Të ardhura operative para provizioneve	2094	1672	1563
Humbjet nga kreditë	-295	-450	-700
Humbje të tjera	0	-56	-125
Taksa	-452	-343	-231
Dividendë	-156	-128	-105
Riblerje e aksioneve	-650	-350	0
Ndërtimi i kapitalit(CB)	541	345	392
S&P aktive të peshuara në rrezik	42000	36500	28500
CB/S&P RWAs (bps)	129	95	138
Mesatarja 3-vjeçare e CB/S&P RWAs		120	
S&P aktive të peshuara në rrezik	42000	36500	28500
Rritja (%)	15.07	28.07	3
Kapitali i rregulluar me rrezik(i fundit i raportuar) (%)	8.49	8.49	8.49
Kapitali total i rregulluar	3566	3099	2420
Kapitali shtesë i kërkuar (ACR)	467	679	226
ACR/S&P RWAs	111	186	79
Mesatarja 3-vjeçare e ACR/S&P RWAs		126	
CB minus ACR (bps)	18	(92)	58
Qendrueshmëria kapitale		(5)	
bps- basis points.			

Në rreshtin e dytë të tabelës, humbjet e vlerësuara në kredi pasqyrojnë skenarin më të ndodhshëm sipas parashikimeve të S&P. Këto janë humbje të llogaritura për një bankë specifike nga ndikim faktorësh në nivel vendi. Këto modifikohen për humbje më të ashpra të pritshme kur ka argumenta në faktorët specifik të rrezikut të bankës si p.sh., për nivelin e pamjaftueshëm të rezervave për humbje nga kreditë, për rritje të dëmtimit të kredive dhe të rënies së forcës kuruese të bankës kur mbulesa për humbje nga kreditë nuk mjafton apo është me mungesë. Për këtë duhen llogaritur rezerva mbështetëse nga fitimet (*earnings buffer*) dhe duhet operuar me humbjet e normalizuara sipas ecuresë së ciklit të kredive.

Megjithëse raporti RAC është matësi më konsistent i pranuar gjithësisht e globalisht, metodologjia e S&P kërkon që gjithësi supozimet ose hipotezat për rrezikun duhen testuar si pjesë vlerësuese e *pozicionit të rrezikut*.

Analiza e *pozicionit të rrezikut* në thelb përcakton shkallën sipas së cilës analiza e kapitalit dhe e fitimeve nënvlerëson apo mbivlerëson rrezikun specifik të bankës, prandaj në këtë analizë përfshihen edhe gjykime cilësore rreth cilësisë së TAC dhe cilësisë së fitimeve.

(c) Cilësinë e kapitalit dhe të fitimeve lidhet me qendrueshmërinë dhe parashikueshmërinë e fitimeve si dhe me prirjen e TAC. Kur raporti i projektuar i

RAC është i lartë atëherë cilësia e kapitalit dhe e fitimeve kategorizohet për më lartë dhe e kundërta. Kriteri që lidhet me cilësinë e kapitalit përmbledh:

► Kapitalin bazë të bankës, që matet me kapitalin aksionar të zakonshëm të korigjuar (*adjusted common equity -ACE*) që duhet të ketë peshë mbi 85% të kapitalit tërësor të korigjuar (*total adjusted capital -TAC*).

► Baza e investitorit është më mbështetëse ndaj bankave me kapital më cilësor e më të fortë se sa ndaj bankave të tjera, sepse kjo i krijon siguri më të lartë në lidhje me dividendët. Gjithashtu riblerja e aksioneve bëhet më konsistente.

► Banka është në gjendje dhe e vullnetshme për të shitur zotërime atraktive që janë 10% apo më shumë ndaj TAC e në këtë mënyrë të ketë likuiditete të shtuara disponibël. Për aktive të tilla ka gjithnjë blerës të interesuar, madje edhe në raste të turbullirave të tregut.

► Banka ka kapital ekonomik të mjaftueshëm në rezerva për të paktën 10% të TAC që kryesisht krijohen nga optimizimi i taksave.

► Banka ka emetuar instrumenta hibrid ose aksione të preferueshme për të paktën 10% të TAC, që institucionet rregullatore i trajtojnë dhe i konsiderojnë kapital.

Metodologjia S&P përcakton edhe kriterin e kapitalit dhe ose të fitimeve me cilësi të ulët në bankë si kombinim i përcaktorëve të mëposhtëm:

1. Kriteri që shoqëron kapitalin apo fitime të cilësisë së ulët duke kombinuar:

► Kapitalin bazë të bankës për pjesën e aksioneve të zakonshme të korigjuar (*adjusted common equity -ACE*), që përfshin më pak se 70% të kapitalit gjithsej të korigjuar të bankës (TAC).

► Kufizime domethënëse tatimore dhe ligjore ose rregullatore duke përfshirë grupet e vogla të interesit, limitime në rrjedhjen e kapitalit për mbulim humbjesh ndërmjet anëtarëve të grupit (Calvo 1998)⁶⁷.

► Shlyerje dividendësh apo riblerje aksionesh të cilat parandalojnë mbajtjen e kapitalit të fortë.

2. Sjellja e një aksionari financiar agresiv duke rritur pronësinë e tij dhe ushtron presion ndaj normuesve për të mbajtur kapital të dobët në të ardhmen.

► Qeveria ka kontribuar në kapitalin gjithsej të korigjuar të bankës (TAC) por pagesat priten kur të jetë e mundur.

► Përmasa absolute e kapitalit është më e vogël se 100 million USD duke ekspozuar bankën në pamundësi të përballimit të goditjeve nga tregu, ndërkohë që bankat e tjera e kanë këtë mundësi.

► Shoqëria bankë-mbajtëse ka nivel të lartë mbi dyfish të burimeve të huajtura.

3. Të ardhurat mbështeten në zëra që tregtohen një herë dhe jo më p.sh. fitime kapitale nga tituj dhe aktive themelore, që prodhojnë nivel më të ulët fitimesh bazë të korigjuara në rrezik ose që krijojnë luhatshmëri në mbarëvajtjen e fitimshmërisë së bankës.

⁶⁷ Calvo, Guillermo A -Capital Flows and Capital Market Crises: The Simple Economics of Sudden Stops. *Journal of Applied Economics* 1998/1(1)

► Mëse 75% e të ardhurave vijnë nga një linjë e vetme ose e ngushtë biznesi ku pesha e të ardhurave neto nga interesat dhe komisionet janë nën 60% të të ardhurave gjithsej të bankës.

► Ka mungesë/pamjaftueshmëri në rezervat provizionuese të kredive.

► Ka nivel nën limi të kapitalit të filialeve jo të konsoliduara.

► Ka humbje faktike por që akoma nuk janë pasqyruar dhe raportuar në pasqyrat financiare.

4. Kur raportet financiare të fitimit janë më të dobët se të bankave konkurruese apo të ngjashme, atëherë cilësia e fitimeve konsiderohet e ulët. Treguesit kryesorë që përdoren përfshijnë:

-Raporti Të ardhura neto nga Interesa ndaj të ardhurave gjithsej ($NII/\Sigma \text{Revenue}$).

-Raporti Të ardhura neto nga Komisione ndaj të ardhurave gjithsej ($NIComms/\Sigma \text{Revenue}$).

-Raporti fitime bazë ndaj aktiveve (R_{coreOA}).

-Raporti fitime bazë ndaj aktiveve të peshuara në rrezik ($R_{coreWAs}$). Ku aktivet e peshuara në rrezik llogariten nga S&P.

-Raporti Të ardhura operuese përpara provizionimit për humbje nga kreditë ndaj aktiveve ($NOI_{before LLP}/\Sigma \text{ass.}$).

(d) Kapacitetin për të realizuar fitim.

Kriteri i vlerësimit të kapacitetit fitues lidhet me faktin se fitimet janë vija e parë e mbulimit të humbjeve normale përgjatë një cikli kredije. Rezerva për fitimet e bankës mund të rezultojë negative (kur fitimet janë < se humbjet normale) ose pozitive (kur fitimet janë > se humbjet normale).

3.2.2.4 Pozicioni i Rrezikut

Pozicioni i rrezikut është faktori i pestë për normimin sipas SACP dhe konsiston në identifikimin e rreziqeve specifike që banka mund të ketë përtej supozimeve standarde. Në thelb bëhet fjalë për pozicionin e rrezikut të një banke më vehte, pra si rrezik specifik. Drejtimit diferencuese të rrezikut të një banke janë pesë dhe renditen si vijon:

1-Si banka amvison rritjen dhe ndryshimet në pozicionin e rrezikut

2-Impakti i përqendrimeve apo diversifikimeve të rrezikut

3-Shkalla e rrezikut shtesë për çdo rritje të kompleksitetit të bankës

4-Nëse rreziqet materiale janë kapur drejt apo jo nga RACF

5-Prova për një pozicion të përshtatshëm, të fortë apo shumë të fortë në rrezik (ku humbjet e kaluara dhe ushtrimore krahasohen me përzierjen e veprimtarive/bizneseve të bankës në rrethana të rënies ekonomike, të krizave dhe të goditjeve nga tregu).

Në vijim jepet një shembull se si kombinohet vlerësimi i pozicionit të rrezikut me vlerësimin e kapitalit dhe të fitimit duke lëvizur nivelin normues të SACP.

Banka A dhe Banka B kanë një rezervë të shëndetëshme fitimi dhe cilësi të përshtatshme kapitali, duke siguruar raporte kapitali mbi nivelin e kërkesave rregullatore. Megjithatë banka A e ka 11% raportin e projektuar RAC ndërsa banka B e ka 6%. Si rrjedhojë Banka A quhet e fortë dhe banka B e moderuar.

Duke u bazuar në analizën themelore të rreziku, shpaloset qartë se përvoja në humbje e bankës A është më e luhatshme se sa bankat e tjera të marra për krahasim. Banka A duket

me nivel të mirë të drejtimit të rrezikut, por shumë produkte i ka komplekse (derivativa, portofol me rrezik të lartë me kapital privat, fokus të ngushtë për shërbime-këshillime). Prandaj thuhet se A ka një pozicion rreziku 'të moderuar'.

Nga ana tjetër, Banka B ka një franshizë tregtare në të gjitha njësitë e biznesit. Produktet janë më të thjeshtë, ka nivel të ulët të veprimtarisë jashtë bilancit, ka luhatshmëri më të ulët, humbjet janë brenda trendit (nën nivelin mesatar). Për këtë arsye, pozicioni i rrezikut të bankës B konsiderohet shumë i fortë.

Tabela 3.7 Ndikimi në SACP i kombinimit të përbashkët të kapitalit dhe fitimeve dhe pozicioni i rrezikut

	Banka A		Banka B		në
	Vlerësimi	Ndikimi në SACP	Vlerësimi	Ndikimi SACP	
Kapitali dhe fitimet	I fortë	+1 dallues	Mjaftueshëm	-1 dallues	
Pozicioni i rrezikut	Mjaftueshëm	-1 dallues	Shumë i fortë	+2 dallues	
Efekti nga Kombinimi	Asnjë ndikim		+1 dallues		

Në ciklet kur përjetohet ekspansion i shpejtë, bankat priren të jenë më rrezik-marrëse duke mos bërë fjalë vetëm për huadhënie të veçanta por krejt si politikë krediti prirja për rrezik kërkon monitorimin e portofolit të rreziqeve dhe të spektrit të rreziqeve që ka ndërmarrë dhe po ekspozohet banka. Një ndryshim në rreziqet e bankës d.t.th., se ekspertiza tradicionale mund të mos jetë e fuqishme për të ndihmuar bankën në stade të tilla. Roli i drejtimit të bankës për të amvisuar rreziqet e shoqëruara me rritje dhe ndryshime në ekspozim ndaj rrezikut të bankës, shihet i lidhur se çfarë pozicioni të ri në rrezik po merr banka. Kjo analizohet me prirjet për rritje të bankës me ritëm si të mëparshëm apo të rënë dhe rritja e ulët vjen nga fakti se po shmangen rreziqe apo sepse ka më pak oportunitete apo kombinime të të dyjave.

Konkurrenca mund të nxisë normuesit për rrezik shtesë, ndërsa ka banka që e pakësojnë ekspozimin në rrezik duke hequr zërat me rrezik të portofolit, duke shtrënguar kufizimet në kredite dhe duke u fokusuar më shumë në bazën e klientëve dhe në strukturën pararendëse të portofolit.

Përqendrimet e rrezikut përkthehen në rënie të diversitetit të portofolit duke krijuar argumentin parësor kërcënues për falimentim të bankave. *Metodologjia e S&P* e përfshin përqendrimin e rrezikut si element më vete sepse kjo nuk pasqyrohet në analizën e kapitalit dhe të fitimeve. Konsiderohet përfitim nga diversifikimi i rrezikut kur një bankë ka këto karakteristika:

- Korigjimi RACF për koncentrim/diversifikim të rrezikut tregon rënie të aktiveve të peshuara në rrezik që vlerësohen sipas S&P (RWAs).
- Diversifikimi gjeografik rritet nga ekspozimet e lidhura me një klient për zgjerim veprimtarie apo ushtrim të një franshize dhe jo për oportunitete në taksa, diferenca ligjore, arbitrazh valutor dhe të ngjashme.

- (c) Banka diversifikon portofolin duke futur zëra investimi, kreditimi, etj., që janë me më pak rrezik se zërat ekzistues të portofolit të saj.

Në çdo rast kur për të njëjtin mjedis operues ekonomik dhe të industrisë, banka vlerësohet se ka përqendrim rreziku më të lartë se grupi krahasues i bankave, normimi i bankës duhet të rritet për ekspozimin në rrezik që d.t.th., se duhet të bjerë për normimin e sigurisë së bankës.

Kompleksiteti i rritur i produkteve (derivativat, detyrimet e kolateralizuara të borxhit, etj.) ul forcën normuese ndaj rrezikut nga ana e stafit të dedikuar për rrezikun. Kompleksiteti krijon hazard moral për transparencë më të ulët për pozicionin e rrezikut, për burimin e fitimeve dhe kontributin e linjave të bizneseve dhe llojet e produkteve në fitim dhe kapital të bankës, etj. Kjo rrit ekspozimin në rrezik të bankës, rrit varësinë ndaj modeleve matematikore, supozimeve komplekse dhe gjykim të kufizuar për rrezikun. Nga ana tjetër me rritjen e kompleksitetit rritet madhësia e bankës dhe mund të gjykohet si më imune nga të tjerat.

Rreziqet që nuk merren në konsideratë nga metodologjia e S&P për kornizën RACF, janë të gjitha rreziqet sistemike e ku më kryesorët janë rreziku i normave të interesit, rreziku valutor dhe luhatjet në financimin e pensioneve. Këto rreziqe pavarësisht se janë sistemike, nga banka të ndryshme përjetohen dhe kanë impakt të ndryshëm. Për këtë arsye këto shihen në ndikimin për një bankë specifike dhe jo për grupin krahasimor të bankave (Geithner 2008)⁶⁸.

Për shembull rreziku i normave të interesit përfshin edhe rrezikun strukturor të normave të interesit që buron nga struktura e linjave të biznesit që ka në specifikën e saj banka; ndërkohë që rreziku strategjik i normave të interesit lidhet me funksionin e amvisimit të zotërimeve dhe detyrimeve.

Si tregues specifik të **rrezikut të normës së interesit** të cilët merren në konsideratë në metodologjinë e S&P janë:

- (a) Ndjeshmëria që zërat e veçantë të portofolit të bankës për rrjedhojë edhe fitimet e bankës kanë ndaj ndryshimeve të normave të interesit (forma e lakores së rendimentit që rezulton nga stres-testi i bankës).
- (b) Monitorimi dhe korigjimi në vendosjen e normave të interesit nga ana e normuesve të bankës.
- (c) Shkalla e honit të maturimit të riçmuarjes së aktiveve dhe detyrimeve.
- (d) Përshtatshmëria e amvisimit të rrezikut të bankës me kërkesat dhe analizat e stres-testit, të testit të dëmtimit të aktiveve, karakteristikave të zërave të veçantë aktiveve dhe të pasiveve në lidhje me opsionet dhe klauzolat për parapagesë, shpejtim shlyerje, etj. (Sorge, Virolainen 2006)⁶⁹.

Evidenca e një pozite më të fortë të rrezikut pasqyrohet në humbje më të ulta, në provizionime më të larta në kompleksitet më të ulët të produkteve të bankës dhe diversifikim më të lartë të portofolit, që banka në fjalë duhet të ketë në krahasim me grupin e bankave krahasimore. Në të kundërtën kemi të bëjmë me një pozitë të dobët të rrezikut për bankën.

Devijimet nga ecuria mesatare e grupit krahasimor të bankave shpjegohen duke u thelluar në shkaqet rrënjësore të këtyre shmangieve nëse kanë të bëjnë me ritmin e rritjes, me shkallën e përqendrimit, të kompleksitetit, ose edhe sepse ka rrezik specifik materialisht të ndryshëm nga supozimet standarde të rrezikut në RACF të S&P.

⁶⁸ Geithner, T, "Speech Reducing Systemic Risk in a Dynamic Financial System". Newyorkfed.org. June 2008

⁶⁹ Sorge, M, Virolainen, K, "A comparative analysis of macro stress-testing methodologies with application to Finland" Journal of Financial Stability 2006, Vol 2.

3.2.2.5–Financimi dhe Likuiditeti

Financimi dhe likuiditeti, në metodologjinë e S&P shihen të kombinuar dhe së bashku formojnë faktorin e gjashtë dhe të fundit të normimit me SACP. Financimet janë burimet e realizimit të likuiditetit p.sh. financime nga depozita, financime nga tregu ndërbankar, nga Banka Qendrore, nga Qeveria, etj., ndërkohë që financimet shndërrohen në likuiditet, ky analizohet edhe nga arkëtim i kredive. Likuiditeti ka të bëjë me gjendjen e mjaftueshme që banka duhet të ketë për shlyerje të detyrimeve të çdokohëshme. Ky kombinim përfaqëson një komponent të rëndësishëm të rrezikut financiar. Analiza e financimit dhe e likuiditetit identifikon përzierjen e fondeve financuese dhe të detyrimeve paguese, lidhjen e financimit me vëllimin e biznesit dhe, të gjithë këto krahasohen me nivelet e bankave analoge që përbëjnë grupin krahasimor. Kriteret që përdoren konsistojnë në detyrimin që niveli mesatar i financimeve dhe likuiditetit të jetë brenda niveleve që përcaktohen me vlerësimin BICRA të financimit. Kushtet/klima e përkundërt e tregut në çënimin e likuiditetit është pikëpamja e praktikës së likuiditetit. Sa më shumë varësi dhe transaksione të përsëritura për financim nga Banka Qendrore aq më me rrezik konsiderohet banka dhe e kundërta.

Metodologjia fokusohet për të gjitha bankat në dy raporte të likuiditetit:

- (a) Aktive ose zotërimi likuide ndaj financimit me shumicë, dhe
- (b) Aktive likuide ndaj depozitave bazë.

Kur të dhënat në dispozicion janë më të detajuara, analiza merr parasysh edhe raportet e mëposhtme:

- (c) Raporti i aktiveve likuide ndaj financimit me shumicë afatshkurtër, dhe
- (d) Raporti i financimit afat-shkurtër me shumicë ndaj financimit total me shumicë

Vlerësimet e financimit dhe të likuiditetit dhe kombinimi i tyre në normimin e bankës duhen parë të lidhur p.sh. banka mund të ketë burim financimi mbi mesataren por ka profil likuiditeti të moderuar apo të dobët gjë që ul nivelin e sigurisë në normimin vlerësues sipas SACP. Një matricë e kombinuar jepet për konkretizim në tabelën 3.8:

Tabela 3.8 Impakti në SACP i kombinimit të likuiditetit dhe financimit

Impakti në SACP I Kombinimit të likuiditetit dhe financimit						
Nivelet		LIKUIDITET				
		I fortë	I përshtatshëm	I mjaftueshëm	I dobët	Shumë i dobët
FINANCI	Mbi mesatare	+1	0	-1 pozicionuar `bbb`	-2 pozicionuar `bb`	-5 pozicionuar `ccc`
	Mesatare	0	0	-1 pozicionuar `bbb`	-2 pozicionuar `bb`	-5 pozicionuar `ccc`
	Nën mesatare	-1	-1	-1 pozicionuar `bb`	-2 pozicionuar `b`	-5 pozicionuar `cc`

Metodologjia e S&P, normimin kundrejt financimit dhe likuiditetit e analizon duke peshuar shumë burimet dhe përdorimet e likuiditetit. Banka duhet të vemendësohet në përmasimin e përdorimit të likuiditetit sidomos kur banka mund të përballë me tërheqje të depozitave pa afat nga individë dhe biznese, disbursim kredish të kontraktuar, etj.

Nëse burimet e likuiditetit janë të besueshme, atëherë bëhet e mundur për të përcaktuar se sa i pakufizuar është likuiditeti i zotërimeve/aktiveve në bilancin e bankës; si dhe për të vlerësuar fuqinë e angazhimeve për likuiditet me palët e tjera, madje edhe gjatë kushteve apo rrethanave të pafavorshme për bankën. Një pjesë e nënkuptuar e këtij vlerësimi

është forca e kornizës së administrimit të rrezikut të një banke të likuiditetit dhe e kontrolleve përkatëse, duke marrë parasysh si llojin e biznesit që ndërmerr po ashtu edhe tregjet ku operon.

3.2.3 Metodologjia e Fitch në Normimin e Bankave

Metodologjia Fitch ofron normim vlerësues specifik apo vetëm për një bankë, të cilat agjensia Fitch quan "normim individual". Për lehtësi krahasimi, ofrohet një hartë e cila shërben për të përkthyer nivelin e normimit në nivel të shkallëzuar të detajuar me njësi të imta prej 5 pikësh duke përfshirë normim tërësor që njihet si "normim i dështimit të emetuesit". Për të rritur transparencën e normimit tërësor (*all-in ratings*), Fitch publikon normimet vlerësuese të veçanta në një shkallë prej pesë pikash e projektuar me synimin për të identifikuar mundësinë dhe shkallën e mbështetjes së jashtme të bankës ose nga shteti, nga qeveria ose nga një pronar institucional. Kjo njihet si "normim për mbështetje" ("support ratings").

Në rastet kur këto normime vlerësuese për mbështetjen reflektojnë ndihmën e mundëshme nga shteti/qeveria, Fitch lajmëron për një nivel bazë normimi për hir të mbështetjes duke shfrytëzuar të njëjtën shkallë normuese sikurse e përdor kur bën normimin gjithëpërfshirës apo tërësor (*all-in ratings*). Normimi gjithëpërfshirës apo tërësor është më i lartë se normimi për nivelin bazë të mbështetjes dhe nivelin e dyshemesë së normimit mbështetës.

Megjithëse Fitch synon të lidhë 'normimin gjithëpërfshirës apo tërësor' që bën, me normimet e bankave më vehte që janë bërë në të kaluarën. Në mes të vitit 2011, Fitch konvertoi nivelin shkallar 9 pikësh në nivel shkallar 19 pikësh duke ju përgjigjur saktësisht nivelit normues sipas 'normimit gjithëpërfshirës apo tërësor'.

Edhe pse Fitch ishte agjensia e parë më e madhe e angazhuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të hapur në rrezikun sistematik dhe që ka ofruar normime vlerësuese për sistemet bankare të vendeve të ndryshme, përsëri këto rezultate janë përfshirë si futje më shumë për tu përpunuar në normimet vlerësuese sovraane dhe jo për normimet e veçanta të bankave. Në vitin 2005, Fitch paraqiti dy matës të rrezikut sistematik, ku njëra karakterizon stabilitetin ekonomik dhe tjetra stabilitetin financiar të një vendi.

Në metodologjinë e Fitch, grupi parë i indikatorëve mishëron një përjasje normimi sipas vlerësimit nga poshtë lartë duke nisur nga normimi i bankave të veçanta dhe mbi këtë bazë arrihet normimi i krejt sistemit. Grupi i dytë i indikatorëve bazohet në indikatorët e maturisë makro (*macroprudential indicators*) me të cilët ravijëzohet rritja ekonomike anormale e kredisë bankare ndaj sektorit privat, si dhe për rrethanat kur vërehet rritje e pazakonshme e çmimeve. Gjithsesi, si më shqetësuese shihet kombinimi i rezultateve të dobëta të të dy treguesve.

Procesi normues" i datës 2 dhjetor 2011, dhe "Të kuptuarit e Procesit të Normimit sipas Financave të Strukturuara", i datës 4 tetor 2011 janë dy materiale më spikatëse që i adresohen metodës së përgjithshme të Fitch në nisjen dhe monitorimin e normimit vlerësues duke përfshirë ndërveprimet me drejtimin e palëve me detyrim të normuara por që vazhdimisht kanë qenë nën kujdesin ripërtëritës dhe korrigjues.

3.2.3.1-Struktura e Metodologjisë së Fitch

Fitch bazohet përgjithësisht në normimin e frytshmërisë (*viability rating*) në krahasim me normimin e veçantë të besueshmërisë së një banke. Ndërkohë që mbështetja financiare

nga qeveria që një bankë ka më shumë gjasa për ta pasur në krahasim me të tjerat përfshihet në atë që quhet normim i mbështetjes (*support ratings*) dhe normim sipas nivelit dysheme të mbështetjes (*support ratings floor*), ndërkohë që niveli më i lartë i vlerësimit të sigurisë së një banke është normimi i dështimit të emetuesit (*issuer default rating -IDR*).

Normimi i dështimit të emetuesit përmbledh edhe normimin e emetimit të borxhit që pritet të ketë mbështetje qeveritare. IDR ka një shkallë me AAA kur edhe normimi për mbështetje nga qeveria arrin nivelin AAA i cili përcaktohet brenda një shkalle 1-5. Nga ana tjetër ‘mbështetja e qeverisë’ vlerësohet si e nivelit AAA kur vetë qeveria normohet si e tillë.

Më pas Fitch ka përmirësuar metodologjinë e normimit vlerësues duke paraqitur normimin sipas Frytshmërisë (*viability rating*) dhe nga Fitch asnjë bankë nuk e ka përmbushur nivelin AAA të frytshmërisë së bankës, gjë që pasqyron rreziqet e brendshme që shoqërojnë modelin e normimit vlerësues të biznesit bankar. Këto rreziqe përfshijnë këto faktorë me peshë ndikimi më të lartë:

- (a) Nivelet e pranisë së burimeve të huajtura në bankë (*leverage*)
- (b) Korrelacionet domethënëse ndërmjet rrezikut të kredisë dhe kredive të maturuara si jo standarde p.sh. si të dyshimta apo me probleme të cilat ndryshojnë nivelin e maturimit të këtyre kredive duke dhënë impakt në lidhje të drejtë për krejt portofolin.
- (c) Pritshmëria që banka të normohet në nivelin ‘aaa’ duke qenë e lidhur me dy grup-faktorësh të mëparshëm konsiderohet shumë e vështirë për tu arritur nga ndonjë bankë.

Niveli më i lartë që Fitch ofron për bankat e vlerësuara është kategoria ‘aa’ e cila i përket bankave me karakteristikat e mëposhtme:

- (a) Kanë standarde të shtrënguara kreditimi,
- (b) Kanë nivel të lartë cilësor të zotërimeve të bankës përgjatë të gjitha fazave luhatëse të cikleve ekonomike që përjeton banka brenda mjedisit operues të saj në një vend.
- (c) Ka një emër apo vlerë franshize prirëse në treg.
- (d) Ka nivel të lartë diversifikimi dhe të ulët përqendrimi duke e shoqëruar edhe me peshë të ulët ndaj portofolit të produkteve komplekse.
- (e) Ka nivele të larta të rezervave kapitale ndaj çdo skenari të mundshëm të disfavorshëm të rrezikut.
- (f) Ka cilësi të lartë në amvisimin e rrezikut dhe në qeverisjen e korporatës.

Në periudhën gjatë krizës metodologjia e Fitch i ka dhënë peshë të lartë mundësisë së mbështetjes financiare që një bankë mund të ketë nga qeveria, por kur vetë qeveria e vendit është normuar në nivele të ulta, paralel me këtë Fitch ka ulur edhe nivelin e sigurisë së bankës. Një gjë e tillë është aplikuar për të gjitha bankat e vendeve të qeverive të normuara me probleme p.sh. me Greqinë, Spanjën, Portugalinë, Irlandën, etj.

Në treguesit makroekonomikë, Fitch bazohet në ecurinë e ekonomive më të përparuara (*most advanced economies -MAE*) dhe mbi këtë bazë ofron një pamje ekonomike globale (*global economic outlook -GEO*). Sipas metodologjisë nëse përcaktohet prania e luhatshmërisë së tregjeve financiare dhe pasiguri në politikat fiskale, atëherë niveli i konfidencës së sistemit apo mjedisit operues të bankave bie. Fitch e peshon uljen e shkallës normuese duke u bazuar në nivelin e qendrueshmërisë së rënies ekonomike për të paktën 2 tremujorë radhazi.

Drejtimi tjetër makro është lidhja me treguesit e borxhit sovran dhe të krizës që e shoqëroi këtë përgjatë 2007-08 deri më sot. Masat e programeve dhe politikave financiare dhe ekonomike të ashpra (*austerity*) kanë sjellë ulje të ashpërsisë së krizës së borxheve sovranë dhe njëkohësisht rënie të çmimeve të naftës. Në këtë rast këto merren si faktorë pozitiv që japin impakt për ripërtëritje të fortë. Ndërkohë që faktorë me ndikim të përkundërt janë ulja e qasjes në burime të huajtura për sektorin financiar dhe familjarët duke krijuar një peisazh financiar të thyeshëm. Të gjithë sëbashku rrisin presionin ndaj financimit të bankave, bankat ndjejnë mungesë likuiditetesh dhe kjo ndikon në sjelljen kundërshtuese ndaj rrezikut të bankave duke çuar në ngurtësim të kreditimit.

Metodologjia e Fitch e ka më të lartë se metodologjitë e tjera shkallën e dyshimit dhe skepticizmit për rritje të ekonomive në zhvillim kur ndërkohë ka rënie ose rritje shumë të ulët të ekonomive të vendeve më të zhvilluara p.sh. të BE. Në eurozono sjellja e Bankës Qendrore Europiane përcaktohet si sjellja e institucionit me fuqinë e vetme për fleksibilitet operacional dhe kapacitet financiar për të parandaluar falimentimet bankare të zonës deri edhe dështime të qeverive të euro-vendeve, prandaj sjellja mbështetëse apo refuzuese e BQE për financimin ose jo të një banke apo qeverie përcakton shumë nivelin e normimit vlerësues që metodologjia Fitch ofron për një Bankë në kuadrin e përcaktorëve të mbështetjes financiare nga jashtë. Dështimi për rimëkëmbjen e Greqisë nga ana e institucioneve të BE (duke përfshirë edhe BQE) bënë që sipas metodologjisë së Fitch Greqia është vend me pritshmëri të lartë dështimi por me probabilitet të ulët për të lëshuar eurozonën.

Duke parë impaktin ndaj bankave që operojnë në vendet në zhvillim apo në tregjet emergjente, metodologjia e Fitch i vlerëson si më pak të ekspozuara nga faktorët e mësipërm duke përcaktuar një normim prioritar ndaj përcaktorëve të pritshëm të rritjes ekonomike më të shëndetshme se sa të bankave të vendeve të zhvilluara, pavarësisht se ekonomitë e vendeve ku ato operojnë nuk janë tërësisht të plota në përmbajtjen e karakteristikave të rritjes.

3.2.3.2-Algorithmi i Metodologjisë së Fitch

Në metodologjinë e Fitch algoritmi apo procesi i normimit vlerësues të bankës ndahet në nivel të përgjithshëm dhe si proces në nivel analitik.

Për ***nivelin e përgjithshëm*** algoritmi përshkruan këto hapa të rëndësishme:

- (a) Analizohen linjat e biznesit, produktet deri në nivel portofoli tërësor si dhe rreziku përkatësues në secilën linjë produkti deri edhe në nivel portofoli.
- (b) Rezultatet e analizës së mësipërme përballen me objektivat e normuesve të pohuara në raportet apo studimet për strategjinë e bankës.
- (c) Shqyrtohet mjedisi ku operojnë bankat që janë në proces normimi vlerësues dhe e ardhmja e biznesit bankar brenda mjedisit dhe elementëve të tij të identifikuar dhe të përcaktuar sipas pikave pararendëse.
- (d) Rrethanat specifike të bankës ekzaminohen brenda gjykimit normues ndërkombëtar për grup vendet ku përfshihet vendi ku operon banka duke konsideruar edhe karakteristikat vlerësuese të industrisë bankare në kriterin për analogji me të ngjashmet në shkallë globale.
- (e) Modeli, rezultatet dhe gjetjet i shpalosen bankës dhe nis faza e bashkëpunimit me bankat duke respektuar parimin për një vlerësim sa më objektiv dhe të pavarur. Normimi vlerësues është rezultat në nivel individual me përvojë mbi 10 vjet (analisti, eksperti) dhe si proces kolegjal (p.sh., komitet, këshill krediti).

- (f) Rindjekja e hapave të mësipërm në shkallë të ngjeshur periodiciteti p.sh. çdo 3 muaj duke mbikëqyrur raportet financiare tremujore, mbulimin nga media dhe ecuria e imazhit në publik (duke përfshirë edhe faqe web të bankës), pjesëmarrja në veprimtari shoqërore dhe karakteristikat e përgjegjësisë sociale që rrezaton banka, ecuria në treg e titujve të bankës dhe vlera e franshizës së saj.
- (g) Rivlersimi normues i bankës duke marrë në konsideratë ndodhjen e ngjarjeve të veçanta por me impakt financiar p.sh. shitja-blerja e paketës kontrolluese, transaksione bashkëshkrirjesh me banka apo institucione të tjera, shpalosjet dhe lajmërimet për riblerje aksionesh etj.
- (h) E drejta e apelimt të vlerësimit të Fitch është brenda 48 orësh, por Fitch kur e sheh të arsyeshme e ruan privilegjin të mos ndikohet nga ky apelim.
- (i) Shpalosja e normimit të bankës bëhet duke ruajtur konfidencialitetin dhe duke shmangur informacionin që konsiderohet i rezervuar për publikim.
- (j) Përgatitja e raportit paraprak dhe paraqitja tek komiteti i normimit.
- (k) Botimi, shpallja publike e normimit të bankës.

Algoritmi si proces analitik përfshin analizën e këtyre komponentëve:

1-Mjedisi i Tregut

Procesi analizues i mjedisit të tregut bazohet në bazën e të dhënave për përmasën dhe shëndetin e bankës brenda suazave të ekonomisë vendore ku ushtron veprimtarinë, duke krijuar një relacion me perspektivën ekonomike, me situatën politike, me strukturën e sektorit bankar (numri i bankave, masa e depozitave/kredive sipas shtrirje territoriale dhe në industritë e bizneset ku kreditojnë, shkalla e koncentrimit), me pozicionin konkurrues të bankës (në krahun e depozitave dhe të kredive).

Përcaktor tjetër me peshë është prania dhe sjellja e insitucioneve mbikëqyrëse dhe rregullatore (roli dhe cilësia e mbikëqyrjes, shkalla e pavarësisë dhe e cilësisë profesionale të insitucioneve dhe burimeve njerëzore mbikëqyrëse). Këto formojnë mjedisin mbikëqyrës/rregullator. Brenda këtij kuadri shihet historiku i dështimeve bankare dhe qendrimi i insitucioneve mbikëqyrëse dhe rregullatore, sjellja e insitucioneve të sigurimit të depozitave.

2-Amvisimi i Rrezikut

Metodologjia e Fitch fokusohet në sistemet, politikat dhe efijencën e amvisimit të rrezikut në bankë duke u vëmendësuar në oreksin për rrezik, vlerësimin e rrezikut dhe shkalla e përmbajtjes së tij në miratimet e kredive (në politikën e limiteve të kreditimit dhe të kriterit e subjektit që vendos këto limite).

Këto kanë të bëjnë me kulturën e amvisimit të rrezikut të bankës e cila ekzaminohet nëse është e mirëshpërndarë për të gjitha departamentet, nivelet miratuese të kredisë, për linja të ndryshme kreditimi deri tek procesi operacional i raportimit të rrezikut dhe i vendimmarrjes korigjuese.

3-Rreziku i Kredisë

Rreziku i kredisë është komponenti i tretë në algoritmin analitik të normimit vlerësues të bankës dhe depistohet si për zërat brenda bilancit (p.sh., kreditë sipas përmasës, tipit, njësisë monetare, sektorit ekonomik, shpërndarje gjeoekonomike) dhe zërat jashtë bilancit ku

peshën kryesore e kanë detyrimet kontingjente (*contingent liabilities*) -p.sh., garancitë, letër kreditë, etj., duke analizuar rrezikun potencial të implikimit të bankës në humbje apo detyrime.

Këndëvshtrimi si rrezik specifik për bankën i rrezikut të kredisë së saj ka të bëjë me identifikimin e shkallës së koncentrimit apo të diversifikimit dhe i cilësisë së kredive. Treguesit më me peshë që metodologjia e Fitch merr për cilësinë e kredive përfshijnë:

- (a) Normën e kredive jo të mbara (*NPL*)
- (b) Normën e Provizioneve për Humbje nga Kreditë (*LLP*)
- (c) Shkallën e garancisë për çdo kreditim (cilësia e kolateralit, raporti kolateral me vlerën e mbetur të kredisë si themelor plus interesa, testi i dëmtimit të kredisë).
- (d) Niveli i migrimit për në humbje të kredive duke përfshirë kreditë që duhen korigjuar për nën vlerën kontabël (*write down*), kredi që duhen hequr si aktiv për faktin se janë humbje (*write off*) dhe kreditë për ristrukturim që njihen si kriteret e ripërtëritjes (*recovery criteria*).
- (e) Cilësia e kredive për palë jo klient (p.sh., kreditë ndërbankare, kreditë për tituj me normë fikse interesi).
- (f) Angazhimet në transaksione për zëra jashtë bilanci (garanci, dorëzani).

4-Rreziku i Tregut

Në procesin analitik të normimit vlerësues të bankës rreziku i tregut përfshin rrezikun strukturor dhe tregues të bankës për të gjithë produktet e saj (brenda dhe jashtë bilanci). Rreziku strukturor përfshin rrezikun që përballet dhe duhet të kontrollojë banka gjatë procesit të amvisimit të zotërimeve dhe detyrimeve (*assets-liabilities management -ALM*) si dhe për rrezikun e marrjes së pozicionit në treg.

Rreziku i tregut ka të bëjë me rrezikun e instrumentave që tregtohen si dhe me teknikën matëse të këtij rreziku nëpërmjet metodës së 'Vlerës në Rrezik' (VAR). Nga ana tjetër përcaktohen treguesit e rrezikut (σ dhe CV) për luhatshmërinë e të ardhurave të bankës (nga interesat dhe jo nga interesat).

Në rrezikun e tregut banka ekspozohet edhe nga investimet që bën në tituj kapital (aksione të zakonshme) duke pjesëmarrë apo blerë banka të tjera, shoqëri financiare, etj.

5-Rreziku Operacional

Rreziku operacional përfshin rrezikun e pësimit të humbjeve që një bankë mund të ketë nga sistemet, njerëzit dhe proceset e papërshtatëshme apo të dështuara, si dhe/ose nga ngjarje të jashtme. Metodologjia e normimit bazohet në metodologjinë e identifikimit dhe të vlerësimit të rrezikut operacional si dhe në ekzaminimin e strukturës dhe të kulturës organizative në nivel bordi dhe departamentesh, duke u thelluar sipas linjave të biznesit të bankës, në kulturën e korporatës si dhe në procesin e raportimit dhe të kontrollit të këtyre humbjeve.

Faktorë me peshë janë hartat e rrezikut, grumbullimi i të dhënave dhe përfaqësia tërësore për matjen sasiore të rrezikut dhe të efikasitë normuese.

6-Rreziku i Financimit dhe i Likuiditetit

Struktura e financimit të bankës nga depozita me pakicë (*retail*) dhe me shumicë (*wholesale*) duke krijuar një bazë financuese që metodologjia e Fitch e analizon për shkallën e koncentrimin të depozitave, të maturimit, burimit gjeografik dhe njësisë valutore.

Likuiditeti shihet në varësinë brenda bankës p.sh. cilësia e instrumentave financiarë, afati i maturimit të huarave, likuiditeti nga burime jashtë bankës nëpërmjet aksesit që ka banka në tregjet financiare, në linjat e angazhuara financuese si dhe nga huamarrjet me skonto nga Banka Qendrore.

Aspekte plotësuese janë instrumentalizimi në instrumenta financiarë të kontratave financiare të veçanta dhe përpilimi i planeve të likuiditetit mbështetës apo potencial.

7-Rreziku i Kapitalizimit

Fitch ka përfshirë në procesin analitik edhe nivelin e kapitalizimit duke e ekzaminuar si përmasë e kapitalit, si cilësi kapitali dhe si strategji të amvisimit të kapitalit (politika e dividendëve, riblerja e aksioneve, etj.). Metodologjia ndalet edhe tek koncepti i kapitalit të lirë apo pa rrezik, në trendin e raporteve të kapitalit dhe në faktin se sa është i merituar impakti i Basel II.

8-Rreziku i Fitimshmërisë dhe Mbarëvajtjes

Trendi historik i fitimshmërisë, qendrueshmëria dhe cilësia e fitimeve analizohen brenda kuadrit të kapacitetit për të gjeneruar fitimi sipas linjave të biznesit dhe produkteve. Nga ana tjetër metodologjia e Fitch sheh pasqyrimin në pasqyrat dhe planet financiare të të ardhurave operuese, të kostove, të fitimit, të humbjeve dhe të niveleve provizionuese.

Angazhimi i drejtimit në parashikim dhe reagimi me metoda dhe teknika normuese që rrisin fitimshmërinë dhe/ose ulin humbjet janë elementë normimi që veçon një bankë nga një tjetër.

9-Diversifikimi dhe Franshiza

Niveli i diversifikimit është faktor përbërës në metodologjinë e Fitch. Përzgjedhja nga ana e bankës e një bashkësie zotërimesh me një rrezik më të ulët ndaj të njëjtit nivel shlyerje si grup [portofol], konsiston në normimin për siguri të lartë dhe rrezik të ulët. Në të kundërtën, niveli i ulët i larmisë së portofolit tregon se ka nivel të lartë të koncentrimin. Matematikisht vlerësohet sa më i lartë larmimi i portofolit, aq më i vogël është rreziku i portofolit. Këtu mbahet parasysh teoria e portofolit ku ekzaminohet korrelacioni.

Konkretisht sa herë që korrelacioni në mes të zotërimeve është më i vogël se 1, po aq ka hapësirë për të ulur rrezikun përmes kësaj teknike. Në rastin kur korrelacioni është baraz me 1, d.t.th., se rreziku i portofolit është baraz me rrezikun e secilit zotërim që e përbën atë. Parimi kryesor metodik i uljes së rrezikut të një portofoli biznesi, pa cënuar shlyerjet e pritshme të këtij portofoli, konsiston në kombinimin e zotërimeve të llojeve të ndryshme, shlyerjet e të cilave nuk kanë korelacion të lartë me njëra tjetrën. Diversifikimi, koncentrimi dhe amvisimi i portofolit të bankës, nga ana metodologjike, Fitch i sheh të ndërvarura me emrin e mirë të bankës në treg, me lidhjen e qendrueshme me klientelën, pra me franshizën e saj.

Matja e ndikimit në një bankë të treguesit apo të raportit çmime-fitime (P/E) bëhet nga faktori i franshizës. Për shembull, një faktor franshizë me nivel 4 tregon se raporti P/E i një banke do të rritet me 4 njësi për çdo 1 njësi të rritjes së vlerës së portofolit të bankës. Metodologjia e lë të nënkuptuar se faktori i franshizës mund të llogaritet si shumëzim i shlyerjes vjetore të investimeve që tejkalojnë (a) shlyerjet e tregut dhe (b) kohëzgjatjen e

shlyerjeve, më të madhe se kthimit tregut dhe kohëzgjatjen e kthimit. Një bankë me një faktor të lartë franshize ka nivele më të larta të raportit P/E në nivel ekonomik krahasuar me vlerën e tyre kontabël. Kjo vjen nga kapaciteti i bankës për të realizuar vazhdimisht fitimshmëri në pikat e forta bazë.

10-Amvisimi dhe Strategjia

Amvisimi i bankës dhe objektivat strategjike të saj merren në konsideratë kur këto argumentohen dhe provohen si të drejta jo vetëm nga rezultatet por edhe qëndrueshmëria e këtyre rezultateve kur banka përjeton klimën në një cikël rënës biznesi, krize, etj. Në vlerësimin afatshkurtër më peshë kanë metodat cilësore, ndërsa në vlerësimin afatgjatë elementët e drejtimit, amvisimit dhe të strategjisë konkretizohen dhe përfaqësohen nga pasqyrat financiare.

11-Qeverisja e Korporatës, Pronësia dhe Mbështetja

Qeverisja korporative e bankës dhe pronësia e bankës janë faktorët e fundit që merren në përjasjen analitike të metodologjisë së Fitch. Nëse niveli qeverisës i bankës është me një bord të pavarur që arsyeton, vlerëson dhe vendos profesionalisht e larg ndikimit të ndonjë aksionari, d.t.th., se banka ka nivel më të lartë normimi për siguri në krahasim me bankat e tjera që nuk i kanë këto karakteristika.

Nga ana tjetër sipas metodologjisë së Fitch, pronësia e bankës shihet me shkallën e qëndrueshmërisë së strukturës së aksionarëve, sa përgjigjen këto në lidhje me politikat e rrezikut të biznesit dhe të rrezikut financiar. Një bankë ku aksionarët kanë lidhje dhe korrektesë shumë afatgjatë me bankën, atëherë banka vlerësohet me më pak rrezik në krahasim me një bankë tjetër që i mungojnë këto karakteristika.

Në mënyrë kumulative të gjithë faktorët e mësipërm përcaktojnë nga njëra anë se sa është e ‘damarizuar’ banka në publik nëpërmjet pranisë së saj në territor, në bilancet e pasqyrat financiare të subjekteve dhe/ose të firmave huamarrëse, të depozituesve të saj, se sa është baza e klientelës, etj. Këto kanë të bëjnë me faktin se sa kërcënim publik dhe ashpërsi të një krize sistemike do të përbënte dhe kontribuonte falimentimi i bankës e mbi këtë bazë përcaktohet edhe faktori i mbështetjes financiare nga jashtë bankës (kryesisht nga Qeveria).

3.2.4 Krahasimi Divergjues/Konvergjuës i Metodologjive *Moody's*, *S&P*, *Fitch*

Linja e përbashkët konvergjuëse është se të tre agjensitë normuese ndaj metodologjive kanë mbajtur qëndrim rishikues mjaft aktiv që është bazuar në studime dhe kërkime të motivuara nga vetë luhatshmëria e ekonomisë globale e udhëhequr nga problemet e ekonomisë së vëndeve më të zhvilluara.

Konkretisht para vitit 2007 kërkimet e Moody's argumentuan se për nivel të njejtë normimi të korporatave frekuenca e falimentimit të korporatave bankare ka qenë në mënyrë konsistente më e ulët se ajo e falimentimit të korporatave jo bankë. Kjo lidhje korrelative gjeneroi një metodologji të normimit të bankave që njihet si 'Analiza e Dështimeve të Përbashkëta' (*joint default analysis* -JDA) e cila ekzaminoi në mënyrë më sistematike mbështetjen e jashtme disponibël për bankat duke pasur si pikënisje *normimin e forcës financiare të bankës* (*Bank Financial Strength Ratings*) si normim më vehte (*stand-alone ratings*). Për të arritur në normimin gjithëpërfshirës (*all-in ratings*) apo në *normimin e emetuesit* (“*issuer ratings*”) Moody's vlerëson katër tipe mbështetjesh:

- a) Mbështetje nga korporata amë apo korporata e lidhur operuese (*operating parent*)

- b) Mbështetje nga grupi bashkëpunues (*cooperative group*),
- c) Mbështetje nga qeveria rajonale (*regional government*) apo lokale dhe
- d) Mbështetje nga qeveria qendrore apo kombëtare (*national government*)

Të gjithë këto përcaktorë të mbështetjes korrigjonin normimin më vehte të bankave dhe nga ana tjetër pasqyronin vetë normimin vlerësues të palëve mbështetëse. Por sikurse do shohim në vijim, në dallim me S&P dhe Fitch, Moody's nuk boton dhe as shpall ndonjë normim përmbledhës për rrezikun e sistemit bankar (*banking system risk*).

E thënë shkurt, vlerësimi i rolit të një banke në ekspozimin ndaj një rreziku sistemik implikon variabla të pavarur apo shpjegues të matjes së mbështetjes nga autoritetet kombëtare për bankën në fjalë e cila është variabël i varur (funksion). Kjo lidhje përcakton se në rast të krizave apo të një stresi të përgjithshëm financiar, qeveritë do të prirën të mbështesin më pak një bankë që ka ekspozime të njëjta sikurse pjesa tjetër e sistemit bankar. Nga ana tjetër, në rrethana me kushte të njëjta, modeli informon se prirja për mbështetje është më e lartë për bankat, falimentimi potencial i të cilave do të mbart goditje dëmtuese për bankat e tjera.

Me shfaqjen dhe zhvillimin e krizës metodologjia e normimit të Moody's korrigjonte pikërisht probabilitetin e mbështetjes dhe cilësinë e kësaj mbështetjeje, përderisa vetë qeveritë ishin përfshirë në këtë krizë. Kjo krijoi një hon shumë të madh ndaj niveleve normuese të veçanta për secilën bankë dhe për krejt sistemin. Shumë qeveri të vendeve të zhvilluara u normuan për më poshtë, nga AAA në AA.

Në përfundim, Moody's krahas korrigjimit në nivele më të ulta të normimit të sigurisë së bankave, ka njoftuar për përpjekjet e saj që të përfshijë dhe të vlerësojë si faktorin më me peshë raportet kapitale të bankës, të bazuara në humbjet e pritshme për zotërimet me rrezik në kushtet e skenareve stresuese.

Standard & Poor's është agjensia që ka masën më të lartë të ndërhyrjeve rishikuese, sidomos pas vitit 2006. Deri më sot nuk ka akoma një version fundor të metodologjisë dhe modelimit normues. S&P përqendrohet tek transparenca për kriteret, metodën dhe modelin që përdor në normimin vlerësues të bankave dhe boton normimet më vehte të bankave që i quan, profile të besueshmërisë më vehte të bankave' (*"stand-alone credit profiles"*). Kjo bëhet për të qenë sa më e qartë me palët e interesuara që të lexojnë normimin dhe sidomos me investitorët. Për këtë S&P ofron profilet e ankoruara ndaj *Vlerësimeve të Rrezikut të Vendit dhe të Industrisë Bankare (Banking Industry Country Risk Assessments -BICRA)*.

S&P vlerëson së pari rrezikun e vendit dhe rrezikun e industrisë bankare brenda të njëjtit vend ku operon dhe kombinimi i këtyre dy vlerësimeve përcakton nivelin BICRA. Pas kësaj S&P bazohet në normimin më vehte të një banke duke nxjerrë nga BICRA:

- (a) Komponentin e rrezikut të vendit që i përket bankës,
- (b) Komponentin e rrezikut të industrisë që i përket bankës

Të dy komponentët e mësipërm përcaktojnë pozicionin e fiksuar apo të ankoruar të bankës, nga nis futja e të dhënave të ekzaminimit specifik të bankës.

Në normimin specifik të bankës, *Standard & Poor's* fokusohet më shumë në shkallën e pasigurisë për ecurinë e mbarëvajtjes së bankës, duke i dhënë më pak theks përfitimit nga diversifikimi dhe më shumë peshë rreziqeve që lidhen me derivativat jashtë bilancit dhe me instrumentat financiarë të strukturuar (*structured finance instruments*).

Për normimin vlerësues të rrezikut gjithëpërfshirës, S&P përkujdeset për *rrezikun sistemik të bankave* dhe me prirjen e qeverive për të mbështetur një bankë në krahasim me një tjetër.

Fitch është një version i përzier i të dy agjensive të mësipërme, me specifikën se Fitch konsideron si nivelin më të mirë që mund të ketë një bankë atë 'AA' dhe si pikëbazë për

normimin specifik të bankave ka frytshmërinë e tyre. Në *tabelën 3.9* jepen përmbledhtazi diferencat dhe drejtimet spikatëse të një agjensie normimi në krahasim me të tjerat.

Tabela 3.9 Diferencat dhe drejtimet spikatëse të tre agjensive më të mëdha normuese

Metodologjitë për Normimin e Bankave			
Normimet	Fitch	Moody`s	Standard & Poor`s
Normimi më vehte i bankës	Fokusi në të dhënat jashtë bilancit, dhe në riskun e likuiditetit dhe të financimit.	Theksi vihet në parashikimin e vlerësimit të raporteve kapitale duke u bazuar në humbjet e pritura të nënkuptuara(embedded)	Fokusi në performancë e rregulluar me risk dhe aftësinë për të gjeneruar kapital nga fitimet
Normimi gjithëpërfshirës	Normimet dalluese të mbështetjes sovraane.	Të dhëna të bazuara në analizën e dështimit të përbashkët të bankave dhe ofruesit e mbështetjes.	Mbështetja paraprake rritet me rëndësinë sistemike të bankave.
Vlerësim i gjerë i sistemit			
Normimi i vendit	Bazuar në : - faktorët makro - normimin mesatar të bankës	Asnjë	Bazuar në: - faktorët makro - mjedisi rregullativ dhe industria
A ndikon risku sistematik normimin e bankave?	Jo në mënyrë eksplicite; mbështetja e paracaktuar rritet me rëndësinë sistemike të bankës por bie në periudha të çrregullimeve të përgjithësuara.	Jo në mënyrë eksplicite; mbështetja e paracaktuar rritet me rëndësinë sistemike të bankës	Po, ndërmjet: - faktorët makro të vendit në të cilin banka operon -vlerësimi i mjedisit rregullativ dhe industrisë në vendin amë.
Ndryshimet më të mëdha	2005: Analiza e rrezikut sistematik	2007: analiza e dështimit të përbashkët në vlerësimin e mbështetjes	2011: rishikim i metodologjisë së normimit Theksi vihet mbi: - reziqet e sistemit më gjerësisht - lidhja nga fitimet te kapitali

Dallimet në normimin e bankave që hasen ndërmjet agjensive konsistojnë në disa “paradokse” që përmbledhen në faktin se duke marrë bashkësinë e bankave që janë normuar nga të tre agjensitë, vetëm në 8% të numrit të tyre, Moody’s, S&P dhe Fitch përputhen për nivele të njëjta normimi. Brenda së njëjtës kampionaturë rezulton se për 33% të numrit të bankave ka diferenca për 2-3 pikë dalluese në normimin që një agjensi ka dhënë ndryshe nga

tjetra për të njëjtat banka. Këto hone vërehen jo vetëm për banka të veçanta por edhe për periudha dhe normime sistematike që këto kanë bërë në bankat e marra për krahasim.

Për shembull, Moody's ka të paktën dy momente kohore kur ka caktuar nivele më të larta normimi për bankat se sa kanë caktuar S&P dhe Fitch. Në mesin e vitit 2007 Moody's ka normuar afërsisht për 1.5 dallues (*notches*) më lart mesatare se ato të caktuar nga Standard & Poor's dhe Fitch.

Kohët e fundit kjo diferencë ka rënë në mënyrë sistematike duke vijuar deri në prill të vitit 2011 kur, të tre agjensitë nisën të ofronin normime me nivele thuajse të njëjta. Të marra së bashku, këto rezultate sugjerojnë se konvergjenca në *normimet tërësore* është për shkak të vlerësimit në lidhje me mbështetjen e jashtme qeveritare për një bankë.

Duke krahasuar normimet e Moody's, S&P dhe Fitch për periudhat përpara dhe pas Krizës së vitit 2007-8, gjejmë se kriza financiare ka rezultuar në ulje me peshë të nivelit të sigurisë së bankave (apo rritje të ekspozimit në rrezik të tyre) dhe si e tillë nuk konsiderohet ndonjë surprizë (Calvo 2005)⁷⁰.

Gjatë katër viteve të fundit, *normimet gjithëpërfshirëse (all-in ratings)* të përkatësuar për 62 banka nga S&P, kanë rënë mesatarisht me gjashtë të dhjetat e një niveli dallues apo nga një normim vlerësues mesatar A + në nivelin ndërmjet A dhe A +.

Kahu rënës është vërejtur tek të tre agjensitë por intensiteti rënës tek Moody's është dyfish më i lartë se sa tek Fitch dhe S&P. Në normimet që të tre agjensitë kanë bërë për sistemin financiar global ka përsëri disa diferenca spikatëse sidomos kur krahasohen tregje në territore të ndryshme gjeoekonomike.

Konkretisht të tre agjensitë kanë normuar për shumë më poshtë bankat operuese në territoret dhe tregjet financiare në SHBA dhe BE, ndërkohë që normimi i bankave operuese në territoret dhe tregjet financiare në Azi dhe Pacifik ka normim shumë më të lehtë në ulje deri edhe aspak. Ndërsa për gatishmërinë e qeverive për të mbështetur bankat, normimi më i lartë i është dhënë SHBA dhe Mbretërisë së Bashkuar.

Përgjithësisht është pranuar se normimet vlerësuese të bankave janë rezultat i kombinimit të modeleve statistikore objektive me gjykimet subjektive dhe kjo është kuptuar mirë se rastësia diskrete në procesin e normimit ka gjasa që të shkaktojë një hon diferencues ndërmjet tre agjencive të normimit vlerësues.

3.3- MJEDISI MAKROEKONOMIK

Sot të gjitha diagnozat dhe terapitë për dalje nga kriza të sistemeve ekonomike dhe brenda tyre të industrisë financiare po bazohen në varësinë e fortë kërkimore në drejtim të ekzaminimit të cilësisë së informacionit, të përsosjes së teorisë dhe praktikës së sinjalizimit nëpërmjet doktrinë së paralajmërimit të hershëm dhe të uljes maksimale të kostos së rrezikut. Falimentimet sovranë që përfshijnë Greqinë në mesin e viteve 2000-, Argjentinën në fundin e viteve 1980, Indonezinë në fundin e viteve 1990, etj., si dhe falimentimet e korporatave globale si p.sh., Enron, Barings, Lehman, Worldcom, Merrill Lynch etj., kanë si bazë asimetrinë e informacionin dhe hazardin moral që ka krijuar kushte institucionale dhe operacionale për vegjetimin e kësaj asimetrie. Këto falimentime të mëdha kanë përmbysur aksiomën që dikur frymëzonte qetësinë financiare të 'It's too big to fail'. Aktualisht të gjithë argumentat 'post mortum' për 'kiminë' dhe 'fizikën' e gjenerimit dhe të zhvillimit të krizave sistematike me prani globale kanë shpalosur sindromën e institucionalizimit si politikë

⁷⁰Calvo, Guillermo -Crises in Emerging Market Economies: A Global Perspective. NBER Working Paper 11305, Cambridge, Mass, 2005

shtetërore të pabarazisë së informacionit të cilat janë demotivuesit më me impakt ndaj rrjedhjes së kapitalit të huaj (Higgins, Matthew and Thomas Kiltgaard -2004)⁷¹.

Në analizën e mjedisit makro kemi parasysh edhe aspektin e përfitimeve të padrejta që kanë prodhuesit dhe shpërndarësit e informacionit asimotrik, në kurriz të palëve që lidhen me to, duke krijuar kosto të papërballueshme. Financimet që Qeveritë i bëjnë institucioneve që falimentojnë sikurse edhe financimet që BE i ofroi Greqisë dhe nga ana tjetër politika e brendshme e qeverisë së Greqisë në 'rreptësinë financiare (austerity)' kanë disa kosto shtesë për taksëpaguesit por edhe për filozofinë se mund të korruptohesh dhe përsëri do të të mbështesin me burime garantuese për krizat (Goldstein, Morris, Wong -2005)⁷².

Pabarazia e informacionit në pikëvështrimin tonë analizohet së pari ndërmjet sistemeve, ndërmjet vetë institucioneve përfaqësuese të sistemeve dhe shtrihet deri në marrëdhëniet e institucioneve me bizneset dhe publikun. Duhet kuptuar se ne nuk jemi ndryshe nga bota e mësipërme.

Duke u vëmendësuar për bankat, rreziku ex-post lidhet me sjelljen dhe qendrimet që bankat të mos e transmetojnë informacionin për ngurtësimin financiar që përjetojnë tek mbikëqyrësit dhe tek publiku duke manipuluar nëpërmjet përpunimit kontabël, gjendjen reale të portofolit të huarave. Nga ana tjetër, kostoja e agjensisë së bankave rritet shumë sepse drejtuesit e bankave anashkalojnë aksionarët nëpërmjet kozmetikës kontabël dhe politikës së shpërndarjes së dividendëve për fitime të pamerituara. Kjo sepse nuk zbresin nga fitimi pjesën reale për rezerva që destinohen të mbulojnë a) humbjet nga kreditë me problem dhe aktivet e dëmtuara, b) humbjet nga rreziku operacional në bankë (vjedhjet e identitetit, mashtrimet, hackerimet, etj.) dhe c) humbjet nga rreziku i tregut. Të tre këto alternativa janë zëra që duhen mbajtur nga fitimi si shtesë në kapital për të mbrojtur institucionin nga kërcënimet e mësipërme.

Niveli i rritjes ekonomike përpara krizës globale financiare 2007-08 është përjetuar dhe e pranuar nga ana institucionale ndër parametrat më të lartë për 6%. Në periudhën pas vitit 2008 rritja e ekonomike pësoi tkurrje në një nivel jo më shumë se 3-4% duke rënë në 2.4% nga mesi i 2009 deri në 1,5-2% në vitin 2013. Kriza, u konstatua e u përhap si epidemi nëpërmjet kanaleve të kreditimit dhe financimit tregtar të sektorit ekonomik që kishte kontributin më të lartë në rritjen, e që ishte sektori i ndërtimit. Sa që sot mbetet krye hallka e zinxhirit sistemik në rrjetin transmetues privat, publik dhe shtetëror. Ndërsa në bilancin e pagesave u vërejt një rritje e llogarisë korente me 28 pikë përqindje në mes 2009 dhe 2012, në mjedisin e brendshëm, zhbalancimet fiskale u rritën duke përshkallëzuar ashpërsinë e rrezikut në sektorin financiar.

Në vitin 2013, deficit i llogarisë rrjedhëse nga 5% e GDP gati u dyfishua në 9,5% e GDP. Agregati i kërkesës pësoi rënie duke ulur importet për 11%, ndërkohë që eksportet u rritën vetëm 0.8%. Rënia e agregatit të kërkesës solli rënie të të ardhurave të qeverisë (arkëtimet nga taksat) ndërkohë që shpenzimet qeveritare mbeten të njejta. Kjo krijoi një deficit buxhetor që nga 3% e GDP që është norma u rrit në 9%, ndërsa borxhi publik nga 47% në 78% të GDP. Nëse horizonti kohor i rritjes përfshinte një periudhë 7-10 vjeçare, periudha e rënies ekonomike u ngushtuar për Brenda 3-4 vjetëve. Parimet për rrjedhje sa më të qendrueshme të kapitalit në vendet në zhvillim dhe tregjet emergjente (ku përfshihet Shqipëria) kërkojnë stabilizim të borxhit publik dhe ristrukturim të këtij borxhi (IIF -2005)⁷³.

Paralel me kronologjinë e mësipërme, kreditimi i bankave pësoi rënie sepse u shtuan shumë kreditë me problem duke kaluar disa nivele ankorimi. Konkretisht nga 4,5% më 2004

⁷¹ Higgins, Matthew and Thomas Kiltgaard (2004). Reserve Accumulation: Implications for Global Capital Flows and Financial Markets. *Current Issues in Economics and Finance* 10(10): 1-8.

⁷² Goldstein, Morris and Anna Wong (2005). What might the next emerging-market financial crisis look like? Institute for International Economics Working Paper 05-7, Washington, D.C.

⁷³ Institute of International Finance (IIF) (2005). Principles for Stable Capital Flows and Fair Debt Restructuring in Emerging Markets. IIF, Washington, D.C.

në 8,8% më 2009 në 27% më 2013. Pavarësisht pretendimit se shifrat nuk janë të sakta, dukuria që ato përshkruajnë është mëse e drejtë.

Niveli i Kredive jo të Mbara dhe masa e heqjes së kredive nga aktivi i bilancit (*write off*) asnjëherë nuk raportohen drejt dhe saktë për shkak të transaksioneve fiktive të kredive duke rritur transaksionet e shitjes së kredive nga një bankë në tjetrën, pa sjellur rritje të GDP. Konkretisht agregati i kredisë është raportuar për 5,5 miliard lekë, ndërkohë që nuk ka pasur rritje për 20% apo 1,1 miliard lekë të TVSH në autoritetin fiskal. Kjo sepse bankat janë bazuar në kozmetikë kontabël të riskadencimit të kredive duke i ofruar afate të reja, pa efekt në shtim të tyre si sistem bankar por zëvendësim maturimesh nga një bankë në tjetrën.

Sikurse do të trajtohet më hollësisht në vijim, struktura e portofolit të aktiveve të bankës ka ndryshuar duke ulur peshën e kreditimit apo të investimit në aktive me rrezik dhe shtuar peshën e investimit në instrumenta që në normativën financiare njihen si pa rrezik dhe që kryesisht bëhet fjalë për të Mirat e Thesarit. Disa banka si Intesa, Raiffeisen, etj., kanë rënie të ndjeshme të aktiveve si kredi dhe po kaq rritje të aktiveve në instrumenta financiar.

Bankat janë motivuar për një sjellje të tillë nga perceptimi i një rreziku të lartë në kreditë me probleme, nga humbja potenciale dhe faktike që bart dëmtimi i tyre dhe nga rezultatja e rënies së vlerës së aktiveve duke çuar në fitimshmëri të ulët dhe pamjfatueshmëri kapitale. Shtrëngimi i agregatit të kredisë ka ndodhur edhe për faktin se gjenerimi i kredive me problem (NPL) ka ndodhur nga rritja e huamarrjes tregtare (blerje me pagesë të mëvonëshme) duke krijuar mungesë likuiditeti palëve shitëse me arkëtim të mëvonshëm. Për 30%-40% të agregatit të kredisë tregtare në vlerë rrjedh nga kontratat qeveritare të mbetura të pashlyera nga ana e qeverisë deri në momentin që po shkruhet ky punim. Mosarkëtimi nga qeveria e kryerjes së punimeve për vepra të mëdha publike ka përcjellur mungesën e likuiditetit tek të gjitha firmat shitëse, produktet dhe shërbimet e të cilave janë ingredient të këtyre punimeve. Këto janë detyruar të rrisin koston e biznesit të tyre duke huamarrë nga sistemi bankar dhe duke krijuar konflikt për detyrime të vonuara me punonjësit, me palët furnitore, etj.

Përballë një efekti financiar të tillë bankat u bënë prehë e deficitit likuid, ndërkohë që sjellja e qeverisë ka vijuar me politika fiskale tejet ekspansioniste, jo në ulje taksash por në marrje borxhi tregtar dhe financiar për investimet publike ndaj firmave private sipërmarrëse. Kësisoj sektori bankar ende përballet me rreziqe të konsiderueshme edhe nga presionet e bankave të huaja amë për të ulur nivelin e burimeve të huajtura të bankave (*deleveraging*) sepse nuk justifikohen dhe as argumentohen me shndërrimin e këtyre burimeve në aktive me cilësi të lartë që të garantojnë vlerë shtesë dhe mjaftueshmëri kapitali (Briotti 2005)⁷⁴.

Pasiguria e shtuar e mjedisit makroekonomik, shkalla e lartë dhe ekspansioni i kredive me probleme, dhe efekti rrezikues që ka luhatshmëria e politikës fiskale duke shtuar emetimin e borxhit afatshkurtër krijojnë pritshmëri pesimiste aq sa sot masa e depozitave që shndërrohen në kredi ka rënë nga 75-85% (2000-2007) në mesatarisht 55-65% (2008-2013), ndërkohë që për të njejtën periudhë krahasimi, likuiditeti i depozitave i investuar në të Mira Thesari është shtuar nga 10-15% në 30-40%. Nga ana tjetër shumë kërcënues mbetet euroizimi i ekonomisë, për faktin se leku ka pësuar zhvlerësim nga 1 Eur=132 ALL në 1 Eur=141ALL, duke rënduar rrezikun e fuqisë blerëse tek leku. Nisur nga racionalja makroekonomike, qeveria është huamarrësi më i madh në lek dhe si e tillë në thelb për të ulur koston e borxhit ka interes për një inflacion të fshehtë të lekut, ndërkohë që Banka e Shqipërisë ka si detyrë krahun e kundërt, ruajtjen e qendrueshmërisë së lekut.

Kundërtia Qeveri-BQ gjendet përmes reshtave të deklaratave zyrtare institucionale, por rreziku financiar i ndryshimit të pafavorshëm të kursit të këmbimit në sistemin bankar godet më shumë palët depozituese se sa huamarrëse. Nga ana tjetër presione për uljen e nivelit

⁷⁴ M. Gabriella Briotti, "Economic Reactions to Public Finance Consolidation: a Survey of the Literature", ECBank Occasional Paper No. 38/ Oct 2005

të burimeve të huajtura të bankave vijnë edhe nga Banka Qendrore Europiane e cila në *Vlerësimin Gjithëpërfshirës* të cilësisë së aktiveve të bankave kryesore të eurozonës, ka vendosur parametra shtrëngues për tu respektuar dhe përmbushur që në gjysmën e parë të vitit 2014. Kjo do të përcjellë kufizimet e kapitalit edhe të filialeve të bankave të eurozonës që operojnë në Shqipëri (Raiffeisen, Procredit, Societe Generale, etj.). Në Shqipëri pronësia e huaj e bankave është mbi 98%, ku rreth 90 për qind mbahet nga bankat aksionare amë në përkatësi të Bashkimit Evropian (austriake, gjermane, greke, italiane). Portofoli i NPL në fund të muajit nëntor 2013 arriti në 24.2 përqind të gjithsej kredive, ndërsa në 6-mujorin e parë të 2014 ka arritur afër 30%. Kreditimi ndaj sektorit privat po pëson rënie me 3-5% bazë vjetore, ndërkohë që rritja ekonomike ka inerci pozitive të vlerësuar për 2% në vit, nga kreditimet e mëparshme. Kreditimet e rëna në 3 vitet e fundit janë sinjale paralajmëruese për rënie ekonomike më 2015 dhe më tej nëse nuk ka ndërhyrje korigjuese. Pikërisht për të sfiduar këtë pritshmëri qeveria e re ka ndërmarrë masa për rilëshimin përtëritës të ekonomisë.

Në vetvete edhe pse pohohet nga Banka e Shqipërisë se “pavarësisht nga niveli i lartë i kredive me probleme, bankat mbeten të shëndosha me një raport të përgjithshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 17,8 për qind në fund të shtatorit 2013” kjo përsëri duket më shumë një asimetri informuese përkundër panikut bankar sepse gjendja nuk është në fakt kaq e qetë. Fitimshmëria e sektorit bankar e matur nga shlyerja ndaj aktiveve (ROA) është në nivelin më të ulët në rajon. Banka e Shqipërisë si rregullator dhe mbikëqyrës i sistemit bankar, ka qenë proaktive në disiplinën e kërkesave të saj për treguesit e likuiditetit dhe treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, por jo aq për masat kundër rritjes së NPL.

Përprjekjet e Bankës së Shqipërisë për të motivuar ekonominë nëpërmjet uljes së normës së interesit janë ezauruar. Banka e Shqipërisë ka arritur limitin e fundit të saj [me marzh negativ] duke ulur normën bazë të interesit nën normën e pritshme të inflacionit. Kjo politikë liberale monetare nuk dha efekt në bankat e nivelit të dytë, sepse përcaktor i tkurrjes së kreditimit nuk është interesi i shtrenjtë sikurse percepton Banka e Shqipërisë, por shkalla e lartë e rrezikut dhe sjellja e bankave si ‘*risk adverse*’ dhe përpos rrezikut është edhe kostoja e biznesit të bankave që kanë ulur përpjesën e shpenzimeve variabël dhe kanë rritur shumë përpjesën e shpenzimeve fikse (koston e depozitave dhe koston e zhytur me infrastrukturë, zyra, administratë, etj.). Rikujtojmë se sot numërohen rreth 200 agjensi/pika bankare që me një kosto mesatare për 320 000 Euro në vit krijon një kosto të zhytur minimale për 64 milion euro. Bankat nuk kanë rrugëdalje për të mbuluar këtë kosto përveç se të godasin depozituesit duke i ofruar normë negative reale interesi dhe të godasin huamarrësit me norma të larta interesi. Bankat me nivelin më të lartë të kostove të zhytura kanë edhe rënie në konkurrueshmërinë e tyre (Jäger, Redak -2005)⁷⁵. Më fleksibël ka qenë banka Raiffeisen që ka ulur numrin e degëve në qytete p.sh., në Durrës nga 5 degë në 3 duke shtuar vëllimin shërbyes për degë (pra duke shtuar koston variabël). Më pak fleksibël apo shumë të vonuar në këto ndërhyrje janë Alfa Bank, NBG, Emporiki (sot Credit Agricole) dhe Tirana Bank. Tek secila nga këto banka sikurse nuk ka pasur sens ekonomik rritja e shpenzimeve marginale fikse ashtu nuk ka bërë sens edhe prerja e tyre. Konkretisht Alfa, Credit Agricole, NBG, Tirana Bank etj., janë reduktuar në prani shumë të ulët.

Sikurse në pozitë e çdo huamarrësi, edhe qeveria për çdo njësi borxhi shtesë ekspozohet në rrezikun e uljes së mbulimit të borxhit me garanci duke shtuar kapacitetin huamarrës të saj si dhe duke implikuar zëra shpenzimesh shtesë për shërbim borxhi dhe rritje të deficitit buxhetor. Rritja e borxhit për shkak të mbulimit të rritjes së deficitit buxhetor bëhet me argumentin se shtesa e shpenzimeve do të ndikojë në rritjen e GDP dhe ku shtesa e GDP

⁷⁵Johannes Jäger, Vanessa Redak, “Austrian Banks’ Lending and Loan Pricing Strategies against the Background of Basel II” –Financial Stability Report No 12, 2006.

me nivel taksash (nga constant në progresiv) do të rrisë arkëtimet e qeverisë për t'i shërbyer pa problem shlyerjes së borxhit (IMF Paper 2006)⁷⁶.

Problemi përpara sistemit bankar me fondet disponibël që ka, mbetet ndërmarrja e një vendimi optimal [zgjedhja se kujt t'i huajapë] dhe vendimi racional [qëllimi apo objektivi përse huajep]. *Vendimi i zgjedhjes se kujt t'i huajepet sistemit qeveritar apo ekonomisë reale, varet nga eficienta e secilit. Nëse Qeveria e përdor borxhin për investime/infrastrukturë, etj., kërkon të peshohet me elementët e koston dhe të konkurrimit në eficientë me alternativën e huadhënies në ekonomi* (Dervis, Birdsall)⁷⁷. Indikatori më i rëndësishëm që rekomandohet është analiza marzhinale e borxhit sipas raportit bazë:

[3] $\Delta \text{Borxh} / \Delta \text{Net Income}$

Nëse ky raport vjen në rritje atëherë d.t.th., se vendimi racional për të rritur huamarrjen qeveritare ndeshet me sfidën për pasigurinë e rritjes së të ardhurave. Në afat shkurtër ndikimi rritës në GDP vjen për shkak të komponentit G [shpenzimeve qeveritare], por nga ana tjetër kjo si kosto ka përqesimin e deficitit [G-Tx], duke krijuar një rreth vicioz për ta gjetur zgjidhjen në rimarrje borxhi deri sa rrezikohet të soset kapaciteti huamarrës i Qeverisë. Kësaj rritet pritshmëria e krijimit të një krize që del jashtë kontekstit kontrollues qeveritar duke krijuar një stad më problemor të **rrezikut të vendit**. Problemi i mësipërm rrit *barrën e borxhit* [sakrifica që duhet të bëjnë qytetarët e një vendi për të përballuar shlyerjen e borxhit publik]. Kjo e prir qeverinë që të shesë aktive/asete të saj nëpërmjet tenderave të privatizimit dhe arkëtimet nga këto privatizime rimbushin vakumet financiare të krijuara nga borxhi (Mendoza)⁷⁸. Problemi shtrohet se ndërkohë që qeveria pakëson asetet e saj sa ulët fuqia huamarrëse e vetë Qeverisë, gjë që të rikthen në argumentat e pikës së mësipërme⁷⁹.

Aktualisht Greqia sintetizon këto dy probleme në versionin më kritik sepse Qeveria greke nëpërmjet dikotomisë borxh-deficit nga njera anë dhe shitjes së krejt aseteve nga ana tjetër ka 'ezauruar' rëndë kapacitetin huamarrës jo vetëm të saj, por edhe të bizneseve po ashtu edhe të bankave. Borxhi publik dhe deficitet fiskale janë më shqetësueset në rajon, ndërkohë që varësia nga remitancat në rënie që Shqipëria pret nga emigracioni në Itali dhe Greqi mbeten përsëri si faktor me ndikim më me peshë edhe pse i dobësuar ndjeshëm. Baza e kufizuar e eksporteve, rishikimi i reformimit strukturor të ekonomisë janë kërcënuesit më të ashpër të besimit të investitorëve të huaj, sepse Shqipëria ka rritur oportunitetet për të investuar pa vënë re se ka rritur shumë edhe koston financiare, njerëzore, institucionale dhe ligjore të shfrytëzimit të këtyre oportuniteteve⁸⁰.

Banka e Shqipërisë ka akumuluar shqetësimet dhe ka paraqitur versionin e saj për Reformën e Modernizimit Financiar të Shqipërisë duke u bazuar në:

(a) Ristrukturimin e borxhit qeveritar duke dhënë impakt në pakësimin e NPL-ve që janë krijuar nga përcjellja në rrjet e efekteve negative të borxhit të vonuar të Qeverisë ndaj bizneseve;

(b) Zgjidhja e paqartësive kohëgjatë në marrëdhëniet tatimore në lidhje me heqjen e kredive të dështuara nga portofoli i bankave që kërkojnë njohje shpenzimesh shtesë dhe ulje fitimi, për pasojë edhe ulje të tatim-fitimit që qeveria pret të marrë nga bankat.

(c) Reforma gjyqësore për:

⁷⁶IMF (2006b). Further consideration of a new liquidity instrument for market access countries: Design issues. Paper prepared by the Policy Development and Review Department. IMF, Washington, D.C. <http://www.imf.org/external/np/pp/eng/2006/080306>.

⁷⁷Dervis, Kemal and Nancy Birdsall (2006). A Stability and Social Investment Facility for High-Debt Countries. In Ted Truman (ed.). Reforming the IMF for the 21st Century. Institute for International Economics, Washington, D.C.

⁷⁸Mendoza, R, A Compendium of Policy Instruments to Enhance Financial Stability and Debt Management in Emerging Market Economies –DESA Working Paper No. 48 ST/ESA/2007/DWP/48

⁷⁹Hoti, I, 'Informacioni Asimetrik, Kundërtitë Makro, IFRS dhe Basel II -Impakti i Ekspozimit në Rrezik i Industrisë Bankare në Shqipëri –Economicus Nr 02 2008, Tiranë.

⁸⁰ Ibid

- Përmirësimin e regjimit të ngurtësimit financiar të bankave dhe të bizneseve,
- Ekzekutimin e kolateralit, dhe nxitjen e strukturës private të përmbarimit; dhe
- Asistencë teknike për zhvillimin e tërë-portofolit bankar me NPL të pakësuar
- Krijimi i një kornize për ristrukturimet me pajtim të borxhit.

Në thelb operacioni i mësipërm është projektuar në tri shtylla: (i) forcimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit bankar dhe financiar; (ii) përshpejtimin dhe zgjidhjen e teknikave korigjuese për kreditë me probleme; dhe (iii) forcimin e rregullimit dhe të mbikëqyrjes së institucioneve financiare jo-banka.

Për shkak të NPL, që nga Nëntori 2013 sistemi bankar nuk ka rritje të kredive por rënie të tyre për 2,4% në vit⁸¹. Kjo ka rritur investimet në qeveri duke financuar mbi 75% të deficitit buxhetor, ndërkohë që Shqipëria nuk ka treg dytësor dhe nuk ka shoqëri financiare p.sh., fond investimesh për të krijuar treg alternativ nga ai i vetëm bankar.

Një pjesë e NPL kanë ardhur edhe përshkak të mosfunksionimit si duhet të industrisë së sigurimeve që mbulon pjesën e rrezikut puro të kontratave bankare. Kompanitë e sigurimit nuk financojnë në mënyrë dhe masë të plotë detyrimet për humbjet e pësuarat e të siguruarat në kontratat e kredive. Shumë huamarrës kanë pësuar goditje nga zjarri, vjedhja, përgjegjësia e produktit, aksidente, etj., ndërkohë që kanë rezultuar transaksione ose të pasiguruarat ose fiktivisht të siguruarat duke bërë që shoqëritë e sigurimit të mos kompensojnë për dëmin (Operational Risk Research Forum 2012)⁸².

Ngjarjet katastrofike dhe mosmbulimi i tyre ka krijuar dëmtim të rëndë të portofolit të bankave (përmbytja e Shkodrës, Lezhës, etj.). Shoqëritë e sigurimit çenojnë suazën morale kur përfshijnë në kontrata të mbulimit të rrezikut edhe ngjarjet katastrofike kur një gjë e tillë në vendet e BE konsiderohet mashtrim. Disiplina e kontratave sigurorese dhe rreziku operacional i sigurimeve fiktive ka një peshë 25-35% të kredive me probleme nga një bankë në tjetrën (Hess, Ulrich, Richter dhe Stoppa 2002)⁸³.

E vetmja gjë deridiku pozitive lidhet me faktin e shmangies së panikut bankar nëpërmjet sigurimit të depozitave të cilat mbulojnë 58% të depozituesve por më pak të vlerës së depozitave. Problemi bëhet shqetësues kur kimia inefficente e shndërrimit të depozitave në aktive me cilësi mbetet përsëri sfidë. Duke qenë se NPL vijnë në rritje, atëherë bankat ekspozohen më shumë në rrezik falimentimi duke shtuar koston e depozituesit (ASD), por primi i sigurimit të depozitave në mënyrë paradoksale mbetet i njëjtë për banka me ekspozime të ndryshme në rrezik (Hoti, Aliaj)⁸⁴.

ASD ka siguruar një strukturë financimi *back-stop* nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) në vlerë prej 100 milion euro. Kjo linjë do të përdoret (thirrjet), nëse është e nevojshme që ASD të financojë me likuiditet për depozituesit e siguruar bankat në prag falimentimi. Gjithsesi urgjentisht kërkohet që Ligji për Sigurimin e Depozitave duhet të rishihet në përcaktimin e primit dhe në vendosjen e standardeve se cilat institucione banka dhe jo banka do të mbulohen nga ASD.

Në përmbyllje shohim se treguesi më i ndikuar dhe njëkohësisht më ndikues është NPL dhe nga ana tjetër, sfida më problemore nuk është identifikimi, vlerësimi dhe kontrolli i rrezikut por raportimi i tij, që d.t.th., se sërish shfaqet jo beteja por lufta kundër asimetrisë së informacionit. Informacioni kontabël i korporatave në përgjithësi dhe i bankave në veçanti

⁸¹ IBRS-Program Document for a Proposed Loan in the Amount of Equivalent to US\$100 Million' -Report No 86955-AL/March 2014.

⁸² Insurance as a Mitigant for Operational Risk: a Report Submitted to the Basel Committee on Banking Supervision. London: Operational Risk Research Forum. 2012

⁸³ Hess, Ulrich, Kaspar Richter and Andrea Stoppa -Weather Risk Management for Agriculture and Agri-Business in Developing Countries. In Robert Dischel (ed.). *Climate Risk and the Weather Market: Financial Risk Management with Weather Hedges*. Risk Books, London, 2002.

⁸⁴ Hoti, I, Aliaj, A, Bank Assurance and Wealth Gain Allocation -An Alternative Economies of Scope, Journal of studies on economics & society UAMD -2013

mbetet larg standardeve ndërkombëtare dhe të BE⁸⁵. Për SME është e njëjta gjë sepse bankat marrin vendime si lexues të informacionit të kontabilitetit financiar, ndërkohë që për SME në Shqipëri nuk janë përkthyer dhe as ripunuar Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për SME. NPL nga SME përfshijnë 64% të numrit të kredive të dështuara nga portofoli i kreditimit të bizneseve.

Niveli i ulët dhe mos krijimi i sistemeve të sigurimit të cilësisë nga audituesit nuk justifikon akoma koston e lartë që bankat, korporatat dhe bizneset paguajnë ndaj audituesve. Këtu kërkohet ndërtim kapacitetesh jo vetëm për audituesit e jashtëm por edhe për burimet njerëzore të auditit të brendshëm.

3.4 PËRZGJEDHJA E VARIABLAVE

Racionalja e zgjedhjes së variablaeve për modelin e normimit të bankave bazohet në logjikën se këto përmbahen tërësisht dhe vetëm në treguesit financiar të bankës të cilët në vetvete kanë informacion të shumëfishtë.

Me indikatorët dhe treguesit financiar në anën e depozitave, banka kontrollon se sa mjete të lira monetare kanë depozituesit dhe çdo ndryshim i numrit dhe i vlerës mesatare të kursyer/depozituar për çdo depozitues informon nëse në mjedisin në fjalë sjellja e depozituesve ka pritshmëri për mungesë, tepricë apo qendrueshmëri likuiditeti. Depozita janë pasqyrim i vendimmarrjes për të kursyer në kushtet kur ka rritje të prirjes margjinale për kursim dhe e kundërta. Nëse depozituesit përjetojnë mungesë likuiditeti do të rritet tërheqja e depozitave për të zëvendësuar likuiditetin e munguar. Ndaj sistemit bankar, depozitat mbeten të pandryshuara për faktin se depozita që tërhiqet për blerje/pagesa krijon ose shton depozitën e shitësit. Por nëse për çdo njësi depozite të tërhequr nga mbajtësi i saj (blerësi, paguesi) shihet se banka nuk ka shtesë të depozitës nga një mbajtës tjetër (shitësi, arkëtuesi) atëherë banka më vehte duhet të përjetojë ikje të likuiditeteve për tek një bankë tjetër konkurruese. Prandaj agregati i depozitave i induktuar në makro informon për rritje të ofertës në para kur këto shtohen, për rritje të kërkesës për para kur këto tërhiqen dhe për regjimin monetar (inflator, disinflator) kur analizohet rezultantja e sjelljes së segmentuar të depozituesve.

Me indikatorët dhe treguesit financiar në anën e kredive dhe të aktiveve, bankat kanë një informacion gjithashtu të disafishtë. Së pari përpara vendimit për të kredituar një person fizik dhe/ose juridik banka ka analizuar në kontekstin makro, mikro, mjedisor ligjor, tregu, konkurrence, etj. Kjo d.t.th., se produkti i bankës ka lëndë të parë depozitat me të gjitha futjet për to dhe përpunohet për tu transformuar në një produkt tjetër bankar me vlerë të shtuar dhe me rrezik shtesë sikurse janë kreditë. Nëse cilësia e aktivitetit që po krijohet nëpërmjet kreditimit është e duhur atëherë kjo informohet nga cilësia e vetë portofolit që ka krijuar banka me kredi. Profili i larmisë së kredive (për shumë, klientë, biznese, shtrirje territoriale, industri, etj.), bart profilin e ciklikës së vetë bizneseve. Nëse banka ka portofol të përqendruar në biznese të caktuara, rritet rreziku i dështimit të bankës sepse cikli i bankës korrelohet tërësisht me ciklin e biznesit në fjalë. Të gjitha këto mishërohen në treguesin e portofolit të kredive për diversifikimin, për kreditë e padëmtuara, jo toksike apo të cilësisë së mirë, etj.

Të gjithë faktorët makro dhe mikro të bizneseve dhe të makromjedisit ekonomik, ligjor, tatimor, rregullativ, konkurrues etj., nëpërmjet kreditimit infuzohen në vetë bankën.

E thënë shkurt, aktivet e bankave janë 50-60% e llogarive për tu paguar në bilance e personave fizik/juridik, në grupimin e tyre sipas bizneseve, industrisë dhe shtrirjes territoriale tek të cilat formojnë rrezikun e likuiditetit, ndërsa në bankë rrezikun e kredisë.

⁸⁵ IBRS-Program Document for a Proposed Loan in the Amount of Equivalent to US\$100 Million' -Report No 86955-AL/March 2014.

Resurset që pasqyrohen si zotërime në aktivin e bilancit të individëve, firmave, bizneseve, industrive dhe të enteve qeveritare janë të financuara në masën mbi 50% nga bankat. Nga ana tjetër shumë aktive të tjera që janë në bilanc të firmave por edhe jashtë tij apo në bilancet e pasurisë vetiake të pronarëve të tyre p.sh. të patundshme, ndërtime, tokë, etj., janë përsëri jo të lira, por të mbajtura peng nga bankat në rast të skenarëve të pafavorshëm kur rreziku i likuiditetit të bizneseve shndërrohet në humbje për bankën. Kjo është një mpleksje që përmbahet dyanësisht në bilancin e bankës (si kredi) dhe në bilancin e huamarrësve (si detyrime), jashtë bilancit të bankës si kolateral për tu sekuestruar dhe ekzekutuar nëse huamarrësi nuk shlyen detyrimin, por brenda bilancit të biznesit ose bilancit personal të huamarrësit si aktiv.

Përfundimisht duke ju referuar dhe kritikave progresive të ekspertëve dhe të akademikëve, brenda konceptit të normimit nga distanca dhe për nivel renditës (*ordinal*) dhe jo themelor (*non cardinal*) zgjedhja e variablave bazohet në përmbajtjen më sintetike të gjithë informacionit financiar dhe kompleksitetin e marrëdhënieve të bankës me huamarrësit dhe me kategoritë përmbledhëse të tyre si konsumator, pronar të bizneseve mikro, SME, korporatë.

Aspektet specifike të kriterit dhe renditjes së variablave përmbledhen dhe kërkohen brenda pesëkëndëshit më përfaqësues të mbarëvajtjes dhe të shëndetit financiar të një banke që përmban fitimshmërinë, likuiditetin, mjaftueshmërinë financiare, efiçencën dhe cilësinë e aktiveve. Në vijim ndalemi në specifikat e zgjedhjes së secilës kategori variabli dhe të përmbajtjes së saj:

I-Përzgjedhja e variablave të Fitimshmërisë [X1, X2, X3 dhe X4]

I/1-Hierarkia e rëndësisë së variablit shpjegon funksionin qëllimor që është **fitimi**. Në model ne e përkufizojmë funksionin qëllimor të bankës si „maksimizim fitimi kundrejt një niveli të implikuar të dendurisë së rrezikut dhe të ashpërsisë së tij, pra të kostos“. Për këtë arsye, fitimi në gjuhën standarde njihet si e ardhura neto pas taksave. Si variabël është marrë në raport ndaj aktiveve të bankës që e kanë krijuar këtë të ardhur neto pas taksave. Ky është variabli i parë ose $ROA=X1$. Hierarkia në fjalë respektohet për analiza të tjera të ndarjes në emërues duke përfshirë të ardhurat neto ndaj kapitalit dhe të ardhura neto ndaj aktiveve me rrezik (X3, X4).

I/2-Analiza e variablit sintetik (fitimshmërisë) si përcaktues e përlllogaritës funksional të tij shihet e veçuar si fitim nga interesat (*Të ardhurat nga interesat – Shpenzimet për interesa*) ndërkohë që në raport aplikohet vetëm ndaj aktiveve fitimsjellëse të bankës. Ky variabël mund të nëndahet në dy tregues efiçence (ardhura nga interesat ndaj aktiveve fitimsjellëse dhe shpenzimet për interesa ndaj aktiveve fitimsjellëse). Në këtë rast banka zbërthen si anën e zotërimeve (kreditë) po ashtu edhe anën e detyrimeve (depozitat ose burime të tjera likuiditeti për tu shndërruar në kredi). Ky raport formon **X2**.

II-Përzgjedhja e variablave të Likuiditetit [X5 dhe X6]

II/1-Niveli i dytë hierarkik është likuiditeti që përmban dy klasa rreziku financiar: (a) rrezikun e likuiditetit në krahun e depozitave dhe (b) rrezikun e kredisë. Në thelb likuiditeti si variabël është përpjestim që shpjegon raportin e kredisë apo të huamarrësve të bankës ndaj depozituesve pranë saj. Në vlerë përkthehet se sa njësi huamarrësish qëndrojnë për njësi depozitash. Nga ana tjetër, ky variabël i pavarur përmban raportin produkt/faktor (*output/input*) duke përfaqësuar në nivelin më të lartë gjithëpërfshirës funksionin operacional të shpenzimeve/të kostos (grumbullimi i depozitave) me funksionin qëllimor funksional të të ardhurave (kredive). Marrëdhëniet e përgjegjësisë sociale deri në suazën publike që banka krijon me depozituesit, është se banka për çdo njësi depozite i garanton depozituesve mirëadministrimin e tyre duke u zotuar dhe performuar përballë mbikqyrësve dhe

rregullatorëve për mos shpërdorimin e depozitave që kanë kosto oportune eficientë e munguar nëse do të përdreshin në bankën X, Y ose edhe jashtë sistemit bankar.

Likuiditeti është edhe raport i rreziqeve të niveleve të ndryshme ndërmjet zotërimeve ushtrimore me detyrimet ushtrimore të bankës. Krahas variablit parësor kredi/depozita (X5) ne kemi përfshirë edhe një variabël të dytë që kombinon si raport, rrezikun minimal të aktiveve ushtrimore (para dhe barazvlerës) me rrezikun gjithëpërfshirës të detyrimeve ushtrimore (të pagueshme deri 1 vit. Ky është raporti i parasë (*cash ratio*) apo raporti para në të holla plus barazvlerës ndaj të pagueshmeve nën 1 vit. Ky variabël në lidhjen modelore është X6.

III-Përzgjedhja e variablave të Mjaftueshmërisë Kapitale [X7 dhe X8]

Variabli i pavarur i nivelit të tretë (pas fitimshmërisë dhe likuiditetit) përkon me racionalen e impaktit që jep në nivelin minimal të kërkuar apo të domosdoshëm aktivet dhe fitimi në kapitalin e bankës. Argumenti i përfshirjes së këtij variabli lidhet me faktin se niveli i tij informon për nivele të ndryshme të mjaftueshmërisë. Bankat Qendrore përcaktojnë pesë nivele të mjaftueshmërisë kapitale:

- 1-E kapitalizuar mirë;
- 2-E kapitalizuar mjaftueshëm;
- 3-E nënkapitalizuar;
- 4-E nënkapitalizuar në masë të dukshme.
- 5-E nënkapitalizuar në masë kritike.

Mjaftueshmëria kapitale informon edhe për praninë e burimeve nga të tretë në financimin e veprimtarisë së bankës (*leverage*). Sa më e ulët mjaftueshmëria kapitale aq më të pranishme burimet e treta [huamarrjet] aq më të çnueshme fitimet e bankës. Banka Qendrore të ndryshme në varësi të rrethanave që përjetojnë caktojnë nivele të ndryshme detyrë të raportit të kapitalit në rrezik ndaj zotërimeve gjithsej. Për modelin tonë, mjaftueshmëria kapitale është parë në dy variabla me përmbajtje alternative:

- (a) Detyrime Gjithsej/Kapitali Gjithsej (*Liabilities/equity*) që i referohet variablit X7
- (b) Kapitali Total/Aktive të peshuara në rrezik (*Equity /Risk weighted Assets*) X8.

IV-Përzgjedhja e variablave të Eficientës [X9]

Eficienta është mbarëvajtje financiare që një bankë e arrin ose e rrit pa dëmtuar imazhin, detyrimin ligjor, social, etj. Eficienta në politikën e kredisë dhe në krejt veprimtarinë e bankës i referohet rrethanës kur shpenzimet japin maksimumin e dobisë apo nivelin maksimal të të ardhurave neto para dhe/ose pas taksave. Nga aspekti i rrezikut shpenzimet pasqyrojnë të gjitha rreziqet që ndërmerr banka brenda suazës së shpenzimeve dhe humbjeve që njih edhe autoriteti tatimor si të zbritshme për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm.

Duke qenë se shpenzimet përmbajnë zërat e shpenzimeve në interesa, komisione, paga, etj., por duke shtuar shpenzimet e provizionimit, ka rëndësi që pjesa e të ardhurave neto (e fitimit) të llogaritet si fitim neto por i pa zbritur për provizionim. Për këtë arsye si variabël shpjegues i eficientës është zgjedhur raporti Shpenzimeve Gjithsej (para Taksave) ndaj (Të Ardhurave Netë në Interesa (para provizioneve) + Të Ardhura të Tjera) [X9].

V-Përzgjedhja e variablave të Cilësisë së Aktiveve [X10]

Në hierarkinë fundore buron nga pesha që aktivet toksike apo me probleme zënë ndaj aktiveve gjithsej. Në procedurën amvisuese dhe vlerësuese të bankave raporti i kredive me

probleme (NPL) ndaj kredive gjithsej shpreh raportin e rrezikut të pakontrolluar sipas parametrave të duhur (kreditë jo të mbara) ndaj rrezikut tërësor agregat të krejt portofolit të kredive.

Ky tregues shpreh disa marrëdhënie:

- a) Marrëdhënie brenda departamentit të kredisë p.sh. sa mirë është dizenuar një produkt kredie;
- b) Marrëdhënie ndërmjet departamentit të kredisë dhe departamentit të marketingut të bankës p.sh. sa arritje në klientë të rinj dhe sa ka koeficientin e ruajtjes së klientëve ekzistues një produkt krediti, sa shitje kryq gjeneron dhe si ndikojnë këto në imazhin dhe reputacionin e bankës.
- c) Marrëdhënie ligjore si debitor-kreditor. Një kredi shkel konceptin për të qenë e mbarë kur tejkalon mbi 30 ditë mos shlyerja e saj. Banka si palë huadhënëse para shenjave të një situate të tillë rrit praninë e garancive anësore (*collateral*) që huamarrësi vë shtesë, ose kërkon shlyerje të menjëhershme të kredisë që e ka parashikuar në kontratën e kredisë si shlyerje të përshpejtuar (*acceleration clause*).
- d) Marrëdhënie të drejtuesve me Aksionarët dhe institucionet mbikëqyrëse sepse, rritja e kredive me probleme ul aktivet dhe si rrjedhojë pakëson kapitalin. Për aksionarët është kosto shtesë për rregullatorët është prag për heqjen e licensës së bankës.
- e) Marrëdhënie të bankës me depozituesit dhe publikun.

Të gjitha këto krijojnë rrethana rreziqe ligjore që nuk analizohen vetëm si specifike për një bankë por në nivel sistematik.

Përfundimisht ky variabël shprehet nga raporti Kredi jo të mbara ndaj totalit të kredive (NPL/ Loans)

3.5- KAMPIONATURA E ZGJEDHUR DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE

Tregu bankar në Shqipëri konsiston në 16 banka tregtare, mbi 90% e të cilave janë me kapital të huaj. Megjithëse numri i bankave është i madh tregu është i shformuar, vetëm 6 banka zënë 80% të totalit të aktiveve të industrisë bankare. Nga ana tjetër shihet se sa koherente janë normimet e bankave në tregjet emergjente me probabilitetet e dështimit të tyre. Për këtë arsye homogjeniteti dhe diversiteti i kampionaturës kur kemi të bëjmë me një nivel të lartë opaciteti në rritje të sektorit bankar, me nivel akoma të paplotë të mbikëqyrjes dhe me mjedis rregullator, ligjor, institucional dhe kontraktual që ka ndikuar në sjelljen e bankave. Duke u bazuar në teknikat e pikëzimit (*scoring techniques*) dhe të hartave (*mapping*) kemi përzgjedhur një kampionaturë sa më përfaqësuese ndaj krejt popullimit të 16 bankave. Teknika scoring tregon se sa drejt është arritur përcaktimi sasior i shkallëve të normimit (koherenca) ndërsa rezultati nga hartat tregon prirjen e normimit bazuar në informacionin për rrezikun agregat të dështimit të një banke për në nivele të ndërmjetme apo më të ulta sigurie (Godlewski)⁸⁶.

Qëllimi është të ndërtojmë një model normimi, për vlerësimin e "shëndetit ekonomik dhe financiar" të bankave krahasimisht me njëra tjetrën. Mirëpo të imponuar nga kushtet

⁸⁶ Godlewski, C, -Are Bank Ratings Coherent with Bank Default Probabilities in Emerging Market Economies ? LaRGE, Université Robert Schuman, Institut d'Etudes Politiques 47 avenue de la Forêt Noire, 67082 Strasbourg Cedex, FRANCE -August 2004.

objektive faza e parë e modelit është renditja (*ranking*) e bankave dhe me çdo të dhënë kumulative shtesë kalohet nga renditja sipas shkallës së rrezikut (nga më e ulta apo minimale tek më e larta) për tek normimi vlerësues që konvertohet në simbolikë analoge sikurse përdorin edhe shoqëritë e normimit. Kampionatura e zgjedhur konsiston në 6 banka: Raiffeisen, Intesa San Paolo, Credins, Alpha Bank, Pro credit, BKT si përfaqësuese të tregut bankar pasi që zotërojnë 75.1% të aktiveve dhe 77.2% të totalit të depozitave. Sikurse cekëm në paragrafin e mësipërm, shkalla e lartë e përfaqësueshmërisë së kampionaturës ndaj krejt bankave krijon bazë të shëndoshë për objektivitetin e normimit.

Të dhënat e bankave janë marrë nga raportet 6-mujore dhe vjetore të audituara e të publikuara në faqet zyrtare të tyre dhe nga shoqata e bankave. Periudha e raportimit është marrë nga viti 2009-2012 duke qenë se bankat janë më homogjene në përpunimin kontabël të informacionit duke qenë të detyruara të raportojnë sipas IFRS-ve në vitin 2009.

Gjithashtu kjo periudhë përkon me qendrueshmërinë më të lartë të bankave për nga struktura e kapitalit sepse para vitit 2009 ka pasur transaksione të blerjes dhe bashkëshkrirjes së bankave, p.sh. Societe Generale bleu Bankën Popullore, Intesa San Paolo Bankën Amerikane dhe Credit Agricole bleu Emporiki Bank. Kjo përforcon argumentin e zgjedhjes së kampionaturës për të shmangur luhatjet për shkak të mospërputhjeve në mbajtjet e kontabilitetit dhe të ndryshimeve të përkatësisë kapitale.

Për secilën nga bankat kemi llogaritur një grup prej 10 variablash të cilët bazohen në të dhënat e marra nga pasqyrat financiare dhe i kemi grupuar në pesë grupe.

1. Në grupin e parë janë përfshirë raportet financiare matëse të mjaftueshmërisë së kapitalit (totali i kapitalit/aktiveve të peshuara në rrezik dhe të ngarkesës me burime të huajtura detyrime/aktive).
2. Në grupin e dytë janë përfshirë raportet financiare që masin cilësinë e aktiveve (kredi me probleme/totalit të kredive).
3. Në grupin e tretë janë përfshirë raportet financiare që masin eficientë (Shpenzime Gjithsej (para Taksave)/Të Ardhura Neto në Interesa + Të Ardhura të Tjera).
4. Në grupin e katërt janë përfshirë raportet financiare që masin përfitueshmërinë (fitimi pas tatimit/totalit të aktiveve, të ardhurat nga interesat - shpenzimet për interesa/aktive mesatare fitimsjellëse, të ardhura neto pas taksave/kapitalit mesatar, e ardhura neto/aktiveve të ponderuara në rrezik)
5. Në grupin e pestë janë përfshirë raportet financiare që masin likuiditetin (kredi/depozita, Cash+ Ekuivalente të Cash)/Detyrime të Pagueshme_{< 1 vit}).

Raportet nuk janë marrë të gatshme por janë përlllogaritur. Mesatarja, minimumi, maksimumi dhe devijimi standard për secilin variabël dhe bankë paraqiten në *shtojcën A*.

Duke qenë se modeli përfshin vetëm bankat që operojnë në tregun bankar të Shqipërisë nuk ka ndikime të ndërsjella të rrezikut të vendit (country risk) që do të rezultonin nëse do të kishim marrë banka rezidente në vende të ndryshme. Faktorët makroekonomikë janë të izoluar brenda një vendi me ndikim sistemik në të gjithë bankat. Në bazë të teorisë së pritjeve racionale konsiderojmë se mbarëvajtja e pjesës së shëndoshë të portofolit të bankave pasqyron informacion të njëkohshëm disponibël që ato kanë pasur rreth rrezikut të ndërtimit dhe të amvisimit të portofolit.

Vetitë teorike të indikatorëve makroekonomik, mishërohen dhe e japin impaktin nëpërmjet krahut të kreditimeve të bankave dhe jo atë nga krah i depozitave. Kjo d.t.th., se thyeshmëria apo fragiliteti i bankave është më i ulët ku ka shkallë më të ulët të aktiveve toksike në portofolin e secilës apo ku ka ditimshmëri sa më të sigurt. Fragiliteti është në rënie ku fitimshmëria është e qëndrueshme dhe është në rritje kur fitimshmëria është luhatëse dhe e patretshme financiarisht që d.t.th., se banka do të rrisë nivelin e burimeve të huajtura. Si rrjedhojë faktorët makro futen dhe japin impakt në portofolin e bankës nga huamarrësit e saj që janë bizneset. Ne kemi shmangur marrjen dy herë edhe si ndikim në biznese edhe si ndikim në bankë të indikatorëve makro (Gropp, Vesala, Vulpes 2004)⁸⁷.

Kompanitë më të mëdha të normimit në rishikimin e metodologjive të përdorura, i vendosin një peshë të rëndësishme faktorëve makroekonomikë. Për të bërë normimin e një banke ato fillimisht bëjnë normimin e vendit në të cilën banka operon, duke u ndalur në riskun ekonomik dhe atë të industrisë, më tej bëjnë normimin më vehte të bankës me racionalen se një bankë e cila operon në një vend të normuar të tipit A nuk mund të ketë një normim AAA, maksimumi mund të renditet një shkallë më lartë.

Ka rëndësi specifika se punimi i dedikohet normimit të bankave që operojnë në tregun bankar të Shqipërisë, e cila është normuar nga *Standard & Poor's* për nivelin B+ (aftësi të kufizuara në përmbushjen e detyrimeve financiare). Në pajtim me shumë studiues edhe këtu mund të themi se bankat që operojnë në Shqipëri mund të performojnë me një nivel rreziku apo sigurie 'pak më të mirë' se sa rreziku/siguria e vetë vendit ku operojnë (Shqipëri), krahasimisht edhe me vetë industrinë bankare në Shqipëri por nuk mund të jenë të normuara më lartë sesa BB. Ndryshe nga tre nga kompanitë më të mëdha të normimit të cilat përdorin një shkallë normimi me 21 klasa ne do të përdorim një shkallë me 6 klasa (ku me 1 do të shënohet banka që performon më mirë dhe me 6 banka që performon më keq).

Studimet e shumta të bëra në fushën e normimin kanë të përbashkët përfundimin që normimi është rezultat i kombinimit të modeleve objektive statistikore dhe gjykimit subjektiv (Ron, Verma 1989)⁸⁸. Ne po zhvillojmë një normim në distancë, në kushtet e një informacioni të kufizuar për bankat, përqendrimi ynë në normim bazohet në përpunimet statistikore dhe modelimin ekonometrik duke vazhduar më tej me gjykimin tonë, duke marrë për bazë informacione plotësuese e të rëndësishme për secilën bankë në veçanti (Curry, Elmer dhe Fissel 2001)⁸⁹. Informacioni kontabël i marrë nga pasqyrat financiare dhe të dhënat që shpalosen me to krijon bazë të shëndoshë për të normuar nga distanca bankat dhe nga ana tjetër nxjerr mangësi subjektive në kontabilitet që thjesht janë shmangie nga standardet, pra të korigjueshme për të ardhmen (Evanoff, Wall 2001)⁹⁰.

3.6. -NDËRTIMI I MODELIT DHE TESTIMI I TIJ

Kompanitë më të mëdha të normimit nuk shpalosin përmbajtjen e modelit por vetëm rezultatet/daljet e tij. Mirëpo kriza 2007-08 hodhi poshtë këto rezultate duke gjeneruar kritikën ndaj gabimeve për normat vlerësuese të bankave. Në këto rrethana u kritikua edhe hermetizimi i agjensive normuese për sekretimin e modeleve; kur në fakt kritika përqëndrohet tek identifikimi i gabimeve dhe alternativave përsosëse të këtyre modeleve.

⁸⁷ Gropp, R, Vesala, J, Vulpes, G, - Market Indicators, Bank Fragility, and Indirect Market Discipline –FRBNY *Economic Review*, Sept. 2004

⁸⁸ Ron, E., dhe A. Verma. "Risk-Based Capital Adequacy Standards for a Sample of Forty-Three Major Banks." *Journal of Banking and Finance* 13, no. 1 March 1989

⁸⁹ Curry, T., P. Elmer, dhe G. Fissel "Regulator Use of Market Data to Improve the Identification of Bank Financial Distress." Paper, Federal Deposit Insurance Corporation -2001..

⁹⁰ Evanoff, D., and L. Wall. "Sub-debt Yield Spreads as Bank Risk Measures." *Journal of Financial Services Research* 20, no. 2-3 October 2001.

Kjo nuk ndodhi dhe mbetet edhe sot sfidë. E vetmja gjë pozitive është angazhimi i shumë forcave, akademikëve ekspertëve për të riparë metodologjitë, modelet komponentët e tyre deri tek standartet e raportimit të këtyre gjetjeve. Gjithë sa më sipër ka orientuar që punimi të ketë kushtin parapërgatitor ekzaminim e specifikave të tregut bankar në shqipëri si edhe të gjithë segmenteve të tregjeve të tjera të ndërsjella.

Në këto kushte dhe pasi studiuam karakteristikat e tregut bankar Shqiptar vendosëm të ndërtonim një model normimi. Për të realizuar normimin janë përdorur 3 modele të ndryshme. Jemi bazuar në përpunime statistikore dhe në modelim ekonometrik. Mungesa e përvojave të mëparshme nga kompani apo akademikë na bëri të aplikojmë modele alternative për të parë nëse do të na sillnin të njëjtat rezultate.

Në adresë të pyetjes kërkimore bazë: **A kanë mbarëvajtje financiare të qëndrueshme bankat në Shqipëri krahasimisht me njëra-tjetrën?**

Ne jemi fokusuar në treguesin më rezultativ dhe që nga ana kontabël është më pak i manipulueshëm dhe më shumë diskriminues për cilësinë e aktiveve të bankave sikurse është treguesi i kredive jo të mbara (*non performing loans -NPL*). Ky tregues përfshin rezultanten e ndikimit të faktorëve që lidhen me dëmtimin e kredive (*loan impairment*), me kreditë toksike (*toxic loans*) si dhe me pjesën e kredive të peshuara në rrezik por që klasifikohen si standard (Pozen 2009)⁹¹.

Për këto arsye vlerësimin e shëndetit financiar të bankave kemi vendosur ta masim me këtë tregues. **Pra hipoteza që shtrojmë në funksion të pyetjes kërkimore bazë është:**

H_0 : Mbarëvajtja financiare e bankave krahasimisht me njëra tjetrën nuk mund të matet me normën e NPL-së.

H_1 : Mbarëvajtja financiare e bankave krahasimisht me njëra tjetrën mund të matet me normën e NPL-së.

Për të vërtetuar këtë hipotezë do të kalojmë në dy faza:

1. Fillimisht duhet të testojmë nëse treguesi NPL/totalit të kredive shpjegohet nga treguesit e tjerë (matësit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale dhe efikasitetit) të cilët janë zgjedhur si tregues që shpjegojnë më mirë normimin. Për këtë shtrojmë hipotezat e mëposhtme:

H_0 : Treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale dhe efikasitetit nuk e shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së.

H_1 : Treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale dhe efikasitetit e shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së.

2. Më pas testojmë rëndësinë e secilës bankë të marrë në shqyrtim së bashku me treguesit e tjerë (matësit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale dhe efikasitetit) në shpjegimin e normës së NPL-së. Duke qenë se rëndësia e secilës bankë është një variabël cilësor, përdorim variablat dummy.

⁹¹ Robert C. Pozen "How to Value Toxic Bank Assets" –Wall Street Journal Feb. 3, 2009

H_0 : Treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale, efijencës dhe rëndësia e secilës bankë të përfshirë në shqyrtim nuk e shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së.

H_1 : Treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale, efijencës dhe rëndësia e secilës bankë të përfshirë në shqyrtim shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së.

Së fundi në funksion të testimit të hipotezës që i vjen në ndihmë pyetjes kërkimore bazë përdorim metodën e mesatares shumëpërmasore.

Nga sa më sipër jemi përpara situatës të përzgjedhjes së një modeli i cili duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme sipas Hendry dhe Richard⁹²:

1. Të dhëna duhet të jenë të pranueshme, që do të thotë që parashikimet e bëra nga modeli duhet të jenë logjike.
2. Modeli duhet të jetë konsistent me teorinë, pra të ketë kuptim ekonomik.
3. Variablat shpjegues/të pavarur duhet të jenë të pakorreluara me termin e gabimit.
4. Parametrat duhet të jenë të qëndrueshme, në të kundërt parashikimi do të ishte thuajse i pamundur. Sipas Friedman⁹³, testi i vetëm me rëndësi për të vërtetuar një hipotezë është krahasimi i eksperiencës/faktikes me parashikimin.
5. Mbetjet duhet të jenë variabla të rastit. Duhet të zbulojmë natyrën e tyre.
6. Modeli i zgjedhur duhet të përfshijë të gjithë modelet e tjera alternative, në kuptimin që duhet të jetë në gjendje të shpjegojë rezultatet e tyre. Thënë ndryshe, zgjedhja e një modeli alternativ nuk do të përmirësonte asgjë kundrejt modelit të zgjedhur.

Gjithsej janë kryer 48 observime: për secilën nga 6 bankat janë llogaritur dhjetë variabla për tetë periudha. Kemi të bëjmë me të dhëna panel. Variabli i varur në model është sasior. Ndërsa si variabla të pavarura që supozojmë se shpjegojnë këtë variabël kemi zgjedhur raportet financiare matëse të mjaftueshmërisë kapitale (totali i detyrime/totali i kapitalit dhe totali i kapitalit/ aktiveve të peshuara në rrezik), raportet financiare që masin efijencën (Shpenzime Gjithsej(paraTaksave)/Të Ardhura Neto në Interesa + Të Ardhura të Tjera), raportet financiare që masin përfitueshmërinë (fitimi pas tatimit/totalit të aktiveve, të ardhurat nga interesat - shpenzimet për interesa/aktive mesatare fitimsjellëse, të ardhura neto pas taksave/kapitalit mesatar, e ardhura neto/aktiveve të ponderuara në rrezik), dhe së fundi raportet financiare që masin likuiditetin (kredi/depozita, Cash+Ekuivalente të Cash /Detyrime të Pagueshme_{< 1 vit}). Nga literatura e studiuar presim që variablat e pavarur do të kenë lidhje funksionale me variablin e varur si më poshtë paraqitur në tabelën 3.10.

⁹² D.F. Hendry and J.F. Richard, "The Econometric Analysis of Economic Time Series," *International Statistical Review*, vol.51, 1983, pp.3-33.

⁹³ Milton Friedman, "The Methodology of Positive Economics," in *Essays in positive Economics*, University of Chicago Press, Chicago, 1953, p.7.

Tabela 3.10 Lidhja funksionale ndërmjet variablave

Raporte Financiare		Cilësia e aktiveve (NPL/totali i kredive) Y
Përfitueshmëri		Lidhja funksionale
ROA Fitimi pas tatimit/totalit të aktiveve (NI/Asset)	X1	Negative
(Të ardhurat nga interesat – Shpenzimet për interesa / Aktive Mesatare Fitimsjellese (NIM)	X2	Pozitive
ROE Të ardhura neto pas taksave / Kapital Mesatar	X3	Negative
Të ardhurat neto/ aktive të ponderuara në rrezik (Net Income/Risk Weighted Assets)	X4	Negative
Likuiditet		
Kredi/Depozita	X5	Negative
Cash+Cash Equivalents)/Detyrime të Pagueshme _{< 1 vit}	X6	Negative
Mjaftueshmëri kapitale		
Detyrime Gjithsej/Kapitali Gjithsej	X7	Pozitive
Kapitali Total/Aktive të peshuara në rrezik	X8	Pozitive
Efiçencë		
Shpenzime Gjithsej (para Taksave)/Të Ardhura Neto në Interesa (para provizioneve) + Të Ardhura të Tjera	X9	Negative

Duke qenë se qëllimi ynë është të vlerësojmë funksionin e regresionit të popullimit mbi bazën e funksionit të regresionit të kampionaturës së zgjedhur përdorim metodën e katrorëve më të vegjël (*OLS*). Ndërtojmë funksionin linear të shumëfishtë (multiple regression function) me variablat e sqaruar.

$$Y(\text{NPL/kredi gjithsej}) = \beta_0 + \beta_1 X_1(\text{Fitimi pas tatimit/totalit të aktiveve}) + \beta_2 X_2(\text{Të ardhurat nga interesat – Shpenzimet për interesa / Aktive Mesatare Fitimsjellese}) + \beta_3 X_3(\text{Të ardhura neto pas taksave / Kapital Mesatar}) + \beta_4 X_4(\text{Të ardhurat neto/ aktive të ponderuara në rrezik}) + \beta_5 X_5(\text{Kredi/Depozita}) + \beta_6 X_6(\text{Cash+Cash Equivalents)/Detyrime të Pagueshme}_{< 1 \text{ vit}} + \beta_7 X_7(\text{Detyrime Gjithsej/Kapitali Gjithsej}) + \beta_8 X_8(\text{Kapitali Total/Aktive të peshuara në rrezik}) + \beta_9 X_9(\text{Shpenzime Gjithsej (para Taksave)/Të Ardhura Neto në Interesa (para provizioneve) + Të Ardhura të Tjera})$$

Siç edhe sqaruam më sipër variablat e pavarur i kemi grupuar në katër grupe, dhe brenda të njëjtin grup janë përfshirë 2 ose më shumë raporte financiare. Sic shihet nga *tabela 3.11* variablat brenda të njëjtit grup krijojnë korrelacion për këtë arsye vetëm një ose dy prej tyre janë zgjedhur.

Tabela 3.11 Korrelacionet midis variablave

	X1	X2	X3	X4	X5	X6	X7	X8	X9	X10
X1	1.00	0.29	0.92	0.96	-0.45	0.07	0.03	0.07	-0.36	-0.30
X2	0.29	1.00	0.25	0.20	0.26	0.25	-0.26	-0.16	-0.40	0.19
X3	0.92	0.25	1.00	0.91	-0.44	0.04	0.18	0.02	-0.36	-0.31
X4	0.96	0.20	0.91	1.00	-0.61	0.04	0.08	0.18	-0.27	-0.27
X5	-0.45	0.26	-0.44	-0.61	1.00	0.17	-0.20	-0.40	-0.01	-0.08
X6	0.07	0.25	0.04	0.04	0.17	1.00	0.16	-0.29	0.06	-0.03
X7	0.03	-0.26	0.18	0.08	-0.20	0.16	1.00	-0.58	0.22	-0.23
X8	0.07	-0.16	0.02	0.18	-0.40	-0.29	-0.58	1.00	-0.05	0.34
X9	-0.36	-0.40	-0.36	-0.27	-0.01	0.06	0.22	-0.05	1.00	-0.15
X10	-0.30	0.19	-0.31	-0.27	-0.08	-0.03	-0.23	0.34	-0.15	1.00

Ndërtojmë modelin e parë të regresionit pa përfshirjen e variablave të cilat krijojnë korrelacion. Me anë të këtij modeli do të testojmë hipotezën:

H_0 : Treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale dhe efikasitetit nuk e shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së.

H_1 : Treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale dhe efikasitetit shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së.

Më pas ndërtojmë modelin duke përfshirë edhe 6 variabla dummy, për të shprehur rëndësinë që ka secila nga bankat në model.

Ku me D1 shënojmë bankën BKT, D2 Bankën Crendis, D3 Bankën Intesa San Paolo, D4 Bankën Raiffeisen, D5 Bankën Alpha dhe D6 Bankën Pro-Credit. Dimë që kur $D1 = 1$ të gjithë variablat e tjerë dummy janë të barabartë me 0, e njëta gjë kur $D2 = 1$ e kështu me rradhë. Me këtë model do të testojmë hipotezën e mëposhtme:

H_0 : Treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale, efikasitetit dhe rëndësia e secilës bankë të përfshirë në shqyrtim nuk e shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së.

H_1 : Treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale, efikasitetit dhe rëndësia e secilës bankë të përfshirë në shqyrtim e shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së.

Funksioni i regresionit të shumëfishtë të gjetur na lejon të përlogarisim vlerat e pritshme të X_{10} . Gjejmë *mbetjet* (*residuals*) si diferencë e vlerave faktike të variablës X_{10} me vlerat e parashikura nga modeli i regresionit të shumëfishtë me variabla dummy. Një nga kriteret që duhet të përmbushë modeli i përzgjedhur është që mbetjet duhet të jenë rastësore dhe të studiojmë shpërndarjen e tyre. Për të testuar këtë bëjmë testin e normalitetit *Jarque-Bera*. Testi bazohet në hipotezën e përbashkët (skewness = 0 dhe kurtosis = 3) që duhet të përmbushen që mbetjet të kenë shpërndarje normale. Në këtë rast statistika **JB** pritët të jetë 0. Në grafikun e mëposhtëm shikojmë që skewness = -0.21, kurtosis = 2.35 dhe statistika **JB**=1.21 me probabilitet $0.544547 > 0.05$, që do të thotë që kriteri përmbushet, duke marrë në konsideratë se numri i vrojtimit është 48. Mbjetet janë rastësore dhe kanë shpërndarje normale.

Tabela 3.12 Testet për vlefshmërinë e modelit

Testet	Lloji i testit	Statistika e testeve	Hipotezat
Test i normalitetit të mbetjeve	<i>Jarque-Bera</i> ⁹⁴	<i>JB</i> =1.21 Probabilitet 0.544547	Shpërndarja e termave të gabimit është normale
Test i heteroskedasticitetit	<i>White`s General Heteroscedasticity</i> ⁹⁵	Obs*R-squared = 0.155896	Mbetjet kanë variancë të njëjtë.
Testi për autokorrelacion	<i>Breusch-Godfrey</i> ⁹⁶	Obs*R-squared = 0.229991	Termat e gabimit nuk krijojnë autokorrelacion
Testi për formën funksionale	<i>Ramsey RESET</i>	Probabiliteti = 0.002211	Modeli linear është i duhur.

Një nga supozimet e rëndësishme të modelit të regresionit linear është që mbetjet duhet të kenë të njëjtën variancë për disa zgjedhje, pra duhet të plotësojnë kushtin e (*homoscedasticity*). Për të testuar mbetjet (*residuals*) përdorim testin e White (*White`s General Heteroscedasticity Test*). Testi llogarit një probabilitet të Obs*R-squared = 0.155896 i cili kalon kufirin prej 0.05 që përcakton nivelin që mbetjet të kenë variancë jo të njëjtë. Si përfundim themi që kushti që duhet të plotësojë modeli i regresionit linear për mbetjet me variancë të njëjtë plotësohet.

Së fundi termat e gabimit i testojmë për autokorrelacion. Nëse termat e gabimit do krijojnë autokorrelacion atëherë koeficientët të llogaritur me metodën e katrorëve më të vegjël megjithëse mund të jenë linear, të pazhvendosur dhe kanë shpërndarje normale, nuk janë eficient kundrejt koeficientëve të tjerë. Si rrjedhojë testet, *t*, *F* dhe χ^2 nuk janë të vlefshëm. Për të testuar termat e gabimit për autokorrelacion përdorim testin *Breusch-Godfrey*⁹⁷ (*BG*) i cili njihet ndryshe edhe si testi *LM*. Testi llogarit një probabilitet të Obs*R-squared = 0.229991 i cili kalon kufirin prej 0.05 që përcakton nivelin që termat e gabimit të krijojnë autokorrelacion. Si përfundim themi që kushti që duhet të plotësojnë termat e gabimit për të mos krijuar autokorrelacion plotësohet.

Për të plotësuar kushtin e fundit të përzgjedhjes së modelit, pra që ai të përfshijë të gjithë modelet e tjera alternative, në kuptimin që duhet të jetë në gjendje të shpjegojë rezultatet e tyre, testojmë formën e modelit. Përdorim testin *Ramsey RESET*⁹⁸. Sipas këtij testi ndërtojmë

⁹⁴ Jarque, Carlos M.; Bera, Anil K. "Efficient tests for normality, homoscedasticity and serial independence of regression residuals". *Economics Letters* 6, 1980.

⁹⁵ White, H. "A Heteroskedasticity-Consistent Covariance Matrix Estimator and a Direct Test for Heteroskedasticity". *Econometrica* 48, 1980.

⁹⁶ Godfrey, L.G. "Misspecification tests and their uses in econometrics", *Journal of Statistical Planning and Inference*, 49 (2), (Econometric Methodology, Part II, 1996

⁹⁷ L. G. Godfrey, "Testing Against General Autoregressive and Moving Average Error Models When the Regressor include Lagged Dependent Variables," *Econometrica*, vol. 46, 1978, pp 1293-1302, dhe T. S. Breusch, "Testing for Autocorrelation in Dynamic Linear Models," *Australian Economic Papers*, vol. 17, 1978, pp. 334-355.

⁹⁸ J. B. Ramsey, "Test for Specification Errors in Classical Linear Least Squares Regression Analysis," *Journal of the Royal Statistical Society*, series B. vol. 31, 1969, pp. 350-371

funksionin e regresionit duke përfshirë si variabël të pavarur, variablin e varur të parashikuar. Më pas krahasojmë koeficientin e determinacionit të llogaritur në funksionin e ri të regresionit linear me koeficientin e determinacionit që kemi llogaritur. Për të parë nëse kemi ndryshime të rëndësishme përdorim testin F i cili nga llogaritjet rezulton $0.002211 < 0.05$, që është kufiri informues për përzgjedhjen e modelit të gabuar. Si përfundim mund të themi që modeli linear i zgjedhur është i duhuri.

Vlerat e parashikuara të variablit X_{10} dhe testet për vlefshmërinë e modelit gjenden në shtojcën C.

Tabela 3.13 Lidhja funksionale e variablave me normimin

Raporte Financiare		Normimi
Përfitueshmëri (<i>Profitability</i>)		Lidhja funksionale
Të ardhura neto pas taksave /totalit të aktiveve <i>ROA (NI/Asset)</i>	X_1	Pozitive
(Të ardhurat nga interesat – Shpenzimet për interesa / Aktive Mesatare Fitimsjellese (<i>NIM</i>))	X_2	Pozitive
Të ardhura neto pas taksave / Kapital Mesatar <i>ROE (NI/Equity)</i>	X_3	Pozitive
Të ardhurat neto pas taksave/Aktive të ponderuara në rrezik (<i>Net Income/Risk weighted Assets</i>)	X_4	Pozitive
Likuiditet (<i>Liquidity</i>)		
Kredi/Depozita (<i>Loans/Deposits</i>)	X_5	Pozitive
Mjete monetare +Ekuivalente /Detyrime të Pagueshme _{< 1 vit} (<i>Cash+Cash Equivalents</i>)/ <i>Payables</i> _{< 1 vit}	X_6	Pozitive
Mjaftueshmëri kapitale (<i>Capital Adequacy</i>)		
Detyrime Gjithsej/Kapitali Gjithsej (<i>Liabilities/equity</i>)	X_7	Negative
Kapitali Total/Aktive të peshuara në rrezik (<i>Equity/Risk weighted Assets</i>)	X_8	Pozitive
Efiçencë (<i>Efficiency</i>)		
Shpenzime Gjithsej (para Taksave)/Të Ardhura Neto në Interesa (para provizioneve) + Të Ardhura të Tjera	X_9	Negative
Cilësia e aktiveve (<i>Asset quality</i>)		
Kredi jo të mbara/totali i kredive (<i>NPL/ Loans</i>)	X_{10}	Negative

Në funksion të pyetjes kërkimore kryesore, për të vlerësuar qendrueshmërinë financiare të bankave krahasimisht me njëra-tjetrën, kemi vendosur të përdorim *metodën me mesatare shumëpërmasore*. Për këtë metodë përdorim raportet financiare të llogaritura. Në tabelën 3.13 kemi paraqitur lidhjen funksionale midis treguesve të përzgjedhur dhe normimit. Këto tregues i grupojmë në dy grupe, në tregues që kanë lidhje funksionale pozitive me

normimin ku përfshihen ($X_1, X_2, X_3, X_4, X_5, X_6, X_8$) dhe tregues që kanë lidhje funksionale negative me normimin ku përfshihen (X_7, X_9, X_{10}).

Për secilën nga bankat janë llogaritur treguesit (X_1 - X_{10}) për tetë periudha kohore gjashtëmujore (2009-2012). Për secilin prej treguesve është llogaritur mesatarja e përgjithshme e treguesit për të gjitha bankat të përfshira në studim për tetë periudhat, dhe i shënojmë $\overline{X_1}, \overline{X_2}$ e kështu me rradhë. Më pas secilën karakteristikë e pjesëtojmë me mesataren e përgjithshme dhe e shumëzojmë me 100. $[(X_i/\overline{X_i}) * 100]$ për i nga 1 në 10.

Në vijim llogarisim mesataren shumëpërmasore për treguesit ($X_1, X_2, X_3, X_4, X_5, X_6, X_8$) dhe për treguesit (X_7, X_9, X_{10}), për secilën bankë më vehte. Duke qenë se lidhja e treguesve ($X_1, X_2, X_3, X_4, X_5, X_6, X_8$) me normimin është pozitive atëhere, sa më i madh ky tregues aq në nivel më të lartë normimi do të renditet banka. Ndërsa lidhja e treguesve (X_7, X_9, X_{10}), me normimin është negative, atëhere, sa më i vogël ky tregues aq në nivel më të lartë normimi do të renditet banka. Secilës prej metodave i vendosim një peshë, sipas rëndësisë që besojmë se kanë dy grupet e treguesve.

Mënyra tjetër që kemi përdorur për të renditur dhe normuar bankat është: duke përdorur të njëjtën metodë (mesatare shumëpërmasore) por duke marrë për bazë vetëm treguesin X_{10} (NPL/Totalit të kredive). Llogaritjet për të gjitha mënyrat e mësipërme gjenden në *Shtojcën B*. Treguesve me ndikim pozitiv i japim peshën më të vogël 0.3 dhe treguesve me ndikim negativ në normim i japim peshën 0.3, ndërsa treguesit X_{10} i japim peshën 0.4. Duke ponderuar peshat me renditjet e rezultuara nga secila metodë, përcaktojmë renditjen e secilës bankë.

Deri tani kemi normuar bankat sipas përpunimit statistikor dhe modelimit ekonometrik të treguesve kryesorë financiarë. Më tej ndalemi në disa tregues që i konsiderojmë të rëndësishëm për të normuar bankën dhe që përfshijnë qendrueshmërinë e fitimeve dhe indeksin Z që ka përmbajtje universale për matjen e rrezikut të bankës. Qendrueshmërinë e fitimeve e masim me koeficientin e variacionit të fitimeve. Për secilën nga bankat kemi llogaritur koeficientin e variacionit të fitimeve dhe indeksin Z për periudhën 2009-2012.

Më pas përcaktojmë pesë nivele (shumë mirë, mirë, mjaftueshëm, dobët dhe shumë dobët) si për qendrueshmërinë e fitimeve edhe për indeksin Z dhe ndërtojmë matricën e mëposhtme. Duke u bazuar në këtë matricë do të përcaktojmë normimin e bankës duke e rregulluar normimin e përcaktuar nga modeli me shkallë rritëse ose zbritëse, sipas karakteristikave specifike të secilës bankë.

Tabela 3.14 Matrica përcaktuese e normimit

Qendrueshmëria e fitimeve Risku i biznesit	Shumë i fortë	I Fortë	Mjaftueshëm	Dobët	Shumë dobët
Shumë i fortë	5	4	3	2	1
I Fortë	3	2	1	0	-1
Mjaftueshëm	2	1	0	-1	-2
Dobët	1	0	-1	-2	-3
Shumë dobët	-1	-2	-3	-4	-5

KAPITULLI 4

ANALIZA E REZULTATEVE DHE GJETJET

Rezultatet e gjetura do ti analizojmë si më poshtë. *Fillimisht* do të analizojmë rezultatet e modelit të parë të regresionit sipas të cilit treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale dhe efikasitetit shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së. *Në çështjen e dytë* do të analizojmë rezultatet e modelit të dytë të regresionit sipas të cilit treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale, efikasitetit dhe rëndësia e secilës bankë të përfshirë në shqyrtim shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së. *Në çështjen e tretë* do të analizojmë metodën me mesatare shumëpërmasore. Së fundi do të analizojmë secilën bankë në veçanti duke marrë në konsideratë disa faktorë të tjerë të cilët i konsiderojmë të rëndësishëm për normimin.

4.1- ANALIZA E REZULTATEVE TË MODELIT TË PARË TË REGRESIONIT PA VARIABLA DUMMY]

Në kapitullin 3 shtruam hipotezën bazë në funksion të pyetjes kërkimore:

H_0 : Mbarëvajtja financiare e bankave krahasimisht me njëra tjetrën nuk mund të matet me normën e NPL-së.

H_1 : Mbarëvajtja financiare e bankave krahasimisht me njëra tjetrën mund të matet me normën e NPL-së.

Për të vërtetuar këtë hipotezë sqaruam që do të kalojmë në dy faza:

1. Fillimisht duhet të testojmë nëse treguesi NPL/totalit të kredive shpjegohet nga treguesit e tjerë (matësit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale dhe efikasitetit) të cilët janë zgjedhur si tregues që shpjegojnë më mirë normimin. Për këtë shtrojmë hipotezat e mëposhtme:

H_0 : Treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale dhe efikasitetit nuk e shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së.

H_1 : Treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale dhe efikasitetit e shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së.

Për të testuar hipotezën e ngritur ndërtojmë funksionin e regresionit, ku variabël të varur kemi normën e NPL-së dhe variabla të pavarur treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale dhe efikasitetit. Rezultatet e modelit të parë të regresionit paraqiten në tabelën 4.1 Duke qenë se numri i vrojtimit është 48 mund të përdorim statistikën t për të testuar rëndësinë e treguesve, dhe statistikën F për të testuar rëndësinë e përgjithshme të regresionit të shumëfishtë.

Variabli fitimi pas tatimit/totalit të aktiveve matës i përfitueshmërisë është statistikisht i rëndësishëm me besueshmëri mbi 99%, pasi vlera p (e cila tregon nivelin ekzakt të rëndësisë) është shumë e vogël. Mund të themi se hipoteza nul sipas të cilës treguesi i përfitueshmërisë nuk e shpjegon ndryshimin e normës së NPL bie poshtë. Për më tepër nga rezultatet e modelit kthimi nga aktivet shfaqet si një tregues i rëndësishëm dhe me shenjë negative sipas pritshmërive. Kuptohet që një rritje e kthimit nga aktivet do të rezultojë në një zvogëlim të normës së NPL, madje në rastin tonë ky ndikim është i rëndësishëm me koeficient (- 7.604483).

Treguesi të ardhurat nga interesat – Shpenzimet për interesa / Aktive Mesatare Fitimsjellëse, matës i përfitueshmërisë është statistikisht i rëndësishëm me besueshmëri mbi 99% pasi vlera p është shumë e vogël. Mund të themi se probabiliteti që t - statistikore $>$ t - kritike është 0.0012 pra pothuajse e parëndësishme. Sa thënë më sipër hipoteza nul sipas të cilës treguesi i përfitueshmërisë nuk e shpjegon ndryshimin e normës së NPL bie poshtë. Nga rezultatet e modelit marzhi neto në interesa është tregues i rëndësishëm dhe me shenjë pozitive sipas pritshmërive. Një rritje e marzhit neto në interesa do të rezultojë në një rritje të normës së NPL-së me 2.15 herë sepse koeficienti për këtë tregues është 2.150025.

Treguesi Kredi/Depozita matës i likuiditetit është statistikisht i rëndësishëm me besueshmëri mbi 99%. Probabiliteti që t - statistikore $>$ t - kritike është 0.0087 pra i parëndësishëm, e si rrjedhim hipoteza nul sipas të cilës treguesi i likuiditetit nuk e shpjegon ndryshimin e normës së NPL-së bie poshtë. Treguesi kredi/depozita shfaqet në regresion me koeficient -0.223364, pra është i rëndësishëm dhe me shenjë negative sipas pritshmërive. Një rritje e raportit, që përkthehet në përmirësim të likuiditetit të bankës do të rezultojë në një zvogëlim të normës së NPL.

Treguesi Kapitali Total/Aktive të peshuara në rrezik matës i mjaftueshmërisë kapitale është statistikisht i rëndësishëm me besueshmëri mbi 97.38%. Probabiliteti p i llogaritur është 0.0262, dhe kaq është mundësia që t - statistikore $>$ t - kritike, pra pothuajse e parëndësishme. Hipoteza nul sipas të cilës treguesi i mjaftueshmërisë kapitale nuk e shpjegon ndryshimin e normës së NPL-së bie poshtë.

Treguesi Shpenzime Gjithsej (para Taksave)/Të Ardhura Neto në Interesa (para provizioneve) + Të Ardhura të Tjera, matës i efikasitetit është statistikisht i rëndësishëm me besueshmëri 88.39%. Mund të themi se probabiliteti që t - statistikore $>$ t - kritike është 0.1161 pra pothuajse e parëndësishme. Sa thënë më sipër hipoteza nul sipas të cilës treguesi i efikasitetit nuk e shpjegon ndryshimin e normës së NPL bie poshtë. Më tej akoma mund të themi se matësi i efikasitetit është tregues i rëndësishëm dhe me shenjë negative në regresion. Nëse banka bëhet më efiçente pra treguesi rritet, norma e NPL zvogëlohet me 0.156544 herë.

Pra hipoteza nul që kemi ngritur në ndihmë të hipotezës bazë bie poshtë, dhe mund të themi që treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale dhe efikasitetit e shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL.

Përveç testimit të secilit variabël, testojmë edhe rëndësinë e përgjithshme të regresionit të shumëfishtë në terma të R^2 duke përdorur testin F . Shikojmë që probabiliteti i statisikës F është 0.000039, që do të thotë se mundësia që të pranohet hipoteza nul është shumë e vogël, thuajse e papërfillshme. Mund të themi se të gjithë variablat e regresionit të shumëfishtë janë statistikisht të rëndësishëm.

Tabela 4.1 Analiza e regresionit pa variabla dummy

Dependent Variable: X10				
Method: Least Squares				
Sample: 1 48				
Included observations: 48				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	0.280729	0.101679	2.760940	0.0085
X1	-7.604483	1.562569	-4.866654	0.0000
X2	2.150025	0.620042	3.467547	0.0012
X5	-0.223364	0.081209	-2.750485	0.0087
X8	0.474059	0.205659	2.305074	0.0262
X9	-0.156544	0.097554	-1.604692	0.1161
R-squared	0.473912	Mean dependent var		0.170337
Adjusted R-squared	0.411282	S.D. dependent var		0.080539
S.E. of regression	0.061796	Akaike info criterion		-2.613489
Sum squared resid	0.160387	Schwarz criterion		-2.379589
Log likelihood	68.72374	F-statistic		7.566905
Durbin-Watson stat	1.269501	Prob(F-statistic)		0.000039

Për të matur fuqinë shpjeguese të të gjithë treguesve të sqaruar më sipër përdorim koeficientin e determinacionit R^2 . Shikojmë nga tabela se koeficienti i determinacionit është 0.4739 që do të thotë se 47.39% e ndryshimeve që pëson norma e NPL shpjegohen nga treguesit e përzgjedhur ndërsa pjesa tjetër e ndryshimeve shpjegohet nga faktorë të tjerë që nuk janë përfshirë në model.

4.2- ANALIZA E REZULTATEVE TË MODELIT TË DYTË TË REGRESIONIT [ME VARIABLA DUMMY]

Në funksion të testimit të hipotezës bazë ndërtojmë një model të dytë regresioni i cili do të na ndihmojë të testojmë rëndësinë e secilës bankë të marrë në shqyrtim së bashku me treguesit e tjerë (matësit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale dhe efikasitetit) në shpjegimin e treguesit normës së NPL-së. Duke qenë se rëndësia e secilës bankë është një variabël cilësor, përdorim variablat dummy.

H_0 : Treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale, efikasitetit dhe rëndësia e secilës bankë të përfshirë në shqyrtim nuk e shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së.

H_1 : Treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale, efikasitetit dhe rëndësia e secilës bankë të përfshirë në shqyrtim shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së.

Për të testuar hipotezën e ngritur ndërtojmë funksionin e regresionit, ku variabël të varur kemi normën e NPL-së dhe variabla të pavarur treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale, efijencës dhe rëndësinë e secilës bankë të përfshirë në model.

$$X_{10} = 0.4577840799 - 6.049243404 \cdot X_1 + 2.74465006 \cdot X_2 - 0.576899171 \cdot X_5 + 0.3279941623 \cdot X_8 - 0.151360799 \cdot X_9 + 0.06694273541 \cdot D_2 - 0.04697258782 \cdot D_3 - 0.05491042432 \cdot D_4 + 0.1432285107 \cdot D_5 + \varepsilon$$

Rezultatet e modelit të regresionit paraqiten në *tabelën 4.2*. Duke qenë se numri i vrojtimeve është 48 mund të përdorim statistikën *t* për të testuar rëndësinë e treguesve, dhe statistikën *F* për të testuar rëndësinë e përgjithshme të regresionit të shumëfishtë.

Variablat e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale dhe efijencës janë statistikisht të rëndësishëm. Duke përdorur të njëjtat argumente si më sipër vlera *p* për secilin nga variablat është shumë e vogël respektivisht (0.0001, 0.0000001, 0.1628, 0.0911) kështu që hipoteza nul bie poshtë.

Treguesit e përfitueshmërisë: të përfaqësuar nga *kthimi nga aktivet* dhe *marzhi neto në interesa* janë të rëndësishëm dhe shfaqin shenja sipas pritshmërive. Konkretisht kthimi nga aktivet rezulton me koeficient -6.049243, që do të thotë se një rritje e këtij treguesi do të zvogëlojë normën e NPL-së me 6.049 herë. Marzhi neto në interesa ka koeficient 2.744650, që do të thotë se një rritje e marzhit neto në interesa do të rrisë normën e NPL-së.

Treguesi i likuiditetit i matur me raportin *kredi/depozita* shfaq shenjë negative dhe është i rëndësishëm. Përmirësimi i likuiditetit të bankës me 1 njësi do të zvogëlojë normën e NPL-së me 0.576899 herë.

Treguesi i mjaftueshmërisë kapitale shfaqet në regresion me koeficient 0.327994, që do të thotë se një rritje e raportit *Kapitali Total/Aktive të peshuara në rrezik* do të sjellë një rritje të normës së NPL-së përafërsisht me 0.33 herë.

Treguesi i efijencës rezulton me koeficient -0.151361, që do të thotë se një përmirësim i efijencës së bankës do të zvogëlojë normën e NPL-së me 0.151361 herë. Nga sa më sipër mund të themi se treguesi është i rëndësishëm dhe shfaqet me shenjën sipas pritshmërive.

Rëndësia e secilës bankë të cilën e kemi shprehur me variabla dummy paraqet në regresion 4 variabla. Variablat D_1 dhe D_6 që përfaqësojnë respektivisht rëndësinë e bankës BKT dhe Pro-Credit janë shfaqur të parëndësishëm në shpjegimin e normës së NPL-së. Bankat e tjera Credins (D_2), Intesa San Paolo(D_3), Raiffeisen (D_4) dhe Alpha Bank (D_5) kanë rëndësi në shpjegimin e ndryshimit të normës së NPL. Për të testuar rëndësinë e secilës prej variablave dummy përdorim statistikën *t*.

Variabli D_2 që mat rëndësinë e bankës Credins është statistikisht i rëndësishëm me besueshmëri 98.85%. Probabiliteti *p* i llogaritur është 0.0115, dhe kaq është mundësia që *t*-statistikore > *t*-kritike, pra i parëndësishëm. Hipoteza nul sipas të cilës rëndësia e bankës Credins nuk e shpjegon ndryshimin e normës së NPL bie poshtë. Rëndësia e Bankës Credins rezulton me koeficient 0.066943, që do të thotë se nëse bankat e tjera i shënojmë me 0 pra si

të parëndësishme norma e NPL-së do të rritet me 0.067 herë me ndikimin e vetëm të bankës Credins.

Variabli D_3 që mat rëndësinë e bankës Intesa San Paolo është statistikisht i rëndësishëm me besueshmëri 91.64%. Mund të themi se probabiliteti që t -statistikore $> t$ -kritike është 0.0836 pra pothuajse e parëndësishme. Sa thënë më sipër hipoteza nul sipas të cilës rëndësia e bankës Intesa San Paolo nuk e shpjegon ndryshimin e normës së NPL bie poshtë. Me ndikimin 0 të bankave të tjera dhe vetëm nën efektin e bankës Intesa San Paolo, norma e NPL-së do të zvogëlohet me 0.047 herë, pasi koeficienti është -0.046973.

Variabli D_4 që mat rëndësinë e bankës Raiffeisen është statistikisht i rëndësishëm me besueshmëri 93.76%. Probabiliteti p i llogaritur është 0.0624, dhe kaq është mundësia që t -statistikore $> t$ -kritike, pra i parëndësishëm. Hipoteza nul sipas të cilës rëndësia e bankës Raiffeisen nuk e shpjegon ndryshimin e normës së NPL bie poshtë. Rëndësia e bankës Raiffeisen shfaqet në regresion me koeficient -0.054910 që do të thotë se vetëm nën ndikimin e kësaj banke dhe kur bankat e tjera kanë ndikim 0 norma e NPL-së do të zvogëlohet me 0.055 herë.

Variabli D_5 që mat rëndësinë e bankës Alpha është statistikisht i rëndësishëm me besueshmëri 99.99%. Mund të themi se probabiliteti që t -statistikore $> t$ -kritike është 0.0001 pra pothuajse e parëndësishme. Sa thënë më sipër hipoteza nul sipas të cilës rëndësia e bankës Alpha nuk e shpjegon ndryshimin e normës së NPL bie poshtë. Me ndikimin 0 të bankave të tjera dhe vetëm nën ndikimin e bankës Alpha, norma e NPL-së do të rritet me 0.1432 herë, pasi koeficienti është 0.0143229. Krahësimisht me të gjitha bankat ndikimin më të rëndësishëm në ndryshimin e normës së NPL-së e jep banka Alpha.

Për të matur fuqinë shpjeguese të krejt treguesve të sqaruar më sipër përdorim koeficientin e determinacionit R^2 . Sikurse shihet në tabelë koeficienti i determinacionit është 0.7129. Kjo d.t.th., se 71.29% e ndryshimeve që pëson norma e NPL shpjegohen nga treguesit e përzgjedhur, ndërsa pjesa tjetër e ndryshimeve shpjegohet nga faktorë të tjerë që nuk janë përfshirë në model.

Përveç testimit të secilit variabël, testojmë edhe rëndësinë e përgjithshme të regresionit të shumëfishtë në terma të R^2 duke përdorur testin F . Shikojmë që probabiliteti i statistikës F është 0.00000002, që do të thotë se mundësia që të pranohet hipoteza nul është shumë e vogël, e papërfillshme. Përfundimisht themi se të gjithë variablat e regresionit të shumëfishtë janë statistikisht të rëndësishëm.

Tabela 4.2 Analiza e regresionit me variabla dummy

Dependent Variable: X10				
Method: Least Squares				
Sample: 1 48				
Included observations: 48				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	0.457784	0.092404	4.954141	0.0000
X1	-6.049243	1.355560	-4.462542	0.0001
X2	2.744650	0.529157	5.186835	0.0000
X5	-0.576899	0.090419	-6.380279	0.0000
X8	0.327994	0.230421	1.423457	0.1628
X9	-0.151361	0.087311	-1.733575	0.0911
D2	0.066943	0.025215	2.654929	0.0115
D3	-0.046973	0.026435	-1.776908	0.0836
D4	-0.054910	0.028604	-1.919670	0.0624
D5	0.143229	0.032510	4.405621	0.0001
R-squared	0.712980	Mean dependent var		0.170337
Adjusted R-squared	0.645001	S.D. dependent var		0.080539
S.E. of regression	0.047987	Akaike info criterion		-3.052738
Sum squared resid	0.087503	Schwarz criterion		-2.662905
Log likelihood	83.26572	F-statistic		10.48831
Durbin-Watson stat	1.574993	Prob(F-statistic)		0.000000

Nga sa më sipër pohojmë se bie poshtë hipoteza nul që bazohet në supozimin se ‘*treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit, mjaftueshmërisë kapitale, efijencës dhe rëndësia e secilës bankë të përfshirë në model nuk e shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së*’.

Të dy modelet alternative me dhe pa variabla dummy hodhën poshtë hipotezat nul sekondare.

Si përfundim bie poshtë hipoteza bazë nul sipas të cilës mbarëvajtja financiare e bankave krahasimisht me njëra tjetrën nuk mund të matet me normën e NPL-së.

Të dyja modelet na vërtetojnë se mbarëvajtjen financiare të bankave krahasimisht me njëra-tjetrën mund ta masim me normën e NPL-së duke qenë se kjo është përfaqësuesja e të 4 grupeve raporteve bazë (përfitueshmëri, likuiditet, mjaftueshmëri kapitale, efijencë) që përdoren për të normuar bankat.

Thënë ndryshe, këto raporte shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së, që do të thotë se përdorimi alternativ i cilitdo prej tyre për të normuar bankat do të rezultojë në përfundime të njëjta.

Si rrjedhojë bëjmë renditjen e bankave duke u nisur nga norma mesatare e NPL-së faktike dhe nga norma mesatare e NPL-së të parashikur nga modeli. Në tabelën 4.3 është paraqitur renditja e bankave bazuar në normën mesatare faktike të NPL-së. Banka me normën më të ulët të NPL-së renditet e para dhe me rritjen e normës së NPL-së përkeqësohet pozicioni i bankës. Sipas kësaj llogjike Banka Pro Credit renditet e para sepse mesatarja e normës së NPL-së për periudhën e marrë në studim 2009-2012 është 14.4%, më e ulta krahasimisht me të gjitha bankat e tjera. Më pas renditet Banka Raiffeisen me normën e NPL-së 15.3%.

E treta në renditje është banka Credins me normën mesatare të NPL-së 15.7%. Banka Intesa San Paolo renditet e katërta me normën mesatare të NPL-së 16.2%. E renditur në vendin e

pestë është banka BKT me normë mesatare të NPL-së 17.9% dhe e fundit është banka Alpha me normën mesatare më të lartë të NPL-së 22.9%.

Tabela 4.3 Renditja e bankave sipas vlerës mesatare të normës së NPL faktike

Bankat	Vlera mesatare e normës së NPL faktike	Devijimi standart	Renditja
Pro Credit	0.144	0.06346	1
Raiffeisen	0.153	0.024842	2
Credins	0.157	0.04982	3
Intesa San Paolo	0.162	0.098416	4
BKT	0.179	0.030284	5
Alpha	0.229	0.14285	6

Më tej, kemi llogaritur normën e parashikuar të NPL-së, dhe kemi gjetur mesataren për secilën bankë për 8 periudhat. Siç vërehet nga *tabela 4.4* norma mesatare e parashikuar e NPL-së është e njëjtë me normën mesatare faktike të saj, që do të thotë se renditja e bankave nuk ndryshon.

Tabela 4.4 Renditja e bankave sipas vlerës mesatare të normës së parashikuar të NPL

Bankat	Vlera mesatare e normës së parashikuar të NPL	Devijimi standart	Renditja
Pro Credit	0.14	0.049905	1
Raiffeisen	0.153	0.030165	2
Credins	0.157	0.0646	3
Intesa San Paolo	0.162	0.069066	4
BKT	0.179	0.022371	5
Alpha	0.229	0.111676	6

4.3- METODA ME MESATARE SHUMËPËRMASORE

Në funksion të testimit të hipotezës që i vjen në ndihmë pyetjes kërkimore bazë përdorim metodën e mesatares shumëpërmasore⁹⁹.

Në mënyrë të përmbledhur do paraqesim llogaritjet në tabelën 4.5 dhe në mënyrë të detajuar do ti gjeni në shtojcën B. Duke qenë se disa nga treguesit e përzgjedhur për normimin e bankave shfaqen me shenjë pozitive në normim ndërsa disa të tjerë me shenjë negative, treguesit i ndajmë në 2 grupe. Në grupin e parë përfshihen të gjithë ato tregues (X1, X2, X3, X4, X5, X6, X8) rritja e të cilave do të përmirësojë gjendjen financiare të bankave duke e pozicionuar atë më lartë, ndërsa në grupin e dytë kemi përfshirë ato variabla (X7, X9, X10) rritja e të cilave do të përkeqësojë gjendjen financiare të bankave duke ulur pozicionin e saj. Për secilën nga grupet e treguesve të secilës bankë është llogaritur mesatarja shumëpërmasore.

Fillimisht kemi renditur bankat duke u nisur nga grupi i parë i treguesve më pas renditja është bërë bazuar në grupin e dytë të treguesve. Kemi vijuar më tej me renditjen e bankave duke u bazuar në treguesin X10 (norma e NPL-së) të cilin e shikojmë si tregues shumë të rëndësishëm për normimin. Vihet re se ekzistojnë diferenca në renditjen e bankave për disa pozicione dhe në gjykimin tonë kjo ndodh pasi treguesit i kemi të ndarë në grupe dhe nuk po i rendisim duke i marrë për bazë të gjithë treguesit njëherësh. Për këtë arsye secilës mënyrë i vendosim një peshë dhe mbi këtë bazë bëjmë renditjen.

Tabela 4.5 Renditja e bankave sipas metodës Mesatare Shumëpërmasore

Banka	Mesatare shumëpërmasore			Renditja			
				1	2	3	4
	X1 -X8 pa X7	X7, X9, X10	X10	X1 -X8 pa X7	X7, X9, X10	X10	4=(0.3*1+0.3*2+0.4*3)
BKT	116.68	107.91	103.24	2	5	5	5
CRED	115.11	100.33	92.4	3	4	3	4
INT	110.51	88.66	94.98	4	1	4	3
RAIF	143.22	98.6	81.2	1	3	1	1
ALPHA	44.09	108.7	134.71	6	6	6	6
PROCR	70.37	95.78	84.71	5	2	2	2

Renditja në kolonën e parë është bërë duke u bazuar në treguesit me ndikim pozitiv mbi normimin. Banka me mesataren shumëpërmasore më të lartë të treguesve (X1-X8 pa X7) është banka Raiffeisen e cila renditet në vendin e parë me një diferencë të dukshme

⁹⁹ Sqarimi i metodës në kapitullin 3.6 fq.82

krahasimisht me të tjerat. Në vendin e dytë renditet banka BKT me diferencë shumë të vogël me bankën Credins e cila renditet e treta. Banka Intesa San Paolo renditet e katërta dhe me një diferencë të madhe me të renditet në vendin e pestë banka Pro Credit dhe në vendin e fundit renditet banka Alpha.

Renditja në kolonën e dytë është bërë duke u bazuar në treguesit me ndikim negativ në normim. Banka me mesataren shumëpërmasore më të ulët të treguesve (X7, X9, X10) është banka Intesa e cila renditet e para, më pas me diferencë të vogël renditet banka Pro Credit. Në vendin e tretë pozicionohet banka Raiffeisen dhe me diferencë shumë të vogël në vendin e katërt renditet banka Credins. Në vendin e pestë është banka BKT dhe në vendin e fundit banka Alpha.

Vihet re se në renditjen e bërë duke u bazuar në treguesit me ndikim negativ në normim, ka një diferencë shumë të vogël nga njëri pozicion në tjetrin, ndërsa në renditjen sipas treguesve me ndikim pozitiv në normim diferencat nga një pozicion në tjetrin janë të mëdha.

Në kolonën e tretë renditja është bërë duke marrë për bazë treguesin X10 i cili ka lidhje funksionale negative me normimin. Banka me mesataren shumëpërmasore më të ulët të këtij treguesi renditet e para e kështu me rradhë. Konkreisht e para renditet banka Raiffeisen dhe me një diferencë të vogël ndiqet nga banka Pro Credit. Në vendin e tretë renditet banka Credins dhe në vendin e katërt banka Intesa San Paolo. Banka BKT renditet e pesta dhe me një diferencë shumë të madhe renditet e fundit banka Alpha.

Së fundmi në kolonën e katërt rendisim bankat duke marrë për bazë të gjithë faktorët. Kështu renditjes sipas faktorëve me ndikim pozitiv i japim peshën 30%, renditjes sipas faktorëve me ndikim negativ i japim peshën 30% dhe renditjes sipas X10 i japim peshën 40%. Sipas kësaj rëndese në peshë të faktorëve, rezulton se e para renditet banka Raiffeisen e më pas banka Pro Credit. Në vendin e tretë dhe të katërt renditen respektivisht Intesa San Paolo dhe Credins, dhe në vendin e pestë banka BKT. E fundit në renditje është banka Alpha.

Deri tani kemi renditur bankat duke përdorur dy metoda, në modelim ekonometrik dhe në përpunim statistikor të të dhënave. Renditja sipas dy metodave paraqitet në *tabelën 4.6.* ku vërehen diferenca të vogla në renditje. Banka Alpha dhe banka BKT me të dyja metodat renditen respektivisht në vendin e gjashtë dhe të pestë. Banka Credins sipas modelit ekonometrik renditet e treta dhe sipas metodës së mesatares shumëpërmasore renditet e katërta. Ndërsa banka Intesa sipas modelit ekonometrik renditet e katërta dhe sipas metodës së mesatares shumëpërmasore renditet e treta. Duhet theksuar se diferencat nga njëri pozicionin në tjetrin në renditje midis bankave sipas modelit ekonometrik janë të vogla. Me të njëjtën mënyrë banka Raiffeisen sipas modelit ekonometrik renditet e dyta dhe sipas metodës së mesatares shumëpërmasore renditet e para duke këmbyer pozicionet me bankën Pro Credit.

Tabela 4.6 Krahasimi i renditjes sipas dy metodave

Banka	Renditja	
	Mesatare shumëpërmasore	Modeli ekonometrik
BKT	5	5
CRED	4	3
INT	3	4
RAIF	1	2
ALPHA	6	6
PROCR	2	1

4.4- RACIONALJA NË NORMIMIN E BANKAVE

Në kapitullin 3 sqaruar se për të bërë normimin e bankave, kompanitë më të mëdha normuese pajtohen për faktin se banka nuk mund të normohet më lartë se vendi në të cilin ajo operon. Edhe në modelin tonë pranohet një kriter i tillë që motivon për të korrigjuar nivelin e normimit për specifikat që bankat kanë në mjedisin e Shqipërisë. Komponentët kryesor të modelit (modelimi ekonometrik dhe mesatarja shumëpërmasore) janë të domosdoshëm por nuk e ezaurojnë normimin në versionin përfundimtar të tij. Nga ana tjetër, ne kemi dy grupime bankash, ato që e tejkalojnë nivelin normues të vendit dhe grupi tjetër që është më poshtë se vendi.

Në këto kushte nëse do të përcaktonim disa nivele normuese, një pjesë e bankave në Shqipëri nuk do të renditeshin më lartë se `bb`, ndërsa disa të tjera rezultojnë nën `bb`. Kjo për faktin se vetë vendi në të cilën operojnë këto banka është e normuar `b+`. Vështirimi alternativ për të përfshirë në normim mbështetjen nga qeveria, krijon kundërti që bazohet në pyetjen e hapur nëse ka mundësi një qeveri e normuar për nivel `b+` të ketë gjasa reale të mbështesë një bankë me nivel normues më të lartë. Në Shqipëri kjo kundërti merr vlera shumë domethënëse aq sa nuk bëhet fjalë realisht për mbështetje sepse p.sh., RBAL ka mbi 30% të financimit buxhetor të qeverisë së Shqipërisë, që d.t.th., se dëshira e qeverisë shqiptare për të mbështetur RBAL është e padiskutueshme pozitive, por mundësia financiare për të realizuar këtë është krejtësisht negative. Kështu e vetmja alternativë mbështetëse për një bankë analoge në fjalë është vetëm nëse mbështetet nga institucionet shumëpalëshe p.sh., FMN ku propozimi kërkon inisiativë dhe miratim të vetë qeverisë shqiptare. Që FMN të endorsojë një mbështetje financiare kërkon kushtet e respektimit të programit financiar nga ana e qeverisë, gjë që për qeveritë dhe politikat e paqëndrueshme ekonomike dhe fiskale të tyre në vendet në zhvillim krijon një rreth vicioz.

Kështu që racionalja në normim vazhdon me faktin se sa mbështetje financiare nga qeveria mund të marrë banka. Siç edhe kemi sqaruar në kapitullin 2 sjellja e paqëndrueshme

ndaj politikave fiskale, nga taksë progresive për periudhën 1992-2005, në politikën e taksës së sheshtë për periudhën 2006-2013 dhe duke u rikthyer edhe njëherë në taksën progresive për 2014-, krijon prirje që mundësia e qeverisë shqiptare për të financuar bankat të jetë thujse zero. Në Shqipëri bankat nuk mund të marrin mbështetje nga qeveria.

Deri në këtë fazë bankat operuese në Shqipëri ndodhen të gjitha në të njëjtin pozicion normues.

Për të përcaktuar pozicionin e tyre përfundimtar do të bazohemi në fuqinë financiare të secilës prej tyre. Përveç treguesve financiarë që kemi marrë në shqyrtim për normimin e bankave kemi ndaluar edhe në disa tregues të tjerë të cilët i shikojmë si shumë të rëndësishëm në kushtet e një mjedisi të paqëndrueshëm dhe një tregu të shformuar bankar. Më gjerësisht për karakteristikat e mjedisit bankar Shqiptar është folur në kapitullin 3. Për këto arsye shikojmë të nevojshme që renditjen që i kemi bërë bankave duke u bazuar vetëm në treguesit financiar ta rregullojmë bazuar edhe në faktorët e tjerë të marrë në konsideratë. Si faktorë të rëndësishëm kemi konsideruar qendrueshmërinë e fitimeve të cilën e masim me koeficientin e variacionit dhe indeksin Z si matës i riskut të biznesit. Moody's dhe S&P i caktojnë një peshë të rëndësishme indeksit Z për normimin e bankave. Kemi analizuar secilën nga bankat me qëllim matjen e shëndetit financiar dhe normimin.

4.4.1 Përqendrimi i tregut bankar

Fillimisht kemi llogaritur indeksin Herfindahl-Hirschman (HHI) për të parë përqendrimin e tregut bankar. Këtë indeks e kemi llogaritur për depozitat, aktivet dhe kreditë duke marrë për bazë totalin e tyre, për 6 bankat e marra në shqyrtim.

Tabela 4.7 Indeksi HHI për depozitat

Banka	Depozita	Dep/Totalit	(Dep/Tot) ²
Raiffeisen	260'597'003'000	0.38	0.15
BKT	155'807'088'300	0.23	0.05
Alpha	59'635'450'806	0.09	0.01
Procredit	34'138'692'403	0.05	0.00
Credins	63'058'049'917	0.09	0.01
Intesa	105'064'945'236	0.15	0.02
Totali	678'301'229'662	HHI	0.24

Nga tabela 4.7 dhe 4.8 vërehet që banka Raiffeisen zotëron 38% të totalit të depozitave dhe aktiveve të të 6 bankave të marra në shqyrtim, banka BKT zotëron 23% të depozitave dhe 22 % të aktiveve ndjekur nga banka Intesa me 15% të depozitave dhe 16% të aktiveve. Të treja këto banka zotërojnë 76% të depozitave dhe aktiveve. Indeksi HHI merr vlera nga 0 në 1. Në SHBA është indeksi orientues i Departamentit të Drejtësisë (*Department of Justice*) për të vlerësuar shkallën e përqendrimit të tregut në pak banka [firma]. P.sh., një indeks mbi 1800

lexohet si nivel i lartë i përqendrimit të tregut¹⁰⁰. Prandaj në rastin tonë tregu bankar si për depozitat edhe për kreditë duhet konsideruar shumë i koncentruar.

Tabela 4.8 Indeksi HHI për aktivet

Banka	Aktive	Aktive/Totalit	(Aktive/Totalit) ²
Raiffeisen	287'972'284'000	0.38	0.14
BKT	172'143'418'300	0.22	0.05
Alpha	69'261'548'117	0.09	0.01
Procredit	39'825'788'623	0.05	0.00
Credins	71'453'844'119	0.09	0.01
Intesa	124'724'315'921	0.16	0.03
Totali	765'381'199'080	HHI	0.24

Indeksi i përqendrimit të tregut për kreditë është 0.20, që tregon përsëri për një treg të përqëndruar. Banka Raiffeisen zotëron 31% të totalit të portofolit të kredive të 6 bankave të marra në studim ndërsa BKT dhe Intesa respektivisht 21% dhe 14%. Këto 3 banka zotërojnë 66% të totalit të kredive të dhëna nga këto banka.

Tabela 4.9 Indeksi HHI për kreditë

Banka	Kredi	Kredi/Totalit	(Kredi/Totalit) ²
Raiffeisen	109'138'314'000	0.31	0.10
BKT	73'711'506'700	0.21	0.04
Alpha	44'916'766'570	0.13	0.02
Procredit	23'599'221'388	0.07	0.00
Credins	45'929'068'723	0.13	0.02
Intesa	50'271'411'530	0.14	0.02
Totali	347'566'288'911	HHI	0.20

Indeksin e kemi llogaritur më gjerësisht edhe për depozitat, për aktivet e për kreditë duke marrë për bazë të gjithë industrinë bankare. Llogaritjet përmbahen në tabelat 4.10, 4.11 dhe 4.12. Për krejt industrinë bankare, indeksi HHI për depozitat është 0.11. Raiffeisen zotëron 26% të totalit të depozitave të sistemit bankar, BKT zotëron 16% dhe Intesa San Paolo 11% të totalit të depozitave. Të treja së bashku zotërojnë 53%. Indeksi HHI duke marrë për bazë kreditë rezulton 0.08. Raiffeisen zotëron 19% të totalit të kredive, BKT dhe Intesa zotërojnë respektivisht 13% dhe 9%.

Këto të dhëna pasqyrojnë në fakt një industri dhe treg të shformuar bankar ku konkurojnë 16 banka dhe vetëm 3 prej tyre zotërojnë 53% të depozitave dhe 42% të kredive të totalit të tregut. Gjithashtu edhe në analizën e strukturës së deficitit buxhetor, po këto tre banka financojnë monetizimin e borxhit qeveritar për 60%, që do të thotë se këto krijojnë

¹⁰⁰ Hoti, I. (2001), Fjalor enciklopedik trigjuhësh, anglisht, italisht, shqip për bankën, biznesin, ekonominë etj.

varësi të lartë të qeverisë duke përqendruar rrezikun Sovran. E thënë ndryshe nëse ndonjëra prej tyre refuzon financimin e qeverisë kjo krijon impakt dhe hazard moral të lartë drejt një rreziku sistemik që shkon deri në kontrollin e sjelljes së qeverisë dhe të institucioneve që varen prej saj.

Kjo na bën të rishikojmë dhe të peshojmë në kushtet specifike të Shqipërisë përcaktorin e mbështetjes financiare që qeveria mund të ofrojë për bankat për të cilin të tre agjensitë e normimit pajtohen të marrin në konsideratë.

Në mjedisin e industrisë bankare ka pengesa dhe kundërti që rrisin deri në fiktivitet praninë dhe veprimin real të mbështetjes nga qeveria. Shkurt a mundet qeveria Shqiptare që të mbështesë bankat e tjera jashtë 4 bankave që e ushqejnë me 70-80% financim. Kjo d.t.th., se të gjitha bankat jashtë këtij grupi nuk e përfitojnë këtë mbështetje. Nëse futemi dhe analizojmë bankat e grupit, përsëri do shohim se qeveria shqiptare nuk ka lëndë financiare të mbështesë, por vetëm mund të endorsojë çdo mbështetje potenciale nga FMN. Pa dashur ta ripërsërisim këtë argument që e kemi cekur dhe trajtuar në çështjet pararendëse, ne grupojmë këto prag pamundësish për mbështetje qeveritare:

a) Gjendja financiare e qeverisë (Deficiti buxhetor dhe Borxhi publik) nuk është - optimiste për të përballuar një financim ndaj bankës apo bankave me problem.

b) Sjellja e qeverisë mund të orientohet më shumë nga preferencat duke favorizuar më shumë bankën që e ka financuar më shumë dhe e kundërta. Kjo shmang kriterin racional të financimit sipas meritës financuese të bankave.

c) Bankat duke vlerësuar se kanë marrëdhënie të mira nga financimet që i kanë bërë qeverisë mund të implikohen në hazardin moral se edhe po patën probleme e marrin për fakt të kryer mbështetjen financiare nga qeveria në një skenar rënës të biznesit të tyre.

d) Qeveria është aksionari kryesor i Agjensisë së Sigurimit të Depozitave, duke qenë se niveli i sigurimit të depozitave është i ulët (2 500 000 ALL) dhe fakti se bankat janë në mbi 98% në pronësi të huaj, mund të ekspozojë hazardin moral që bankat të perceptojnë kosto të ulët falimentimi ndaj përfitimeve që mund të kenë.

e) Fakti se banka që e ka financuar më shumë është edhe banka më e preferuar për t'i ofruar financim mbështetës. Në këtë mënyrë zgjedhja rationale se cila bankë duhet financuar kërcënohet nga rreziku që qeveria të vendosë financimin për bankën me të cilën ka më shumë interes marrëdhëniesh.

f) Bankat kanë edhe dukurinë e zinxhirit të koncentrimin, sepse pak depozitues kanë mbi 85% të depozitave. Kjo ekspozon varësinë e bankës nga depozituesit. Në Shqipëri varësia e Bankave nga shoqëritë e sigurimeve ka çënuar lirinë e tregut dhe zhduk rolin e ndërmjetësuesit në sigurime (*broker*), sepse bankat de facto nuk pranojnë të sigurohen nga cilado shoqëri siguri, por pranojnë sigurim vetëm nga shoqëria që zotohet të mos i transferojë gjatë depozitat¹⁰¹.

Prandaj është shumë e nevojshme që të normohen dhe të përcaktohet pozita dhe fuqia e tyre financiare më vehte.

¹⁰¹ Ilir Hoti, Francesco Scalera "Bank Asymmetric Behavior on Insurance Agencies and Insurance Brokerage-Context of Albania" –Symposium -UNIQA Group, Wien –IFIBI 2012.

Tabela 4.10 Indeksi HHI për depozitat/totalit të tregut

Banka	Depozita	Dep/Dep tot	(Dep/Tot) ²
Raiffeisen	260'597'003'000	0.26	0.07
BKT	155'807'088'300	0.16	0.02
Alpha	59'635'450'806	0.06	0.00
Procredit	34'138'692'403	0.03	0.00
Credins	63'058'049'917	0.06	0.00
Intesa	105'064'945'236	0.11	0.01
Totali	992'279'768'635	HHI	0.11

Tabela 4.11 Indeksi HHI për kreditë/totalit të tregut

Banka	Kredi	Kredi/Totalit	(Kredi/Totalit) ²
Raiffeisen	109'138'314'000	0.19	0.04
BKT	73'711'506'700	0.13	0.02
Alpha	44'916'766'570	0.08	0.01
Procredit	23'599'221'388	0.04	0.00
Credins	45'929'068'723	0.08	0.01
Intesa	50'271'411'530	0.09	0.01
Totali	570'666'480'773	HHI	0.08

Tabela 4.12 Indeksi HHI për aktivet/totalit të tregut

Banka	Aktive	Aktive/Totalit	(Aktive/Totalit) ²
Raiffeisen	287972284000.00	0.24	0.06
BKT	172143418300.00	0.14	0.02
Alpha	69261548117.00	0.06	0.00
Procredit	39825788623.00	0.03	0.00
Credins	71453844119.00	0.06	0.00
Intesa	124724315921.00	0.10	0.01
Totali	1218229334491.00	HHI	0.09


4.4.2 Pozita në biznes

Për secilën nga bankat e përfshira në studim do të analizojmë kompozimin e aktivitetit, numrin e degëve, numrin e punonjësve dhe prirjen ndër vite, qëndrueshmërinë e fitimeve dhe riskun e biznesit.

1. Analiza e përpjesës së tregut duke u bazuar në numrin e degëve.


Nga studimi i tregut vërejmë se banka Raiffeisen ka numrin më të madh të degëve krahasimisht me bankat e tjera dhe në të njëjtën kohë këtë numër e ka më të qëndrueshëm në vite. Për periudhën 2009-2012 ajo ka 31% të degëve totale të të gjitha bankave. Siç shikohet edhe në grafikët 4.1, 4.2, 4.3, 4.4 banka BKT nga viti 2009 deri në vitin 2012 ka rritur numrin e degëve duke zotëruar 25% të degëve totale të të gjithë tregut. Madje e ka diversifikuar më tej portofolin duke hapur degë edhe në Kosovë. Banka Alpha është edhe më pak e qëndrueshme pasi ka pasur një ndryshim të numrit të degëve në këto vite duke zvogëluar përpjesën e tregut në numër degësh nga 14% në 8%. Rënia e numrit të degëve në këto vite është rezultat i një situatë financiare jo të mirë për bankën. Në këto vite banka është me humbje financiare dhe me nivel të NPL shumë të lartë. Ndërkohë që bankat e tjera janë të qëndrueshme me disa luhaje të lehta. Intesa dhe Pro credit kanë zvogëluar numrin e degëve në këtë periudhë. Të gjitha bankat kanë një numër të madh degësh dhe mbulojnë pothuajse të gjithë territorin e vendit. Qëllimi i diversifikimit pra i rritjes së numrit të degëve dhe shtrirjes gjeografike duhet të jetë rritje e vëllimit të të ardhurave dhe fitimeve. Diversifikimi i suksesshëm dhe i vazhdueshëm e drejton bankën drejt një pozite më të fortë në biznes. Por nëse banka diversifikohet duke rritur gamën e produkteve apo të degëve në mungesë të ekspertëve/punonjësve të specializuar, atëherë pozita e saj në biznes dobësohet. Në vendin tonë degët e bankave janë më të përhapura se sa janë nevojat reale në treg. Për më tepër bankat duke dashur të konkurrojnë me njëra tjetrën aty ku njëra bankë hap një degë të re, të njëjtën gjë bëjnë edhe të tjerat. Kjo bën që ato të çenojnë biznesin e njëra-tjetrës e më tej akoma të kenë degë të cilat nuk janë fitimprurëse. Duke marrë në konsideratë diversifikimin në shtrirje gjeografike pozitën më të fortë në biznes e kanë bankat Raiffeisen dhe BKT.

Grafiku 4.1 Përpjesa e tregut në numër degësh në vitin 2009




Burimi: Përlllogaritje të autorit, Raportet vjetore të Bankave

Grafiku 4.2 Përpjesa e tregut në numër degësh në vitin 2010




Burimi: Përlllogaritje të autorit, Raportet vjetore të Bankave

Grafiku 4.3 Përpjesa e tregut në numër degësh në vitin 2011



Burimi: Përlllogaritje të autorit, Raportet vjetore të Bankave

Grafiku 4.4 Përpjesa e tregut në numër degësh në vitin 2012




Burimi: Përlllogaritje të autorit, Raportet vjetore të Bankave

2. Analiza e kompozimit të aktiveve

Nga analiza e pasqyrave financiare vihet re se bankat nuk e luajnë funksionin dhe rolin që duhet të kenë si banka tregtare pra të japin kredi dhe të marrin depozita. Për këtë arsye u ndalëm për të parë kompozimin e aktiveve për secilën nga bankat që kemi marrë në shqyrtim. Siç shihet nga *grafiku 4.5* në bankën Raiffeisen peshën më të madhe të aktiveve në vitin 2009 e zënë investimet me 51.23% ndaj totalit të aktivitetit ndërkohë që pesha që zënë kreditë është 34.88%. Investimet banka i ka bërë në Bono thesari dhe obligacione të emetuara nga qeveria pra është financuese e borxhit qeveritar duke kërkuar zotërime pa rrezik (RF). Nga viti 2009 deri në vitin 2012 vihet re një rënie e peshës së investimeve në 38.46% dhe një rritje e lehtë e raportit të kredive ndaj totalit të aktiveve në 39.06%. Zgjedhja që bën banka që të investojë në letra me vlerë në vend që të japë kredi çënon fitimshmërinë e bankës sepse të ardhurat nga interesat e kredive janë shumë më të larta se të ardhurat nga interesat e obligacioneve apo të bonove të thesarit. Çënohen më tej aksionerët të cilët me normën e kërkuar të shlyerjes synojnë maksimizimin e pasurisë së tyre, e në fakt në politikën e ndjekur nga banka nuk e realizojnë atë.

Marzhi neto në interesa i bankës zvogëlohet dhe banka ndjek politikën e uljes së normave të interesit të depozitave. Në fakt normat e interesit të depozitave nga Banka janë ulur shumë thuajse 6-8 herë më pak se normat e interesit të depozitave të bankave konkurente në treg. Kjo tregon edhe për pozitën dominuese që ka në treg banka Raiffeisen. Depozituesit janë të prekur nga kjo politikë pasi rezultojnë në përfundim të maturimit të depozitës me fuqi blerëse rënëse. Të gjitha këto janë rezultate të keqmenaxhimit të aktiveve dhe çënimit të rolit kryesor të bankës tregtare.


Grafiku 4.5 Kompozimi i aktiveve për bankën Raiffeisen



Burimi: Përlllogaritje të autorit, Raportet vjetore të Bankave

Krahasimisht me bankën Raiffeisen banka BKT ka një nivel më të lartë të peshës së kredive ndaj aktiveve krahasimisht me peshën e investimeve ndaj aktiveve. Peshë e kredive ndaj totalit të aktiveve në vitin 2009 ishte 40.28% ndërsa investimet zinin 37.32% të totalit të aktiveve. Nga viti 2009-2011 pati një rritje të peshës së kredive dhe një rënie të peshës së investimeve ndaj totalit të aktiveve. Kjo është rezultat i një rritje të kredive disa herë më shumë se rritja e investimeve. Në vitin 2012 siç shikohet edhe nga *grafiku 4.6* është rritur peshë që zënë investimet ndaj totalit të aktiveve dhe ka rënë peshë e kredive ndaj totalit të aktiveve. Kjo është rezultat i rritjes së financimit të borxhit të qeverisë, dhe rishikimit të politikave kredituese (shtrëngimit të tyre) për shkak të rritjes në këto 4 vite në mënyrë të menjëhershme të kredive që nuk performojnë mirë.


Grafiku 4.6 Kompozimi i aktiveve për bankën BKT



Burimi: Përlllogaritje të autorit, Raportet vjetore të Bankave

Banka Alpha ka nivelin më të lartë të peshës së kredive ndaj totalit të aktiveve krahasimisht me bankat e tjera. Në vitin 2009 kjo peshë ishte 71.93% ndërsa pesha e investimeve ndaj totalit të aktiveve ishte 11.65%. Me të njëjtin ritëm vazhdoi edhe në vitin pasardhës, ndërsa në vitin 2011 e në vazhdim vihet re një rënie e menjëhershme e peshës së kredive ndaj aktiveve totale në 49.68% dhe një rritje e peshës së investimeve ndaj aktiveve në 35.51%. kjo tregon për një rënie të kredive dhe jo vetëm si rezultat i shtrëngimit të kredidhënies por edhe si rezultat i nivelit shumë të lartë të kredive që performojnë keq. Banka Alpha ka nivelin më të lartë të NPL krahasimisht me të gjitha bankat e tjera. Gjatë këtyre viteve banka ka rezultuar me humbje financiare.


Grafiku 4.7 Kompozimi i aktiveve për bankën Alpha



Burimi: Përlllogaritje të autorit, Raportet vjetore të Bankave

Banka Pro Credit ka nivel të qendrueshëm të raportit kredi ndaj totalit të aktiveve dhe në të njëjtën kohë pesha që zënë investimet në aktivet e bankës ka pësuar rënie. Investimet e bëra në letra me vlerë nga Procredit përfshijnë letra me vlerë qeveritare të emetuar nga shteti shqiptar dhe obligacione të normuara të tipit AAA nga Fitch apo nga S&P. Banka Pro credit ka një menaxhim më të mirë të aktiveve duke ruajtur një raport të pranueshëm të kredive dhe investimeve.


Grafiku 4.8 Kompozimi i aktiveve për bankën Pro Credit



Burimi: Përlllogaritje të autorit, Raportet vjetore të Bankave

Në të njëjtën linjë si Pro Credit banka Credins gjatë katër viteve ka një raport të kredive ndaj totalit të aktiveve mesatarisht 65%, ndërsa investimet me luhatje të vogla zënë 7.6% të totalit të aktiveve. Banka ka parametra të qëndrueshëm dhe kryen funksionin e saj si bankë tregtare.


Grafiku 4.9 Kompozimi i aktiveve për bankën Credins



Burimi: Përlllogaritje të autorit, Raportet vjetore të Bankave

Banka Intesa San Paolo gjatë vitit 2009 ka pasur një nivel pak më të lartë të kredive ndaj totalit të aktiveve në krahasim me investimet. Megjithatë pesha që zënë kreditë ndaj aktiveve ka pësuar rënie ndërsa pesha e investimeve ndaj aktiveve pothuajse nuk ka ndryshuar ndër vite, derisa në vitin 2010 pesha e kredive në krahasim me atë të investimeve ka pësuar rënie. Në krahasim me bankat e tjera mund të themi se pesha e kredive është e ulët dhe bankës i humbet roli i saj si bankë tregtare.

Grafiku 4.10 Kompozimi i aktiveve për bankën Intesa San Paolo



Burimi: Përlllogaritje të autorit, Raportet vjetore të Bankave

Si përfundim nga analiza e bërë mund të themi se bankat në të cilat peshën më madhe të aktivitetit e zënë investimet dhe kryesisht investime në letra me vlerë të emetuara nga shteti Shqiptar nuk mund të jenë të normuara shumë më lartë se `b<sup>+</sup>`, duke qenë se siguria që i është dhënë vendit nga kompanitë normuese Moody's dhe S&P është `b<sup>+</sup>`. Shikojmë që Raiffeisen, BKT, Intesa San Paolo dhe më pak Alpha i kanë pothuajse të gjitha investimet në bono thesare dhe obligacione të emetuara nga shteti Shqiptar. Në kushtet kur rreth 40% e aktiveve të bankave janë investime në këto tituj atëhere ato kanë rrezik të ngjashëm me vendin.

3. Analiza e përpjesës së tregut duke u bazuar në numrin e punonjësve.

Kur analizuar përpjesën e tregut për numrin e degëve theksuar se diversifikimi është i rëndësishëm dhe forcon pozitën në biznes të bankës por kur mbështetet nga staf i qendrueshmën dhe i kualifikuar. Nga grafikët 4.11, 4.12, 4.13, 4.14 vërehet se bankat kanë të qendrueshëm numrin e punonjësve ndër vite me diferenca për disa banka. Banka Pro Credit ka zvogëluar numrin e punonjësve nga viti 2010 në vazhdim. Luhatshmëri në përpjesën e tregut për numër punonjësish shfaq edhe banka Credins.

Bankat për këtë periudhë kanë përjetuar një qarkullim të lartë të stafit të departamentit të kredisë dhe të riskut. Kjo më e theksuar gjatë 2008-2011 dhe ka pësuar rënie në 2012. Mesatarisht në çdo bankë, çdo punonjës krediti ka një përvojë pune me një apo dy banka të tjera.


Nga një studim i bërë¹⁰², niveli më i lartë i qarkullimit të stafit ka qenë më i lartë fillimisht tek FEFAD drejt RBAL, nga BKT drejt RBAL, nga RBAL drejt Emporiki dhe Procredit, etj. Tipike janë p.sh. ikjet nga BKT tek RBAL, nga BKT tek Intesa, nga BKT tek NBG. Ndërkohë që hyrjet e stafit në BKT për periudhën 2008-2009 janë kryesisht nga Universitetet.

Për çdo njësi stafi të ri nga Universitetet, është rritur shumë edhe rritja e refuzimit të dosjeve, sidomos për RBAL dhe BKT.

Nëse krahasojmë këto dy banka vërehet se RBAL ka pasur qarkullim më të lartë të stafit *senior*, ndërsa BKT të stafit *middle*. 75-80% e lëvizjeve janë të fokusuara në dy departamente [të Kredisë dhe Riskut], 15% e lëvizjeve të stafit janë për *front office* dhe vetëm 1% e lëvizjeve janë për departamente të burimeve njerëzore.


¹⁰² Hoti, I, Përjasje të Reja në Doktrinën e Identifikimit, të Vlerësimit dhe të Kontrollit të Rrezikut Sistemik dhe Specifik në Industrinë Bankare të Shqipërisë, Phd Dissertacion. UBT, Shqipëri, 2012.

Grafiku 4.11 Përpjesa e tregut për numrin e punonjësve në vitin 2009



Burimi: Përlllogaritje të autorit, Raportet vjetore të Bankave

Grafiku 4.12 Përpjesa e tregut për numrin e punonjësve në vitin 2010



Burimi: Përlllogaritje të autorit, Raportet vjetore të Bankave

Nga ana tjetër cilësia e refuzimeve të aplikimeve për kredi është goditur, sepse mbajtja e një qendrimi mohues nga 13% e dosjeve në 36% të tyre (rreth 3 herë më shumë) d.t.th., se brenda punonjësve përjetohet një shkallë më e lartë pasigurie subjektive e që është bazë për gabime të tipit false pozitiv, pra kur mund të refuzohet një kërkesë kredie që duhej të ishte miratuar. Ky qendrim del jashtë nivelit mesatar të rrezikut që duhet të ndërmarë banka, duke krijuar tipin e bankierit *risk averse* që punon ‘për të qenë brenda’. Ndërkohë bankat kanë investuar në trajnime për rrezikun operacional [pas vitit 2010], për produktet e kredisë dhe përsëri ndërkohë ka rritje të cilësisë së informacionit kontabël. Kjo d.t.th., se shumë shpejt në banka do të raportohet konflikti themelor-agjent, apo konflikti ndërmjet palëve aksionare që kërkojnë maksimizim fitimi dhe drejtuesve të bankës që kërkojnë maksimizim të pagës apo të

shpërblimit të tyre¹⁰³. Ky konflikt vërehet edhe me faktin se bankat kanë ulur përpjekjet për të investuar në rrezik dhe mjaftohen që pjesën më të madhe të portofolit ta investojnë në Bono Thesari që konsiderohen pa rrezik.

Ky skenar shtron pyetjen, a i duhet aksionarëve një staf banke për të investuar në bono thesari, ndërkohë që mund ta bëjnë vetë atë?!

Duke parë standardet e kreditimit, dosjet e refuzuara nga individë janë gati 2 herë më të ulta se sa dosjet e refuzuara nga bizneset. Ky skenar argumenton atë pararendës, që d.t.th., se bankat perceptojnë më shumë rrezik tek bizneset se sa tek individët. Sipas doktrinë së strukturës së rrezikut bazuar në afatin e kredive (*term structure of risk*) bankierët priren të miratojnë për 1,6 herë më shumë kredi afatshkurtër (< 1 vit) se sa kredi afat gjatë nga 1-5 vjet, por nga ana tjetër miratojnë gjithashtu më lehtë edhe kredi afat gjatë p.sh. për shtëpi mbi 10 vjet.

11% norma e refuzimit të aplikimeve nga PI	12% norma e refuzimit të aplikimeve nga PI	14% norma e refuzimit të aplikimeve nga PI	12% norma e refuzimit të aplikimeve nga PI	14% norma e refuzimit të aplikimeve nga PI
--	--	--	--	--

Ky formon një hazard moral, sepse punonjësi i kreditit duke përjetuar përkohësinë në bankë, kur është në rolin brenda njësisë së gjenerimit të rrezikut (*risk originating unit*) miraton lehtë kredi shumë afatgjatë, sepse e sheh veten të transferuar nga banka, ndërkohë që nuk miraton kredi afat-mesëm sepse e ndjen ashpër përgjegjësinë e rrezikut të karrierës së tij. Edhe ky është përsëri ***problem themelor-agjent***.


Disa banka si BKT, RBAL, etj kanë reaguar duke korigjuar kontratat e punës, ndonëse ka vend shumë për ta rishikuar në dritën e këtyre skenareve. Arsyeja që RBAL ka pushuar apo hequr staf senior lidhet edhe me faktin se është banka që ka pësuar humbjet më të ashpra në njësi klienti p.sh. birra Norga për 10 milion Euro. E njëjta gjë vërehet edhe tek bankat e vogla p.sh., tek Banka Veneto, NBG, ku niveli i dosjeve në përpunim gjyqësor ka nivelin më të lartë.

Duke ju referuar grafikut, shohim se ashpërsia e standardeve të kreditimit në banka nis më 2009, kur bankat reflektun nga informacioni kontabël i strukturës në rrezik të kredive. Në këtë vit ndodhën migrimet më të mëdha nga ‘kreditë standard’ në kreditë ‘nën standard’ dhe në ‘të dyshimta’, por në vitet vijuese migrimi i kredive spikat në rrjedhën nga kredi ‘të dyshimta’ në kredi ‘me humbje’ dhe nga këto në write off apo shitje kolaterali. Paralel me konservatizmin bankar në shtrëngimin e standardeve të kreditimit, ka ndodhur edhe ulja e kërkesës për kredi. Kjo krijon atë që njihet si ‘bllokimi i kredive’ (*credit crunch*).

Ky skenar nxjerr dobësi të departamentit të rrezikut, që nuk ka marrë në konsideratë diversifikimin nëpërmjet kundërciklikës, sepse ka bërë të kundërtën, ka forcuar standardet kur bie kërkesa për kredi. Kjo përsëri të rikthen tek kufizimet profesionale të punonjësve të departamenteve përgjegjëse.

¹⁰³ Moody's Investors Service, 2003. *Moody's Analytical Framework for Operational Risk Management of Banks*. London.

Grafiku 4.13 Përpjesa e tregut për numrin e punonjësve në vitin 2011



Burimi: Përlllogaritje të autorit, Raportet vjetore të Bankave

Grafiku 4.14 Përpjesa e tregut për numrin e punonjësve në vitin 2012



Burimi: Përlllogaritje të autorit, Raportet vjetore të Bankave

4. Qendrueshmëria e fitimeve dhe risku i biznesit

Faktorë të rëndësishëm për të vlerësuar pozitën në biznes të bankës janë qendrueshmëria e fitimeve dhe risku i biznesit. Qendrueshmërinë e fitimeve e masim me koeficientin e variacionit. Kemi zgjedhur koeficientin e variacionit (CV) dhe jo shmangien standarte pasi teoria na ka vërtetuar që në rastet kur shmangia standarte është shumë e madhe, tregues më i mirë është koeficienti i variacionit. Ndërsa riskun e bankës e masim me indeksin Z që është

matës universal i riskut të biznesit. Indeksi është i lidhur në mënyrë monotnike me distancën nga dështimi të bankës. Ndryshe mund të themi se sa më i madh të jetë indeksi aq më e madhe është tretshmëria financiare e bankës. Duke qenë se indeksi Z nuk është simetrik por ka shmangie të madhe atëherë për ta normalizuar përdorim logaritmin natyror të tij.

Indeksi Z llogaritet me formulën: $Z = (ROA + Equity/Assets) / \sigma_{ROA}$

Në tabelën 4.13 jepen llogaritjet për koeficientin e variacionit dhe indeksin Z për të gjashtë bankat të përfshira në model. Kuptohet që banka me koeficientin e variacionit më të ulët është banka me qendrueshmëri fitimesh më të lartë, dhe e rritja e këtij koeficienti informon për të ardhura më pak të qendrueshme. Për të përcaktuar pozicionin në biznes të secilës bankë shikojmë efektin e treguesve/faktorëve të përzgjedhur më lartë në pozicionin ekzistues të bankës.

Vlerësimi për secilin faktor mund të rrisë ose të ulë ankorimin me një ose dy dallues deri edhe pa ndikim. Për këtë arsye normimi përcakton numrin e dalluesve që duhen aplikuar për të regjistruar pozicionin në biznes të secilës bankë. Kjo jepet në tabelën 4.14 ku faktorët normues strukturohen sipas niveleve (shumë e fortë, e fortë, etj.) .

Tabela 4.13 Llogaritja e koeficientit të variacionit dhe Indeksit Z

	CV	Indeksi Z
Raiffeisen	0.18319521	2.9386999
BKT	0.337137249	3.15571
Procredit	0.614269442	3.335054
Alpha	-5.491191665	2.733327
Credins	0.59396261	2.766796
Intesa San Paolo	0.415910775	3.053864

Shikojmë që banka Raiffeisen krahasimisht me të gjitha bankat e tjera ka fitime të qendrueshme. Koeficienti i variacionit për bankën Raiffeisen është nga 2- 30 herë më i ulët krahasimisht me bankat e tjera.

Tabela 4.14 Strukturimi i faktorëve normues sipas niveleve

Vlerësimi nivelor	Rregullimi i normimit
Faktorët	
Qendrueshmëria e fitimeve	
Shumë i fortë	+3
I fortë	+1
Mjaftueshëm	0
Dobët	-1
Shumë dobët	-3
Risku i biznesit	
Shumë i fortë	+2
I fortë	+1
Mjaftueshëm	0
Dobët	-1
Shumë dobët	-2

Për secilën nga bankat kemi bërë vlerësimin intervalor të faktorëve, dhe nga kombinimi i vlerësimit të faktorëve kemi gjetur ndryshimin në pozicion që pëson secila bankë. Rezultatet paraqiten në tabelën 4.15. Pozicioni i bankës Alpha korigjohet me 5 dallues më poshtë se pozicioni i modelit ekonometrik, por duke qenë se edhe sipas modelit ekonometrik është e renditur e fundit pozicioni i saj nuk ndryshon. Banka Raiffeisen sipas modelit ekonometrik është renditur e dyta por nga kombinimi i faktorëve shtesë të llogaritur pozicioni i saj korigjohet me 3 dallues në rritje kështu që ajo pozicionohet në vendin e parë. Banka Procredit është e pozicionuar në vendin e parë sipas modelimit ekonometrik por pozicioni i saj korigjohet me 1 dallues më poshtë kështu që ajo renditet e dyta. Në vendin e tretë sipas modelit ekonometrik është e renditur banka Credins dhe pas kombinimit të faktorëve të përfshirë në analizë pozicioni i saj korigjohet me 4 dallues në rënie, duke u renditur në vendin e pestë. Banka BKT ndryshon pozicionin e saj duke u renditur e treta pas korigjimit të bërë me +4 dallues të renditjes ekonometrike. Së fundi, banka Intesa San Paolo sipas modelit ekonometrik është e renditur e katërta dhe po në këtë pozicion mbetet edhe pas korigjimit me +1 dallues.

Tabela 4.15 Ndikimi në pozicionin e bankës i kombinimit të përbashkët të qendrueshmërisë së fitimeve dhe riskut të biznesit

Ndikimi në pozicionin e bankës i kombinimit të përbashkët të qendrueshmërisë së fitimeve dhe riskut të biznesit												
	Banka Raiffeisen		Banka BKT		Banka ALPHA		Banka Intesa san Paolo		Banka Credins		Banka Pro Credit	
	Vlerësimi	Ndikimi në pozicion	Vlerësimi	Ndikimi në pozicion	Vlerësimi	Ndikimi në pozicion	Vlerësimi	Ndikimi në	Vlerësimi	Ndikimi në pozicion	Vlerësimi	Ndikimi në pozicion
Qendrueshmëria e fitimeve	Shumë fortë	+3 dallues	Shumë i fortë	+3 dallues	Shumë dobët	-3 dallues	Mjaftueshëm	0 dallues	Shumë dobët	-3 dallues	Shumë dobët	-3 dallues
Risku i biznesit	Mjaftueshë	0 dallues	I fortë	+1 dallues	Shumë	-2 dallues	I fortë	+1 dallues	Dobët	-1 dallues	Shumë i	+2 dallues
Kombinimi	+3 dallues		+4 dallues		-5 dallues		+1 dallues		-4 dallues		-1 dallues	

DISKUTIMI I REZULTATEVE, KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET

Industria bankare po implikohet në mënyrë të alternuar nga rrezik biznesi në rrezik financiar dhe anasjelltas. Nga ana tjetër rreziqet e portofolit të biznesit të bankave pasqyrojnë krahas rrezikut të tyre si institucion edhe atë të firmave huamarrëse duke krijuar një portofol rreziqesh gjithnjë e më të larmishme. Kjo kushtëzon gjithashtu rishikim ritmik të doktrinaeve të rrezikut duke përfshirë si aspektet normuese, operacionale, mbikëqyrëse dhe rregullatore.

Brendapërbrenda rrezikut financiar, ka një kompleksitet në ndryshim që vështirëson priorizimin e rrezikut sidomos në periudha kohore të caktuara krizash globale dhe rajonale duke implikuar thuajse të gjitha sistemet bankare të vendeve të zhvilluara, ndërkohë që ka dëmtuar portofolet bankare të vendeve në zhvillim.

Përcaktori themelor i ashpërsisë dhe i dendurisë së rrezikut mbetet asimetria jo vetëm në informacion por edhe në sjelljen organizative dhe institucionale të bankave që kërkojnë të trajtohen gjithnjë e më shumë në suazat e rrezikut operacional apo brenda rrezikut specifik.

Bankat e mëdha, por me shtrirje më të pakët globale, kanë varësi shumë më të lartë nga rreziku politik dhe rreziku makroekonomik i vendit amë dhe i vendeve ku përhapen me degë dhe produkte. Këto banka janë më shumë të ndjeshme nga rreziqe sistematike të përkohshme dhe statistikave të falimentimeve kanë goditur më shumë këto banka. Bankat e mëdha me shtrirje të gjerë globale, kanë natyrë më të diversifikuar dhe modelet e kontrollit të rrezikut janë shumë më dinamike. Kjo për faktin se nëse në një vend vijon recesioni, në një tjetër ka nisur ngritja, etj. Si rrjedhim bankat e mëdha globale përfshihen nga filozofia e të qenurit në krizë të vazhdueshme por janë më të mbrojtura nëse dinë të shfrytëzojnë prirjet kundërciklike duke u shpërblyer me ulje të kostos së rrezikut.

Kompleksiteti i rreziqeve që përjeton industria bankare në dekadën e fundit po përjetohet me 'mplakjen e shpejtë' të doktrinaeve drejtuese, me ndryshime në legjislacion, me rishikim modelesh vlerësuese deri edhe në riformatim të Kornizës së Kontrollit të Rrezikut ku nga Basel II u kalua në Basel III dhe pa u maturuar dhe u zbatuar plotësisht Basel III sot po flitet edhe për një Basel IV.

Vetë Komiteti i Baselit ka hedhur në diskutim fletën me titull "Korniza rregullatore: ndjeshmëria e balancimit të rrezikut, thjeshtësia dhe krahasueshmëria," ku tregohet gatishmëria për të riparë matjen e rrezikut bazuar në riprojektimin e metodologjisë së vlerësimit të aktiveve/zotërimeve të peshuara me rrezik (*Basel Committee Discussion Paper July 2013*).

Pesha më e madhe e opinioneve drejtohen për të kombinuar projektin e rishikimit të vlerësimit të aktiveve në rrezik të kombinuar me dy grup faktorësh: a) *të brendshëm* që mbizotërohen nga rreziku operacional, b) *të jashtëm* që mbizotërohen nga impakti i sistemit legjislativ, institucional dhe mbikëqyrës.

Ngjarjet dhe argumentat që burojnë prej tyre kanë ndikuar në rishikimet e modeleve normuese të bankave për nga niveli i rrezikut dhe sigurisë. Ndonëse për normimin e bankave më vehte dhe të sistemeve bankare në gjithëpërfshirjen e tyre ka pak referenca, por e përbashkëta është se përmbajtja e tyre karakterizohet nga shkalla e lartë e dialektikës së identifikimit, matjes dhe modelimit të problemeve që lidhen me çështjet se:

(a) Çfarë duhet të përgatitet në ex ante për një model sa më të mirë normimi përballë sifdës së standardizimit të përpunimit dhe raportimit të informacionit kontabël të bankave;

(b) Sa modele disponibël ka për të përpunuar bazën e të dhënave të standartizuar (sikurse kërkohet më sipër) dhe cili model do të konsiderohet më i qendrueshmi;

(c) A duhet konsideruar e pranueshme diferenca në normimin e bankave në ekonominë e zhvilluara ku shqetësimet janë më shumë për rrezikun specifik ndaj normimit të bankave në ekonominë e zhvillimit ku shqetësimet janë më shumë për rrezikun sistematik;

(d) A janë imunë modelet e normimit për të pasur gabime fals negativ apo fals pozitiv? Ndërkohë që mbi 85% e shkrimeve janë kritike ndaj modeleve të *Moody's*, *Fitch* dhe *Standard & Poor's*.

Nga punimi ynë sikurse edhe nga kërkimet analoge, del se shqetësimi për qendrueshmërinë e modeleve mbetet kronik si për akademikët, ekspertët dhe për vetë bizneset e normimit (*Moody's*, *Fitch* dhe *Standard & Poor's*). Gjithashtu konkludohet se asnjë kornizë modelore dhe institucion apo korporatë e specializuar nuk gjen prehje sidomos kur bëhet fjalë për vende në zhvillim që kanë portofol shumë të diversifikuar dhe të ndërvarur mangësish.

Pikërisht kjo dinamikë kundërtish kërkimore, kritikash modelore dhe rishikimesh rregullative kanë krijuar prirjen për një model normimi, ku dallimet e një ekonomie në zhvillim me ekonominë e vendeve të zhvilluara duhen thelluar edhe në specifikat brenda vendeve në zhvillim, ku Shqipëria ka shumë. Prandaj duhet që modeli i normimit dhe i produktit që modeli ofron të ndikojë jo vetëm tek bankat, investitorët, publiku por edhe tek rregullatorët e mbikqyrësit.

Modelet e sofistikuara matematikore dhe burime njerëzore të kualifikuara janë resurse të rralla për bankat, për Bankën e Shqipërisë, po ashtu edhe palët e tjera lojtare të tregut financiar e bankar. Kërkesa për ekspertizë dhe modelim të avancuar kërcënon shumë ashpërsisht kur duhet pranuar mungesa e transparencës së bankave për të shpalosur problemet përballë publikut financues i bankave për të paktën 6/7. Bankat ushtrojnë kontabilitetin sipas IFRS (në Shqipëri që nga viti 2009) gjë që rikthen në domosdoshmërinë për një model normimi që i shërben paralajmërimit të hershëm.

Sa më shumë ekonomia shqiptare liberalizohet, aq më shumë pasurohet kërkesa për produkte të ndryshme dhe më komplekse financiare e bankare (me përmbajtje më të lartë risish teknologjike p.sh. bankimin elektronik, mobile banking, etj.) këto pasurojnë ekspozimin e sistemeve elektronike të informacionit, të burimeve njerëzore me shkallë më të ulët rreziku por me ashpërsi më të lartë. Nëse po punohet për sistemimin e pasojave nga kriza që po ikën, krijohen rreziqe me kërkesa cilësore më të larta për tu kontrolluar nga kriza që jemi apo nga kriza që po vjen.

Institucioni politik më i lartë që është Qeveria në shumicën e vendeve në zhvillim edhe në Shqipëri ka nivelin më të lartë të hazardit moral në lidhje me opacitetin (*mungesën e transparencës*) duke cënuar moralin institucional (p.sh., *INSTAT*, *Banka e Shqipërisë*) për të ofruar informacion objektiv, të vërtetë, ***të përgjegjshëm dhe në kohë*** për mbarë publikun pjesë e të cilit është qeveria vetë edhe entet e saj. Problemi shtrohet se informacioni për mbarëvajtje të ulët financiare shpesh herë është i vonuar dhe ndërkohë kostoja e falimentimit bëhet edhe më e lartë. Mungesa e të dhënave paraqet probleme të dukshme për modelimin e normimit për shqetësimin e përbashkët si industri financiare si dhe për varësinë financiare ndaj falimentimit.

Asnjë bankë nuk përkon me standardet e raportimit në rrezik, madje asnjë bankë nuk ngjason njëra me tjetrën kur raportojnë, si dhe për produktin kontabël që raportojnë. Kjo përcakton shumë suksesin/dështimin aplikues të modelit të normimit. Treguesit e diferencimit në rrezikun e mbarëvajtjes së pritshme financiare varen nga vetë diferencimi në transparencën, drejtësinë, saktësinë dhe objektivitetin e përpunimit dhe raportimit kontabël që përfshihen si bërthama e modelit të normimit.

Prandaj ne jemi të vetëdijshëm se mbushim një vakum por nuk ezaurojmë shqetësimet për model perfekt normimi. Nga ana tjetër pasurimin modelor dhe strukturor duke përpunuar mangësitë dhe kritikën kumulative të të gjitha aspekteve që lidhen me normimin del nga puna kërkimore bazë por implikon përsosmëri ushtrimore që merr në konsideratë teorinë e sinjalizimit të hershëm, hazardin moral dhe përcaktorët specifik që shërbejnë për të përmbushur honin ndërmjet alarmit të rremë për jo krizë ose krizë dhe ndodhjes së vërtetë të kësaj.

Konkluzion me peshë është fakti se misioni i normimit të bankës nga distanca përqendrohet në parashikimin dhe parandalimin e rreziqeve sistematike si rreziku më kërcënues për investitorët. Për matjen e rrezikut financiar duhet të ketë akses në informacion të standardizuar të bankave që duhen vënë përballë raportimit uniform të treguesve për të identifikuar dhe matur motivuesit e rrezikut që veprojnë në kthesat dinamike të industrisë financiare, në rrethanat goditëse nga krizat e mjedisve makroekonomike dhe financiare, si dhe në mënyrë implicite nga prirja që rreziku i veçantë i një banke të proliferojë në rrezik të krejt sistemit. Bankat duhet të unifikohen për treguesit që përmbushin këto kërkesa, që njihen edhe si **matësit e performancës të rregulluar me rrezikun** (RAPM).

Përfundimi themelor është se sot mungon një model për normimin e bankave sipas rrezikut apo sigurisë financiare dhe institucionale të tyre që është thelbësor për mbarëvajtjen e qëndrueshme afatgjatë të Institucioneve Bankare në Shqipëri. Në aspektin metodologjik dhe modelor si rreziku financiar dhe ai operacional janë produkte të fundme për të cilat Banka e Shqipërisë ka miratuar rregullore por pa një kornizë parimore.

Ka një hon kohor që nuk ofron rrjedhshmëri të Rregulloreve për faktin se janë miratuar me 3-4 vjet diferencë, ndërkohë që nga 1991-2011 nuk ka pasur rregullore të rrezikut operacional [miratuar në Mars 2011], nuk ka asnjë tentativë për të standardizuar informacionin kontabël financiar dhe amvisues të bankave, që vërehet në format e ndryshme të raportimit të kredive me problem, të shmangies së raportimit të rezultatit financiar (me ose pa humbje) që imponojnë observim si një *Proces të Vazhdueshëm për Transparencën dhe Pakësimin e Rrezikut*.

Në projektimin dhe testimin e modelit të normimit duhet përfshirë edhe raportimi periodik i tij, duke mos krijuar frymë penguese për një të vërtetë objektive se si janë bankat (*renditja -ranking*), se ku rrezikohet më shumë apo më pak në rolin si depozitues paafat, me afat, etj. Për këtë qëllim kërkohet të aplikohen metoda dhe struktura konsistente modelore, sistem cilësor dhe infrastrukturë IT duke realizuar (a) provigjionimin dhe administrimin në kohë të të dhënave, (b) agregimin e informacionit për të përfituar indikatorë me peshë për kontrollin e rrezikut dhe (c) vendosjen e një mekanizmi automatik, që lajmëron përpara arritjes së niveleve kritike të limiteve të rrezikut.

Burimi kryesor i rrezikut në librat e bankave është grupimi i llogarive të dështuara p.sh. në kreditë e ndërtimit. Ndryshimet negative në kushtet makroekonomike dhe financiare ndikojnë në aftësinë paguese të të gjitha firmave huamarrëse (financiare dhe jo-financiare), në ekonomi që përcillet deri tek portofolet e bankave. Faktorët e vëzhguar të rrezikut makrofinanciar janë sistematike dhe një burim i varësisë kryq. Ajo që ndodhi në sistemin bankar pas gushtit 2008 ka treguar se, në kushte të paqëndrueshme ekonomike, madhësia e

një banke qoftë vendore apo globale nuk është garanci absolute për besueshmërinë në qendrueshmërinë apo stabilitetin financiar dhe biznesit të saj.

Në sektorin bankar të Shqipërisë, përballemi me gjasa për rreziqe më të mëdha dhe më të vështira për tu pohuar. Për këtë arsye edhe vlerësimet për model normimi argumentohen të jenë sa më shpalosëse për mbarëvajtjen dhe besueshmërinë e një banke. Diferencat apo dallimet ndërmjet klasifikimeve të ndryshme në normim formojnë përkushtimin sistematik për tu analizuar se çfarë i motivon dhe i nxit këto dallime.

Në vendin tonë asnjë bankë nuk ka kontraktuar ndonjëherë nga agjensitë e normimit për të vlerësuar “shëndetin ekonomik dhe financiar” të saj. Një nga arsyet është edhe tarifa e lartë që duhet ti paguajnë agjensive të normimit. Shqipëria është shumë e vonëshme në përcaktimin e normimit edhe për faktin se gjithçka është në mënyrë dhe masë fillestare (jo më shumë se 10 vjet). Kjo rrit koston kohore të punimit për informacion dhe seri kohore më të pasur.

Punimet konvergjojnë në dyshimet për aftësinë e modeleve ekonomike për të kapur detajet e duhura në normimin e falimentimit të bankave duke divergjuar se në cilin tregues kyç duhet mbështetur. Në studimin tonë ne kemi zgjedhur një alternativë më sintetike, duke u fokusuar në treguesin më rezultativ dhe që nga ana kontabël është më pak i manipulueshëm dhe më shumë diskriminues për cilësinë e aktiveve të bankave sikurse është treguesi i kredive jo të mbara (*non performing loans -NPL*). Ky tregues përfshin rezultanten e ndikimit të faktorëve që lidhen me dëmtimin e kredive (*loan impairment*), me kreditë toksike (*toxic loans*) si dhe me pjesën e kredive të peshuara në rrezik por që klasifikohen si standard.

Përfundimisht vlerësohet se NPL si tregues bilanci (*pozicioni, statik*) duke u kombinuar me tregues të të ardhurave (*performanca, dinamik*) p.sh., në raportet NPL/Ninc, NPL/GM, NPL/AR i përgjigjet më mirë edhe formatit të Basel II/III. Prandaj vlerësojmë se në marrëdhënie me kapitalin NPL është shkak dhe rënia e kapitalit është pasojë, por në marrëdhënie me performancën e kërkuar të bankës nga rregullatorët, mjaftueshmëria kapitale bëhet shkak që banka të vijojë të ofrojë kredi duke pasë si pasojë krijimin e NPL.

Sugjerojmë fort që krahas modelit ekonometrik (me dhe pa dummy) të përfshihet edhe modeli i mesatares së peshuar shumëpërmasore që duke u bazuar në NPL interferohet me 4 grupet e raporteve bazë (përfitueshmëri, likuiditet, mjaftueshmëri kapitale, efikasitet) që formojnë dhe informojnë gjendjen në rrezik dhe/ose në siguri të bankave. Këto raporte shpjegojnë ndryshimin e normës së NPL-së, që provohet se përdorimi alternativ i cilitdo prej tyre për të normuar bankat do të rezultojë në përfundime të njëjta. Përfundimet bazohen në modelin e normimit nga jashtë apo nga distanca, i cili nuk bazohet në shqyrtimin e informacionit të brendshëm ose manaxherial të bankave.

Niveli i Kredive jo të Mbara dhe masa e heqjes së kredive nga aktivi i bilancit (*write off*) asnjëherë nuk raportohen drejt dhe saktë për shkak të transaksioneve fiktive të kredive duke rritur transaksionet e shitjes së kredive nga një bankë në tjetrën, pa sjellur rritje të GDP. Konkretisht agregati i kredisë është raportuar për 5,5 miliard lekë, ndërkohë që nuk ka pasur rritje për 20% apo 1,1 miliard lekë të TVSH në autoritetin fiskal.

Ka shumë rëndësi konkluzioni se në Shqipëri nuk ka treg aktiv ndërbankar, por ky fakt nuk d.t.th., se bankat janë të paimplikuara dhe të izoluara nga transmetimi i rrezikut me njëra tjetrën. Kjo sepse bankat mbajnë firma që janë kliente të ndërsjellta të njëra tjetrave, janë firma që shesin me arkëtim të mëvonshëm dhe blejnë me pagesë të mëvonshme duke pasur llogaritë nëpër banka të ndryshme. Në këtë skemë shumë të ndërthurur operohet ekspozimi në rrezik i një kredie me probleme për tu transmetuar nga një bankë tek tjetra.

Kjo d.t.th., se rreziku i kredive tregtare shndërrohet në rrezik bankar sepse firmat kreditore në mallra/shërbime me pritje kur nuk arketojnë paratë ekspozohen ndaj rrezikut të huamarrjeve nga bankat, nga ana tjetër mosarkëtimi i shitjeve me kredi (rrezik kredie)

shndërrohet në rrezik likuiditeti duke mos paguar bankën. Kësisoj krijohet zinxhiri i transmetimit të rrezikut, duke u mbarsur me energji potenciale për të shndërruar rrezikun idiosinkratik në rrezik sistemik. Duke perceptuar rrezik më të lartë bankat kanë tkurrur kreditimin.

Në një aspekt tjetër, punimi argumenton dhe provon se bankat kanë një sjellje të përbashkët në strukturimin e portofolit, duke u shmangur nga veprimtaria e tyre kreditore drejt transaksioneve të investimeve me rrezik minimal që në financat normative njihen si pa rrezik (të Mira Thesari, Eurobonde, etj.).

Vlerësimi i bankës për rrezik sistemik implikon variablat shpjegues të mbështetjes nga qeveria për bankën në fjalë. Një lidhje e tillë përcakton se në rast të krizave apo të një stresi të përgjithshëm financiar, qeveritë do të priren të mbështesin më pak një bankë që ka ekspozime të njëjta sikurse pjesa tjetër e sistemit bankar. Nga ana tjetër, në rrethana me kushte të njëjta, prirja për mbështetje nga qeveria është më e lartë për bankat, falimentimi potencial i të cilave do të mbart goditje dëmtuese për bankat e tjera dhe thuajse zero për bankat falimentimi i të cilave do të godiste vetëm këto.

Shtrëngimi i agregatit të kredisë ka ndodhur edhe për faktin se gjenerimi i kredive me probleme (NPL) është nxitur edhe nga rritja e huamarrjes tregtare (blerje me pagesë të mëvonshme) duke krijuar mungesë likuiditeti palëve shitëse me arkëtim të mëvonshëm. Për 30%-40% të agregatit të kredisë tregtare në vlerë rrjedh nga kontratat qeveritare të mbetura të pashlyera nga ana e qeverisë deri në momentin që po shkruhet ky punim.

Duke qenë se NPL vjen në rritje, atëherë bankat ekspozohen më shumë në rrezik falimentimi duke shtuar koston e depozituesit (ASD), por primi i sigurimit të depozitave në mënyrë paradoksale mbetet i njëjtë për banka me ekspozime të ndryshme në rrezik

Në përmbyllje shohim se treguesi më i ndikuar dhe njëkohësisht më ndikues është NPL dhe nga ana tjetër, sfida më problemore nuk është identifikimi, vlerësimi dhe kontrolli i rrezikut por raportimi i tij, që d.t.th., se sërish shfaqet jo beteja por lufta kundër asimetrisë së informacionit.

Banka e Shqipërisë ka pohuar në mënyrë kronike se “pavarësisht nga niveli i lartë i kredive me probleme, bankat mbeten të shëndosha me një raport të përgjithshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 17,8 për qind në fund të shtatorit 2013”. Ne e gjykojmë këtë si asimetri informuese sepse gjendja nuk është kaq e qetë. Fitimshmëria e sektorit bankar e matur nga shlyerja ndaj aktiveve (ROA) është në nivelin më të ulët në rajon. Përpjekjet e Bankës së Shqipërisë për të motivuar ekonominë nëpërmjet uljes së normës së interesit janë ezauruar. Banka e Shqipërisë ka arritur limitin e fundit të saj [me marzh negativ] duke ulur normën bazë të interesit nën normën e pritshme të inflacionit.

Qeveria ka pasur një sjellje të pakontrolluar në krijim borxhi duke e shndërruar sot në masë të lartë huamarrjeje. Për çdo njësi borxhi shtesë qeveria ekspozohet në rrezikun e uljes së mbulimit të borxhit me garanci duke sosur kapacitetin huamarrës të saj si dhe duke implikuar zëra shpenzimesh shtesë për shërbim borxhi dhe rritje të deficitit buxhetor. Rritja e borxhit për shkak të mbulimit të rritjes së deficitit buxhetor bëhet me argumentin se shtesa e shpenzimeve do të ndikojë në rritjen e GDP dhe ku shtesa e GDP me nivel taksash (nga constant në progresiv) do të rrisë arkëtimet e qeverisë për t'i shërbyer pa problem shlyerjes së borxhit. Nga ana tjetër, ngjarjet katastrofikat dhe mosmbulimi i tyre nga qeveria ka krijuar dëmtim të rëndë të portofolit të bankave (përmbytja e Shkodrës, Lezhës, etj.).

Niveli i lartë i deficitit buxhetor, i borxheve të pashlyera, i humbjeve nga rrjetet e shërimit infrastrukturor (hekurudha, rrjeti rrugor, shpërndarja e energjisë, etj.) kanë një specifikë problemore të vazhdueshme për Shqipërinë duke krijuar gjithnjë e më shumë argumentin se mbështetja nga qeveria është thuajse krejtësisht e pamundur dhe mbetet vetëm mbështetja nga FMN.

Në mjedisin e industrisë bankare ka pengesa dhe kundërti që rrisin deri në fiktivitet praninë dhe veprimin real të mbështetjes nga qeveria. Shkurt a mundet qeveria Shqiptare që të mbështesë bankat e tjera jashtë 4 bankave që e ushqejnë me 70-80% financim. Kjo d.t.th., se të gjitha bankat jashtë këtij grupi nuk e përfitojnë këtë mbështetje. Nëse futemi dhe analizojmë bankat e grupit, përsëri do shohim se qeveria shqiptare nuk ka lëndë financiare të mbështesë, por vetëm mund të endorsojë çdo mbështetje potenciale nga FMN.

Shqipëria ka një industri dhe treg të shformuar bankar ku konkurojnë 16 banka dhe vetëm 3 prej tyre zotërojnë 53% të depozitave dhe 42% të kredive të totalit të tregut. Gjithashtu edhe në analizën e strukturës së deficitit buxhetor, janë po këto tre banka që financojnë monetizimin e borxhit qeveritar për 60%, që do të thotë se këto krijojnë varësi të lartë të qeverisë duke përqendruar rrezikun Sovran. E thënë ndryshe nëse ndonjëra prej tyre refuzon financimin e qeverisë kjo krijon impakt dhe hazard moral të lartë drejt një rreziku sistematik që shkon deri në kontrollin e sjelljes së qeverisë dhe të institucioneve që varen prej saj.

Në vendin tonë degët e bankave janë më të përhapura dhe shumë ‘të grimcuara’ me numër të lartë degësh dhe agjensish në krahasim me raaportin përfitim kosto në treg. Rritja e kostos marginale e bankave që duke dashur të konkurrojnë me njëra tjetrën, hapin degë të reja nga forca e imitimit dhe jo racionalja e efijencës. Kjo bën që ato të çenojnë biznesin e njëra-tjetrës e më tej akoma të kenë degë të cilat nuk janë fitimprurëse.

Në sintezën e konkluzioneve të renditura më sipër, ndërmarrja e një veprimtarie normimi për bankat kërkon rishikime të sjelljes institucionale, të krijimit të një baze ligjore dhe të klimës pranuese në publik nga palët depozituese, investuese, rregulluese, etj. Në mënyrë të përmblëdhur krahas rekomandimeve të shprehura në mënyrë plotësuese dhe të tërthortë më lart, rendisim si me rëndësi spikatëse këto drejtime:

- 1) Normimi vlerësues i bankave është një produkt publik dhe jo privat, duke krijuar vendimmarrje në kushtet e qartësisë, vërtetësisë, objektivitetit dhe vullnetit të palëve për të zgjedhur se ku të investojnë/depozitojnë paratë, në cilën bankë dhe me çfarë strukture kohore dhe rreziku.
- 2) Që të arrihet një normim sa më i saktë kërkohet të vendoset standard i *treguesve uniform të raportimit të performancës dhe pozicionit financiar të bankave* duke mos pasur shmangie në raportimin qoftë në ‘hard copy’ po ashtu edhe në faqet e internetit të bankave.
- 3) Banka e Shqipërisë duhet të përfshijë treguesit e rrezikut IBNR (*incurred but not reported*) për rreziqet që implikohen por që akoma ose nuk shfaqen në kontabilitet ose edhe nuk raportohen. Pikërisht përballë uljes së kostos së një rreziku të tillë shërben Normimi që duke shpalosur informacionin për pozicionin nivelor në rrezik të bankave, ndihmon edhe vetë Bankën Qendrore dhe palët e tjera mbikëqyrëse e legjislative.
- 4) Sistemi i treguesve në rrezik sot raportohen jo të gjithë dhe jo të plotë. Në shumë studime kërkohet që bankat të raportojnë sipas Treguesve të Korigjimit të Performancës me Rrezikun (RAPM). Kjo ndihmon edhe Agjensinë e Sigurimit të Depozitave për të caktuar nivelin e duhur të mbulesës që reflekton riskun e aktiveve të bankës për të siguruar apo garantuar marrëdhëniet me depozituesit dhe palët e tjera financuese të bankës.
- 5) Normimi përfshin cilësinë e aktiveve dhe strukturën e kapitalit duke krijuar analizë diskriminuese për të gjitha institucionet bankare të cilat duhet të krijojnë rezerva sa më realiste e të sakta për humbjet nga kreditë, duke pasqyruar të dyja përmasat e

portofolit si dhe shpenzimet për to. Për kreditë e riskeduluara *portofoli në risk* duhet të vlerësohet më vete dhe të interpretohet më me kujdes se sa veprohet për një portofol standard. Kreditë që kanë rënë nga statusi herë më parë si kredi të vonuara, janë kreditë në rrezikun më të madh se sa krejt portofoli. Për shembull, një vlerësim i *portofolit në risk* gjithmonë duhet të përfshijë *raportin e kredive write off* dhe *raportin e riskedulimeve* të kredive.

- 6) Agjensia e normimit duhet të marrë rolin e një depistuese rreziku duke normuar bankat në rrezik dhe përcaktuar kontributin për mbulimin e sigurimit të depozitave, të mjaftueshmërisë kapitale, të rrezikut kërcënues ndaj depozituesve, të shmangies nga caqet rregullatore, deri edhe në përmasat e përgjegjësisë sociale dhe publike.
- 7) Kontrolli i borxhit nga ana e qeverisë ul shumë rrezikun Sovran që bankat të kontrollojnë financiarisht qeverinë, kur këto financojnë mbi 70% të deficitit buxhetor. Modeli i normimit duke marrë në konsideratë shkallën e përqendrimit të bankave e argumenton si alternativ me rëndësi implikimin e borxhit qeveritar me portofolin e investimit të bankave.
- 8) Doktrinat e kontrollit të rrezikut sipas Basel II/III kërkojnë rishikimin e rregullores së rrezikut dhe të raportimit periodik të aktiveve në rrezik të bankave duke hequr dorë nga niveli 5 klasor (Standard, Vëmendje të Veçantë, Nën Standard, Dyshimta, Dështuara) në nivelin 10 klasor. Kjo do të rrisë edhe strukturën kontabël të kredive me problem dhe do të shmangë raportimin e diferencuar p.sh. RBAL dhe Societe Generale në Shqipëri raportojnë me 5 klasa ndërsa në autoritetet monetare të vendeve amë raportojnë me 10 klasa.

BIBLIOGRAFIA

Citimi i revistave

1. A. A. Peresetsky and A. M. Karminsky, 2011, Models for Moody's bank ratings, MPRA 34864
2. Alfaro, Laura and Fabio Kanczuk (2006). Sovereign Debt: Indexation and Maturity. Inter-American Development Bank Working Paper 560, Washington, D.C.
3. Altman, E, Saunders, A "Credit Ratings and the BIS Reform Agenda" 2001, Center for International Political Economy and the Bank of England Conference on "Banks and Systemic Risk," May 23rd – May 25th, London, England.
4. Alvin Toffler, Powershift: Knowledge, wealth, Violence at the Edge of the 21st Century, NY, Bantam, 1990, pages 43-57
5. Amato, Jeffery D. and Furfine, Craig, Are Credit Ratings Procyclical? (February 2003). Bank for International Settlements Working Paper No. 129.
6. An analysis of the determinants of sovereign ratings', Global Finance Journal, vol. 15, pp. 251-280.
7. Bauer, D, Zanjani, G, "The Marginal Cost of Risk, Risk Measures, and Capital Allocation" –Georgia State University Oct. 2012
8. Birdsall, Nancy -Stormy Days on an Open Field. Asymmetries in the Global Economy. WIDER Research Paper No. 2006/31
9. Borio, C and P Lowe (2002): "Assessing the Risk of Banking Crises", BIS Quarterly Review, December.
10. Calvo, Guillermo A -Capital Flows and Capital Market Crises: The Simple Economics of Sudden Stops. *Journal of Applied Economics* 1998/1(1)
11. Calvo, Guillermo -Crises in Emerging Market Economies: A Global Perspective. NBER Working Paper 11305, Cambridge, Mass, 2005
12. Cani, Sh, Baleta, T, -Central Bank of Albania. Is it really independent? Bank of Albania Working Papers -1999
13. Cantor, R, Packer, F, "Determinants and Impact of Sovereign Credit Ratings" –FRBNY Economic Policy Review, Oct. 1996
14. Cantor, Richard; Packer, Frank (Summer/Fall 1994). "The credit rating industry". Federal Reserve Bank of New York Quarterly Review (Federal Reserve Bank of New York).
15. Cantor, Richard; Packer, Frank (Summer/Fall 1994). "The credit rating industry". Federal Reserve Bank of New York Quarterly Review (Federal Reserve Bank of New York).
16. Cantor, Richard; Packer, Frank (Summer/Fall 1994). "The credit rating industry". Federal Reserve Bank of New York Quarterly Review (Federal Reserve Bank of New York). p. 8.
17. Casey, Kathleen. ""In Search of Transparency, Accountability, and Competition: The Regulation of Credit Rating Agencies", remarks at "The SEC Speaks in 2009"". February 6, 2009. US SEC. Retrieved 21 August 2013.
18. Catão, Luis A.V. and Sandeep Kapur : Volatility and the Debt Intolerance Paradox. IMF Staff Papers 53(2) 2006.
19. Christopher Cox (26 September 2007). "The Role and Impact of Credit Rating Agencies on the Subprime Credit Markets". sec.gov. Securities and Exchange Commission.
20. Curry, T., P. Elmer, dhe G. Fissel "Regulator Use of Market Data to Improve the Identification of Bank Financial Distress." Paper, Federal Deposit Insurance Corporation -2001..
21. D.F. Hendry and J.F. Richard, "The Econometric Analysis of Economic Time Series," International Statistical Review, vol.51, 1983, pp.3-33.
22. Derviş, Kemal and Nancy Birdsall (2006). A Stability and Social Investment Facility for High-Debt Countries. In Ted Truman (ed.). Reforming the IMF for the 21st Century. Institute for International Economics, Washington, D.C.

23. Determinants and Impact of Sovereign Credit Ratings” Richard Cantor, Franck Packer –FRBNY Economic Policy Review, Oct. 1996
24. Drehmann, M and N Tarashev (2011): “Systemic Importance: Some Simple Indicators”, BIS Quarterly Review, March
25. Estrella, A, Park, S, Peristiani, S “*Capital Ratios as Predictors of Bank Failure*” - FRBNY Economic Policy Review / July 2000.
26. Evanoff, D., and L. Wall. “Sub-debt Yield Spreads as Bank Risk Measures.” Journal of Financial Services Research 20, no. 2-3 October 2001
27. Financial Crisis Inquiry Commission Final Report-Conclusions-January 2011
28. Financial Crisis Inquiry Report. GPO. 2011. p. 119.
29. Friedman, M, “The Methodology of Positive Economics,” in Essays in positive Economics, University of Chicago Press, Chicago, 1953, p.7.
30. Geithner, T, ”*Speech Reducing Systemic Risk in a Dynamic Financial System*”. Newyorkfed.org. June 2008
31. Godfrey, L.G. "Misspecification tests and their uses in econometrics", *Journal of Statistical Planning and Inference*, 49 (2), (Econometric Methodology, Part II, 1996
32. Godlewski, C, -Are Bank Ratings Coherent with Bank Default Probabilities in Emerging Market Economies ? LaRGE, Universit’e Robert Schuman, Institut d’Etudes Politiques 47 avenue de la Forêt Noire, 67082 Strasbourg Cedex, FRANCE -August 2004.
33. Goldstein, Morris and Anna Wong (2005). What might the next emerging-market financial crisis look like? Institute for International Economics Working Paper 05-7, Washington, D.C.
34. Golosov, M, Sarg, T, “*Taxation, redistribution, and debt with aggregate shocks*” Princeton University press July 2012.
35. Gramlich, D, Miller, G, Oet, M, Ong, S, “Early warning systems for systemic banking risk: critical review and modeling implications” - Banks and Bank Systems, Volume 5, Issue 2, 2010
36. Gropp, R, Vesala, J, Vulpes, G, - Market Indicators, Bank Fragility, and Indirect Market Discipline –FRBNY Economic Review, Sept. 2004
37. Harald Hau, Sam Langfield and David Marques-Ibanez “Bank Ratings -What determines their Quality?” -Working Paper Series –of European Central Bank NO 1484 / OCTOBER 2012
38. Higgins, Matthew and Thomas Kiltgaard (2004). Reserve Accumulation: Implications for Global Capital Flows and Financial Markets. *Current Issues in Economics and Finance* 10(10): 1-8
39. Hoti, I, Scalera, F, “Bank Asymmetric Behavior on Insurance Agencies and Insurance Brokerage- Context of Albania ” –Symposium -UNIQA Group, Wien –IFIBI 2012.
40. Hoti, I, ‘Informacioni Asimetrik, Kundërtitë Makro, IFRS dhe Basel II -Impakti i Ekspozimit në Rrezik i Industrisë Bankare në Shqipëri –Economicus Nr 02 2008, Tiranë.
41. Hoti, I, Aliaj, A, Bank Assurance and Wealth Gain Allocation -An Alternative Economies of Scope, Journal of studies on economics & society UAMD -2013
42. Hoti, I, -Banking Portfolio Impairment Test Outcomes According to International Financial Reporting Standards [Real Case: *BIS Banca Implementation*], Journal of Business and Economics UAMD 2011
43. Hoti, I, Përjasje të Reja në Doktrinën e Identifikimit, të Vlerësimit dhe të Kontrollit të Rrezikut Sistemik dhe Specifik në Industrinë Bankare të Shqipërisë, Phd Dissertacion. UBT, Shqipëri, 2012.
44. Hoti, I, IFIBI ‘Report on Incurred but Not Reported Portfolio of Risks from Business Conflicts Analysis and Proliferation to UNIQA Group’ –May 2014.
45. I. Hoti, IFIBI ‘Report on Incurred but Not Reported Portfolio of Risks from Business Conflicts Analysis and Proliferation to UNIQA Group’ –May 2014.

46. IBRS-Program Document for a Proposed Loan in the Amount of Equivalent to US\$100 Million' -Report No 86955-AL/March 2014.
47. IBRS-Program Document for a Proposed Loan in the Amount of Equivalent to US\$100 Million' -Report No 86955-AL/March 2014.
48. IMF (2006b). Further consideration of a new liquidity instrument for market access countries: Design issues. Paper prepared by the Policy Development and Review Department. IMF, Washington, D.C. <http://www.imf.org/external/np/pp/eng/2006/080306>.
49. Institute of International Finance (IIF) (2005). Principles for Stable Capital Flows and Fair Debt Restructuring in Emerging Markets. IIF, Washington, D.C.
50. Insurance as a Mitigant for Operational Risk: a Report Submitted to the Basel Committee on Banking Supervision. London: Operational Risk Research Forum. 2012
51. J. B. Ramsey, "Test for Specification Errors in Classical Linear Least Squares Regression Analysis," Journal of the Royal Statistical Society, series B. vol. 31, 1969, pp. 350-371
52. Jarque, Carlos M.; Bera, Anil K. "Efficient tests for normality, homoscedasticity and serial independence of regression residuals". *Economics Letters* 6, 1980.
53. Johannes Jäger, Vanessa Redak, "Austrian Banks' Lending and Loan Pricing Strategies against the Background of Basel II" –Financial Stability Report No 12, 2006.
54. John, H, Holthausen, R –"The effect of Bond Rating Agency Announcements on Bond and Stock Prices", Journal of Finance 47, 1986.
55. Krugman, P, "The Return of Depression Economics and the Crisis of 2008" W.W. Norton Company Limited, 2009.
56. L. G. Godfrey, "Testing Against General Autoregressive and Moving Average Error Models When the Regressor include Lagged Dependent Variables," *Econometrica*, vol. 46, 1978, pp 1293-1302, and T. S. Breusch, "Testing for Autocorrelation in Dynamic Linear Models," *Australian Economic Papers*, vol. 17, 1978, pp. 334-355.
57. Langohr, Herwig M.; Patricia T., Langohr (2009). The rating agencies and their credit ratings. Wiley, John & Sons,
58. Leone, M, "Revised Fair-Value Rule Is Weaker: Moody's" –CFO.com, November 2008.
59. Lessons from the Credit Crisis for the Future of Regulation: Before the Committee on Oversight and Government Reform, United States House of Representatives, 110th Cong. (2008) (testimony Concerning the Role of Federal Regulators by Chairman Christopher Cox, U.S. Securities and Exchange Commission), available at <http://www.sec.gov/news/testimony/2008/ts102308cc.htm>
60. Lewis, Michael "Boomerang" – Travels in the New Third World. Norton (2011).
61. M. Gabriella Briotti, "Economic Reactions to Public Finance Consolidation: a Survey of the Literature", ECBank Occasional Paper No. 38/ Oct 2005
62. McNamara, G, Vaaner, P, "The Influence of Competitive Positioning and Rivalry on Emerging Market Risk Assessment", 2000 Journal of International Business Studies
63. Mendoza, R, A Compendium of Policy Instruments to Enhance Financial Stability and Debt Management in Emerging Market Economies –DESA Working Paper No. 48 ST/ESA/2007/DWP/48
64. Moody's 1-"Request for Comment: Incorporation of Joint-Default Analysis for Systemic Support into Moody's Bank Rating Methodology," October 2005; "Update to Proposal to Incorporate Joint-Default Analysis into Moody's Bank Rating Methodology," April 2006; 2- "Bank Joint Default Analysis: Rating Methodology Update," August 2006.
65. Moody's History: A Century of Market Leadership". moody's.com. Retrieved 17 September 2013.
66. Moshirian, Fariborz, Wu, Qiongbing –"Banking Industry Volatility and Banking Crises", Journal of International Financial Markets, Institutions and Money, Vol. 19, 2009
67. Omaina A. G. Hassan and Ray Barrell, "Accounting for the determinants of banks' credit ratings" Working Paper N. 13/2 Brunel University.

68. Outstanding World Bond Market Debt from the Bank for International Settlements via Asset Allocation Advisor. Original BIS data as of March 31, 2009; Asset Allocation Advisor compilation as of November 15, 2009. Accessed January 7, 2010.
69. Oversight of Credit Rating Agencies Registered as Nationally Recognized Statistical Rating Organization". sec.gov. Securities and Exchange Commission. 2 February 2007. Retrieved 19 September 2013.
70. P.H. Poon, W, Firth, M, Hung Gay Fung – “A multivariate analysis of the determinants of Moody’s bank financial strength ratings” Elsevier, Vol 9, Aug. 1999.
71. Packer,F, Tasharev, N, “Rating methodologies for banks” BIS Quarterly Review 2011.
72. R. King, M, “The cost of equity for global banks: a CAPM perspective from 1990 to 2009” - BIS Quarterly Review, September 2009
73. Richard Sylla (1–2 March 2000). "A Historical Primer on the Business of Credit Ratings". The Role of Credit Reporting Systems in the International Economy. Washington, D.C.: The World Bank. Retrieved 21 September 2013.
74. Robert C. Pozen “How to Value Toxic Bank Assets” –Wall Street Journal Feb. 3, 2009
75. Ron, E., dhe A. Verma. “Risk-Based Capital Adequacy Standards for a Sample of Forty-Three Major Banks.” Journal of Banking and Finance 13, no. 1 March 1989
76. Rupert Neate, Ratings agencies suffer 'conflict of interest', says former Moody's boss| The Guardian| 22/08/2011 International Economy Magazine Washington D.C. 2008
77. Sinclair, Timothy J. (2005). The New Masters of Capital: American Bond Ratings Agencies and the Politics of Creditworthiness. Ithaca, New York: Cornell University Press. p. 26.
78. Sorge, M, Virolainen, K, “A comparative analysis of macro stress-testing methodologies with application to Finland” Journal of Financial Stability 2006, Vol 2.
79. Statistical Models of Bond Ratings: A Methodological Inquiry.” JOURNAL OF BUSINESS 52, no. 2, 1979
80. Trevino L., Thomas S. “Systematic Differences in the Determinants of Foreign Currency Sovereign Ratings by Rating Agency” Working Paper University of Southhampton, 2000.
81. Trevino, L. and Thomas, S., (2000), “Systematic Differences in the Determinants of Foreign Currency Sovereign Ratings by Rating Agency”, Discussion paper, University of Southampton, No. 00-153
82. White, Ben (31 January 2002). "Do Rating Agencies Make the Grade?; Enron Case Revives Some Old Issues". The Washington Post.
83. White, H. "A Heteroskedasticity-Consistent Covariance Matrix Estimator and a Direct Test for Heteroskedasticity". *Econometrica* 48, 1980.
84. White, Lawrence J. (24 January 2009). "Agency Problems—And Their Solution". The American. American Enterprise Institute.
85. White, Lawrence J. (Spring 2010). "The Credit Rating Agencies". Journal of Economic Perspectives (American Economic Association) 24 (2): 211–226. doi:10.1257. Retrieved 22 September 2013.

Citimi i librave

1. Bowen, E, Starr, M, (2011), Basic Statistics for Business and Economics, McGraw Hill
2. Chiang, A, (1985), Fundamental methods of mathematics and economics, Mc.Graw Hill
3. Dermine, J, (2009), Bank valuation and value based management, Mc.Graw Hill (2009)

4. Gujarati, D.N., 1995, Basic Econometrics, McGraw Hill, New York.
5. Hoti, I. (2011), Amvisimi i Rrezikut dhe Industria e Sigurimeve, Instituti i Inxhinierisë Financiare për Bankë dhe Sigurime, Tiranë
6. Hoti, I. (2001), Fjalor enciklopedik trigjuhësh, anglisht, italisht, shqip për bankën, biznesin, ekonominë etj., Star, Tiranë
7. Hull, J. (2007). Risk Management and Financial Institutions, Prentice Hall, New Jersey.
8. Marshall, M, (1999), The bank- the birth of Europe`s Central Bank and the Rebirth of Europe power, Random house,
9. Rose,P, (2002), Commercial bank management, Mc.Graw Hill
10. White, G, Sondhi, A, Fried, D, (1998) The Analysis and use of Financial Statements. John Wiley & Sons, Inc. (1998)

› Raporte financiare vjetore të bankave

1. Alpha Bank e Shqipërisë/Raporte Vjetore/ Raporti Vjetor 2009/www.alphabank.al
2. Alpha Bank e Shqipërisë/Raporte Vjetore/ Raporti Vjetor 2011/ www.alphabank.al
3. Alpha Bank e Shqipërisë/Raporte Vjetore/ Raporti Vjetor 2012/ www.alphabank.al
4. Banka Credins/Publikime/Raport Vjetor 2009/ www.bankacredins.al
5. Banka Credins/Publikime/Raport Vjetor 2010/ www.bankacredins.al
6. Banka Credins/Publikime/Raport Vjetor 2011/ www.bankacredins.al
7. Banka Credins/Publikime/Raport Vjetor 2012/ www.bankacredins.al
8. Banka e Shqipërisë/Publikime /Raporti Vjetor 2005/ www.bankofalbania.al
9. Banka e Shqipërisë/Publikime /Raporti Vjetor 2006/www.bankofalbania.al
10. Banka e Shqipërisë/Publikime /Raporti Vjetor 2007/www.bankofalbania.al
11. Banka e Shqipërisë/Publikime /Raporti Vjetor 2008/www.bankofalbania.al
12. Banka e Shqipërisë/Publikime /Raporti Vjetor 2009/www.bankofalbania.al
13. Banka e Shqipërisë/Publikime /Raporti Vjetor 2010/www.bankofalbania.al
14. Banka e Shqipërisë/Publikime /Raporti Vjetor 2011/ www.bankofalbania.al
15. Banka e Shqipërisë/Publikime /Raporti Vjetor 2012/ www.bankofalbania.al

16. Banka Intesa SanPaolo/Publikime/Raport Vjetor 2009/ www.intesasanpaolobank.al
17. Banka Intesa SanPaolo/Publikime/Raport Vjetor 2010/ www.intesasanpaolobank.al
18. Banka Intesa SanPaolo/Publikime/Raport Vjetor 2011/ www.intesasanpaolobank.al
19. Banka Intesa SanPaolo/Publikime/Raport Vjetor 2012/ www.intesasanpaolobank.al
20. Banka Kombëtare Tregtare /Treguesit Financiare /Raporti Vjetor 2009/www.bkt.al
21. Banka Kombëtare Tregtare /Treguesit Financiare /Raporti Vjetor 2010/www.bkt.al
22. Banka Kombëtare Tregtare /Treguesit Financiare /Raporti Vjetor 2011/www.bkt.al
23. Banka Kombëtare Tregtare /Treguesit Financiare /Raporti Vjetor 2012/www.bkt.al
24. Procredit Bank/Raporte Financiare/Raport vjetor 2009/ www.procreditbank.com.al
25. Procredit Bank/Raporte Financiare/Raport vjetor 2010/ www.procreditbank.com.al
26. Procredit Bank/Raporte Financiare/Raport vjetor 2011/ www.procreditbank.com.al
27. Procredit Bank/Raporte Financiare/Raport vjetor 2012/ www.procreditbank.com.al
28. Raiffeisen Bank e Shqipërisë, Raporti Vjetor 2009, www.raiffeisenbank.al
29. Raiffeisen Bank e Shqipërisë, Raporti Vjetor 2010, www.raiffeisenbank.al
30. Raiffeisen Bank e Shqipërisë, Raporti Vjetor 2011, www.raiffeisenbank.al
31. Raiffeisen Bank e Shqipërisë, Raporti Vjetor 2012, www.raiffeisenbank.al

SHTOJCA A

Llogaritja e Mesatares, Shmangies Standarte, Vlerës Minimum dhe Maksimum për Variablat e Përzgjedhur për Secilën Bankë

Mesatarja, devijimi standart, minimumi, maksimumi për variablat e zgjedhur për bankën BKT

BKT	X1	X2	X3	X4	X5	X6	X7	X8	X9	X10
6-M I 2009	0.003754	0.018066	0.054172	0.008215	0.41371	0.121905	13.4296	0.151655	0.588181	0.147159
6-M II 2009	0.009734	0.032253	0.137779	0.021285	0.436424	0.11861	13.15477	0.154488	0.577954	0.141354
6-M I 2010	0.010331	0.031351	0.115248	0.022025	0.448651	0.13608	10.15528	0.19111	0.579184	0.139294
6-M II 2010	0.015306	0.042099	0.19384	0.030871	0.451066	0.135884	11.66456	0.159259	0.494195	0.209439
6-M I 2011	0.010728	0.03236	0.122326	0.023128	0.524169	0.122917	10.40286	0.189067	0.585066	0.175602
6-M II 2011	0.015775	0.040364	0.212896	0.033909	0.511286	0.117924	12.49615	0.159276	0.48185	0.182305
6-M I 2012	0.00861	0.024655	0.095115	0.018722	0.46984	0.105241	10.0471	0.196835	0.701131	0.198972
6-M II 2012	0.013218	0.034749	0.167632	0.02685	0.492099	0.115104	11.68186	0.160172	0.499051	0.212807
Mesatarja	0.010932	0.031987	0.137376	0.023126	0.468405	0.121708	11.62902	0.170233	0.563326	0.175866
Dev Stand	0.003902	0.007821	0.052416	0.007896	0.038204	0.010335	1.336511	0.018643	0.071808	0.030284
Min	0.003754	0.018066	0.054172	0.008215	0.41371	0.105241	10.0471	0.151655	0.48185	0.139294
Max	0.015775	0.042099	0.212896	0.033909	0.524169	0.13608	13.4296	0.196835	0.701131	0.212807

Mesatarja, devijimi standart, minimumi, maksimumi për variablat e zgjedhur për bankën Credins

CREDINS	X1	X2	X3	X4	X5	X6	X7	X8	X9	X10
6-M I 2009	0.003373	0.013441	0.051816	0.004712	0.736736	0.214984	14.36002	0.09094	0.607349	0.079521
6-M II 2009	0.010586	0.05228	0.140641	0.014715	0.665651	0.249253	12.28621	0.104631	0.530271	0.102034
6-M I 2010	0.002527	0.012923	0.035696	0.003607	0.643967	0.190612	15.12654	0.101044	0.555858	0.130879
6-M II 2010	0.009397	0.059295	0.123895	0.014684	0.624238	0.252219	12.18402	0.118517	0.455429	0.15
6-M I 2011	0.0069	0.054309	0.092728	0.009559	0.728586	0.174506	12.43809	0.103092	0.620556	0.200822
6-M II 2011	0.019654	0.064604	0.217071	0.026254	0.784415	0.187242	10.03779	0.120948	0.512026	0.18
6-M I 2012	0.015839	0.089113	0.15337	0.022344	0.809136	0.14347	8.683299	0.145688	0.247203	0.204143
6-M II 2012	0.007286	0.067506	0.075619	0.009521	0.768896	0.159783	9.378477	0.125901	0.380526	0.2113
Mesatarja	0.009445	0.051684	0.111354	0.013175	0.720203	0.196509	11.8118	0.113845	0.488652	0.157337
Dev Stand	0.005883	0.026317	0.059581	0.008012	0.068394	0.03963	2.301939	0.017405	0.125	0.049821
Min	0.002527	0.012923	0.035696	0.003607	0.624238	0.14347	8.683299	0.09094	0.247203	0.079521
Max	0.019654	0.089113	0.217071	0.026254	0.809136	0.252219	15.12654	0.145688	0.620556	0.2113

Mesatarja, devijimi standart, minimumi, maksimumi për variablat e zgjedhur
për bankën Intesa San Paolo

INTESA	X1	X2	X3	X4	X5	X6	X7	X8	X9	X10
6-M I 2009	0.004957	0.014499	0.058054	0.011803	0.524094	0.072891	10.71061	0.203316	0.564212	0.0682
6-M II 2009	0.014147	0.041088	0.147232	0.028368	0.548008	0.059466	9.407169	0.192676	0.469373	0.07215
6-M I 2010	0.007756	0.019011	0.079996	0.013373	0.493774	0.107203	9.31382	0.167168	0.474613	0.112
6-M II 2010	0.017975	0.045523	0.170573	0.035067	0.520188	0.101941	8.489239	0.205584	0.429275	0.123219
6-M I 2011	0.010233	0.023107	0.096154	0.019308	0.480534	0.083479	8.396208	0.200804	0.479286	0.0968
6-M II 2011	0.019121	0.042221	0.169466	0.038785	0.421365	0.082244	7.862748	0.228868	0.402655	0.218
6-M I 2012	0.00661	0.048053	0.057793	0.012107	0.459669	0.10811	7.742776	0.209487	0.47948	0.289
6-M II 2012	0.00614	0.046554	0.047189	0.011495	0.397036	0.160851	6.685033	0.243585	0.391293	0.315
Mesatarja	0.010868	0.035007	0.103307	0.021288	0.480583	0.097023	8.57595	0.206436	0.461273	0.161796
Dev Stand	0.00554	0.013738	0.051678	0.01123	0.052244	0.030983	1.231164	0.022885	0.05458	0.098416
Min	0.004957	0.014499	0.047189	0.011495	0.397036	0.059466	6.685033	0.167168	0.391293	0.0682
Max	0.019121	0.048053	0.170573	0.038785	0.548008	0.160851	10.71061	0.243585	0.564212	0.315

Mesatarja, devijimi standart, minimumi, maksimumi për variablat e zgjedhur
për bankën Raiffeisen

Raiffeisen	X1	X2	X3	X4	X5	X6	X7	X8	X9	X10
6-M I 2009	0.006048	0.023817	0.07828	0.015119	0.40402	0.11461	11.94419	0.193137	0.487734	0.110404
6-M II 2009	0.018538	0.049416	0.203803	0.045054	0.387797	0.099151	9.354062	0.234677	0.590133	0.12477
6-M I 2010	0.019285	0.035381	0.140805	0.029676	0.425075	0.155884	9.257509	0.210762	0.582347	0.161911
6-M II 2010	0.019285	0.051542	0.194346	0.0411	0.395505	0.155849	9.074963	0.211478	0.541906	0.17125
6-M I 2011	0.009783	0.02006	0.111057	0.022048	0.400063	0.148203	10.35218	0.198532	0.646505	0.160814
6-M II 2011	0.021946	0.045715	0.111057	0.048336	0.425088	0.180025	9.980631	0.200529	0.577728	0.146971
6-M I 2012	0.0106	0.028049	0.112701	0.025029	0.465659	0.294982	9.632255	0.222086	0.59166	0.163971
6-M II 2012	0.016636	0.043665	0.112701	0.037115	0.43507	0.297586	9.295478	0.216621	0.626464	0.185846
Mesatarja	0.015265	0.037206	0.133094	0.032935	0.417285	0.180786	9.861409	0.210978	0.58056	0.153242
Dev Stand	0.005686	0.012125	0.044108	0.011816	0.025619	0.075622	0.941611	0.013625	0.048979	0.024842
Min	0.006048	0.02006	0.07828	0.015119	0.387797	0.099151	9.074963	0.193137	0.487734	0.110404
Max	0.021946	0.051542	0.203803	0.048336	0.465659	0.297586	11.94419	0.234677	0.646505	0.185846

Mesatarja, devijimi standart, minimumi, maksimumi për variablat e zgjedhur
për bankën Alpha

Alpha Bank	X1	X2	X3	X4	X5	X6	X7	X8	X9	X10
6-M I 2009	0.0042	0.022343	0.03989	0.004784	0.883873	0.155841	8.496989	0.119928	0.624173	0.06119
6-M II 2009	0.013748	0.041393	0.113436	0.015802	0.828926	0.1418	7.251197	0.139304	0.53571	0.096054
6-M I 2010	-0.001304	0.021621	-0.113664	-0.017291	0.834853	0.122297	7.715498	0.152128	0.604856	0.123745
6-M II 2010	-0.00284	0.034896	-0.02437	-0.00618	0.852473	0.132943	7.593599	0.253686	0.630803	0.16562
6-M I 2011	-0.003853	0.033875	-0.033808	-0.008814	0.799558	0.124414	7.775232	0.260716	0.607119	0.221131
6-M II 2011	-0.00794	0.035288	-0.0615	-0.01764	0.710173	0.115689	6.748863	0.28678	0.603066	0.34593
6-M I 2012	-0.00426	0.0283	-0.032865	-0.008189	0.652175	0.118013	6.7144	0.249175	0.482171	0.380383
6-M II 2012	-0.00794	0.029174	-0.12677	-0.01557	0.535252	0.116271	13.83628	0.122838	0.627742	0.441752
Mesatarja	-0.001274	0.030861	-0.029956	-0.006637	0.76216	0.128409	8.266507	0.198069	0.589455	0.229476
Dev Stand	0.007196	0.006795	0.078257	0.011684	0.11976	0.014257	2.324294	0.070538	0.052798	0.14285
Min	-0.00794	0.021621	-0.12677	-0.01764	0.535252	0.115689	6.7144	0.119928	0.482171	0.06119
Max	0.013748	0.041393	0.113436	0.015802	0.883873	0.155841	13.83628	0.28678	0.630803	0.441752

Mesatarja, devijimi standart, minimumi, maksimumi për variablat e zgjedhur
për bankën Pro Credit

Procredit	X1	X2	X3	X4	X5	X6	X7	X8	X9	X10
6-M I 2009	0.000979	0.012683	0.011008	0.001399	0.688823	0.147999	10.23932	0.127105	0.557412	0.059
6-M II 2009	0.004773	0.057673	0.064696	0.007414	0.70499	0.146598	12.55342	0.114604	0.633448	0.050267
6-M I 2010	-0.004663	0.030982	-0.053382	-0.00683	0.599391	0.130845	10.44781	0.1279	0.965546	0.133019
6-M II 2010	0.00257	0.06064	0.025437	0.003388	0.668737	0.125486	8.898964	0.1332	0.61338	0.148277
6-M I 2011	0.004202	0.043465	0.038838	0.005257	0.679811	0.150726	8.242363	0.135358	0.418838	0.163269
6-M II 2011	0.007057	0.075405	0.007057	0.008596	0.752107	0.155593	8.132334	0.133381	0.527064	0.162104
6-M I 2012	-0.00023	0.047716	-0.002176	-0.00031	0.731115	0.196328	8.458419	0.142471	0.464369	0.216424
6-M II 2012	0.001496	0.079173	0.013504	0.001951	0.710498	0.235394	8.024773	0.144463	0.538492	0.22209
Mesatarja	0.002023	0.050967	0.013123	0.002608	0.691934	0.161121	9.374675	0.13231	0.589819	0.144306
Dev Stand	0.003568	0.022243	0.034166	0.004871	0.046183	0.03677	1.590923	0.009428	0.167428	0.063461
Min	-0.004663	0.012683	-0.053382	-0.00683	0.599391	0.125486	8.024773	0.114604	0.418838	0.050267
Max	0.007057	0.079173	0.064696	0.008596	0.752107	0.235394	12.55342	0.144463	0.965546	0.22209

SHTOJCA B


LLogaritjet për metodën mesatare shumëpërmasore

X1	X2	X3	X4	X5	X6	X8	X9	X10	X7	MSHP
47.66078	45.59888	69.40703	56.98855	70.10899	82.5953	88.1821	107.8213	86.39271	135.3805	79.01362
123.575	81.40791	176.5266	147.6484	73.95826	80.36289	89.82957	105.9467	82.98491	132.61	109.485
131.1569	79.13175	147.6589	152.7818	76.03028	92.19943	111.1242	106.1723	81.77574	102.3728	108.0404
194.3126	106.2596	248.3536	214.144	76.43956	92.0667	92.60375	90.59254	122.9557	117.5875	135.5316
136.19	81.67821	156.7283	160.432	88.82782	83.28085	109.9361	107.2504	103.0908	104.8687	113.2283
200.2666	101.8804	272.7687	235.2178	86.64469	79.8981	92.61363	88.32954	107.0261	125.9706	139.0616
109.3049	62.2314	121.8642	129.869	79.62102	71.30496	114.4527	128.5266	116.8106	101.2823	103.5268
167.805	87.70792	214.7751	186.2514	83.39318	77.98744	93.13463	91.48271	124.9329	117.7619	124.5232
42.82608	33.92637	66.38771	32.68674	124.8504	145.6603	52.87866	111.3352	46.68475	144.7598	80.1996
134.3913	131.9569	180.1935	102.0741	112.804	168.8786	60.8394	97.20575	59.90125	123.8542	117.2099
32.07896	32.61847	45.73459	25.01984	109.1293	129.1469	58.75378	101.8962	76.83528	152.4869	76.37002
119.2967	149.663	158.738	101.859	105.786	170.8882	68.91365	83.48622	88.06073	122.8241	116.9516
87.6015	137.0771	118.8057	66.31167	123.4693	118.2347	59.94449	113.7563	117.8966	125.3853	106.8483
249.5112	163.0632	278.1179	182.1171	132.9303	126.8637	70.32719	93.8612	105.6729	101.1885	150.3653
201.0738	224.9248	196.5019	154.9952	137.1196	97.20674	84.71259	45.31553	119.8465	87.53418	134.9231
92.49714	170.3879	96.88533	66.04467	130.3004	108.2592	73.20719	69.7555	124.0482	94.5421	102.5928
62.93538	36.59641	74.38109	81.87701	88.8152	49.38651	118.2214	103.4276	40.03828	107.971	76.36498
179.5988	103.7078	188.6381	196.7814	92.86776	40.29053	112.0346	86.04234	42.35721	94.83134	113.715
98.46642	47.98503	102.4933	92.76332	83.67701	72.63392	97.20241	87.00289	65.75201	93.89031	84.18666
228.196	114.9019	218.5432	243.2506	88.15326	69.06899	119.5402	78.69184	72.33836	85.57791	131.8262
129.9135	58.32409	123.1955	133.9351	81.43326	56.56021	116.7605	87.85946	56.82852	84.64009	92.94503
242.7447	106.5676	217.1249	269.0413	71.4063	55.72351	133.079	73.81204	127.9816	79.26241	137.6743
83.91989	121.2871	74.04615	83.98245	77.89753	73.24898	121.8099	87.89509	169.6637	78.053	97.18038
77.94846	117.5042	60.45996	79.73779	67.2834	108.9828	141.6365	71.72923	184.9275	67.39016	97.76
76.77441	60.11489	100.295	104.8752	68.467	77.6528	112.3026	89.40815	64.81483	120.4064	87.51113
235.3447	124.728	261.1184	312.5305	65.71772	67.17839	136.457	108.1793	73.24897	94.29597	147.8799
244.8296	89.30203	180.4033	205.8569	72.03505	105.6178	122.5511	106.7519	95.05335	93.32265	131.5724
244.8267	130.0941	249.0019	285.0999	67.02395	105.5938	122.9673	99.33861	100.536	91.48245	149.5965
124.1955	50.63222	142.2897	152.9441	67.79636	100.4136	115.4398	118.5131	94.4093	104.3578	107.0991
278.6086	115.3866	142.2896	335.2941	72.03721	121.9739	116.6009	105.9053	86.28249	100.6123	147.4991
134.5627	70.79782	144.3964	173.6224	78.9126	199.8621	129.1355	108.4592	96.26296	97.10037	123.3112
211.2026	110.2126	144.3964	257.4541	73.72887	201.6258	125.9576	114.8392	109.1049	93.70541	144.2227
53.32347	56.39471	51.10842	33.18486	149.7849	105.5886	69.73393	114.4192	35.92315	85.65603	75.51173
174.5335	104.4776	145.3376	109.6143	140.4733	96.07502	81.00059	98.2028	56.39057	73.09752	107.9203
-16.55706	54.57127	-145.6297	-119.9431	141.4778	82.86114	88.45758	110.8782	72.64725	77.77802	34.65414
-36.05434	88.07895	-31.22357	-42.86903	144.4637	90.07406	147.5099	115.6346	97.23078	76.54919	64.93942
-48.91075	85.50211	-43.31595	-61.14248	135.4964	84.29513	151.5977	111.2931	129.82	78.38019	62.30153
-100.7998	89.06838	-78.79564	-122.364	120.3489	78.3838	166.7529	110.5501	203.0856	68.03361	53.42638
-54.08404	71.43075	-42.10711	-56.80494	110.5204	79.95836	144.8867	88.38842	223.3118	67.6862	63.31866
-100.7998	73.63639	-162.4215	-108.005	90.70607	78.77813	71.42616	115.0735	259.34	139.4801	45.7214
12.43329	32.01201	14.10314	9.705258	116.7309	100.2754	73.90718	102.181	34.63722	103.22	59.92055
60.59413	145.569	82.89045	51.42897	119.4706	99.32585	66.63837	116.1195	29.51032	126.5479	89.80951
-59.19766	78.1993	-68.39398	-47.37653	101.5754	88.65254	74.36955	176.9975	78.09159	105.3218	52.82394
32.62663	153.0579	32.59065	23.50166	113.327	85.02165	77.45132	112.4407	87.0492	89.70825	80.6775
53.34696	109.7074	49.75997	36.46629	115.2037	102.1229	78.70605	76.77853	95.85041	83.08921	80.10314
89.58995	190.3253	9.04164	59.62819	127.4552	105.4203	77.55656	96.61787	95.16664	81.98004	93.27818
-2.921163	120.4372	-2.787828	-2.150388	123.8978	133.0202	82.84203	85.1251	127.0565	85.26723	74.97867
18.992	199.8359	17.30173	13.53357	120.404	159.4886	84.00037	98.71277	130.3827	80.89575	92.35474
99.99441	99.99918	99.99955	99.99782	100	99.99978	99.99973	100	100.0002	100	99.99907

SHTOJCA C

Testet e Vlefshmërisë së Modelit dhe Vlerat e Parashikuara të Normës së NPL-së

TESTI I NORMALITETIT



TESTI HETEROSIT

Ëhite Heteroskedasticity Test:

F-statistic	1.577207	Probability	0.138457
Obs*R-squared	19.24230	Probability	0.155896

Test Equation:

Dependent Variable: RESID^2

Method: Least Squares

Sample: 1 48

Included observations: 48

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-0.009033	0.014136	-0.639023	0.5272
X1	-0.285951	0.152851	-1.870780	0.0703
X1^2	7.041571	6.898491	1.020741	0.3148
X2	0.232198	0.081743	2.840583	0.0077
X2^2	-2.252744	0.938083	-2.401434	0.0221
X5	-0.033910	0.029742	-1.140141	0.2624
X5^2	0.023251	0.024156	0.962540	0.3428

X8	0.123735	0.090738	1.363658	0.1819
X8^2	-0.365171	0.237703	-1.536247	0.1340
X9	0.030560	0.017313	1.765200	0.0868
X9^2	-0.026541	0.013720	-1.934382	0.0617
D2	0.004093	0.001524	2.684756	0.0113
D3	-0.000122	0.001104	-0.110890	0.9124
D4	-0.000116	0.001291	-0.089688	0.9291
D5	-0.000420	0.001903	-0.220851	0.8266
R-squared	0.400881	Mean dependent var		0.001823
Adjusted R-squared	0.146710	S.D. dependent var		0.002143
S.E. of regression	0.001979	Akaike info criterion		-9.361853
Sum squared resid	0.000129	Schwarz criterion		-8.777103
Log likelihood	239.6845	F-statistic		1.577207
Durbin-Watson stat	2.313538	Prob(F-statistic)		0.138457

TEST LM

Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test:

F-statistic	1.174193	Probability	0.320625
Obs*R-squared	2.939434	Probability	0.229991

Test Equation:

Dependent Variable: RESID

Method: Least Squares

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-0.010330	0.094999	-0.108737	0.9140
X1	-0.025717	1.402794	-0.018333	0.9855
X2	-0.148603	0.537386	-0.276529	0.7837
X5	0.000459	0.091069	0.005037	0.9960
X8	0.009523	0.238978	0.039847	0.9684
X9	0.024532	0.092974	0.263862	0.7934
D2	0.005268	0.025500	0.206599	0.8375
D3	0.001256	0.026370	0.047621	0.9623
D4	0.000428	0.030093	0.014209	0.9887
D5	-0.001509	0.032568	-0.046345	0.9633
RESID(-1)	0.252256	0.179839	1.402676	0.1693
RESID(-2)	-0.148754	0.189308	-0.785777	0.4371
R-squared	0.061238	Mean dependent var		1.41E-17
Adjusted R-squared	-0.225606	S.D. dependent var		0.043148
S.E. of regression	0.047768	Akaike info criterion		-3.032598
Sum squared resid	0.082145	Schwarz criterion		-2.564798
Log likelihood	84.78236	F-statistic		0.213490
Durbin-Watson stat	1.967004	Prob(F-statistic)		0.995437

TEST RESET

Ramsey RESET Test:

F-statistic	7.280810	Probability	0.002211
Log likelihood ratio	16.30434	Probability	0.000288

Test Equation:

Dependent Variable: X10

Method: Least Squares

Sample: 1 48

Included observations: 48

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	1.028172	0.558097	1.842282	0.0737
X1	-14.07978	8.594836	-1.638168	0.1101
X2	6.866701	3.690270	1.860758	0.0710
X5	-1.357501	0.780696	-1.738835	0.0906
X8	1.124193	0.548345	2.050157	0.0477
X9	-0.391358	0.236454	-1.655111	0.1066
D2	0.161299	0.098114	1.643995	0.1089
D3	-0.141357	0.071305	-1.982422	0.0551
D4	-0.155566	0.081689	-1.904361	0.0649
D5	0.297555	0.193045	1.541381	0.1320
FITTED^2	-12.86169	7.541752	-1.705398	0.0967
FITTED^3	27.40463	12.42278	2.205999	0.0339

R-squared	0.795641	Mean dependent var	0.170337
Adjusted R-squared	0.733198	S.D. dependent var	0.080539
S.E. of regression	0.041601	Akaike info criterion	-3.309079
Sum squared resid	0.062302	Schwarz criterion	-2.841279
Log likelihood	91.41789	F-statistic	12.74185
	1.752398	Prob(F-statistic)	0.000000

Durbin-Watson stat